Asllan Muharremi

Ëndrra lirie

(***Kujtime 1978–1999)***

...Tani Hefest, ti duhet të zbatosh
Atë që do yt atë: e mbërthe
Këtë rebel mbi shkëmbin e thepisur,
Aty shpejt lidhe me vargonj të fortë
E të pathyeshëm. Ai ta vodhi zjarrin,
Burimin e çdo mjeshtërie, stolinë tënde
Për një mëkat të tillë atë hyjnitë
Do ta ndëshkojnë rreptë: të mësojë
Si tiranisë së Zeusit t'i përulet
Dhe dashurinë për njeriun ta harrojë!

ESKILI "Prometeu i mbërthyer"

PARATHËNIE

Jam i lindur dhe rritur në një familje që brez pas brezi e ka derdhur gjakun për çlirimin e Shqipërisë. Gjyshi dhe xhaxhai i tim atë, me pushkë në dorë, kanë luftuar kundër pushtuesve turq dhe serbë.

Edhe unë bëra përpjekje të ecë gjurmëve të stërgjyshërve dhe të vë një gur në murin e kështjellës që i vuri themelet Gjergj Kastrioti.

Në prag të njëqindvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u vura në kontakt me veprimtarë të organizatës "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVShJ)."

Në nëntor të vitit 1979, për shkak të zbulimit të veprimtarisë së LNÇKVShJ-së, jam arrestuar dhe përballur me Shërbimin e Sigurimit Shtetëror Jugosllav, kësaj vegle të regjimit antipopullor dhe antishqiptar të Jugosllavisë së Titos.

Me shpërthimin e demonstratave të pranverës së vitit 1981, së bashku me shokët e Organizatës sime politike, jemi bërë pjesë e zërit dhe vullnetit të popullit shqiptar të Kosovës dhe me gjithë fuqinë tonë e kemi mbështetur kërkesën që Kosovës t'i njihej statusi i Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave.

Ashtu si edhe shumë të tjerë, në prill të vitit 1981, jam arrestuar dhe mbajtur në burg (autoritetet jugosllave e quanin "qëndrim në vend të caktuar") me vendim të Sekretariatit Krahinor të Punëve të Brendshme.

Në dhjetor të vitit 1981, ia kam përcjell lajmin Jusuf Gërvallës se do ta prisnim "Zërin e Kosovës" në Bled të Sllovenisë, ashtu siç ishte pajtuar me me te, Xhafer Durmishi, i cili ato ditë, me porosi të tij, kishte ardhur në Kosovë.

Me 7 prill 1983, UDB-a dhe një grusht policë, ma rrethoi shtëpinë, por nuk më arrestoi dot! U"hap toka"e më "futi në gjirin" e saj dhe sapo policia u larguan nga oborri i shtëpisë unë mora bekimin e nënës: ***le të piqen pemët kur të kesh ardhur serish****...*[1]

Që nga 7 prilli 1983, unë që kisha fajësinë e Prometeut, bëra jetën e gurit, që rrokulliset e nuk gjen vend! Disa muaj pas rrethimit të shtëpisë, bëra jetë ilegali në Kosovë. Ilegal isha edhe në Turqi, Bullgari, Rumani, Hungari, Austri,

Gjermani, Zvicër(gjersa e kam shtruar kërkesën për strehim politik), Francë, Danimarkë dhe Suedi(gjithashtu gjersa e kam shtruar kërkesën për strehim politik).

Që në javët e para të vendosjes sime, të përkohshme, në Munih, nisi përplasja në mes të udhëheqjes së "Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi". Kjo ishte sfida ime e parë e përballjes me një realitet të ri, që e gjeta në emigracionin tonë politik dhe që ishte i panjohur për mua.

Verën e vitit 1987, për herë të parë, e kam vizituar Shqipërinë. Vizita përmbysi shumë nga ëndrrat dhe pritjet që kisha për Shqipërinë, por nuk i mori me vete ëndrrat e lirisë dhe idealet për një bote të re dhe të drejtë.

Lufta për liri, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, më gjeti dymijë kilometra larg atdheut, megjithëkëtë, me mendje e zemër isha përkrah luftës nacionalçlirimtare të popullit tim.

Kosovën e lirë, e kam vizituar për herë të parë pas çlirimit të saj. Fshatin tim të lindjes dhe Kosovën në përgjithësi, e gjeta të djegur dhe më ma shumë plagë, por të lirë e pa policë dhe ushtarë serbë.

Për herë të parë, pas rreth shtatëmbëdhjetë vjetësh, jam takuar me shumicën e personazheve të këtij libri kujtimesh. Vetën e vitit 1999, edhe familja ime, bënte jetë refugjati, brenda territorit të Kosovës. Shokët kishin zbritur nga malet dhe kishin rinisur ndërtimin e Kosovës së lirë.

Autori

Kontaktet e para me Lëvizjen

Një ditë të bukur pranvere isha në ushtrimet e boksit të cilat i zhvilloja në Klubin e Boksit "Trepça" në Mitrovicë. Kalova nëpër *Malin e Hajdar Agës,* u rashë fund e krye *Livadheve të Kosovës* dhe arrita në Stacionin Hekurudhor në Mihaliq. Pas një pritjeje të shkurtër, e pashë lokomotivën e trenit duke kaluar, tejpërtej, nëpër Urën e Frengut dhe duke lënë pas vete një tym të bardhë e të zi, në qiellin e kaltër.

E prisja se treni i orës pesëmbëdhjetë, sidomos ai ditëve të punës, do të ishte i stërmbushur me udhëtarë, të cilët, kryesisht, ishin punëtorë të Termocentralit "Kosova" në Obiliq. Prandaj sapo treni u ndal në stacion, u ngjita, me shpejtësi shkallëve përpjetë, hyra brenda në vagon dhe nisa kërkimin e një vendi të lirë. Në kërkim e sipër e pashë Asllan Avdiun nga fshati Ashlan i Komunës së Vushtrrisë, të cilin e njihja prej kohësh dhe e kisha shok pune të tim atë. Asllani na kishte vizituar dy-tre herë në shtëpinë tonë dhe unë e mbaja mend se e kisha vizituar njëherë në shtëpinë të tij. Pranë tij, qëndronte i ulur, një burrë i panjohur, i rreth të tridhjetave, të cilin po e shihja për herë të parë.

Sapo më pa dhe ende pa arritur ta pyesja se a ishte vendi i lirë, Asllani ma preku krahun me dorë dhe e drejtoi dorën e djathtë drejtë vendit të lirë, përballë tij; ai na prezantoi, me njëri-tjetrin, mua dhe shokun e tij, Ramadan Pllana, i cili ishte nga fshati Shtitaricë dhe studionte në Fakultetin Filozofik-Dega e Gjuhës Frënge.

Pas prezantimit, Ramadan Pllana, më tha fjalë miradije për gjyshin e tim atë– Beh Mihaliqi. Ai më bëri edhe shumë pyetje për kohën e lirë, librat që kisha lexuar dhe radiostacionet që i dëgjoja!

Çuditërisht, koha iku shumë shpejtë dhe treni nisi ta ngadalësonte shpejtësinë. Pas pak, treni u ndal në Stacionin e Hekurudhor në Vushtrri. Asllani e Ramadani, u ngritën në këmbë dhe po bëheshin gati ta linin vagonin. Para se të përshëndeteshin me mua, Ramadani më tha:

– Qenke djalë i mirë, por sportin e paske të keq!

I shtrënguam duart me njëri-tjetrin, u përshëndetem dhe ata e lanë vagonin.

I habitur nga vlerësimi i shokut të Asllanit, e hapa dritaren dhe po i përcillja me sy duke zbritur nga treni. Edhe ata e kthyen shikimin kah dritarja ku

ndodhesha unë. Ua bëra me dorë dhe ata ikën në drejtim të brendisë së fshatit Shtitaricë, që ishte ngulitur në kodrën përballë Stacionit Hekurudhor. Ndërsa unë, me shpejtësinë e trenit, ika në në drejtim të Mitrovicës.

Ndonëse nuk biseduam më shumë se pesëmbëdhjetë minuta, biseda me shokun e Asllan Avdiut më la mbresa të madhe, sidomos, na shtuan kureshtjen për te, pyetjet e tij, që ishin sa të papritura aq edhe interesante.

Kurreshtjen time, për ta njohur Ramadan Pllanën, e shtonte edhe fakti se Asllanin e dija për burrë të mirë, të urtë e patriot, dhe që shpeshherë, gjatë bisedave që kisha pasur me atë, e kisha dëgjuar duke folur me simpati për Shqipërinë.

Gjithë atë pasdite, mendja me ka vajtur tek vlerësimi që m'i patë bërë sportit të boksit, shoku i Asllanit, sidomos më rrinte në kokë thënia e tij: *"Qenke djalë i mirë, por sportin e paske të keq!"* Pas takimit, vetën time e kam pyetur shumë herë se përse vallë, Ramadan Pllana ma kritikoi sportin të cilin unë e adhuroja aq shumë dhe që më kishte bërë të ëndërroja se një ditë do të bëhesha një boksier i njohur si Mehmet Bogujevci, Nazif Gashi, Xhevdet Peci, Aziz Salihu e boksierë të tjerë? Mos vallë, me këtë, shoku i Asllanit donte të më thoshte se koha në të cilën jetojmë ka punë të tjera, madje edhe më të rëndësishme se boksi me të cilin merresha unë?!

Biseda në tren ishte shumë e shkurtër dhe unë nuk pata arritur t'i shpjegoja shokut të Asllanit se cilat libra i kisha lexuar dhe aq më pak t'i shpjegoja se cilat prej tyre më kishin pëlqyer më shumë. Biseda jonë, nuk ma dha as mundësinë as t'i tregoja Ramadan Pllanës se unë e dëgjoja Radio Tiranën përditë, madje edhe nga disa orë në ditë. Ndoshta, edhe Ramadan Pllana është dëgjues i Radio Tiranës,– e pyeta vetën time – ndonëse ai gjatë bisedës me mua, si me shaka, më pati thënë se ishte dëgjues i Radio Pekinit?

Pas takimit të parë, sa herë shkoja në shkollë, Ramadan Pllanën, e kam kërkuar nëpër vagonët e trenit, gjatë udhëtimeve më autobusë e sa herë kam kaluar pranë Fakultetit Filozofik. Disa herë, nga larg, udhëtarë e njerëz të ndryshëm, më janë dukur të ngjashëm me te, por kur jam afruar pranë tyre, më kanë zhgënjyer duke më dal njerëz të tjerë dhe të panjohur! Sikur ndjeja një etje për ta vazhduar bisedën me burrin flokë ngjyrë gështenje e pak kaçurrela dhe me një fytyrë babaxhane; ai të dëgjonte me vëmendje kur flisje.

Takimi im i parë me Ramadan Pllanën, ka ndodhur në një kohë interesante të jetës sime. Unë isha student i Fakultetit Ekonomik e njëkohësisht isha edhe dëgjues i rregullt i Radio Tiranës. Gjithashtu, isha edhe lexues i rregullt i "Rilindjes", i "Zërit të Rinisë" dhe i librit shqip. Në shkollë, dhe jashtë saj, shoqërohesha me një rreth shokësh, me të cilët, në mënyrë spontane flisnim për lirinë, për Shqipërinë, për Kosovën, për luftërat e Skënderbeut, Azem e Shote Galicës, Isa Boletinit, Shaban Polluzhës dhe të heronjve të tjerë. Për mua ajo ishte edhe një kohë kur në kokë më silleshin shumë pyetje, që lidheshin me lirinë dhe çlirimin e shqiptarëve nga zgjedha serbe.

Mirëpo, dorën në zemër, asokohe unë ende s'e dija se cila ishte rruga me të drejtë, që duhej ta ndiqja për të arritur në cak, ashtu siç nuk e kisha të qartë se çka mund të bëja unë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës? Në atë kohë, nganjëherë më dukej vetja sikur ndodhesha në një udhëkryq dhe s'kisha idenë se nga duhej t'ia mbaja!

Nga aq sa kisha dëgjuar e lexuar, e kisha të "qartë" se lufta për liri nuk mund të bëhej pa një organizatë politike. Deri diku, librat që i kisha lexuar, ma kishin kristalizuar idenë se çfarë duhej të ishte organizata dhe se nga ç'brumë duhej të krijohej ajo? Por, më duhet pranuar, gjithashtu, se tek unë e tek shokët e mi, me të cilët shoqërohesha, ende, pothuajse, gjithçka ishte në stadin e bisedave, që nganjëherë më dukeshin se ishin tepër të gjata dhe monotone! Nganjëherë, më shkonte mendja, se mua dhe shokëve të mi, na mungonte një dorë, që do të na ndihmonte ta braktisnim "kaosin" ku gjendeshim dhe ishim futur pa dëshirën tonë!

***

Në shtëpinë tonë, dy-tre herë në vit na vizitonin" bijat tona" e shtëpisë sonë (dada Nurie, Halë dhe Fazë). Dada Nurie, ishte e martuar në Abri të Drenicës, dada Halë në Hade të Obiliqit dhe dada Fazë në Cerrnushë të Shalës së Bajgorës. Më duhet ta them, pa pasur frikë se po e teproj, se ato, ishin mësueset e mia të para të historisë së lavdishme të familjes dhe popullit tonë! Jam rritur me rrëfimet e tyre për rrethimin, djegien e rrafshimin, me tokë, të kullës së Beh Mihaliqit nga ushtarët turq; me rrëfimet për luftimet, nga kulla, të burrave e grave dhe çarjen e rrethimit pas ardhjes së ndihmës së shokëve të Beh Mihaliqit; me rrëfimet për jetën nëpër bunker në malin e Qyqavicës, nëpër miq dhe shokë të Shaban Beh Mihaliqit dhe kushëririt të tij, Avdullah Mihaliqit; më rrëfimet për përcjelljen deri tek dera e oborrit, mbrëmjen e natës së vrasjes nga OZNA jugosllave, gjersa ishin duke fjetur në konakun e Gelajve të Mihaliqit; rrëfimet për konfiskimin nga Jugosllavia e Titos të disa dhjetëra hektarëve mal dhe dhënies së tyre kolonëve serbë dhe këngët e Zhuj Selmanit e Ahmet Delisë, të cilat dada Halë i këndonte me ëndje të madhe gjatë vizitave të saj!

Gjurmë të thella në jetën time kanë lënë edhe rrëfimet për rrugëtimin nëpër Bjeshkët e Nëmura të Sahit Hasanit (fqinjit tim), të Zenel Tërnavës (dhëndrit të mixhës Halim) dhe bacës Selim Sadikut. Baca Selim, ishte pushkatuar së bashku me mijëra shqiptarë në Tivar, por përkundër njëmbëdhjetë plagëve në trup, kishte shpëtuar i gjallë, të cilin fat nuk e kishin pasur vëllai i tij, Zeneli dhe kushëriri Ramadani, trupat e të cilëve ishin hedhur në det nga partizanët jugosllavë!

***

Nga leximi dhe rrëfimet e dëshmitarëve të kohës, e kisha kuptuar dhe mësuar, se shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi, që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e gjer në fillim të viteve të shtatëdhjeta, ishin përballur

me sfida shumë të mëdha, ashtu siç e kisha kuptuar se Jugosllavia e Titos, ishte vazhduese e denjë e përpjekjeve për jetësimin e memorandumeve dhe elaborateve të hartuara për shfarosjen e shqiptarëve; se në emër të luftës kundër nacionalizmit e irredentizmit shqiptar, Jugosllavia e Titos, kishte kryer krime të rënda kundër shqiptarëve. Gjithashtu, kisha dëgjuar se mijëra shqiptarë ishin vrarë nga partizanët jugosllavë, se mbi 250 mijë shqiptarë ishin detyruar të shpërngulen në Turqi, ashtu siç ishin rrahur me mijëra burra, gjatë aksionit famëkeq të armëve, që ishte udhëhequr nga ministri i Titos –Aleksandër Rankoviç.

Gjatë viteve të gjimnazit dhe sidomos gjatë vitit të parë të studimeve, kisha mësuar se Kosova dispononte pasuri të mëdha nëntokësore, se toka e saj pjellore ofronte mundësi të mëdha zhvillimi e përparimi, e, megjithatë, dallimi në mes Kosovës dhe republikave tjera të Federatës Jugosllave, ishte shumë i madh! Kosova, ndonëse ishte një vend me mundësi të mëdha zhvillimi, për shkak politikës diskriminuese dhe të mos investimeve në ngritjen e industrisë përpunuese, kishte shumë prapa republikave tjera. Industria e Kosovës ishte kryesisht një industri që merrej me nxjerrjen e mineraleve të nëntokës së saj dhe mineralet e saj përpunoheshin nëpër republikat tjera! Në popull nuk thuhej kot se "Trepça punon- Beogradi ndërton"! Populli e dinte se përkundër disa ndryshimeve pozitive, shqiptarët dhe vendi i tyre nuk ishte i lirë dhe i barabartë me republikat tjera, se shqiptarët vazhdonin të ishin nën kthetrat serbe.

Nga këndvështrimi im, gjendja ekonomike e Kosovës, pasqyrohej më së miri në gjendjen ekonomike e komunës së Vushtrrisë.

Vushtrria dhe 69 fshatrat e saj, përkundër ndryshimeve pozitive, vazhdonte të ishte një komunë e varfër. Vushtrria, që shtrihej në mes gjigantëve të industrisë së Kosovës – "Trepçës" dhe Termocentralit të Obiliqit – kishte një fabrikë të llamarinës, një fabrikë të ngjyrave dhe tekstilit, dhjetë-pesëmbëdhjetë kafene ku pihej çaji i rusit, një shtëpi kulture, një bibliotekë, një librari, një shkollë të mesme, një shkollë të mesme speciale (të policisë), një stacion të policisë dhe rrugë të mbushura me baltë dhe pisllëk. Ditëve të pazarit, Vushtrria të ngjante me qytetet e Indisë, ku njerëz, bagëti mblidheshin ditën e pazarit dhe defilonin nëpër qytet.

Ndërsa fshati Prelluzhë, fshat fqinj ky me fshatin tim, i banuar kryesisht me serbë, kishte rrugë të asfaltuara, shtëpi kulture, shtëpi shëndeti, disa shitore, fushë futbolli dhe një ndërmarrje bujqësore etj..

Për dallim nga fshati Prelluzhë, fshatrat shqiptare ishin pa rrugë të asfaltuara, pa ujësjellës, pa kanalizim, pa shkolla, pa shtëpi kulture dhe shtëpi shëndeti. Madje, ato përkundër faktit se dispononin sipërfaqe të madhe të kokës pjellore, nuk kishin asnjë kooperativë bujqësore!

Fshati Mihaliq, që përbëhej nga tri fshatra të vegjël, me gjithsej dyqind shtëpi, deri në vitin 1974, ishte pa energji elektrike, me rrugë të mbytura në baltë dhe me një shkollë katërvjeçare. Shtëpitë e ndërtuara me tulla dhe të rrethuara me mure ose avlli (gardhe thuprash lajthie ose fera) ishin si republika të pavarura të

mbretërisë së Kanunit të Lekë Dukagjinit! Nxënësit e Mihaliqit, pas shkollës katërvjeçare duhej ta vijonin shkollën fillore në Prelluzhë ose Druar, që gjendeshin rreth 5-6 kilometra larg. Rrugët e Mihaliqit, ishin po ato që kanë qenë tash e mijëra vjet më parë: të mbytura në baltë, deri në gju, e me puse, deri në brez.

Pasuria më e madhe e fshatit Mihaliqi ishte toka pjellore, e cila shtrihej në fushë të gjerë e të gjatë, në mes lumit Silnicë dhe hekurudhës Fushë Kosovë-Mitrovicë; po e punove si duhej ajo nuk të le asnjëherë pa bukë. Shpeshherë më është sjell vërdallë nëpër kokë ideja se po të punohej si duhet kjo sipërfaqe tokësore, fshatarët e Mihaliqit, nuk do të kishin nevojë të punonin në Termocentralin e Obiliqit e as të kërkonin punë nëpër qytetet tjera nëpër Kosovë dhe jashtë saj!

Në një gjendje të mjerueshme gjendej edhe arsimi shqip në Kosovë. Përkundër hapjes së Universitetit të Prishtinës dhe shkollave në gjuhën shqipe, numri i shqiptarëve që nuk dinin shkrim dhe lexim ishte shumë i lartë. Flitej dhe shkruhej se mbi 30 për qind e popullsisë nuk dinte shkrim e lexim, mirëpo dihej nga të gjithë se kjo përqindje, sidomos tek gjinia femërore, numri i analfabeteve ishte mbi 50 për qind. Gjithashtu, përfshirja e vajzave në shkollat e mesme dhe të larta ishte shumë e ultë. Nëpër fshatrat e Kosovës, një numër i madh i vajzave, e ndërprisnin shkollimin, madje edhe gjatë vijimit të ciklit të ultë të shkollës fillore, përkundër faktit se shkolla fillore ishte e obligueshme me ligj.

Shoqëria shqiptare, përkundër ndryshimeve kushtetuese të vitit 1974, hapjes Universitetit të Prishtinës dhe të shkollave të mesme në çdo qytet dhe qytezë të Kosovës, vazhdonte të ishte një shoqëri patriarkale ku ligjin e bënte kanuni i Lekë Dukagjinit, kleri fetar dhe pushteti titist. Kishte një bashkëpunim, të hapur e të fshehtë, në mes të pushtetit titist, të klerit mysliman dhe atij të krishterë. Ky bashkëpunim bëhej për ta mbajtur në prapambetje dhe errësirë shoqërinë shqiptare!

Vëllavrasja dhe gjakmarrja ndër shqiptarët ishte mjaftë e madhe dhe pushteti nuk bënte asgjë për çrrënjosjen e saj, ashtu siç nuk bënte asgjë për ta ndërprerë veprimtarinë obskurantiste të klerit mysliman, i cili bënte gjithçka për ta ruajtur pushtetin e tij të dikurshëm mbi familjen shqiptare, sidomos për të mos e përfshirë gruan shqiptare në shkollë dhe punë dhe duke e penguar në këtë mënyrë emancipimin e saj.

***

Ndonëse në një gjendje të rëndë dhe pa vullnetin e udhëheqjes titiste, qoftë asaj federative apo kosovare, në Kosovë kishte lindur dhe po rritej edhe një elitë e guximshme intelektuale shqiptare e cila me punën e saj të palodhshme e kishin shndërruar Universitetin e Prishtinës në një qendër të zhvillimit dhe përparimit, por edhe në bastion të qëndresës dhe përpjekjeve të shqiptarëve për liri. Në krye të kësaj elite ishin Ali Hadri, Anton Çeta, Dervish Rozhaja, Mark Krasniqi, Rexhep Qosja, Ukshin Hoti, Fehmi Agani e intelektual të tjerë të

shquar shqiptarë. Fara e hedhur në tokën dardane, nga elita intelektuale shqiptare, kishte mbirë e shëndetshme dhe po rritej me shpejtësi të jashtëzakonshme.

As një dekadë nuk kishte kaluar që nga hapja e Universitetit të Prishtinës e megjithatë nëpër fakultete të ndryshme studionin disa dhjetëra mijëra të rinj e të reja, që kishin ardhur nga të gjitha viset shqiptare në Jugosllavi. Universiteti i Prishtinës, pa edhe më të voglin dyshim, mund të thuhet se ishte boshti kurrizor edhe i luftës së shqiptarëve për liri dhe pavarësi nga Serbia.

Universiteti i Prishtinës dhe elita intelektuale që lindi në gjirin e tij, bëri një revolucion në shoqërinë shqiptare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nën Jugosllavi. Veç kësaj, Universiteti i Prishtinës bëri edhe një ndarje përfundimtare në mes pushtetit titist dhe popullit shqiptar. Fal shkollimit të shqiptarëve, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, Lidhja e Socialistëve Jugosllavisë, kishte ngelur me vetëm një turmë spiunësh matufë dhe pa gjakun e ri të rinisë shqiptare të Kosovës.

Udhëheqja e Kosovës, qoftë ajo që punonte në Kosovë, qoftë ajo që mbante poste në organet e Republikës së Serbisë dhe organet federative, ishte një udhëheqje që asnjëherë nuk kishte arritur të krijonte lidhje me popullin. As ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 nuk e kishin ndihmuar udhëheqjen titiste (shqiptare) të lëshonte rrënjë në popull. Si dukej, shkëputjet e bëra, qysh gjatë Luftës së Dytë Botërore, kishin qenë vendimtare në dështimin e këtyre përpjekjeve. Populli shqiptar i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare, që nuk mashtrohej lehtë nga pushtuesi serbo-sllavë, i mbante sytë tek bijtë e tij të shkolluar dhe të armatosur me dije në Universitetin e Prishtinës.

Udhëheqja titiste e Kosovës, e cila ishte e ndarë nga populli dhe ishte tërësisht në shërbim të Beogradit, bënte zhurmë për përfitimet që kishin marrë shqiptarët nga ndryshimet kushtetuese të vitit 1974, por nuk tregonte as vullnetin e as gatishmërinë më të vogël për të përfituar prej tyre e për ta çuar përpara dhe forcuar pozitën e shqiptarëve në Federatën Jugosllave; ajo nuk ishte e gatshme të rrezikonte interesat e saj për hir të interesave të popullit shqiptar, përkundrazi zbatonte vetëm urdhrat e padronëve të saj.

Se ç'lidhje kishte udhëheqja e shqiptare (titiste) e Kosovës me popullin shqiptar, unë e shihja më së miri nga vizitat e Fadil Hoxhës dhe udhëheqësve tjerë titist që i bënte fshatit tim.

Fshati Mihaliq ka disa qindra hektar pyje të pasur me drurë, por edhe me lepuj të egër. Menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore i gjithë pylli i fshatit është prerë rrafsh me tokë dhe druri është marrë nga shteti jugosllav. Dimër për dimër në fshatin tonë vinte personalisht Fadil Hoxha dhe disa shokë të tij nga Beogradi. Ai vinte në fshat me një suitë komunistësh jugosllavë dhe policë civilë dhe e braktisin fshatin me dhjetëra kuti të mbushura me lepuj. Para se të vinte dhe gjersa iknin funksionarët "popullor" fshati mbahej si në karantinë nga policia. Të gjithë gëzoheshim kur "mysafirët e paftuar" e thyenin qafën dhe iknin nga fshati!

Ringjallja e kontakteve me Shqipërinë

Qysh i vogël kam dëgjuar se përtej malit të Qyqavicës shtrihej Shqipëria. Mirëpo asnjëherë, gjatë fëmijërisë sime, s'e kam kuptuar se përse një vend duhej të shtrihej pas një mali, që e "prek" qiellin, ndërsa vendi ku kisha lindur e bërë hapat e parë të jetës, ndonëse frymonte shqip, rreth e rrotull tij, nuk quhej Shqipëri?

Nga dëshira për të mësuar për Shqipërinë, kam nisur t'i lexoja librat të cilat im atë na i kishte sjell në shtëpi. Qysh në klasën e gjashtë të shkollës fillore e kam lexuar librin e Marin Barletit "Historia e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut", ashtu siç kam lexuar edhe shumë shkrimtarë të periudhës së Rilindjes sonë Kombëtare.

Mirëpo, ndonëse gjatë leximit më kishte lindur edhe dëshira për ta vizituar Shqipërinë, nga prindërit e mi dhe të afërmit e familjes, kisha mësuar se vizita në Shqipëri ishte diçka që nuk ishte më shumë se një dëshirë apo ëndërr e parealizueshme! Ata më kishin thënë se Shqipëria ishte si një "mollë e ndaluar" për ne që jetonim në Kosovë dhe gjetiu në viset shqiptare në Jugosllavi!

Radio Tiranën e kam dëgjuar për herë të parë tek dajat në Hade. Pas kthimit nga vizita në Stamboll, im atë na e solli një transistor të cilin ia kishte dhuruar baca Selim. Nga kjo kohë, lidhja ime me Radio Tiranën u bë e përjetshme! Radio Tiranën e dëgjoja në mëngjes, para se të shkoja në shkollë, por edhe pas shkolle e deri natën vonë.

Si dëgjues i rregullt i Radio Tiranës dhe shikues i rregullt i Radiotelevizionit Shqiptar, unë kisha krijuar përfytyrimet e mia për vendin që propaganda jugosllave e quante Shqipëria e Enver Hoxhës. Shqipërinë e përfytyroja si një vend të lirë, ku mbretëronte barazia e demokracia e vërtetë. Ndërsa, udhëheqjen e Shqipërisë së re e përfytyroja si një udhëheqje të dal nga gjiri i popullit. Gjithçka që kisha lexuar dhe dëgjuar nga propaganda jugosllave për Shqipërinë, e konsideroja si propagandë antishqiptare, që gatuhej nga armiqtë e kombit shqiptar. Madje, edhe rrëfimet e disa të arratisurve nga Shqipëria, ashtu si edhe disa të arratisurve nga Kosova (pas kthimit të tyre të serishëm nga Shqipëria) i konsideroja si propagandë të spiunëve të UDB-ës jugosllave!

***

Për ndryshim nga vitet e pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, në fund të viteve të shtatëdhjeta, vëreheshin disa zhvillime pozitive në marrëdhëniet Kosova- Shqipëri. Një numër profesorësh nga Universiteti i Tiranës, mbante ligjërata në fakultete të ndryshme të Universitetit të Prishtinës. Kosovën e vizitonin shkrimtarë të shquar, grupe të ndryshme muzikore, trupa teatrale,

klube sportive, por edhe pjesëtarë të familjeve nga Shqipëria, që kishin pjesëtarë të familjes këndej kufirit, të vendosur arbitrarisht nga forca e Fuqive të Mëdha. Nga Shqipëria në Kosovë, gjithnjë e më shumë, lejoheshin libra të botuara në Tiranë (ndonëse në ndonjë libër që e kishte kaluar sitën e UDB-ës mund të gjeje, aty këtu, ndonjë rresht të fshirë me tush të zi). Unë dhe të gjithë njerëzit që kisha pranë meje u gëzoheshim këtyre zhvillimeve.

Mirëpo, përkundër këtyre hapave pozitiv, në marrëdhëniet Kosovë-Shqipëri, shihej se nga ana e shtetit jugosllav – që kontrollohej rreptësisht nga LKJ-ja dhe UDB-ja – bëheshin përpjekje maksimale që lëvizjet pozitive të ngadalësoheshin apo që ato të ngeleshin të kufizuara e sa për sy e faqe. Shqiptarët që dëshironin ta vizitonin Shqipërinë përballeshin me shumë telashe. Leja e udhëtimit për në Shqipëri shoqërohej me marrje në pyetje nga oficerët e UDB-ë, qoftë para udhëtimit për Shqipëri ose pas kthimit në Kosovë. Njerëzit shtrëngoheshin të mos flisnin për përshtypjet që u kishte lënë vizita. Për shkak të këtyre telasheve dhe për shkak të kontrollimit të rreptë të UDB-ës, numri i vizitorëve nga Kosova, ishte shumë i kufizuar.

Mirëpo, përkundër pasojave, për shumë të rinj dhe të reja, një shtrëngim duarsh apo një përqafim me njerëzit nga Shqipëria, madje edhe një duartrokitje entuziaste pas një koncerti muzikor apo pas një ndeshje sportive, përjetohej si një kënaqësi e madhe.

Kjo sjellje normale e të rinjve dhe të rejave, zgjonte "kureshtjen" e njerëzve të UDB-ës dhe vëzhgohej, hap pas hapi, prej saj. Pas shfaqjeve, ndeshjeve sportive apo vizitave të ndryshe, njerëzit ftoheshin në biseda informative e madje edhe burgoseshin dhe e gjithë kjo motivohej me shkeljen e edukatës e "vëllazërim-bashkimit" dhe "socializmit vetëqeverisës jugosllav".

Ndonëse, pasojat e një përqafimi, shtrëngimi duarsh apo edhe të një përshëndetje të vetme ishin të rënda, numri i pjesëmarrësve nëpër paraqitje të ndryshme të profesorëve, të këngëtarëve dhe të sportistëve, që vinin nga Shqipëria, sa vinte e shtohej. Si një "epidemi" përhapej lajmi dhe sallat mbusheshin me të rinj e të reja. Nëpër koncertet muzikore, së bashku me artistët nga Shqipëria, këndonte edhe publiku dhe duartrokitjet e tij nuk kishin të ndalur. Publiku kthehej në adhurues të "vizitorëve" nga Shqipëria. I gjithë shpirti liridashës, i gjithë pezmi, i gjithë zemërimi e mospajtimi i rinisë me padrejtësinë dhe pabarazinë, shpalosej para pushtuesit jugosllav, por edhe përpara vëllezërve që vinin nga shtetit shqiptar.

Isha pjesëmarrës i një ndeshje volejbolli, në mes reprezentacionit të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, në Palestrën e Sporteve në Prishtinë. Salle "25 Maji" ishte përplot me spektatorë të cilët qëndronin në këmbë dhe duartrokisnin për reprezentacionin e Shqipërisë. Sportistët e ekipit jugosllav dhe agjentët e UDB-ës kapnin kokën dhe sikur pyesnin: se vallë ku ishin duke luajtur, brenda apo jashtë vendi?!

Pas ndeshjes, policët u lëshuan si lukuni ujqish mbi spektatorët dhe arrestuan e përplasen burgjeve disa dhjetëra të rinj e të reja shqiptare, për mëkatin e prishjes së rendit dhe animin e publikut për ekipin e një vendi të "huaj".

Në prag të njëqindvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, shtypi i Kosovës, Radio Televizioni i Prishtinës, Trupa e Teatrit Popullorë të Prishtinës por edhe ato të rretheve të tjera të Kosovës dhe shoqëri muzikore po përkujtonin këtë ngjarje shumë të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar.

Aktiviteti i historianëve, gazetarëve, shkrimtarëve, shoqërive kulturore dhe të trupave teatrale për ta ndriçuar veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në kuadër të saj edhe të përpjekjeve të paraardhësve tanë për liri, vinte në shënjestër luftën e popullit shqiptar për heqjen qafe të Perandorisë Otomane, ambiciet e shteteve shoviniste fqinje, por edhe vendimet e padrejta të Fuqive të Mëdha gjatë Kongresit të Berlinit.

Ndërgjegjësimi i popullit, sidomos i rinisë studentore, që po bëhej në këto përpjekje, ishte një punë jashtëzakonisht e vlefshme, të cilën, unë dhe shokët e mi e çmonim shumë. Ne mendonim se inteligjenca shqiptare duke e ndërgjegjësuar popullin shqiptar, me këtë periudhë të lavdishme të historisë popullit tonë, po e armatoste atë me dije dhe po e përgatiste për betejat e ardhshme për liri dhe çlirim.

Një punë shumë të mirë në ndriçimin e veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit bënte edhe Radio Televizioni Shqiptar. RTSh-ja emitoi dramën *"Epoka para gjyqi*" të dramaturgut Ekrem Kryeziu, ashtu siç emitoi edhe pjesë tjera teatrale dhe emisione dokumentare nga periudha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në Kosovë, shoqëri të shumta muzikore, gjithashtu, po bënin një punë shumë të vlefshme në ndërgjegjësimin e popullit dhe sidomos rinisë me të kaluarën e lavdishme të paraardhësve tanë. Lista e këngëtarëve dhe këngëtareve që kishte fituar zemrat e publikut liridashës të Kosovës ishte e gjatë. Shkurte Fejza dhe Shyhrete Behluli ishin heroinat e kohës, si për zërin e tyre të ëmbël ashtu edhe për këngët plotë kushtrim. Këngët si "Ushton gryka e Kaçanikut", " Gjithë shqiptarët janë Mic Sokola", "Kënga e Rexhës" e shumë këngë të tjera, që gjëmonin nëpër stadiume, shtëpi kulture dhe valët e Radiotelevizionit të Prishtinës, ishin shndërruar në himne të rinisë shqiptare.

Në kuadër të njëqindvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Galerinë e Arteve në Prishtinë ishte hapur një ekspozitë e piktorëve dhe artistëve nga Tirana. Qysh ditën e parë të hapjes së ekspozitës shkova dhe e vizitova Galerinë e Arteve. Eca nëpër sallë dhe i shikova një nga një pikturat dhe skulpturat e vendosura, që kryesisht bënin fjalë për historinë e lavdishme të popullit shqiptar gjatë periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në atë rast, në një sallë përplot me vizitorë, ndërrova dy-tri fjalë me artistët e pranishëm dhe u thashë fjalë shumë të mira për veprat e tyre. Disa nga përfaqësuesit e ekspozitës, që kishin ardhur nga Tirana, ishin edhe autorë të veprave të pranishme në ekspozitë.

Isha i mahnitur nga ajo që më panë sytë, ashtu siç isha krenar, për pranin time në një ekspozitë të krijuesve nga Shqipëria nënë. Duke e vizituar ekspozitën u ndala në mënyrë të veçantë para pikturës së Mic Sokolit dhe Sefë Koshares. Pranë pikturës së Sefë Koshares shkruante edhe një tekst që ishte njëherësh edhe teksti i një kënge që e kisha dëgjuar sa e sa herë në Radio Tiranë por edhe në Radio Prishtinë:

" *Sefë Kosharja i pari i fisit*
Hije të paska maja e plisit
Hije më ka o shokët e mi
Kam dhanë jetën për Shqipni."

Ekspozita dhe pikturat e saj, më mbushën me krenari që isha pasardhës i personazheve të pikturave dhe skulpturave që u ekspozuan! Më dukej sikur, në mesin e pikturave, po shihja edhe gjyshin e tim atë- Beh Mihaliqi- të cilin nuk e kisha parë kurrë, por që për pjesëmarrjen e tij në betejat e Cerrnalevës, Merdares, Mitrovicës dhe përpjekjet e tij për liri përkrah Isa Boletinit, kisha dëgjuar nga të bijat e tij, dada Nurie dhe dada Halë.

Artistët nga Tirana, bashkë me veprat e tyre të artit sikur na e kishin sjellë edhe një pjesë të madhe të historisë së të parëve tanë të lavdishëm dhe luftërat e tyre për liri dhe pavarësi, duke filluar nga koha e Gjergj Kastriotit e deri tek heronjtë e penës dhe pushkës të periudhës së Rilindjes sonë Kombëtare. Mic Sokoli i kishte hapur gjoksin topit turk, Abdyl Frashëri, Sylejman Vokshi, Ymer Prizrenin kishin shtrënguar duart dhe thirrja e famshme "gegë dhe toskë- një është Shqipnia", sikur na thërriste edhe ne që të luftonim për realizimin e atij amaneti?

Dola nga Galeria e Arteve dhe u nisa në drejtim të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë, i entuziazmuar dhe i dehur nga gëzimi për ato që kisha parë .

Njohja me Ferki Morinën

Menjëherë pas vizitës në Galerinë e Arteve u nisa për shtëpi.

Në hyrje të Stacionit të Vjetër të Autobusëve në Prishtinë, e gjeta Ferki Morinën, të cilin më dukej se e kisha parë në fakultet. Ai e mbante në dorë të përjavshmen "Zëri i Rinisë", në ballinën e të cilës ishte piktura "Mic Sokoli". Ballina e "Zërit të Rinisë" me pikturën "Mic Sokoli", më nxiti t'i afrohesha dhe të bisedoja me Ferkiun. Gjatë bisedës, mësova se Ferki Morina ishte nga fshati Akrashticë i Vushtrrisë . Ai ishte edhe kushëri me dajat e tim atë (Bajram dhe Miran Morina). Në pritje të autobusit dhe gjatë rrugës biseduam rreth ekspozitës në Galerinë e Arteve dhe përshtypjeve që na kishte lënë ajo. Edhe Ferkiu, ishte i entuziazmuar nga ajo që kishte parë në ekspozitë. Udhëtuam së bashku gjer në Lum të Madh, ku edhe u përshëndetëm me njëri-tjetrin dhe unë zbrita nga autobusi e vazhdova rrugën, në këmbë, për në shtëpi.

Biseda që pata me Ferkiun me la përshtypje shumë të mira. U gëzova shumë që u njoha me një student të fakultetit tim dhe kushëri të dajave të tim atë.

Pas takimit të parë, me kemi vazhduar të takohemi, kryesisht, në fakultet, ku pothuajse nuk linim ditë pa u takuar e biseduar me njëri-tjetrin. Nuk vonuam shumë dhe nisëm ta vizitojmë njëri-tjetrin edhe në shtëpi. Gjatë vizitave të mia, kam vërejtur se në shtëpi të Ferkiut, ashtu si edhe në shtëpinë time, dëgjohej Radio Tirana e shikohej Radiotelevizioni Shqiptar.

Me kalimin e kohës, njohja dhe miqësia jonë po thelloheshin gjithnjë e më shumë. Me Ferkiun, nuk na bashkonte vetëm shkolla, por interesi për librin dhe leximin. Të dy kishim lexuar e vazhdonim të lexonim. I lexonim me përkushtim të madh librat e shkrimtarëve shqiptarë, si ata të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare ashtu edhe ata bashkëkohorë. Me ëndje të madhe lexonim edhe shkrimtarë të huaj. Shpeshherë gjatë takimeve i komentonim librat që i kishim lexuar.

Sa më shumë që po shoqërohesha dhe po bisedoja më atë, po bindesha se Ferkiu ishte një shok i veçantë! Ai shquhej për shumë virtyte që të bënin për vete. Ferkiu, ishte një njëri jashtëzakonisht i qetë, fjalëpakë, parimor në qëndrimet e tij dhe që kishte edhe një formim politik të admirueshëm. Ai, gjithashtu dallohej për sjelljen e tij. E kisha vërejtur se nuk vonohej asnjëherë në kohën e takimeve, por vinte gjithmonë me kohë. Gjatë kohës së lirë, i binte çiftelisë me pasion të madh. Falë ndikimit të tij pothuajse të gjithë vëllezërit dhe motrat e tij i binin çiftelisë dhe merreshin gjatë kohës së lirë me këngën e bukur të melosit shqiptar.

Disa muaj më vonë, për befasinë time, sapo zbrita nga treni në Fushë Kosovë dhe u nisa në drejtim të Stacionit të Autobusëve, e takova Ferkiun së bashku me Ramadan Pllanën.

Takimi i serishëm me Ramadan Pllanën më gëzoi shumë. Një befasi e këndshme ishte, sidomos, shoqërimi i tij me Ferkiun.

Nga Fushë Kosova gjer në oborrin e Fakultetit Filozofik udhëtuam së bashku. Aty u ndamë. Unë dhe Ferkiu vazhduam në drejtim të Fakultetit Ekonomik.

Gjatë një takimi tjetër, në fakultet, me Ferkiun kemi biseduar për Danin. Në atë rast, Ferkiu më ka folur se si është njohur me Danin, për qëndrimin e tij në Francë, për kthimin në Kosovë dhe regjistrimin e tij në Fakultetin Filozofik-Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge në Universitetin e Prishtinës. Ferkiu, gjithashtu, e ka shprehur edhe respektin e madh që kishte për Danin.

Ramadan Pllana dhe Ferki Morina

Sa më shumë që po shoqërohesha me Ferkiun, gjithnjë e më shumë po e kuptoja edhe ndikimin e madh që Dani kishte pasur në formimin e tij intelektual dhe revolucionar.

Disa javë më vonë, gjatë ligjëratave, Ferkiu më propozon që pas mbarimit të ligjëratave të shkonim së bashku gjer në fshatin Shtitaricë dhe të takoheshim aty me Danin dhe me disa shokë të tjerë.

Pas mbarimit të ligjëratave e vazhduam rrugën gjer në Stacionin e Trenit në Vushtrri. E lamë trenin dhe u ngjitem kodrës përpjetë. Pas pak dolëm mbi fshat. Nga aty, Vushtrria dukej si në pëllëmbë të dorës. Në të majtë, qëndronte krenare Sokolica e Isa Boletinit , krejt në veri, Shala e Bajgorës dhe përballë Rrafshi i Kosovës me lumin Silnica, që e gjarpëronte fushën dhe të mahniste me bukurinë e saj.

Në maje të kodrës, mbi fshatin Shtitaricë, i gjetëm Danin, Latën (Latif Pllanën, Xhemën (Xhemajl Pllanën), Demën (Demë Jasharin) dhe Samiun (Sami Pllanën). Disa prej tyre, po më dukej, se po i njihja si fytyra dhe se i kisha parë gjatë udhëtimeve për në shkollë, mirëpo nuk e dija se të gjithë ishin shokë dhe njiheshin me njëri-tjetrin. Kjo ishte një befasi e këndshme. Ndjehesha i entuziazmuar. Megjithëkëtë me kishte pushtuar një heshtje e pakuptueshme. Për mua, kjo ishte hera e parë që po takoja, në një vend, jashtë shkolle, një numër kaq të madh studentësh dhe me ta po bisedoja, apo më mirë të them po i dëgjoja duke debatuar, për çështje shumë serioze. Njëri niste të fliste për një libër, që kishte lexuar dhe përshtypjet që kishte lënë libri i lexuar dhe tjetri i nxirrte në kuvend përshtypjet, mendimet dhe argumentet apo kundër argumentet e tij lidhur me librin në fjalë apo çështjen e shtruar. Në këtë debat shquheshin Dani dhe Lata. Të tjerët flisnin më rrallë. Ndërsa unë më shumë dëgjoja dhe miratoja me kokë ato që i thoshin. Ndonëse unë kisha lexuar, sipas mendimit tim mjaft shumë, e shihja se ata ishin shumë më përpara dhe për shumë çështje që ata i shtronin, unë edhe nuk i merrja vesh se përse e kishin fjalën! Megjithëkëtë, ndjehesha shumë i nderuar, por edhe i lumtur që gjendesha në një mes të tillë dhe që kisha nderin të njoh gjithë këta studentë që kishin qartësi dhe vetëdije politike e kombëtare. Ma merrte mendje se ata ishin shokë të vjetër dhe që njiheshin shumë mirë me njëri-tjetrin.

Ferki Morina, Xhemajl Pllana dhe Ramadan Pllana

Nuk e mbaj mend sa orë qëndruam në kodrën e Shtitaricës. U përshëndeta me shokët dhe së bashku me Ferkiun u nisëm drejtë Stacioni të Trenit. Duke ecur, Ferkiu ma dha me vete një libër të vogël, që ishte një monografi për Shyqëri Ishmin, që për mua, ishte libri i parë i "ndaluar" që po merrja në dorë. E futa në xhepin e brendshëm të palltos dhe "fluturova" në shtëpi. Sapo arrita në shtëpi u futa në odën e burrave, ku s'kishte njëri, dhe lexova dhe rilexova po atë

natë librin për jetën heroike të Shyqëri Ishmit, heroit të Luftës Antifashiste e Nacionalçlirimtare Shqiptare.

Pas takimit në kodrën mbi fshatin Shtitaricë, kontaktet me Ferkiun i kishim pothuajse të përditshme. Edhe Danin e takoja më shpesh. Ndërsa, kohë pas kohe i kam takuar edhe Xhemën, Latën, Samiun dhe Demën, por takimet me këta të fundit, kanë qenë kryesisht gjatë udhëtimeve për në shkollë apo shtëpi dhe kanë qenë takime të rastësishme.

Përshtypje shumë të mira më kanë lënë takimet me Xhemën, që ishte student i Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore- Dega e Gjeografisë. Ai ishte njëri jashtëzakonisht i qetë, fliste ngadalë e rrjedhshëm dhe të bënte për vete me gjuhën e pastër dhe mendimet e tij të pjekura, që t'i thoshte.

Gjithashtu, edhe Latën që për nga natyra ishte shumë i qetë dhe shumë i matur. Deri në një masë ai më dukej shumë i kujdesshëm kur fliste me të tjerët! Lata ishte student i Fakultetit Juridik.

Samiu, studenti i Fakultetit Filozofik- Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, fliste shumë rrallë, por ishte shumë miqësor dhe që të bënte për vete me sjelljen e tij shumë të urtë. Pas njohjes me të e mora vesh se ai ishte vëlla i arsimtarit tim të biologjisë Sejdi Pllana, për të cilin unë kisha shumë simpati dhe ruaja shumë kujtime të mira që nga shkolla fillore në fshatin Prelluzhë.

Dani e Xhema ishin vëllezër, ndërsa Lata dhe Samiu kushërinj të tyre.

***

Disa javë më vonë, së bashku me Danin dhe Ferkiun kemi marrë pjesë në një ligjëratë të dy profesorëve nga Shqipëria në Amfiteatrin e Fakultetit Ekonomik. Tema e ligjëratës ka qenë: "*Ngushtimi i dallimit në* m*es punës fizike dh*e *mendore*". Njëri nga ligjëruesit quhej prof. Hekuran Mara dhe prof. Astrit Kaflla. Salla e Amfiteatrit të Fakultetit Ekonomik ishte përplot me studentë. Lista e pyetjeve që studentët ju shtruan profesorëve ishte shumë e gjatë. Dhe në fund të ligjëratës, duartrokitjet e duartrokitje që vazhduan një copë herë.

***

E mbaj mend një takim me Sylejman Qyqallën dhe Danin në hyrje të Fakultetit Filozofik.

***

Në kuadër të njëqindvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Prishtinë ishte mbajtur një koncert me artistë nga Shqipëria. Të nesërmen, në faqet e "Rilindjes" lexova një shkrim të Jusuf Gërvallës me titull *"Klodiana Skënderi dhe nëntë pranverat e saj".* Nëntëvjeçarja Klodiana Skënderi, me paraqitjen e saj dinjitoze, kishte pushtuar zemrën e Jusuf Gërvallës dhe të spektatorëve të tjerë të pranishëm në koncert. Jusuf Gërvalla, me një zgjuarsi të jashtëzakonshme dhe mjeshtri të madhe, kishte shfrytëzuar shtypin legal për ta prezantuar gjithë entuziazmin që kishte shfaqur koncerti dhe artisja e vogël. Shkrimi ishte një befasi e këndshme.

***

Gjatë një takimi, verën e vitit 1979, Dani më ka njoftuar se së shpejti do të udhëtonte në Francë dhe se atje do t'i vizitonte disa shokë dhe miq të tij francezë. Ndonëse, Dani, nuk më ka thënë asgjë me tepër lidhur me udhëtimin e tij, megjithëkëtë udhëtimin e tij në Francë e konsideroja të rëndësishëm për çështjen tonë.

Gjatë dëgjimit të Radio Tiranës kisha dëgjuar se në Francë vepronin shoqata e organizata revolucionare që bashkëpunim me Shqipërinë. Shpresoja se udhëtimi i tij, ka si cakë selinë e ndonjë organizate të tillë? Ndoshta, thosha vetë me vete, Dani qysh gjatë kohës së qëndrimit të tij në Francë, ka pasur kontakte me ndonjë organizatë të tillë revolucionare?

Dy javë më vonë isha duke e pritur trenin në Stacionin e Trenit në Mihaliq. Treni u ndal dhe në dritaren e trenit e pashë Danin. Hyra në vagon, u përqafuam me mall dhe së bashku e vazhduam rrugën gjer në Prishtinë.

Lidhur me udhëtimin e tij në Francë, Dani, më tha se kishte kaluar mirë. Asgjë më shumë. As unë nuk e pyeta më tepër.

Danin e konsideroja më tepër se shok. Ma merrte mendja se ai ishte i vetëdijshëm se çka duhet të më tregonte e çka jo. Veç kësaj, disa çështje, si bie fjala, udhëtimin në Francë, i konsideroja si çështje "të punëve të tij". Prandaj, as unë s'e shihja të udhës as të pyesja por as edhe të dija më shumë për to.

Gjatë kohës së njohjes me Danin dhe Ferkiun, unë i kisha intensifikuar kontaktet me shokët e mi të "vjetër". Kisha disa shokë që gjithashtu lexonin literaturë të ngjashme me atë që lexoja unë, që e dëgjonin Radio Tiranën dhe që gjatë takimeve që kishim flisnim kundër pushtuesit jugosllav.

Qysh gjatë gjimnazit në Mitrovicë, nëpërmjet Shaqir e Bedri Selmanit (Bedës) dhe nipave të mi, isha njohur me Rexhep Ahmetin (Rexhën) nga fshati Stranë (Gurakuq). Gjatë studimeve të tij në Fakultetin Filozofik-Dega Sociologji-Filozofi në Universitetin e Prishtinës, u afruam edhe më shumë. Rexha ishte student i shkëlqyeshëm dhe vet drejtimi që studionte i bënte takimet dhe debatet tona shumë interesante. Rexhës, i kam ofruar edhe literaturë të ndaluar, e cila literaturë i shtronte çështjet e luftës sonë për liri shumë më ndryshe nga librat që ne i kishim studiuar në shkollë.

Xhafer Durmishi (Xhafa) nga fshati Stanovc i Ultë, që e njihja qysh nga shkolla fillore, ishte një shok tjetër me të cilin kisha kontakte prej vitesh. Xhafa, për nga mosha, ishte një vjet më i ri nga unë, shquhej për pjekurinë dhe formimin intelektual që kishte dhe që të bënte për vete. Kontaktet dhe veprimtarinë politike e kemi nisur gjatë studimeve të Xhafës në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik- Dega e Teknologjisë në Mitrovicë. Në fillim, jemi takuar dhe kemi biseduar për çështje të ndryshme dhe bisedat tona kanë pasur më tepër karakter njohës. Me kalimin e kohës, kemi thelluar bashkëpunimin. Më vonë, pas kontakteve të mia me Danin dhe Ferkiun, literaturën ilegale ia kam ofruar

edhe Xhafës. Gjithashtu edhe Xhafa më ka ofruar libra dhe revista të ndaluara, që i ka marrë nga shokët e krahut të tij. Gjatë takimeve tona, me Xhafën nuk kemi folur për shokët e njëri-tjetrit dhe nuk i kemi zë në gojë emrat e tyre.

Kontakte të vazhdueshme kisha edhe me Mahmut Muratin, hoxhë i xhamisë së Beçukut, të cilin e kisha edhe kushëri.

Mahmut Murati vinte dhe na vizitonte shpesh në shtëpinë tonë. Gjatë vizitave të tij dhe takimeve bisedonim për tema të ndryshme. Ai shfaqte një formim shumë të mirë si njeri dhe fliste me simpati për Shqipërinë dhe filmat shqiptar që i kishte parë në RTSh-ë. Ky qëndrim i Mahmut Muratit më bënte përshtypje shumë të madhe, aq më tepër kur kisha parasysh se ai ishte hoxhë i xhamisë së Beçukut.

Një ditë *Hoxha i Vogël* (kështu e quanim Mahmut Muratin, meqë i ati i tij ishte gjithashtu hoxhë) vije tek ne për vizitë. Gjatë vizitës biseduam edhe për çështje të fesë. Gjatë bisedës u "grindem" e dolëm se ishim krejt të ndryshëm. Unë, u bëra tym në *Hoxhën e Vogël*. Kisha përshtypjen se edhe ai ishte prekur shumë nga qëndrimet e mia! Më vonë, e pashë se nuk kisha qenë i drejtë ndaj tij, sepse ma merrte mendja, se nuk kishte qenë e nevojshme një bisedë e tillë, sepse fundi i fundit ai ishte hoxhë dhe unë do të duhej të tregoja më tepër mirëkuptim për profesion e tij dhe bindjet e tij. A nuk e kisha lexuar diku se "feja është një çështje private"!

Në një takim tjetër, u morëm vesh që të mos bisedojmë për çështje të fesë në ardhmen. Mund të them me plotë gojë se të dy e kemi mbajtur fjalën, sepse pas atij takimi të neveritshëm, ne, asnjëherë nuk kemi folur për fenë! Unë e kam respektuar *Hoxhën e Vogël,* ashtu siç ka qenë dhe nuk jam përpjekur asnjëherë t'ia mbushë mendjen e kotësinë e besimit në Zot. Kam pasur përshtypjen se edhe ai më respektonte ashtu siç kam qenë.

Është interesant të thuhet se shpeshherë, gjatë muajit të agjërimit, *Hoxha i Vogël,* ma ka shtruar drekën, nëse kam qëlluar në vizitë tek ai, ashtu siç ka bërë, nëse e kam ndihmuar me ndonjë punë të verës, ma ka sjell bukën dhe ujin në arë. Kjo sjellje e *Hoxhës së Vogël* më ka mahnitur gjithmonë!

Në shtëpi të *Hoxhës së Vogël* jam njohur edhe me kunatin e tij, Vehbi Muja, nga fshati Gradicë, me banim në Gllogovc, që ishte student i Fakultetit Xhehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë. Vehbi Muja ishte një shok i mirë, i formuar politikisht dhe që fliste me simpati për Shqipërinë dhe tregohej i interesuar për çështjen tonë kombëtare.

Në Mitrovicë, gjithashtu kisha kontakte të vazhdueshme me Bedri Selmanin, i cili ishte nxënës i shkollës së mesme. Bedri Selmanin e kisha edhe nip të burrit të hallës sime. Beda ishte një djalë i ri që po përparonte me ritëm të shpejtë.

Në Fakultetin Ekonomik, pos kontakteve me Ferkiun, kisha kontakte me Burim Zagragjën, Behxhet Ahmetin, Ymer Dragushën, Hilmi Gashin, Nysret Pllanën, Fatmir Makollin si dhe me disa nga ish shokë të klasës sime nga gjimnazi i Mitrovicës me të cilët studionim së bashku.

Nga Ferki Morina, për herë të parë, e kam marrë revistën "Ylli" që botohej në Tiranë. "Yllin" e kam lexuar dhe ua kam dhënë të gjithë shokëve dhe disa të afërmve të tjerë që u besoja.

Gjithashtu nga Ferki Morina e kam marrë edhe librin e Ajet Haxhiut "Shota dhe Azem Galica", të cilin për disa muaj rresht ua kam përcjell shokëve të mi. Këtë libër ia kam dhënë edhe Ramadan Nasufit, bashkëfshatarit tim që ishte mësues në Shkollën Fillore "Liria" në Strofc dhe që ishte edhe nip i Shaban Kapuçit, për të cilin me disa rreshta shkruhet edhe në librin "Shota dhe Azem Galica."

***

Gjatë takimeve me Danin, Ferkiun dhe shokët tjerë një detyre e pashkruar, që i kishim dhënë vetës, ishte ngritja ideologjike dhe vetëdijesimi kombëtar. Për ta arritur këtë qëllim studionim historinë e popullit tonë, filozofë që nga antika e deri në ditët tona, si dhe studionim shkrimtarë të letërsinë shqiptare e asaj botërore dhe të shfrytëzonim gjithë literaturën legale, që e konsideronim si progresive dhe revolucionare.

Shtëpitë botuese në Kosovë, sidomos *"Rilindja*", kishte botuar e ribotuar shumë shkrimtarë të Rilindjes sonë Kombëtare, por edhe ata bashkëkohorë nga Shqipëria, Kosova dhe viset shqiptare në Jugosllavi, si dhe shkrimtarë nga letërsia botërore. Këtë punë ne e konsideronim si një punë shumë të rëndësishme për të mirë në rritjen e vetëdijes kombëtare dhe të përballjes me përpjekjet që bëheshin nga propaganda jugosllave për nxitjen e ndasive në mes shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë etj. Unë dhe shokët e rrethit tim i përhapnim librat që botoheshin në Prishtinë dhe i konsideronim si libra të mirëfillta për shkak të frymës kombëtare e progresive që përmbanin në vete, ndërsa i luftonim ata libra që bënin propagandë antishqiptare dhe që ishin të shkruar nga autorë jugosllavë apo disa renegatë shqiptarë.

Libra politike, që shkruheshin nga autorë jugosllavë apo shqipfolës ishin kryesisht libra që Shqipërinë e paraqitnin si një vend të izoluar, të varfër dhe që nëpërmjet kësaj synonin të krijonin përshtypjen tek shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare se Jugosllavia titiste u kishte dhënë shqiptarëve të "saj" më shumë të drejta e liri sesa Shqipëria e Enver Hoxhës. Veç kësaj hartuesit e librave sipas kuzhinës së Beogradit synonin t'i thellonin ndarjet në mes shqiptarëve. Jugosllavia e Titos dhe titistët bënin përpjekje për krijimin një kombi të ri nga shqiptarët në Jugosllavi. Në librat e kuzhinës serbomadhe propagandohej për ndasitë gjuhësore dhe krahinore që kanë shqiptarët. Shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare prezantoheshin si *shiftar*i[2] ndërsa ata të Shqipërisë si *albanci*.

Një nga çështjet që bisedonim me shokët ishte dhe çështja e fesë dhe rolit të saj në radhët e shqiptarëve. Duke ditur ndasitë dhe përçarjet që kishte shkaktuar feja tek shqiptarët, që nga pushtimi i tokave shqiptare nga Perandoria Otomane, ne e konsideronim të drejtë qëndrimin e shtetit shqiptar për mbylljen e kishave dhe xhamive në Shqipëri. Ne e admironim thirrjen e Pashko Vasës se *feja e shqiptarit është shqiptaria.*

Për ndryshim nga gjendja e pozitës së besimeve fetare në Shqipëri, në Jugosllavinë titiste, të gjitha komunitetet fetare gëzonin liri të plotë veprimi. Madje ekzistonte edhe një bashkëpunim shumë i madh në mes të klerit fetar dhe pushtetit. Shumë priftërinj dhe hoxhallarë ishin dorë e zgjatur e pushtetit jugosllav.

Duke qenë ithtar i materializmit dialektik dhe historik, unë e shihja propagandën e priftërinjve dhe hoxhallarëve si reaksionare dhe si përpjekje për ta mbajtur popullin shqiptar në errësirë dhe padituri. Gjithashtu, bashkëpunimin e klerit mysliman e katolik dhe pushtetit jugosllav e konsideroja si përpjekje për islamizimin dhe shkombëtarizimin e shqiptarëve. Kisha parasysh edhe bashkëpunimin e klerit mysliman me pushtetin jugosllav gjatë shpërnguljes së disa qindra mijëra shqiptarëve në Turqi, në që rast kleri mysliman kishte luajtur një rol shumë antishqiptar duke bashkëpunuar me pushtetin dhe duke propaganduar për "atdheun e turqve".

Jugosllavia e Titos, ashtu si pushtuesit Otomanë, nga shqiptarët kishte krijuar edhe popuj të tjerë. Një pjesë e shqiptarëve të besimit myslimanë ishin shpallur turq, boshnjak e të tjerë. Pastaj shumë shqiptarë të besimit ortodoks ishin shkombëtarizuar në serbë, maqedonas e malazias, ashtu siç ishin shkombëtarizuar edhe shumë shqiptarë të besimit katolik në kroat! Në këtë vepër antishqiptare, roli i hoxhallarëve dhe priftërinjve ka qenë thellësisht antishqiptar.

Por, për mua dhe shokët e mi, jo të gjithë hoxhallarët dhe priftërinjtë ishin bashkëpunëtorë të UDB-ës dhe unë e shokët e mi nuk i fusnim të gjithë në një thes. Unë, personalisht, e kisha rastin e *Hoxhës së Vogël* dhe disa hoxhallarëve të tjerë që kishin profesionin e hoxhës, por që para së gjithash ata ndjeheshin shqiptarë dhe atdheun e kombin i vinin në vijën e parë, para fesë. *Hoxha i Vogël* dhe i ati i tij, që ishte gjithashtu hoxhë, i kishin lejuar vajzat e tyre të shkolloheshin dhe ishin treguar shumë përparimtarë kur ishte në pyetje emancipimi i femrës shqiptare.

Një çështje tjetër që ishte pjesë e veprimtarisë sonë dhe debateve ishte edhe pozita e gruas shqiptare. Një pjesë e madhe e grave shqiptare bënin jetë të ngjashme me atë të grave shqiptare të katër-pesë shekujve të kaluar. Shumica e grave ishin analfabete dhe numri i femrave shqiptare që shkollohej dhe punonte ishte ende shumë i vogël. Nëpër zonat rurale, gruaja shqiptare, ishte tërësisht e lënë në mëshirën e traditës patriarkale dhe asaj të klerit. Pushteti i komunistëve jugosllav nuk bënte asnjë përpjekje për emancipimin e femrës shqiptare.

Me shokët bisedonim për pozitën e gruas shqiptare në Kosovë dhe Shqipëri. Për ne transformimet e bëra në shoqërinë shqiptare në Shqipërinë e re, sidomos emancipimi i gruas shqiptare, e konsideronim si shembull se nga duhet të ecnim edhe ne. Në Shqipërinë e re gruaja shqiptare ishte shkolluar, punësuar dhe çliruar nga kanuni i Lek Dukagjinit, zakoneve patriarkale dhe dogmës së fesë.

Duke pasur si shembull ndryshimet në Shqipëri, ne bënim përpjekjeje për ndryshime në shoqërinë tonë edhe në familjet tona. Pothuajse çdonjëri prej nesh në shtëpi bisedonim me vëllezër e motra për rëndësinë që ka shkollimi i femrës dhe barazia gjinore në familje e shoqëri. Në këtë drejtim përdornim si shembull edhe shoqërinë shqiptare në Shqipëri dhe pozitën e gruas atje, në të kaluarën dhe sot. I përhapnim librat legal, si librin e Haki Stërmillit "Sikur të isha djalë", filma bashkëkohorë shqiptarë, kur trajtohej çështja e emancipimit të femrës shqiptare.

I frymëzuar dhe ndikuar nga literatura revolucionare që e studioja, "luftoja" që motrat e mia ta vazhdonin shkollën e mesme dhe që ato të mos rrinin në shtëpi, ashtu siç bënin shumë të reja deri atëherë, por që të shkolloheshin e punonin në të ardhmen. Për këtë qëllim vazhdimisht kam biseduar me prindërit e mi dhe atyre ua kam shpjeguar arsyet se përse motrat e mia duhet të shkolloheshin. Pas shumë përpjekjeve edhe nëna ime, që kishte shkuar në shkollë vetën ditën e parë të klasës së parë dhe e kishte ndërprerë shkollimin pas ndërhyrjes së të atit në shkollë, u "dorëzua" dhe pajtua që motrat ta vijojnë shkollën e mesme.

Në fshatin tim, kushërira ime Sabrije Sadik Sadiku, ka qenë vajza e parë që ka ndjekur Shkollën e Mesme Normale në Mitrovicë. Pas saj, e dyta, ka qenë motra ime Nafija që ka vijuar shkollën e mesme.

Burgosja e Ramadan Pllanës

Me 16 nëntor të vitit 1979, në Stacionin Hekurudhor në Mihaliq, e kam takuar Ferkiun. Ai më njoftoi se ishte duke më kërkuar në Prishtinë dhe kishte një çështje shumë me rëndësi që dëshironte ta bisedonte me mua.

–Pardje, herët në mëngjes, e kanë burgosur Danin!–më tha Ferkiu i brengosur.

–A thua, përse e kanë burgosur?– e pyeta i habitur.

– Nuk i di motivet, por mendja ma thotë se veprimtaria politike e Danit mund të jetë arsyeja e burgosjes së tij!

U trondita nga lajmi që mora. Së bashku me Ferkiun udhëtuam gjer në Zveçan. Rrugës, biseduam për atë që kishte ndodhur, por edhe për rrezikun e madh që na priste dhe masat që duhej t'i ndërmerrnim.

–Mund të na burgosin edhe ne! – më paralajmëroi Ferkiu, pas pak.

Ferkiu, më kështilloi që të tregohesha syçelë dhe që pas kthimit në shtëpi të shikoja se mos gjeja ndonjë material apo libër kompromet ues, që do të mund të përdorej si dëshmi kundër nesh nga UDB-a.

U ndamë me Ferkiun. Unë ika në shtëpi i mbushur me helm dhe ankth. Ndjehesha i tronditur! Druaja për të ardhmen e Danit.

Duke njohur se ç'potencial intelektual kishte Dani, arrestimin e tij e përjetoja si një goditje e rëndë për mua personalisht , por e dhe për ata pak shokë që unë i njihja e që e dija se shoqëroheshin me atë.

–Vallë, pse mund ta kenë burgosur? – e pyetja kokën time. Mos e ka spiunuar ndokush për ndonjë libër apo revistë?

Pas marrjes së lajmit, isha shumë i shqetësuar për Danin, Ferkiun dhe shokët. I shqetësuar isha edhe për vetën time. Unë nuk kisha idenë se çka do të sillte burgosja e Danit. Njohurit e mia për sjelljen e UDB-ës ndaj atyre që guxonin ta ëndërronin lirinë, ishin të pakta. Nuk njihja asnjë ish të burgosur politik. Edhe informacioni që kisha për sjelljen e UDB-ës ndaj të burgosurve politik shqiptarë, ishte jo vetëm i mangët, por edhe i frikshëm dhe i mbushur me thashetheme.

Me 19 apo 20 nëntor 1979, sapo u kthye nga puna, im atë më njoftoi se kishte dëgjuar nga një shok i punës, se *"me 18 nëntor e kishin arrestuar edhe djalin e dajës Hajdar*!"

Edhe këtë lajm e përjetova si një thikë të re në trupin tim! U bëra pelin. E tmerrshme! E tmerrshme! Tani si do të bëj pa dy shokët, – pyetja vetën?

Për shkak të lajmit që mora nuk e di se a kam fjetur atë natë? Më ishte trazuar shpirti dhe ndjeja një dhembje të madhe për shokët.

Mirëpo – një mendje më thoshte – se unë dhe shokët nuk duhej të gjunjëzoheshim për toke! Ndoshta, gjunjëzimi ynë ishte edhe qëllimi i armiqve tanë? Jo, jo ne duhet të bënim ashtu si thoshte kënga e Mic Sokolit "*Shtatë herë bie e tetë herë ngritëm... ",*– e trimëroja vetën time.

22 nëntor 1979

Një trokitje në derën oborrit ma prishi gjumin. Menjëherë u ngrita nga shtrati dhe u afrova shpejtë pranë skajit të dritares. E hapa, vetëm pak, perden e dritares dhe e afrova kokën. Para dyerve të oborrit i pashë disa burra të veshur me rroba civile e disa të tjerët me uniformë policësh. E kuptova se përse kishin ardhur!

U vesha shpejtë e shpejtë, dola nga dhoma, shkova dhe e hapa derën e oborrit. Sapo hapa derën, njerëzit e panjohur u futën brenda në oborr dhe më urdhëruan të qëndroja në dhomën ku kisha fjetur. Pas futjes në odë, ata më urdhëruan, gjithashtu, të rrija aty, i ulur, dhe të mos lëvizja nga vendi.

Dy nga udbashët, që ishin veshur me mantele të gjata e ngjyrë të përhirtë, së bashku me një polic me uniformë, u futën brenda në odë. U prezantuan se ishin Hajriz Mazhiqi dhe Beçir Voca. Më thanë se ishin punonjës të Shërbimit të Sigurimit Shtetëror Jugosllav. Beçir Voca me pyeti:

–A ke dëgjuar ndonjëherë për shërbimin tonë?!

–Jo,– iu përgjigja me gjysmë zëri.

Oficerët e UDB-ës vazhduan ta kontrollojnë dhomën. I kontrolluan të gjitha librat që kisha në vitrinë. Kontrolluan nën shtratin ku kisha fjetur, nën dysheme dhe kudo nëpër dhomë. Pas pak, dy udbashët dolën nga dhoma dhe për një kohë të gjatë, në dhomë ngela i vetëm me një polic.

Sapo udbashët u kthyen në dhomë, m'i vunë prangat, morën disa nga librat e mia dhe më urdhëruan të shkoja me ta.

Më nxorën nga dera e oborrit dhe më nisën drejt një makine të policisë që qëndronte e parkuar në rrugë, para dyerve të oborrit. E hapën derën e makinës dhe më urdhëruan të hyja brenda. Nga makina nuk shihej asgjë jashtë.

–Doli ashtu siç dyshonte Ferkiu,–thashë vetë me vete.

Pas pak, makina lëshoi një gumëzhimë dhe u nis. Disa minuta më vonë, makina bëri një kthesë në të djathtë. Në bazë të kthesës, e kuptova se makina po më çonte në drejtim të fshatit Prelluzhë. Diku pas një gjysmë ore, makina u ndal. Nga jashtë e hapën derën e makinës dhe më urdhëruan të dilja jashtë. E pashë se ndodhesha në Stacionin e Policisë në Mitrovicë. Hajriz Mazhiqi e Beçir Voca më shoqëruan në katin e dytë dhe më futën në një dhomë. E mbyllën derën, dolën nga dhoma dhe për pak kohë më lanë të vetëm aty.

Përballë meje, brenda në dhomë, ishte një tavolinë dhe dy karrige. Pranë karriges sime ishin dy karrige të tjera. Në të djathtë, një dritare me perde të tejdukshme. Aty po pritja i vetëm dhe kjo pritje m'u duk një shekull e gjatë!

Hajriz Mazhiqi dhe Beçir Voca u kthyen serish në dhomë. Hajrizi nisi pritjen e tij me nikoqirllëk të madh! Më pyeti se ç'dëshiroja të pija? Hajrizi dhe Beçiri, gjithashtu, më lutën të ndjehesha si në shtëpi!

Mirëseardhjen e tij, Hajrizi e vazhdoi duke më folur me dashamirësi për familjen time! Sidomos, më fliste mirë për tim atë! Më tha se kishte dëgjuar se ishte anëtar i "devotshëm" i Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, besnik i vëllazërim-bashkimit dhe socializmit vetëqeverisës jugosllav! Edhe për mua nuk kurseu fjalë të zgjedhura. Më tha se e dinte se isha Kryetar i Lidhjes së Rinisë Socialiste të fshatit Mihaliq.



№ 019061

KSA [illegible]OVËS
SAP KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS
SKU[illegible]TINA OPSTINE

I' jipet qytetarit
Uručiti građaninu

(organi [illegible]ve të brendshme) (naziv organa unutrašnjih poslova)

Numër
broj

Më _____ 19____
Datum god.

Vërtetim — Potvrda

Vërtetohet se personi i autorizuar zyrtar i nënshkruar i ka marrë përkohësisht prej
Potvrđuje se da je potpisano ovlašćeno službeno lice privremeno oduzelo od

(emri dhe mbiemri) (prezime i ime) nga iz rruga ulica

nr. broj KK SO këto sende:
sledeće predmete:

Qytetari,
Građanin,

Personi i autorizuar zyrtar,
Ovlašćeno službeno lice,

Formulari nr. 33
Obrazac broj 33

Vërtetimi i marrjes së librave, i nënshkruar nga Hajriz Mazhiqi

Nga aq sa dëgjova se kuptova se ishin të informuar mirë për mua dhe familjen time. Megjithatë ndihesha i shtangur dhe i mbytur në ankth. Ndonëse nuk kisha futur asgjë në gojë, nuk më hahej e nuk më pihej. Dyshoja edhe në sinqeritetin e fjalëve të mira që nxori nga goja udbashi.

Refuzimin e arsyetova me mungesën e shprehisë së ngrënies dhe pirjes kaq herët! Mirëpo, ç'ishte e vërteta, unë, kisha dëgjuar se udbashët, me qëllim që t'i bënin të flisnin, të burgosurve politikë shqiptarë, u hidhnin në pije substanca të ndryshme kimike dhe kisha frikë se ata mund ta bënin të njëjtën gjë edhe me mua! Ku ta dish se ç'mund t'ju pikë mendja këtyre maskarenjve? Duhet ta ketë një qëllim kjo "bujari" e udbashëve?– thosha vetë me vete.

Ndonëse isha në dorë të armiqve të popullit tim, mendjen e kisha tek dy shokët e mi, që e dija se ndodheshin diku, në duart e UDB-ës. Në kokë me silleshin ato që më kishte thënë Ferkiu, dy-tre ditë më parë. Përpiqesha të mbahesha i qetë.

Nuk vonoi shumë e në dhomë erdhën njëri pas tjetrit dhe nisën prezantimin e tyre: Faruk Mehmeti, Burhan Prishtina, Januz Shala dhe Sylejman Arifi.

Ndonëse, ata nuk qëndruan gjatë në dhomën e Hajriz Mazhiqit dhe Beçir Voces, ardhjen dhe prezantimin e tyre e merrja si një demonstrim të forcës! Më këtë udbashët dëshironin të më thoshin se ata ishin të shumtë në numër e të "plotfuqishëm", ndërsa unë fillikat i vetëm! Më shkonte mendja se kjo ishte pjesë e punës së tyre që më dukej se ishte e pasur me kurthe dhe të papritura!

Ndonëse m'i kishin hequr prangat, vetën e ndjeja sikur të më kishin futur në kafaz. Tani, edhe nuk kisha kah t'ia mbaja. E vetmja rrugë që më kishte ngelur, ishte të vazhdoja të qëndroja, të tregohesha kureshtar për ato që do të thoshin dhe ta ruaja gjakftohtësinë! Nuk mund ta merrja me mend se çka do të më pyesnin. Asnjëherë nuk kisha folur me ndonjërin nga shokët se si duhet të sillesha në rrethana të tilla. Megjithëkëtë, mendja ma thoshte se do të më pyesnin për ndonjërin nga librat apo revistat e ndaluara, sepse kjo ishte vepra ime e vetme antiligjore! Mirëpo, për të gjitha këto duhej të prisja...Këshillat e Ferkiut më silleshin nëpër kokë.

Nuk vonoi shumë dhe udbashi Hajriz Mazhiqi më pyeti:

– Na trego se me cilët shoqërohesh në fshat, në fakultet dhe gjatë kohën së lirë?

Ua thashë emrat e disa shokëve, por asnjë emër nuk ishte i atyre me të cilët unë kisha këmbyer ndonjë libër, revistë apo nga ata me të cilët kisha biseduar për çështjen e lirisë dhe kundër pushtimit serb.

Mirëpo, përderisa në burg i kisha dy shokë, e kuptoja se ata nuk më kishin marrë rastësisht. Dyshoja se këta gjarpërinj duhet të më kenë parë duke u shoqëruar me Danin e Ferkiun, qoftë gjatë udhëtimeve me tren ose gjatë takimeve në fakultet.

Nuk vonoi shumë dhe e kuptova se udbashët nuk ishin të kënaqur me përgjigjen time e as me emrat e atyre që i përmendur .

Pas pak, Hajriz Mazhiqi më pyeti:

– Na thuaj se kë e njeh nga fshatrat rrëzë Malit të Qyqavicës, duke filluar nga fshati Pantinë e gjer në fshatin Hade?

Unë e vazhdova përsëri me të vjetrën. Zija në gojë vetëm emrat e atyre shokëve që i kisha përmendur më parë.

– Cilët i njeh në fshatin Shtitaricë? – më pyeti udbashi.

Tani udbashi ishte shumë konkret. Të gjithë burrat dhe studentët e Shtitaricës më dolën para sysh. E kisha të qartë se cilin emër dëshironin ta dëgjonin. Megjithëkëtë edhe kësaj radhe unë ua thashë vetëm emrat e disa burrave që i njihja nga fshati Shtitaricë, por emrin e Danit nuk ua thashë.

Udbashët nuk ishin të kënaqur as pas kësaj përgjigje. Ata kërkonin që unë të mendohesha mirë dhe t'i gjeja në kujtesën time të gjithë ata që i njihja në fshatin Shtitaricë. Këtë unë e kuptoja nga këmbëngulja e tyre për njohjen e kontakteve të mia me njerëzit rreth fshatit të Danit.

Ç'është e vërteta isha në siklet të madh: si të bëja dhe si të përgjigjesha në pyetjen e tyre? Isha në dilemë se a duhej ta pranoja apo jo njohjen time me Danin?

Nga sjellja e tyre, po e kuptoja se udbashët kishin kohë dhe nuk nguteshin. Edhe kur lodheshin, e ndërronin njëri-tjetrin dhe në vend të tyre vinin të tjerët, që ishin të pushuar. Edhe zëvendësuesit vazhdonin punën aty ku e kishin lënë shokët e tyre. Të gjithë, te vjetër e të rinj, silleshin rreth emrit të Danit. Kohë pas kohe, udbashët, gjithashtu, më këshillonin të tregohesha i sinqertë, sepse, siç nisën ta përsëritnin, në mënyrë monotone, sloganin e tyre, "ata i dinin të gjitha dhe se e gjithë kjo bëhej vetëm për ta provuar sinqeritetin tim!"

Hajriz Mazhiqi dhe Beçir Voca kishin shkuar në pushim. Në vend të tyre, "bisedën" me mua po e vazhdonte Burhan Prishtina dhe Jonuz Shala.

Burhan Prishtina është i pari që e zuri në gojë emrin e Danit. Edhe ky, ashtu si edhe shokët e tij, më këshillonte që t'ia thosha të vërtetën.

Megjithatë unë vazhdoja të bëhesha se nuk e njihja Danin. Por as udbashët nuk dorëzoheshin në këmbënguljen e tyre dhe vazhdonin të qëndronin gjithë kohën vetëm tek njohja ime me Danin. Herë njëri e herë tjetri më këshillonin të mos e mundoja vetën sepse : *"i dinin të gjitha dhe se ata vetëm po dëshironin të shihnin se a jam i sinqertë apo jo!*"

Ndodhesha para një dileme të madhe. Si të veproja? Të vazhdoja të qëndroja, në atë që kisha thënë, apo ta pranoja se e njihja Danin? Ndoshta më kanë parë duke u shoqëruar me Danin dhe Ferkiun,– i thosha përsëri vetës sime. Në kokë, më silleshin kujtimet e takimeve që kisha pasur me shokët, gjatë udhëtimeve më tren, takimeve në Prishtinë, në Fushë Kosovë, në Fakultetin Ekonomik, në Fakultetin Filozofik, takimet në kodrën mbi fshatin Shtitaricë dhe në vende të tjera. Të vazhdoja të mos e pranoja njohjen me Danin apo jo? Kjo ishte dilema që kisha para vete. Kisha frikë se mospranimi, do ta rriste edhe më shumë dyshimin në mua. Po të mos e dinin njohjen time me Danin, atëherë përse erdhën dhe më morën, e pyetja vetën? Pas bluarjes në kokë që i bëra kësaj pyetje, vendosa ta pranoj se e njihja Danin, por nuk do të flisja asgjë më tepër. Do të bëhesha që unë s'di asgjë më shumë dhe se gjer me tani nuk e kisha pranuar njohjen për shkak të frikës që kisha pasur.

– E vërtetë është se e njoh një që quhet Dan... Është student i gjuhës frënge... Po, këtë e kam takuar disa herë gjatë udhëtimeve me tren, – i thashë me gjysmë zëri.

Njëri nga udbashët kërceu dhe tha:

– Po fol, more burrë! Tani, ke folur si burrat! Ne vetëm po të prisnim që të na tregosh vet se sa i sinqertë je! Mirëpo, më duhet të jem i sinqertë ndaj teje, njohja jote me Ramadan Pllanën nuk është lajm për ne. Tani lind pyetja: përse nuk e pranove gjer me tani se e njeh Ramadan Pllanën? Pse? Pse? Pse? A e ke lexuar romanin "Pse" të Sterjo Spasës? Pastaj, kjo nuk është gjithë e vërteta. Ti nuk na tregove se si je njohur me Ramadan Pllanën? Me kë dhe ku e ke takuar Ramadan Pllanën dhe çka keni biseduar me njëri-tjetrin?

Burhan Prishtina m'i nguli sytë dhe më qëndronte përpara si një statujë. Në sytë e tij shihja një optimizëm; ai shpresonte se e hapa gojën dhe tani do t'jua thosha të gjitha. Burhan Prishtina dukej i gëzuar dhe sikur e kishte kapur fillin e perit! Optimizëm lexoja edhe në fytyrat e udbashëve tjerë që ndodheshin në dhomë!

Një mendje më thoshte se mos "gabova" që e pranova njohjen time me Danin, se mos duke e pranuar njohjen unë u dhashë, me të vërtetë, fillin e perit? Megjithëkëtë, ma merrte mendja dhe besoja se ata e dinin njohjen tonë dhe mospranimi i njohjes me Danin, vetëm se do t'i shtonte edhe më shumë dyshimet që ata kishin në mua. Prandaj, ma thoshte mendja se unë është dashur ta pranoja njohjen qysh në fillim. Isha i sigurt, se kisha gabuar që nuk e kisha pranuar, më herët, njohjen time me Danin. Mirëpo, tani kjo nuk mund të zhbëhej. Tani e tutje nuk më mbetej tjetër pos të shpëtoja atë që mund të shpëtohej, i thosha vetës sime. Në ndërkohë, po mendoja se si t'i jap një përgjigje udbashit, që tani s'ishte një pyetje, por një listë e gjatë me pyetje.

– E kam takuar në tren... Nuk e njoh... Më është dukur njëri i mirë,– u përgjigja dhe po prisja reagimin e tij.

– Për çka keni biseduar?– më pyeti Burhan Prishtina dhe më shikonte drejtë në sy.

– Nuk e mbaj mend... Kemi folur për studimet, – i thashë dhe nuk ia largova sytë Burhanit, që më shikonte si një statujë.

– Nuk je i sinqertë. Ne po kërkojmë nga ti të na e thuash të vërtetën dhe asgjë tjetër? Nuk ke nevojë ta mundosh vetën tënde! Thuaje të vërtetën dhe shko në shtëpi, – shtoi Januz Shala.

–Unë jam i sinqertë dhe nuk kam se çka të them më shumë. Unë nuk e njoh Ramadan Pllanën dhe nuk e kuptoj se përse më mundoni për diçka që nuk di? , – u përgjigja.

– Përsëri nuk je i sinqertë – vazhdoi Burhan Prishtina – Ramadan Pllana është nacionalist, është kundër vëllazërim-bashkimit të popujve të Jugosllavisë, është kundërrevolucionar, është irredentist....

– Unë u thashë se nuk e njoh, – u përgjigja përsëri.

– E di ti se kush jam unë? – m'u drejtua Burhan Prishtina.

– Jo, – i thashë Burhanit.

–Jam i familjes së Hasan Prishtinës,– ma ktheu Burhan Prishtina. A ke dëgjuar ndonjëherë për Hasan Prishtinën?

– Po, kam dëgjuar. Kam dëgjuar se ka qenë deputet në Stamboll dhe bashkëluftëtar i Isa Boletinit. Fshati im, ka pasur disa bashkëluftëtarë të tij: Shaban Kapuçin, Beh Mihaliqin e ndonjë tjetër, që kanë luftuar përkrah tij e kundër hordhive osmane,– i thashë me krenari Burhan turkut.

– Ti mendon se Ramadan Pllana është më patriot se unë?! – ma ktheu Burhan Prishtina dhe e kapi lëkurën e dorës së majtë me gishtërinjtë e dorës së djathtë dhe e tërhoqi lartë.

– Jo, – i thashë, – unë nuk po mendoj asgjë.

– Na thuaj se cilat libra t'i ka dhënë Ramadan Pllana? – vazhdoi i mërrolur Burhan Prishtina.

– Asnjë, – i thashë i vendosur.

– Ne vetëm po të presim të na e tregosh të vërtetën, sepse ne e dimë të "vërtetën"– vazhdoi Burhani.

– Unë, ua thashë të vërtetën dhe tjetër të vërtetë nuk kam, – i përgjigjem Burhanit.

Unë besoja se shokët nuk kanë folur për librat që kishim pasur nëpër duar dhe se kjo ishte vetëm përpjekje e udbashëve për ta mësuar të vërtetën se a kisha lexuar apo jo literaturë patriotike e revolucionare.

Çuditërisht, për Ferki Morinën nuk më pyesnin! U kisha thënë në fillim se e njihja dhe ata nuk e zgjatën shumë rreth tij.

Ditën e parë, hetimi vazhdoi gjithë ditën dhe gjithë natën. Pyetjet që m'i bënin, ma ngjallnin dyshimin se ata ishin në kërkim edhe të njohjes së bindjeve të mia politike. Ata m'i kishin marrë disa nga librat e mia dhe si duket i kishin shikuar shënimet, nënvizimet dhe citatet e zgjedhura, me kujdes të madh. Filluan të m'i nxirrnin përpara disa nga shënimet që kishin bërë në nënvizimet e mia nëpër libra dhe të më pyesnin se ç'kisha menduar kur e kisha lexuar këtë libër, se ç'mendim kisha për këtë pikëpamje të Marksit, Engelsit Leninit, Kardelit etj.

Gjithnjë e më shumë po bindesha se sa frikë kishin njerëzit e UDB-ës së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë nga veprat e Karl Marksit, Fridrih Engelsit dhe filozofët tjerë përfaqësues të materializmit dialektik dhe historik! Unë kishte kohë që e kisha kuptuar se udbashët dhe pararoja e tyre e "kuqe", i kishin tradhtuar, idealet dhe përpjekjet e popujve të Jugosllavisë për një botë të lirë, të barabartë dhe për një vëllazëri të vërtetë në mes popujve.

Megjithëkëtë, e konsideroja se në këtë "fatkeqësi," që më kishte gjetur, kishte edhe një të mirë: ata nuk më kishin gjetur asnjë libër të ndaluar. Sa për librat që m'i kishin marrë, nga biblioteka ime, si disa libra të Karl Marksit, Fridrih Engelsit, Vladimir Iliç Leninit dhe disa libra e fletore të shënimeve, nuk "shqetësohesha" shumë, ndonëse nuk e dija se ç'kanë gjetur të shënuar e nënvizuar nëpër libra dhe fletoret e shënimeve! Druaja mos kisha shënuar ndonjë "mendim" në kundërshtim me vijën e LKJ-së! Përndryshe, librat në fjalë i kisha edhe literaturë të studimeve. Provimet e lëndëve si *ekonomia politike, marksizmi dhe sociologjia* nuk mund të kaloheshin pa e studiuar, bie fjala, *Kapitalin* dhe veprat e autorëve tjerë. Kisha frikë mos kisha shënuar ndonjë mendim kritik kundër disa librave të Kradelit! Kjo më mbante në ankth. Në anën tjetër isha shumë i lumtur që nuk ma kishin gjetur librin e Ajet Haxhiut "Shota dhe Azem Galica", revistën "Ylli", "Shqipëria e re" apo ndonjë libër tjetër të ndaluar, që kisha pasur nëpër duar.

Të nesërmen, e vazhduan bisedën me mua Hajriz Mazhiqi dhe Beçir Voca. Hajrizi ishte pispillosur.

Gjatë kohës së hetimeve udbashët shpeshherë flisnin turqisht me njëri-tjetrin. Ma merrte mendja se flisnin diçka për mua, por unë nuk i merrja vesh. Unë e merrja me mend se turqishtja ishte si gjuhë koordinimi për punën e tyre. Megjithëkëtë, e folura turqisht, tek unë, krijonte edhe më shumë frikë dhe pasiguri.

Si duket këtë e kishte kuptuar edhe udbashi Hajriz Mazhiqi i cili pas një bisede turqisht me një udbash tjetër me pyeti:

– A po të bezdisim që po flasim turqisht?!

Ç'ka t'i përgjigjesha, këtij derri të UDB-ës? Ju përgjigja me një "Jo" dhe nuk i thashë asgjë më shumë.

E folura turqisht ishte e qëllimshme. Mendja më shkoj se e gjithë kjo ishte një provokim. Ndoshta, thashë vetë me vete, udbashët presin mos po gabojë dhe po flas ndonjë fjalë kundër minoritetit turk! Mirëpo unë se kisha ndërmend të gaboja në këtë çështje. Le të flasin në cilën gjuhë të duan, i thashë vetës sime. Turqishtja s'kishte ngelur më shumë se një njollë mbetjesh të zeza në ujin e pastër të oqeanit shqiptar.

Në një rast tjetër, udbashi Hajriz Mazhiqi më tha me mburrje, se udbashi Burhan Prishtina ishte edhe sekretar LKJ-së në Shërbimin e Sigurimit të Shtetit Jugosllav, Dega në Mitrovicë.

Ky lajm edhe nuk më befasoi. Pushtuesit serbë, ashtu si edhe pushtuesit tjerë, gjithmonë i kanë përdorur në punët e tyre antishqiptare, mohuesit më të mëdhenj të përkatësisë së tyre kombëtare, qofshin ata që mbaheshin si turq, boshnjak e të tjerë. S'kisha asnjë fije dyshimi se Burhan Prishtina ishte një bastard i tillë. Këtë e kisha parë gjatë hetimeve ndaj meje, ku ai shquhej me përkushtimin dhe zellin e madh që tregonte për të zbuluar gjithçka që ishte në llogari të shtetit jugosllav. Burhan Prishtina, nuk e fshihte urrejtjen e madhe që kishte për kundërshtarët e regjimit jugosllav, sidomos për ne shqiptarët; ai dukej sheshazi se ishte një turkoshak dhe antishqiptar i tërbuar.

Më vonë, udbashi Hajriz Mazhiqi më pyet se a e kisha dëgjuar ndonjëherë emrin e Aziz Zhilivodës.

Sapo e dëgjova emrin e Aziz Zhilivodës, mendja me vajti tek një histori që e kisha dëgjuar nga nëna ime dhe që kishte lidhje me emrin e tij. Pa menduar mirë domethënien e saj, nisa t'ia rrëfej udbashit:

– Nëna ime më ka treguar se policia dhe ushtria i kishin urdhëruar të gjitha gratë dhe fëmijët e fshatit Hade dhe të fshatrave përreth Artakollit, të shkonin në Malin e Qyqavicës dhe ta kërkonin Aziz Zhilivodën. Në atë rast policia dhe ushtria i kishte vendosur gratë dhe fëmijët para ushtarëve dhe policëve...

E pashë se iu prish fytyra udbashit. E kuptova se kësaj radhe gabova shumë dhe se nuk do të duhej t'i tregoja këtë histori këtij hyzmeqari të pushtuesit. Udbashi Hajriz Mazhiqi, ende pa e komentuar domethënien e asaj që po i rrëfeja, më ndërpreu:

– A do të thoni, me këtë, se ushtria dhe policia jugosllave është frikësuar nga krimineli Aziz Zhilivoda dhe i ka përdorur gratë dhe fëmijët si mburojë? – mu drejtua Hajriz Mazhiqi dhe m'i nguli sytë.

Mornicat ma pushtuan trupin! Mora frymë dhe po përpiqesha ta balancoja ngrohjen që ma kishe kapluar trupin me ndihmën e ajrit që po thithja dhe po mendoja se ç'përgjigje t'i jepja.

–Jo, unë vetëm të tregova se çka kam dëgjuar për Aziz Zhilivodën, – i thashë, Hajriz Mazhiqit.

Ndjehesha i zemëruar në vetën time për faktin se serish kisha gabuar. Megjithëkëtë, pa dëshirën time, në kokë më silleshin një mori historish që kisha dëgjuar nga heroizmat e Aziz Zhilivodës. S'kisha asnjë fije dyshim se dikur Aziz Zhilivoda kishte qenë një legjendë e rrethit të Artakollit dhe tmerri i serbomëdhenjve e shërbëtorëve të tyre. Por, po e kuptoja, gjithashtu, se këtu nuk ishte vendi e as momenti të flisja e as mendoja për trimëritë e tij.

Në ndërkohë, gjersa po më hetonte Hajriz Mazhiqi, një udbash tjetër, mjaftë i shtyrë në moshë dhe fare tullacë, hyri në dhomën tonë dhe nuk u prezantua fare. Unë u ngrita në këmbë dhe kështu bëra edhe kur erdh dhe u futë në dhomë herën e dytë. Mirëpo kur tullaci u futë në dhomë për herë të tretë, nuk u ngrita në këmbë. Sikur mos ngritja në këmbë të ishte një gabim, udbashi tullac mua afrua e më pyeti se përse s'po ngrihesha në këmbë dhe ende pa u përgjigjur në pyetjen e tij, m'i dha një seri grushte fytyrës dhe trupit, gjersa u lodh e u mbushë me frymë?! Pas kësaj doli nga dhoma dhe na la aty të vetëm mua dhe Hajriz Mazhiqin.

Udbashi Hajriz Mazhiqi, vetëm shikonte dhe priste se si do të reagoja.

Unë e fshiva fytyrën dhe u ula në karrigen time që ishte përballë tavolinës së Hajriz Mazhiqit. Pas një heshtje e theva akullin dhe nisa të flas përsëri me "mikun" tim.

–Tani filluat me grushte? – i thashë Hajriz Mazhiqit.

Ai lëvizi krahët lartë sikur të mos kishte parë asgjë dhe sikur të mos kishte ndodhur fare ai vetë në dhomë!

– Unë s'kam se çka t'ju them. Tani vazhdoni me mënyrën që dini! – ia ktheva Hajriz Mazhiqit.

Grushtet që m'i dhuroi udbashi dhe që s'ia mësova kurrë emrin, sikur ma tërhoqën vërejtjen që të isha shumë i kujdesshëm se çka po flisja. Ata më shkaktuan jo vetëm dhembje, por edhe "frikën" gjer në palcë. Njëkohësisht, grushtet ishin edhe si kambanë alarmi. Historinë që kisha dëgjuar për Aziz Zhilivodën nuk është dashur t'jua thosha udbashëve. Por tani ishte vonë, – thosha vetë më vete.

Sa më shumë që qëndroja aty po e kuptoja se udbashët ishin profesionistë në punën e tyre, se ata ishin aktorë të vërtetë dhe dinin t'i luanin të gjitha rolet që ua besonin padronët e tyre.

Gjatë hetimit i vije radha të më merrte në pyetje edhe një udbashi me përkatësi kombëtare serbe, që quhej Momë . Ai ishte nga fshati Gojbulë i

Komunës së Vushtrrisë. *Zemlaku*[4] e filloi bisedën në serbisht, por pas përgjigjes sime vazhdoi të më flas në gjuhën shqipe, të cilën e fliste mirë dhe rrjedhshëm.

Edhe Moma, m'i dha po ato "këshilla" që i kisha dëgjuar edhe nga shokët e tij. Moma bënte gjithashtu përpjekje që të më lidhte me fjalën time, pra që unë t'ia jepja besën e shqiptarit se do t'ia thosha të vërtetën! Duke e parë "merakun" e tij , "i premtova" se do të tregohesha i "sinqertë" dhe se nëse kisha për t'ju thënë diçka do t'ia thosha në "besë" *Zemlakut* tim! Vetë me vete më shkonte mendja se vallë çka mendonte ky djall se unë shihja ndonjë dallim në mes të tij dhe kolegëve të tij? Harronte Moma se për mua ata të gjithë ishin njerëz të pushtetit jugosllav dhe armiq të shqiptarëve dhe lirisë së tyre!

Ditën e dytë, më nxorën nga dhoma ku më kishin marrë në pyetje Hajriz Mazhiqi, Beçir Voca, Sylejman Arifi, Burhan Prishtina, Zenun Shala e Moma dhe më dërguan në dhomën e shefit, Faruk Mehmeti. Dhoma e shefit ishte më speciale: kishte kolltukë lëkure ngjyrë të zezë dhe dysheme ngjyrë të gjelbër. Kryeudbashi Faruk Mehmeti më priti i mërrolur dhe hijerëndë.

Pyetja e parë që më bëri "shefi" ishte:

– A e di ti se çka shkruan në hyrje të portës së burgjeve turke?

I habitur nga pyetja, por edhe meqë nuk kisha idenë se çka shkruante në derën e burgjeve turke, ju përgjigja pa u përpjekur ta gjeja se çka shkruante:

– Jo, nuk di!

– *Këtu nuk ka Zot!* – lëshoi një britmë i xhindosur shefi i udbashëve dhe më shikonte drejt në sy si një statujë.

– Nuk kam dëgjuar asnjëherë, – ju përgjigja.

Kryeudbashi Faruk Mehmeti vazhdonte të dukej i mërrolur e hijerëndë! Unë nuk po e kuptoja se a ishte përgjigja ime e pamend apo e gjithë kjo ishte vetëm një lojë e taktikës së punës së tij? Ende pa arritur ta kuptoja motivin e reagimit të tij, shefi i UDB-ës i ra tavolinës me kërbaç të zi si korbi dhe pastaj e tundi kërbaçin në ajër dhe mu drejtua:

– Kjo do të thotë se kur njeriu hynë në burg nuk mund ta kërkojë mëshirën e Zotit!

Dhe përsëri e tundi shkopin në ajër dhe pastaj i ra tavolinës me gjithë forcë sa ushtoi e gjithë zyra e tij. Unë, nuk nxora fjalë nga goja. Shefi i UDB-ës vazhdoi:

– Unë të mbys, nëse nuk e thua të vërtetën! Unë s'jap llogari para asnjërit...Unë jam Zoti dhe shteti!

S'dija se çka t'i thosha. Vetëm prisja se do të vazhdonte edhe ky aty ku e kishte nisur një shërbëtor i tij. Nuk e kisha ndërmend t'i kërkoja mëshirë dhe nuk kisha frikë as nga ai e as nga Zoti i tij, meqë ai e identifikoi shtetin e tij me Zotin! Vetën e ngushëllova duke i thënë: shtrëngohu Asllan se të erdhi koha të tregosh se ç'burrë je...

– Jam i "pafajshëm" dhe kam bindjen se ata që s'kanë bërë faje nuk mund të trajtohen si të burgosurit në burgjet turke, – ia ktheva me gjakftohtësi shefit të UDB-ës.

Faruk Mehmeti vazhdoi me britmat, me sharjet dhe me tundjen e kërbaçit në ajër.

Papritur trokiti dera e dhomës së shefit. Kryeudbashi Faruk Mehmeti, u ndal dhe e urdhëroi atë që trokiti të hynte brenda. Edhe unë së bashku me shefin e UDB-ës e ktheva shikimin kah dera. Pas britmave të kryeudbashit prisja se do të hynte ndonjë tjetër udbash me ndonjë hu në dorë, por tek dera pashë një njëri të panjohur, një burrë të thinjur dhe me një fytyrë të thatë. U prezantua se ishte Sefedin Batalli dhe sikur të kishte qenë së bashku me ne brenda në dhomë, nisi bisedën aty ku e kishte lënë në gjysmë shefi i UDB-ës së Mitrovicës dhe m'u drejtua:

– Dua të më tregosh se a e ke lexuar librin e Ajet Haxhiut "*Shota dhe Azem Galica"*? Ma thuaj të vërtetën, sepse ky libër edhe nuk është i ndaluar! Mos harro se unë e di të vërtetën dhe vetëm po e provoi sinqeritetin tënd!

E vërteta ishte se unë e kisha lexuar librin jo njëherë por dy herë dhe e dija se ajo përralla këtij gjarpri të ri, se gjoja libri na qenka i "lejuar," ishte një gënjeshtër udbeske dhe vetëm një kurth e tij, ashtu siç ishte një kurth edhe pjesa tjetër e fjalisë ku ai kërkonte që unë të isha i sinqertë sepse gjoja ai e dinte të "vërtetën." Unë besoja se përmendja e librit "Shota dhe Azem Galica" ishte vetëm një përpjekje për të me befasuar se gjoja ata e dinë se unë e kisha lexuar librin! Përkundër faktit se e kisha lexuar librin, vendosa të mos e pranoj një gjë të tillë. Ma merrte mendja se nëse e pranoj se e kam pasur në dorë librin e " Shota dhe Azem Galica", unë vërtetoj se kam lexuar edhe libra të tjera të ndaluara dhe kështu i nxirrja shumë telashe vetës. Besoja se shokët nuk e kanë pranuar se ma kanë dhënë librin dhe se kjo mund të ishte informatë e ndonjë informatori të UDB-ës.

– Jo, nuk e kam lexuar, – i thashë i vendosur.

Nuk vonoi shumë dhe më nxorën nga dhoma e shefit dhe më vendosën në një dhomë tjetër. Aty më mbajtën deri pasdite. Rreth orës tre pasdite më dërguan në burgun e Mitrovicës, që ishte rreth dy-treqind metra nga Stacioni i Policisë. Gardianët e burgut hapën disa dyer metalike me grila dhe më në fund me futën në një dhomë. Aty më lanë të vetëm.

Të nesërmen në mëngjes më sollën përsëri në Stacionin e Policisë dhe vazhduan hetimet. Ditën e filluan me kërcënime. Më flisnin se ç'fat i pret armiqtë e Jugosllavisë socialiste dhe vetëqeverisëse. Kjo m'u dukë shenjë e mirë. Dikur afër mesit të ditës, udbashi Hajriz Mazhiqi sikur bëri edhe një kthesë tjetër dhe nisi të bëhej më njerëzor, madje edhe human! Ai shkoi aq larg, me zemërgjerësinë e tij, sa u tregua i gatshëm të më "ndihmonte" edhe me dhënien e provimeve, nëse do të kisha ndonjë vështirësi në shkollë. Oferta ishte shumë interesante. Udbashët po ma hapnin derën të bëhesha spiun i tyre.

– Nuk ka problem për ne. Nëse ke problem në ndonjë lëndë studimi, eja dhe na kontakto dhe ne të ndihmojmë, – më tha në fund të marrjes në pyetje, ditën e tretë, udbashi Hajriz Mazhiqi.

Pas gjithë atyre akrobacive, herë lavdërime, herë kërcënime e herë oferta për ndihmë, më nxorën nga dhoma e marrjes në pyetje dhe zbritën poshtë në katin përdhes. Aty m'i bënë dy-tre fotografi dhe m'i morën gjurmët e gishtërinjve. Më kthyen serish në katin e dytë dhe pas një pritje rreth një gjysmë ore më liruan.

– O ç'gëzim ma pushtoj zemrën, – Përsëri i "lirë"! – thashë vetë me vete.

Nga Stacioni i Policisë, që gjendej në veriperëndim të Mitrovicës, ika me vrap tek halla Fazë, që banonte në lagjen Bair, që gjendej në juglindje të Mitrovicës, pak përtej *Varrit të Kangjallozit*[5]. Aty mora vesh se edhe halla Fazë kishte dëgjuar se *në burg ndodhej edhe djali i dajës Hajdar*. Nuk e komentova më shumë me hallën dhe njerëzit që takova aty çështjen e Ferkiut. Unë vetëm shpresoja se edhe ata do të lirohen, ashtu si u lirova unë.

Pas një qëndrimi të shkurtër, tek halla Fazë, u nisa në drejtim të Stacionit Hekurudhor të Mitrovicës prej nga do ta merrja trenin për shtëpi.

Nëna u gëzua shumë kur më pa se u ktheva në shtëpi.

Në shtëpi, mësova sërish se Ferkiu edhe më tutje ndodhej në burg.

Prindërve të mi ua shpjegova arrestimin tim vetëm, si çështje hetimi:

– Policia dyshonte se i njihja disa shokë të shkollës, të cilët mora vesh se ishin burgosur, por ajo u bindë se unë nuk kisha kurrfarë lidhje me ta dhe më liroi!

Në pritje të lirimit të shokëve

Disa ditë më vonë e mora vesh se në burg nuk mbaheshin vetëm Dani dhe Ferkiu, por edhe shumë të tjerë. Në Prishtinë, dëgjova se numri i të arrestuarve ishte shumë më i madh nga numri që e merrja me mend; se arrestime kishte pasur në të katër anët e Kosovës.

Sapo u kthye nga puna, im atë, më njoftojë se nga Ismet Jashari, nga fshati Strofc, kishte dëgjuar se ishin burgosur dy kushërinj të tij: një ish i burgosur politik, që quhej Shefqet Jashari dhe një tjetër që ishte student dhe quhej Demë Jashari. Gjithashtu, nga im atë mësova se nga i ati i Ferkiut i kishte dëgjuar se në burg po mbahej edhe një kushëri i Danit, që quhej Latif Pllana.

Lajmin për burgosjen e Shefqet Jasharit dhe Demë Jasharit, e vërtetova edhe nga *Hoxha i Vogël*, të cilin e takova disa ditë pas lirimit tim. *Hoxha i Vogël* më tha fjalë shumë të mira për Shefqet Jasharin. Ai e njihte Shefqet Jasharin si një burrë të urtë dhe kishte dëgjuar shumë fjalë të mira për atë edhe nga bashkëfshatarët e tij, sidomos nga mësuesi i shkollës fillore "Liria" në Strofc, Sheremet Saraçi.

Gjatë atij takimi, *Hoxhën e Vogël* e kam njoftuar, deri në detaje, se si pata kaluar gjatë arrestimit dhe se çka kërkonte nga unë UDB-a. *Hoxha i Vogël* ndjehej shumë i shqetësuar. Ai më kështilloi të tregohesha i kujdesshëm me njerëzit që po takohesha e bisedoja!

Fjalët e mira që i dëgjova nga *Hoxha i Vogël,* ma shtuan respektin për Shefqet Jasharin, të cilin nuk e kisha takuar asnjëherë dhe nuk dija për të kaluarën e tij. Demë Jasharin e njihja dhe burgosja e tij edhe nuk më kishte befasuar shumë, ndërsa burgosja e Shefqet Jasharit po më befasonte. Për Shefqet Jasharin nuk më kishin folur asnjëherë as Dani e as Ferkiu.

Ato që dëgjova, për Shefqet Jasharin, po ma ngacmonin idenë se mos Dani dhe shokët tjerë, kanë qenë pjesëtarë të ndonjë organizate revolucionare? Më befasonte fakti se gjatë mbajtjes në arrest, udbashët nuk e kishin përmendur emrin e ndonjë organizate "armiqësore"! As Dani dhe Ferkiu nuk më kishin folur për ndonjë organizatë ilegale. Ndoshta, i përgjigjesha vetës, Dani dhe Ferkiu, nuk më kanë folur asgjë për emrin e organizatës, sepse ata nuk më kanë njohur sa duhet dhe kanë pritur që koha të dëshmojë se kush isha? Ky qëndrim i shokëve më pëlqente dhe më dukej si shprehje e pjekurisë së tyre.

Në prag të Vitit të Ri 1979, nga një student në Fakultetin Ekonomik, dëgjova se UDB-a kishte tentuar ta arrestonte edhe poetin, gazetarin dhe këngëtarin e njohur Jusuf Gërvalla, mirëpo ai ishte arratisur dhe nuk dihej se ku fshihej. Në fakultet dëgjova, gjithashtu, se policia kishte dështuar, edhe në përpjekjen e saj,

për arrestimin e një ish të burgosuri politik dhe shoku të Adem Demaçit, që quhej Sabri Novosella, i cili gjithashtu ishte larguar nga shtëpia dhe fshihej diku, larg syve të policisë.

Menjëherë pas lirimit nga paraburgimi, më kishte shkuar mendja ta takoja, të vëllanë e Danit – Xhemën. Mirëpo, meqë gjatë hetimeve kisha deklaruar se nuk e njihja Danin, shkuarja ime në shtëpi te tij dhe zbulimi eventual i kësaj nga ana e policisë, mendoja, se do të ishte e dëmshme jo vetëm për mua e Xhemën, por edhe për shokët në burg. Prandaj, vendosa të tregohesha i përmbajtur dhe të pritja gjersa do të vinte ndonjë kohë më e përshtatshme për ta takuar Xhemën.

Më duhet pranuar se qëndrimi në paraburgim e ballafaqimi me udbashët profesionist, ishte një sfidë e madhe për mua. Ndonëse se më liruan, unë nuk isha i kënaqur me qëndrimin tim dhe dyshoja se gjatë ditëve të hetimit, pa qëllim dhe falë papjekurisë sime, i kisha zbuluar, para udbashëve, bindjet e mia politike! Ma thoshte mendja, se librat e gjetura në shtëpi, nënvizimet dhe shënimet e mia në to, ishin prova të mjaftueshme për të më ndjekur, hap pas hapi, në të ardhmen. Prandaj, përkundër lirimit, këtë e konsideroja si një të keqe të madhe për të ardhmen time politike!

Ç'është e vërteta, unë kam qenë shumë i papërgatitur për t'u përballur me UDB-ën dhe gjithçka më dukej si një ndeshje e pabarabartë. Ata ishin profesionist në punën e tyre , ndërsa unë një "amator" entuziast; ata punonin si ekip, ndërsa unë isha i vetëm; ata ishin të paguar për ta vrarë lirinë, ndërsa unë i brumosur me dashurinë për lirinë, shokët dhe çlirimin e vendit tim.

Mirëpo përkundër kësaj nuk ndjehesha i dëshpëruar, përkundrazi isha krenar. Ndjehesha krenar sepse asnjë nga shokët që kisha, pos Danit, Ferkiut dhe Latës, nuk u zbuluan. Tre ditë në "gojë të ujkut" më dukeshin si një shkollë e madhe për mua dhe unë mendoja se këtë përvojë duhej, patjetër, t'jua përcillja edhe shokëve që i kisha në "liri".

Meqë unë kisha shpëtuar, atë që mund të shpëtoja, dhe asnjë nga shokët e mi nuk ishte zbuluar nga udbashët si dhe duke pasur parasysh përvojën e vlefshme të përballjes me udbashët, nga ky këndvështrim fitoren e bartja në anën time. Ata më zbuluan mua, por kurrë nuk do t'i zbulojnë shokët e mi dhe lufta për liri do të vazhdojmë deri në fitore! – i thosha vetës sime.

Kthimi në "liri" dhe përvoja e përballjes me udbashët, në kokën time, më futi në mendime se si duhet të punojmë në të ardhmen. Puna e parë, që duhej ta bëja, mendoja se duhej të ishte nxjerrja mësime nga gabimet që i kisha bërë, gjatë marrjes në pyetje nga udbashët. Pra, unë duhej t'ju rrëfeja shokëve se si nuk duhet t'i bëjnë gabimet e mia dhe se si ata duhet të punojnë që të mos bien në "gojë të ujkut"?! Kur të lirohen Dani, Ferkiu, Lata, Shefqeti, Dema dhe shokët tjerë, shumë gjëra duhet t'i bëjmë më ndryshe nga ato që i kemi bërë gjer me tani, i thosha vetës. Duhet ta flakim tutje veprimtarinë pothuajse legale që kisha bërë, gjer me tani, dhe ta forcojmë disiplinën dhe konspiracionin e punës sonë. Unë, bie fjala, librat dhe revistat e ndaluara nuk duhet t'jua tregoja miqve dhe dashamirëve, ashtu siç kisha bërë gjer me tani, dhe se një gjë të tillë duhet ta

bëjnë edhe shokët. Nuk duhet të takohem me shokët në vendet publike, ashtu siç isha takuar me Danin dhe Ferkiun. Armiku na do në burg sepse nga burgu ne nuk mund të bëjmë asgjë kundër tij!– i thosha vetës.

Pas lirimit tim, sipas zakonit, vërshuan të afërmit dhe miq për të më vizituar në shtëpi, thuajse kushedi se çka kishte ndodhur! Unë besoja se shumë prej tyre ishin njerëz të mirë dhe që vinin për ta ngushëlluar familjen, apo këtë e bënin për t'i ndjekur traditat tona, sa të mira aq të vjetra, por që nganjëherë ishin edhe të bezdisshme. Por unë nuk kisha fuqinë t'i ndaloja ata të vinin. Njerëzit vinin pa të pyetur e për të qëndruar pranë dhe ne nuk na ngelte tjetër pos t'ua hapnim derën dhe t'u dëshironim mirëseardhje. Mirëpo isha i bindur se në mesin e atyre që do të vinin, do kishte ndonjë që do ta dërgonte UDB-a. Tani e merrja me mend se UDB-a do të përdorte të gjitha fijet për ta marrë informacionin që i duhej. Unë, tashmë isha i bindur, më shumë se asnjëherë më parë se UDB-a, për fatkeqësinë tonë, kishte edhe disa shpirtshitur që i shërbenin me zell të madh!

Nga ata që më erdhën për vizitë, dolën edhe disa, që mund të numëroheshin në gishtat e një dore, që më bënë pyetje që unë nuk dëshiroja të përgjigjesha. Falë dyshimit se jo të gjithë ata që më vinin për vizitë ishin miq, në përgjithësi, unë e kalova mirë këtë "mbikëqyrje" në shtëpi nga UDB-a. Të gjithëve u thosha se mua më kishin marrë gabimisht dhe pasi e vërtetuan këtë më liruan:" Njeriu i pafajshëm e ka vendin në shtëpi, u thosha atyre që më pyesnin për kohën e arrestimit!"

Rinisja e kontakteve me shokë, ishte puna që më priste, por ajo ishte edhe një punë me rrezik, jo vetëm për mua por edhe për shokët. Të lirë ishin Xhema, Xhafa, *Hoxha i Vogël*, Rexha, Beda dhe Veba. Vendosa t'i takoj të gjithë e një nga një.

Në takimin e parë, Xhemën, e kam njoftuar lidhur me arrestimin tim dhe interesimin e udbashëve për veprimtarinë e Danit dhe Ferkiut, ashtu siç e kam njoftuar edhe për pyetjet që më ishin bërë në polici, për librat që i kanë marrë në gojë gjatë hetimeve etj.

Por nga takimi i parë, me Xhemën, e kam kuptuar, edhe më mirë, gjithë seriozitetin e gjendjes së krijuar, pas arrestimeve të nëntorit 1979. Xhema, ishte shumë i shqetësuar për mbajtjen në arrest të Danit, Latës, Ferkiut dhe shumë shokëve të tjerë, që unë nuk i njihja dhe nuk ua kisha dëgjuar emrat ndonjëherë. Ai ishte i mendimit se duhet të tregoheshim shumë të kujdesshëm. Duke pasur parasysh përmasat e arrestimeve, Xhema, druante se UDB-a kishte informacion të mjaftueshëm për veprimtarinë e shokëve dhe për t'i mbajtur ata në burg e ndoshta edhe për t'i dënuar një pjesë të atyre që ndodheshin në hetuesi.

Takimi, me Xhemën, më ndihmoi ta kuptoja gjendjen tonë dhe të isha më i matur në parashikimet e mia për informacionin që kishte UDB-a për veprimtarinë e shokëve tanë?! Xhema, më bëri të kuptoja se UDB-a dinte më shumë gjëra për shokët tanë, sesa dija unë. Nga Xhema dëgjova, për herë të parë, edhe ekzistimin e organizatës "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi". Edhe emri i organizatës në kuadrin e të

cilës kishin vepruar shokët, por siç po dukej kisha vepruar edhe unë, ishte një befasi e këndshme.

Ato ditë e kam takuar edhe Xhafën dhe i kam folur për arrestimin tim, për kohën e mbajtjes në arrest si dhe për arrestimin dhe mbajtjen në burg të shokëve të tjerë. Në atë rast, për herë të parë, Xhafës, i kam folur për kontaktet e mia me Danin dhe Ferkiun. Përkundër kësaj, Xhafa, u tregua kureshtar për ato që dëgjoi nga unë, por nuk më tha asnjë fjalë më shumë lidhur me arrestimet!

Brenda disa ditëve i kam takuar, një nga një, edhe Rexhën, Bedën dhe Vebën dhe të tre i kam njoftuar për arrestimin tim dhe burgosjen e shokëve.

Me të gjithë shokët jemi pajtuar që tani e tutje të mos takohemi në vende publike dhe që të tregohemi të kujdesshëm se me cilët flasim e nga kush marrim libra të ndaluar.

Xhemën, e kam takuar përsëri gjatë janarit 1980, në Shtitaricë. Një natë të ftohtë dimri qëndruam së bashku dhe biseduam për gjendjen tonë! Xhema, në atë rast, më njoftoi për lajmet që kishte marrë lidhur me Danin dhe shokët e burgosur. Ai më njoftoi se policia ende nuk kishte lejuar që familja ta vizitonte Danin. Kësaj radhe, Xhema, ishte edhe më pesimist për lirimin e shpejtë të shokëve. Ai dyshonte se grupit të shokëve të Danit, ishte duke ju përgatitur aktakuza dhe se disa prej tyre do të dënoheshin me dënime të rënda. Xhema ishte për kujdes të shtuar dhe për lëvizje të kufizuara. Ai dyshonte se edhe ai ishte i ndjekur nga njerëz të UDB-ës, ashtu siç më këshilloi edhe mua që të tregohesha edhe më shumë i kujdesshëm, sidomos me shokët që nuk ishin të zbuluar për policinë, pra që kontaktet me ta, në asnjë mënyrë, të mos i bëja në vende publike, por as në shtëpinë time.

Që nga takimi me Xhemën, kontaktet me shokët e krahut tim, i mbaja nëpër vende larg syve të UDB-ës, nëpër shtëpi të shokëve të pazbuluar dhe nëpër vende të tjera. Kontaktet me Xhafën i mbaja në shtëpi të tij e nganjëherë në vendin e quajtur *libar*[6] që ishte fusha me të mbjella në mes lumit Llap dhe Silnicë në mes fshatit Stanofci i Ultë, Prelluzhë, Lumi i Madh dhe Mihaliq. Gjithashtu edhe kontaktet me Rexhën i mbaja në fshatin Cërrnushë, në fshatin Stranë. Nganjëherë vinte Rexha në fshatin Lumi i Madh dhe aty takoheshim afër lumit Llap. Me Vehbiun nga Gradica e Drenicës, i shpërngulur në Gllogovc, kontaktet i mbaja nëpërmjet *Hoxhës* që ishin në mes vete kunetër. Zakonisht takoheshim në shtëpi të Hoxhës. Edhe kontaktet me Bedën i mbaja nëpërmjet shtëpisë së gjyshit të tij dhe burrit të hallës sime, Bahtir Selmanit. Unë shkoja për ta takuar hallën time dhe me Bedri Selmanin, e gjenim mundësinë dhe bisedonim vetëm.

Një thirrje e papritur në polici

Me 18 shkurt 1980 në shtëpi gjeta një thirrje, nëpërmjet të cilës urdhërohesha që me 20 shkurt në ora 08.00 të paraqitesha në Stacionin e Policisë në Prelluzhë!

Thirrja më shqetësoi shumë. Një ankth i madh më kaploi shpirtin. Vallë ç'të re kemi tani?!

Vajta në Stacionin e Policisë në Prelluzhë dhe policët më përcollën menjëherë me makinë në Stacionin e Policisë në Mitrovicë.

Sapo arritëm në Stacionin e Policisë në Mitrovicë, njëri nga udbashët, që bëri pranimin tonë, më shoqëroi në një dhomë të katit të dytë, aty ku edhe më kishin mbajtur gjatë 22 , 23 dhe 24 nëntorit 1979! Pas pak ai doli nga dhoma dhe më la të vetëm. Nuk vonoi shumë dhe në dhomë hyri hijerëndë Burhan Prishtina.



(emni e selija e organit që zhvillon procedurën) — (назив и седиште органа који води поступак)

Numri / Број 271.
Data / Датум 18. 02. 1980 v.

Ap-1
Oy-1

THIRRJE PËR PALËN — ПОЗИВ ЗА СТРАНКУ
(N. 81—86. LPA)
(ЧЛ. 81—86. ЗУП)

Asllan Behram Muharremi
(emri e mbiemri ose titulli) — (име и презиме односно назив)

nga / из Mihaliqi rr. / ул. ... nr. / бр. ..., позива се

thirret që të vijë personalisht ose ta dërgojë përfaqsuesin e vet zyrtar apo t'autorizuemin për ditën / да дође лично или да упути свог законског заступника односно пуномоћника на дан 20. 02. 1980 në / у 8 n'orën / час. у SSB-e Mitrovicë (rruga, numri e kati — улица, број и спрат) dhoma nr. / соба бр. 46 për / ради

VEREJTJE: / НАПОМЕНА:

Në rast pengese, i thirruni asht i detyruem me e njoftue për këte këtë organ. / У случају спречености, позвани је дужан да о томе одмах обавести овај орган.

Nëse i thirruni s'i gjegjet kësaj thirrjeje, do t'i pësojë pasojat ligjore. / Ако се позвани не одазове овом позиву, сносиће законске последице.

(V. V.) / (М. П.)

(nënshkrimi i personit zyrtar) / (потпис службеног лица)

– Çka ke dëgjuar për shkuarjen e Sheremet Saraçit në Turqi?– më pyeti menjëherë Burhan Prishtina.

Pyetja po më trondiste. U përpoqa ta ruaj gjakftohtësinë dhe të bëhesha se nuk di, se nuk më kujtohej se kisha biseduar për këtë çështje me ndonjë njëri, se nuk e njihja Sheremet Saraçin dhe se nuk dija se përse ka udhëtuar ai në Turqi.

– Nuk më kujtohet asgjë! Nuk e njoh Sheremet Saraçin dhe nuk kam dëgjuar se ai ka udhëtuar në Turqi, – i thashë Burhanit.

– Mos u përgjigj pa menduar mirë! Ne nuk flasim kot. Kemi fakte. Prandaj mendohu mirë dhe na thuaj të vërtetën,– ma tërhoqi vërejtjen Burhan Prishtina.

Ndjehesha shumë keq, qe besa edhe i zënë ngushtë. Unë e mbaja mend se kisha dëgjuar për këtë udhëtim të Sheremet Saraçit në Turqi. Këtë e kisha dëgjuar nga Hoxha i Vogël. Por nuk guxoja ta pranoja një gjë të tillë. Më duhej të mbahesha se nuk dija gjë për këtë çështje dhe kështu bëra.

Udbashët hynin e bisedonin me mua dhe dilnin e vinin pas disa orësh.

Atë ditë, gjithë ditën, më mbajtën në lokalet e Stacionit të Policisë në Mitrovicë, deri vonë pasdite. Pasdite më liruan.

***

Pas lirimit, ditën e nesërme, e kam takuar *Hoxhën e Vogël* dhe i kam treguar se përse jam marrë në pyetje nga UDB-a në Mitrovicë. Në atë rast *Hoxha i Vogël* më ka njoftuar se edhe ai dhe Sheremet Saraçi ishin marrë në pyetje nga udbashët lidhur me çështjen e udhëtimit të Sheremet Saraçit në Turqi. *Hoxha i Vogël* më tha se kishte biseduar edhe me Sheremet Saraçin dhe se asnjëri prej tyre nuk kishte pranuar se kishin biseduar me njëri-tjetrin për këtë çështje. Sheremet Saraçi nuk kishte pranuar se me njihte. Ai e kishte pranuar se kishte udhëtuar në Turqi për çështje private.

Marrja në pyetje gjatë gjithë ditës dhe vet mënyra e thirrjes në Stacionin e Policisë në Prelluzhë ma futi edhe njëherë frikën në palcë. Kjo thirrje e papritur sikur më paralajmëroi se ende nuk kishin marrë fund hetimet për shokët që ndodheshin në burg dhe për mua që ndodhesha jashtë tij. Njëkohësisht kjo ishte edhe një paralajmërim se duhet të tregohesha tepër i kujdesshëm sepse udbashët i kisha pas vete kudo e në çdo hap.

***

Diku në fillim të pranverës i kam rivënë përsëri kontaktet me Xhemën. Nga Xhema jam njoftuar se disa anëtarëve të familjes ishin lejuar ta vizitonin Danin në burg. Xhema ishte shumë i shqetësuar për vazhdimin e mbajtjes në burg të shumë shokëve. Ai besonte se tani po përgatitej gjyqi kundër tyre. Ende mbaheshin në burg: Dani, Lata, Ferkiu dhe Shefqeti.

Që nga arrestimi i 22 nëntorit 1979, pothuajse nuk kam zhvilluar ndonjë aktivitet të rëndësishëm. E vetmja punë që kam bërë, gjatë kësaj kohe, ka qenë mbajtja e kontakteve me shokë dhe këmbimi i ndonjë libri që na ka rënë në dorë. Unë isha në pritje se çka do të bëhej me shokët që ndodheshin në burg? A do të liroheshin apo do të dënoheshin ata?

Lirimi i Ferki Morinës

Sapo u kthye nga puna, im atë, më njoftoi se ishte takuar me dajën Hajdar dhe nga ai kishte marrë vesh se ishte liruar nga burgu Ferkiu(18 prill 1980).

Lajmi më gëzojë shumë. Gjithashtu, u mbusha me shpresë se mos po i lirojnë edhe shokët tjerë. Gjithë natën e kam kaluar pa pikë gjumë dhe duke shëtitur në mendime poshtë e lartë.

Të nesërmen, e mora trenin e orës dhjetë dhe u nisa për Akrashticë.

Në shtëpinë e tij, Ferkiun e gjeta së bashku me të gjithë anëtarët e familjes së tij, që ishin të gëzuar për lirimin e tij. U përqafuam fortë e me mall. Ferkiu ishte i zbehtë në fytyrë dhe mezi ecte. Përkundër kësaj, Ferkiu nuk ankohej. Dukej i fortë dhe në anën psikike. Gjatë takimit të parë, ai nuk ma tha asnjë fjalë për trajtimin që i kishin bërë gjatë hetimeve. Vazhdonte të fliste, pak e saktë, ashtu siç e kishte pasur zakon gjithmonë!

Ferki Morina

Ndonëse Ferkiu nuk më tha asnjë fjalë për torturat që i kishin bërë, isha shumë i sigurt se ai kishte kaluar nëpër një trajtim të egër. Për këtë fliste vetë gjendja e tij shëndetësore.

Sapo ngelem vetëm më pyeti për shokët dhe se ç'kishte ndodhur gjatë këtyre muajve sa kishte qëndruar në burg? Ai e dinte se Dani ishte arrestuar, por nuk dinte se ç'kishte ndodhur me shokët tjerë dhe cilët prej tyre ishin paraburgosur.

U ktheva në shtëpi, i shqetësuar shumë për shëndetin e Ferkiut. Mbajtja në paraburgim dhe nën hetime për pesë muaj rresht, deri diku më fliste vete se pse

është mbajtur aq gjatë në burg. E merrja me mend se Ferkiu "nuk ka folur më sa guri" dhe kjo mund të ketë qenë arsyeja që i ka tmerruar udbashët , prandaj kriminelët e kanë "shpërblyer" me torturë të egër dhe paraburgim të gjatë.

Se si e kanë trajtuar në burg hetuesit e kam marrë vesh disa ditë më vonë, gjatë një vizite të re që i bëra Ferkiut në shtëpinë e tij. Së bashku me Ferkiun dolëm në kodrën mbi fshat dhe në atë rast mora vesh se hetuesit dhe torturuesit e tij kishin qenë Ibush Kllokoqi, Sylejman Arifi, Faik Nura dhe Burhan Prishtina. Ferkiu më ka thënë se gjatë hetimeve:

–Udbashët e bënin punën e tyre dhe përpiqeshin të zbulonin gjithçka nga unë, por edhe unë e bëja punën time dhe e mbaja gojën të mbyllur!

Isha i mahnitur me qëndresën e tij. Ferkiu, i ka ditur të gjitha aktivitetet e mia, të gjitha librat dhe gazetat e ndaluara, që i kemi pasur nëpër dorë, por udbashëve nuk ua ka thënë asnjë fjalë! Ai e ka njohur rrethin e shokëve që kisha, por asnjë nga shokët e mi dhe të rrethit të tij nuk është paraburgosur. Kjo më bënte krenar.

Gjatë atij takimi, në bisedë e sipër, Ferkiu më ka folur për mënyrën e torturimit:

– Gjatë hetimeve me mbanin të lidhur e më qëllonin me kërbaç shputave, shuplakave të duarve, barkut dhe shpinës. Meqë unë nuk flisja me ta, nuk i shikoja në sy dhe e refuzoja ushqimin, ata vinin dhe hanin ushqimin në dhomën e torturimit e hetimeve...

Mua më vinte keq për përjetimet e Ferkiut. Kur fillova t'i shaj udbashët Ferkiu u përgjigj:

– Nuk kam pritur se udbashët do të tregoheshin njerëzor me ne! Përkundrazi, ata kanë qenë dhe janë armiqtë e lirisë së popullit tonë dhe silleshin me ne ashtu siç u kanë thënë padronët e tyre. Për atë që bëjnë kundër nesh dhe popullit shqiptar, paguhen...

Duke dëgjuar Ferkiun unë po mbushesha edhe më me shumë urrejtje për udbashët dhe regjimin gjakatar të Titos.

***

Gjersa ishim në pritje të fatit të shokëve që ndodheshin në burgun e Prishtinës, folësit e të gjitha radiove dhe televizioneve të Jugosllavisë, lexonin komunikatat e Kolegjiumit të Mjekëve për gjendjen shëndetësore të satrapit Tito. Lajmet për gjendjen e satrapit Tito, ndryshonin nga dita në ditë. Një ditë flitej për përkeqësim, ditën tjetër për "përmirësim" dhe një ditë tjetër për gjendje shëndetësore të pandryshuar!

Pas disa javë lodhjeje dhe torture psikike të opinionit, me 4 maj 1980, u komunikua lajmi se satrapi Titoja kishte vdekur.

Vdekja e satrapit Titos, e përjetova si njëlloj "çlirimi". Këtë lloj "çlirimi" e ndjeja edhe tek shumë njerëz që takoja. Sikur të gjithë ishim çliruar nga një "mbret" që herë vishte rroba të kuqe, herë të bardha e herë të zeza, por që i kishte të përgjakura duart me gjakun e popujve të Jugosllavisë dhe sidomos me gjakun e popullit shqiptar.

Për mua dhe shokët e mi, Titoja ishte një kriminel, ashtu siç ishin të tillë edhe shumë udhëheqës të tjerë jugosllavë. Titoja ishte përgjegjës për vrasjen e mijëra shqiptarëve në masakrën e Tivarit, të mijëra të tjerëve pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, për shpërnguljen e mijëra shqiptarëve në Turqi dhe për rrahjen masive të burrave të Kosovës, gjatë aksionit të armëve të udhëhequra nga ministri i tij, Aleksandër Rankoviç. Satrapi Tito ka qenë përgjegjës edhe për ruajtjen dhe mos dënimin e doktrinës antishqiptare të shovinistëve serbë. Ideologë të kësaj doktrine antishqiptare si Vasa Çubrilloviç, Ivo Andriç e të tjerë kanë gëzuar privilegje dhe kanë ushtruar detyra të rëndësishme qeveritare në Jugosllavinë e Titos.

Mirëpo vdekja e Titos më ngjalli edhe shqetësime për të ardhmen e shqiptarëve në Jugosllavi. Vallë si do të reagojnë shovinistët serbë, pas vdekjes së satrapit Tito dhe boshllëkut që ka krijuar mungesa e tij në krye të LKJ-së dhe shtetit jugosllav?– e pyetja vetën time.

Me vdekjen e satrapit Tito m'u shtua droja edhe për shokët që ndodheshin nëpër burgje. Shqetësohesha për qëndrimin që do të mbajnë prokurorët dhe udbashët ndaj të burgosurve. Prisja se shumë prej tyre do të egërsohen në emër të besnikërisë ndaj rrugës së Titos dhe me qëllim të frikësimit të armiqve të brendshëm e të jashtëm...

Ditët pas vdekjes së Titos në "Zërin e Amerikës" dhe radiostacionet e vendeve të Evropës Perëndimore, në gjuhën serbo-kroate, dëgjoheshin zëra dhe analiza të ndryshme të cilat paralajmëronin shkapërderdhjen e Jugosllavisë së pas Titos!

Unë kisha frikë se shovinistët serbë do ta shfrytëzonin mungesën e Titos për ta kthyer pozitën e tyre dominuese në Jugosllavi. Shpresoja se udhëheqja e shtetit shqiptar nuk ishte zënë në gjumë dhe se Shqipëria do të na del në ndihmë, nëse vije gjer tek ndonjë përkeqësim i gjendjes në viset shqiptare në Jugosllavi. Përndryshe unë e dija se serbomëdhenjtë ishin të armatosur gjer në dhëmbë dhe ne nuk ishim fare të përgatitur ushtarakisht.

***

"Rilindja" njoftoi se pas mbajtjes së seancës kryesore publike në Gjyqin e Qarkut në Prishtinë me 3-4 qershor 1980, se me 4 qershor ishte shpallur aktgjykimi kundër Shefqet Jasharit, Ramadan Pllanës dhe grupit të shokëve të "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi", se Shefqet Jashari ishte dënuar me tetë vjet burg, Ramadan Pllana me shtatë vjet burg dhe shokët tjerë kishin marrë dënime të tjera të rënda.

Dënimet ishin shumë të gjata. Shatë vite burg për Danin, më dëshpëruan shumë. Dënimi ishte shumë i rëndë.

Disa ditë më vonë, për vajtjen e procesit gjyqësor më ka njoftuar Xhema, i cili ishte lejuar të merrte pjesë në procesin gjyqësor kundër shokëve të LNÇKVShJ-së, si anëtar i familjes.

Ndjeja një dhembje të madhe për Danin, por isha edhe krenar që e kisha pasur shok. Burgosjen e Shefqet Jasharit, Ramadan Pllanës dhe shokëve të tjerë e konsideroja si një humbje të madhe për Lëvizjen tonë. Me qindra herë jam betuar, para vetës sime, se do të bëja gjithçka që do të ishte në mundësitë e mia për ta kompensuar mungesën e tyre!

Dënimi i Danit, torturat ndaj Ferkiut dhe sharjet e britmat që m'u bënë gjatë arrestimit tim, më hodhën, me gjithë qenien time, në radhët e luftës sonë nacionalçlirimtare. Unë e ndjeja vetën përkrah të gjithë atyre që ishin kundër pushtuesve serbë dhe shërbëtorëve të tyre. I konsideroja vëllezër idealesh të gjithë ata që ishin nëpër burgjet serbe dhe të gjithë ata djem e vasha që vepronin e sakrifikoheshin për lirin e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me nënën Shqipëri.

Dalja e Ferkiut nga burgu na gëzoi shumë, Xhemën dhe mua. Tani ishim bërë tre shokë, që do të vepronim së bashku, por edhe që kishim kontakte me shumë shokë të tjerë. Danin e kishim në burg. Dënimi i tij nuk na frikësoi, përkundrazi na mbushi me urrejtje për pushtuesin. Ne dëshironim ta vazhdonim rrugën e shokëve. Prandaj duke u nisur nga dëshira dhe qëllimi për ta ndihmuar luftën tonë çlirimtare, i dhamë besën njëri-tjetrit se do të bënim gjithçka që do të kërkohej prej nesh për ta çliruar popullin dhe vendin tonë nga thundra e Serbisë. Besa e dhënë na mbante gjallë dhe na mbushte me energji.

Ndonëse, ne po ecnim nëpër një rrugë të pashkelur, të panjohur dhe me shumë rreziqe, jo vetëm për ne , por edhe për familjet tona, ne nuk kishim asnjë fije hezitimi në drejtësinë e luftës sonë dhe kishim gjithashtu edhe vendosmërinë për të ecur në këtë rrugë, përkundër sfidave që ajo do të na nxirrte përpara.

Vjeshtën e vitit 1980, i kemi intensifikuar kontaktet Xhema, Ferkiu dhe unë. Ne të tre takoheshim shpesh me njëri-tjetrin dhe çdo takim që mbanim ishte takim pune dhe debatesh për çështje të ndryshme të veprimtarinë sonë e të shokëve tanë me të cilët ne mbanim kontakte.

Nga Ferkiu, gjatë kësaj kohe, jam njoftuar edhe për aktivitetin e tij në kuadër të organizatës "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi". Ferkiu, më ka njoftuar se ai, gjatë burgosjes ka qenë simpatizant i LNÇKVShJ-së, që asokohe ka qenë si hap i parë drejtë anëtarësimit në radhët e organizatës. Gjithashtu, Ferki Morina më ka njoftuar edhe për historikun e Grupit "Shkëndijat e kuqe"[7] i cili ishte themeluar nga Ramadan Pllana dhe rrethi i shokëve të tij, grup ky që kishte vepruar si grup në vete para krijimit të kontakteve të Ramadan Pllanës me LNÇKVShJ-në.

Gjatë takimeve që kemi pasur Treshja jonë (Xhema, Ferkiu dhe unë), jemi pajtuar që të veprojmë secili në rrethet ku kemi vepruar edhe më parë, që vetën tonë dhe shokët, që i kishim, t'i përgatisnim për sfidat që na prisnin në të ardhmen. Ngritja e një një organizate, duke nxjerrë mësim nga gabimet e së kaluarës, ishte sfida me e madhe që na priste dhe që prej nesh kërkonte jo vetëm aktivitet intensiv, por edhe kohë, durim dhe disiplinë të hekurt.

Një ditë, gjersa po shkoja në shkollë dhe po e prisja trenin në Stacionin e Trenit në fshatin Prelluzhë, u takova me Demë Jasharin. U gëzova që e takova, sepse ishte hera e parë që po e takoja që nga lirimi i tij nga burgu. E pyeta për shëndetin dhe i shpreha gëzimin tim që po e shihja të lirë.

Gjatë bisedës, Demë Jashari më foli, pa vonesë, për "Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" dhe shprehu interesimin e tij për riaktivizimin e saj!

E dëgjova me vëmendje shokun Demë, por nuk i thashë asnjë fjalë, as për LNÇKVShJ-në dhe as që dija për ekzistencën e saj! Mirëpo ky interesim i Demës për riaktivizimin e LNÇKVShJ-së nuk më pëlqeu fare. Duke i buzëqeshur dhe duke u treguar i pa interesuar ia thashë:

– Gjithçka kam pasur për të thënë e "kam thënë" në polici!

Disa ditë pas këtij takimi, i kam njoftuar Xhemën dhe Ferkiun për takimin dhe qëndrimin "interesant" të Demë Jasharit. Me shokët jemi pajtuar që të jemi të kujdesshëm. Arsyeja e këtij qëndrimi ishte sepse ne nuk dinim se ç'qëndrim kishte mbajtur Demë Jashari në burg. Shefqet Jashari, Ramadan Pllana dhe shokët tjerë ishin dënuar me dënime të gjata dhe dyshonim se dikush duhet t'i ketë denoncuar për veprimtarinë e tyre!

Gjatë fundit të vjeshtës së vitit 1980, Xhema na ka njoftuar, Ferkiun dhe mua, me programin dhe statutin e LNÇKVShJ-së. Pas leximit dhe shprehjes së gatishmërisë për ta pranuar programin e LNÇKVShJ-së, unë dhe Ferkiu e kemi bërë betimin në prani të Xhemës.

Nga ajo ditë ne kemi vepruar si celulë(treshe) e LNÇKVShJ-së, ndonëse nuk kishim lidhje me udhëheqjen e Organizatës sonë. Ne nuk kishim caktuar udhëheqës të celulës, por për shkak të pjekurisë dhe përvojës, unë dhe Ferkiu, si udhëheqës të pashpallur e kishim Xhemën. Ne të tre i njihnim shokët e njëri-tjetrit dhe vend-veprimin e tyre. Të tre kishim detyra të njëjta dhe çdonjëri vepronte në krahët e tij për ta organizuar luftën për liri dhe për t'i shtuar radhët e LNÇKVShJ-së me anëtarë të rinj. Para shokëve të tjerë, që kishim, ne vepronim si individ. Si individ veproja edhe unë dhe asnjëri nga shokët e mi nuk ka ditur se unë bashkëveproja me Xhemën dhe Ferkiun. Duke vepruar kështu, ne mendonim se mund t'i ruanim shokët nga zbulimi.

Në punën tonë çlirimtare tek unë dhe Ferkiu kishte shumë vrull dhe ne ende e kishim të vështirë të përmbahemi e të mos "bënim gabime"! Kjo vlente, sidomos për mua, që ende isha më i papërvojë në veprimtarinë ilegale dhe liridashëse. Unë, përkundër para burgosjes dhe përballjes me UDB-ën, i merrja punët me vrap, edhe atëherë kur duhej ecur me hapa breshke.

Mirëpo, një ndihmë të jashtëzakonshme në punën time e konsideroja përvojën dhe mbështetjen e pa rezervë të Xhemës. Nga mënyra e shtrimit të problemeve që shfaqeshin, gjuha e argumenteve që përdorte për ta shpjeguar drejtësinë e qëndrimeve të tij ose të një shoku apo veprimi, dukej qartë se

Xhema kishte nxjerrë mësime shumë të vyera nga burgosjet e shokëve të organizatës sonë, vjeshtën e 1979. Këtë e konsideroja një mrekulli, por një fat të madh për mua dhe Ferkiun dhe të gjithë shokët që kishim rreth nesh. Nga qëndrimet e Xhemës unë përpiqesha ta ndihmoja vetën time, por edhe shokët që kishim nëpër rrethe.

I lindur si njeri i qetë, gojëmbël, që shoqërohej e miqësohej lehtë me të tjerët dhe që kishte një durim ta jashtëzakonshëm, Ferkiu kudo që shkonte krijonte shokë dhe miq. Kontaktet me shokët në Fakultetin Ekonomik, Fakultetin Filozofik i zgjeronte me kontakte të shokëve të shkollës së mesme, me kontaktet e lidhjeve familjare, por edhe në kontaktet që kishte me këngëtarë të shoqërive të ndryshme muzikore. Kudo ku hynte e dilet Ferkiu e përhapte zërin e lirisë dhe luftës sonë çlirimtare.

Në Fakultetin Ekonomik, Ferkiu kishte kontakte me Burim Zagragjën, Behxhet Ahmetin, Nysret Pllanën, Ymer Dragushën, Hilmi Gashin, Fatmir Makollin dhe shokë të tjerë. Ai gjithashtu nëpërmjet motrës së tij Drita Morina, që ishte studente e Fakultetit Filozofik, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, mbante kontakte edhe me grupin e studenteve që përbëhej nga Mirvete dhe Fatime Haliti, Hafije Durmishi(studente e Gjuhës Angleze) dhe studente të tjera.

Gjatë kërkimit të shokëve dhe shoqeve të luftës për liri, ka lindur edhe dashuria në mes Mirvete Halitit dhe Ferki Morinës. Mirvete Halitin unë e kisha kushërirë (familja ime i ka konsideruar si kushërinj gjithë fshatin Beçuk, sepse ne jemi shpërngulur që andej diku pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit). Megjithëkëtë, Ferkiu nuk ma "besoi" detyrën e krushkut, por ma "mashtroi" kushërirën time dhe një ditë i pashë dorë për dore para Fakultetit Ekonomik! Ata i bëri bashkë lufta për liri dhe ideali i lirisë. Unë dhe të gjithë shokët ishim krenar me të dy.

Gjatë kësaj kohe edhe kontaktet e mia me Xhafën, *Hoxhën e Vogël*, Rexhën, Vebën dhe Bedën ishin intensifikuar shumë. Takohesha me të gjithë, kuptohet një nga një, përpos takimeve me *Hoxhën e Vogël* dhe Vebën, të cilët në fillim, i takoja së bashku në shtëpi të *Hoxhës së Vogël*. Me shokët shpërndanim literaturë dhe diskutonim për çështje të ndryshme e aktuale për kohën si dhe bënim përgatitjet për hapat e mëtejmë në veprimtarin tonë çlirimtare.

Diku, gjatë fillimit të vjeshtës së viti 1980, për herë të parë më ka ra në dorë organi "Bashkimi" dhe pak kohë më pas edhe organi "Liria". Aty diku kah fundi i vjeshtës nga Xhafa e kam marrë numrin e parë të "Lajmëtari i lirisë".

Ashtu si organin " Bashkimi" edhe organin "Liria" dhe revistën "Lajmëtarin e lirisë" e kemi shpërnda nëpër shokë. Të dy organet dhe revista janë mirëpritur nga shokët. Për shokët tanë nuk ka qenë e rëndësishme se cilat organizata ato përfaqësojnë, përkundrazi, kryesore për ne kanë qenë programet e tyre politike, që ishin shumë të përafërta me programin e LNÇKVShJ-së.

Ne nuk e dinim se cila organizatë politike qëndronte prapa revistës “Lajmëtari i lirisë”. Mirëpo, duke ditur se nga Kosova ishte arratisur Jusuf Gërvalla, mendja na e thoshte se pranë saj qëndronte ndonjë intelektual militant i kalibrit të tij.

Lidhur me revistën “Lajmëtari i lirisë” dhe organet “Bashkimi” dhe “Liria” kam biseduar me Xhemën, Ferkiun, Xhafën, Rexhën dhe shokët tjerë dhe të gjithë shokët kanë qenë të entuziazmuar me përmbajtjen e tyre dhe qëndrimet politike që ato kanë përcjell tek ne.

Pranverë 1981

Së bashku me Skënderin (tim vëlla) ishim në mal për të mbledhur rrema që kishin ngelur aty gjatë prerjes në vjeshtë. Ende pa kryer punë dhe krejt papritur, aty vije Ferkiu. U gëzova kur e pashë dhe pas përshëndetjes e paralajmërova se edhe pak do të mbarojmë punë dhe do të kthehemi në shtëpi.

U ulëm mbi një grumbull drunjtësh dhe Ferkiu na njoftoi se një ditë më parë, në Mensën e Studentëve në Prishtinë, kishte nisur një protestë e cila më vonë ishte shndërruar në demonstratë të fuqishme! Sipas Ferkiut, në demonstratë kishin marrë pjesë me mijëra studentë dhe krahas kërkesave për kushte më të mira për studime, ishin dëgjuar edhe kërkesat: "Kushte për studentët!", "Poshtë robëria!", "Kosova-kosovarëve!", "Jemi shqiptarë-s'jemi jugosllavë!", "Kosova-Republikë!" etj.. Policia kishte ushtruar dhunë kundër studentëve dhe kishte arrestuar disa qindra studentë!

Lajmet që mora më trazuan. Ndjehesha i befasuar. Nuk e prisje një demonstratë të tillë. Njëkohësisht, ndjehesha i entuziazmuar nga guximi i studentëve dhe kërkesat e tyre të drejta. Më mbushi plotë zemërim dhuna e egër, që ishte ushtruar nga policia kundër studentëve.

Pranverë 1981

Kërkesat e drejta të studentëve dhe dhuna e ushtruar nga policia më vunë para dilemave të madha: vallë çdo do të sjell kjo pakënaqësi e studentëve dhe dhuna e pushtuesit? Si do të priten kërkesat e studentëve nga populli? A thua si do të reagoi Shqipëria dhe bota demokratike kundër kërkesave të studentëve dhe dhunës policore?

Uroja të mbretërojë arsyeja e shëndoshë dhe që bota nuk do të bëj sehir, aq më tepër se ajo nuk do të mashtrohet nga demagogjia jugosllave, por do t'i gjykojë me realizëm kërkesat e drejta të studentëve?

Kisha besim të plotë se përkrahja nga populli dhe Shqipëria nuk do të mungojnë, por kur ishte në pyetje përkrahja nga bota e demokracisë perëndimore, deri diku, isha skeptik dhe nuk prisja ndonjë ndihmë të madhe. Nuk ma merrte mendja se bota demokratike do të prishej me pushtuesit serbo-jugosllav, për hir të shqiptarëve, aq më tepër kur jugosllavët do t'i prezantojnë kërkesat e shqiptarëve, jo si kërkesa për barazi, ashtu siç në të vërtetë ishin, por si kërkesa "nacionalistësh" e "irredentistësh" shqiptarë.

Mirëpo, përkundër qëndrimit të faktorit të jashtëm, unë mendoja se ishte krijuar në gjendje e re dhe një terren i përshtatshëm për ta shtuar aktivitetin tonë, liridashës. Prandaj për veprimet që do të bënim dhe detyrat që do t'i nxirrnim për të ardhmen, unë e shihja të nevojshme që të takohesha me shokët dhe ta dëgjoja mendimin e tyre. Mendoja se ne duhej të bisedonim me njëri-tjetrin dhe ta sqaronim qëndrimin tonë karshi kërkesave të studentëve: për kushte më të mira, por edhe lidhur me kërkesën "Kosova-Republikë".

Ne ishin një degë e shkëputur e organizatës "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" dhe veprimet tona nuk duhej të binin në kundërshtim me qëndrimet e udhëheqjes së Organizatës sonë. Prandaj më interesonte shumë qëndrimi i udhëheqjes së Organizatës sonë lidhur me kërkesat e studentëve dhe sidomos ndaj kërkesës "Kosova-Republikë".

Në një takim, që pata me shokët, u pajtuam që të tregoheshim shumë të kujdesshëm dhe që ne asnjë mënyrë të mos nxitoheshim e të mos e kërkonim, me çdo kusht, krijimin e lidhjes me udhëheqjen e LNÇKVShJ-së. Gjendja e krijuar bartte me vete rreziqe të madha. Nuk duhej të rrezikonim e të "shkelnim në dërrasë të kalbur", për hir të krijimit, patjetër, të kontaktit me LNÇKVShJ-së, përkundrazi këtë çështje duhej ta shikonim me gjakftohtësi dhe durim të madh. Gjithashtu, me shokët u pajtuam që gjersa të marrim lidhje me LNÇKVShJ-në, t'i mbështesim, pa rezervë, kërkesat e studentëve dhe ta vazhdonim veprimtarinë tonë në përputhje me programin dhe statutin e organizatës sonë.

Disa ditë pas demonstratës së 11 marsit kam arritur t'i takoj të gjithë shokët, me të cilët shoqërohesha, dhe ta dëgjoj mendimin e tyre për demonstratën dhe kërkesat e studentëve. Shokët shprehën entuziazmin dhe shpresën që kishte ngjallur, në popull, por edhe tek ata, demonstrata e 11 marsit dhe kërkesat e saj. Të gjithë uronim që kjo nisje të ishte fillimi i fundit të shtypjes dhe pabarazisë së shqiptarëve! Takimi me shokët, dhe ajo që dëgjova prej tyre, më mbushi edhe mua me entuziazëm dhe energji të re për ta vazhduar luftën për liri.

Menjëherë pas demonstratës së 11 marsit, Beogradi filloi një fushatë të egër thashethemesh e gënjeshtrash kundër shkaqeve që shtynë studentët të çoheshin në demonstrata! Askund nuk flitej për kërkesat e studentëve dhe nuk shqyrtohej drejtësia e tyre, por përkundrazi autoritetet jugosllave, opinionit i ofronin

gënjeshtra bajate dhe bëheshin përpjekje maksimale për të krijuar armiq të jashtëm dhe fajësuar ata se gjoja i paskan "nxitur" studentët.

Veç kësaj, pushteti serb kishte aktivizuar të gjithë mekanizmat e tij për t'i kundërshtuar kërkesat e drejta të studentëve, të shprehura në demonstratën e 11 marsit. Kundër studentëve dhe kundër të ashtuquajturit nacionalizëm dhe irredentizëm shqiptar, Beogradi villte helm e vrer, sulmonte studentët shqiptarë dhe kërkesat e tyre, por jo vetëm kaq, në këtë fushatë antishqiptare sulmohej edhe Shqipëria, si nxitëse e tyre, që ishte një gënjeshtër e madhe! Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, Lidhja e Socialiste e Jugosllavisë, ajo e Rinisë Socialiste të Jugosllavisë dhe të gjitha degët e saj në Kosovë filluan të ashtuquajturin diferencimit ideopolitikë. Nëpër vende pune, fakultete e shkolla mbaheshin mbledhje të rrufeshme, kur politikanë matufë, që u vinte era shlivovicë, i shanin studentët, të burgosurit dhe kërkesat e tyre, por njëkohësisht kërkonin nga popullit që t'i lëçitnin pjesëmarrësit në demonstratë dhe familjet e atyre që ishin burgosur.

Në këtë valle prinin edhe funksionarë federative si Fadil Hoxha, Sinan Hasani, Ali Shukriu, Xhavid Nimani dhe shërbëtorë të tjerë të politikës serbe që kishin zbritur në Kosovë dhe po villnin vrer kundër studentëve dhe kërkesave të tyre të drejta.

Fatkeqësisht edhe kësaj here, këta politikanë matufë shqiptarë, u treguan përkrah shovinistëve serbë dhe dolën hapur kundër studentëve dhe kërkesave që ata shtruan për zgjidhje! Ky qëndrim qyqar, hodhi për toke edhe gënjeshtrat e UDB-ës se gjoja funksionarët shqiptarë ishin përkrah kërkesave për Republikë, të shtruara nga populli qysh gjatë demonstratave të vitit 1968.

Në vorbullën e kësaj fushate të nisur nga pushtetarët jugosllav, në Prishtinë shpërthyen sërish demonstrata e 25 dhe 26 marsit. Studentë, nxënës e qytetarë shfaqën përsëri kërkesat e tyre të ligjshme: për kushte më të mira për studim dhe që Kosovës t'i njihej statusi i Republikës.

Kundër demonstruesve paqësorë, kësaj radhe ndërhyri jo vetëm policia e Kosovës, por edhe njësitë e policisë speciale jugosllave që kishin ardhur dhe ishin stacionuar në Kosovë. Ndërhyrja ishte e egër. Me qindra studentë u burgosën, torturuan dhe plagosën. Flitej se kishte edhe studentë e nxënës të vrarë. Shifra zyrtare prej 8 të vrarësh nuk besohej nga askush.

Edhe demonstratat e 25 e 26 marsit më "befasuan"! Nuk isha në Prishtinë. Ndodhesha në Mihaliqin tim, që edhe kësaj radhe ndodhej shumë larg zhvillimeve në Prishtinë. "Fajet" për këtë ia hidhja mungesës së kontaktit me LNÇKVShJ-në apo ndonjë organizatë tjetër revolucionare.

Dhuna e përdorur gjatë demonstratave të 25 dhe 26 marsit në Prishtinë nga njësitë e policisë speciale jugosllave, shkaktoi zemërim të madh në popull. Çdo njeri që e takoja fliste me indinjatë të madhe kundër dhunës policore, të ushtruar kundër studentëve në Prishtinë dhe përkrahte kërkesat e studentëve.

Pas disa ditësh "qetësie", si një vullkan shpërthyen demonstrate e 1, 2 dhe 3 prillit 1981, të cilat nuk u zhvilluan vetëm në Prishtinë, por në gjithë Kosovën.

Për ndryshim nga demonstratat e ditëve më parë, që ishin kryesisht demonstrata të studentëve, me 1, 2 dhe 3 prill u ngritën në këmbë studentë, nxënës shkollash, profesorë, punëtorë e fshatarë. Tani nuk kërkoheshin vetëm kushte më të mira për studim, por i gjithë populli thërriste "Kosova-Republikë!"

Demonstratat e 1, 2 dhe 3 prillit 1981 dhe masivizimi i tyre e tmerroi udhëheqjen antishqiptare jugosllave e cila me 2 prill pas një mbledhje të mbajtur, po atë ditë, në Zagreb nga i ashtuquajturi Këshilli për Mbrojtjen e Rregullit Kushtetues, veç të tjerash, vendosi që njësitë e APJ-së të vendoseshin në hyrje dalje të Prishtinës, që të shpallet gjendja e jashtëzakonshme në territorin e komunës së Prishtinës dhe që të kufizohet lëvizja e qytetarëve nga ora 20.00-05.00.

Menjëherë pas demonstratave të 1, 2 dhe 3 prillit 1981, në shtëpinë time vije kushëriri im Avdullah Sadiku, përndryshe punonjës i Termocentralit të Obiliqit. Avdullahu vije për të më treguar se ai kishte shkuar së bashku me rreth 5000 punëtorë të Obiliqit në demonstratën e Prishtinës, por edhe për të më "qortuar":

– Çfarë patrioti je ti që po rri në shtëpi edhe sot kur e tërë Kosova është ç'u në këmbë, më pyeti kushëriri?

I zënë ngushtë nga "akuza" e drejtë që më bëri kushëri im, nuk i thashë asgjë kushëririt, por as nuk u mbrojta. Më erdhi mirë që ai dhe shokët e tij ju kishin bashkuar demonstratës. Aty për aty m'u kujtua se si Avdullahu më kishte folur me skepticizëm të madh kur më kishin liruar nga arrestimi në vitin 1979 dhe kur më kishte thënë në atë rast se "ju s'keni çka bëni, sepse ju s'jeni as pesëqind veta dhe me aq pak njerëz nuk mund ta prishni Jugosllavinë dhe aq më pak që ta bashkoni Kosovën me Shqipërinë!" Tani koha kishte ndryshuar. Kushëriri im merrte pjesë në demonstrata liridashëse, ndërsa unë "patrioti" bëja sehir dhe i shikoja zhvillimet nga televizori. Megjithëkëtë kjo ishte një mrekulli. Populli po zgjohej. Unë kisha besim të patundur se kur zgjohet populli, ai di të bëj edhe mrekulli.

Ato ditë dëgjova, gjithashtu, se në Prishtinë ishte arrestuar edhe bashkëfshatari ime Shemsedin J. Mustafën. Siç dëgjova Shemsedin J. Mustafën e kishin zënë në një demonstratë në Prishtinë dhe në rastin e arrestimit e kishin kapur me një armë në dorë!

Nga dikush tjetër dëgjova se një grup demonstruesish ia kishin marrë armën një polici, por meqë ata nuk kishin ditur ta përdornin atë, në ndihmë u kishte dal Shemsedin J. Mustafa. Siç mësova, më vonë, Shemsedin J. Mustafa ka qenë në rrugë tek një këpucëtar, por ka hasur në demonstrues dhe ju ka bashkuar demonstratës.

Demonstratat e 11 marsit, ato të 25 e 26 marsit dhe 1, 2 dhe 3 prillit si dhe masivizimi i tyre, për mua, ishin një argument i qartë se ne nuk ishim të vetëm dhe se në radhët e studentëve, punëtorëve dhe nxënësve të shkollave të mesme vepronin edhe shumë grupe e organizata patriotike e revolucionare. Edhe ky

fakt ishte një gëzim, por edhe një shtytje e madhe, për mua dhe shokët, në rrugën e lirisë.

Paraqitja e grupeve të ndryshme para nesh shtronte shumë probleme, e ndër to, një nga parësoret, ishte edhe çështja e bashkëveprimit dhe koordinimit të aktiviteteve tona. Por, në kushtet e veprimtarisë ilegale, kontakti me grupet tjera ishte edhe një punë me shumë rrezik. Shërbimi i Sigurimit Shtetëror Jugosllav mund të infiltronte edhe agjentët e tij dhe një gabim i vogël mund të na kushtonte dhjetëra vite burg. Prandaj duhej treguar shumë vigjilent.

Disa ditë pas demonstratave jam takuar me shokët një nga një. Me shokët i kemi komentuar demonstratat e fundit. Tek të gjithë shokët, demonstratat e Prishtinës dhe qyteteve të tjera të Kosovës, përkundër dhunës së egër të ushtruar nga policia, kishin ngjallur shpresë se po afrohej fundi i tiranisë serbo-jugosllave. Tek shokët kam gjetur më shumë se asnjëherë më parë entuziazëm për ta vazhduar rrugën e nisur. Disa nga shokët kishin marrë pjesë në demonstratat 11, 25 e 26 marsit dhe 1, 2 dhe 3 prillit si dhe disa të tjerë flisnin për shokët që kishin marrë pjesë në demonstratat të ndryshme nëpër Kosovë dhe tregonin për heroizmat e shprehur nga demonstruesit.

Në demonstratat e 1, 2 dhe 3 prillit, që u mbajtën edhe në Vushtrri, dëgjova se ishte burgosur edhe një kushëriri im, Zeqir Murati nga fshati Beçuk, i cili ishte punëtor i një ndërmarrje ndërtimore në Vushtrri. Gjithashtu dëgjova se ishin burgosur Ilmi Muzaqi nga Bruzniku, Bali Dervishi nga Gradica dhe Dinore Curri nga fshati Reznik. Flitej se Dinore Curri u kishte pri demonstruesve në Vushtrri, ashtu siç u kishte pri çetave të luftëtarëve të lirisë Shote Galica! Veprat e tyre i frymëzonin të rinjtë, ashtu siç na frymëzonin edhe ne.

Në një gjendje të jashtëzakonshme që ishte shpallur vetëm për komunën e Prishtinës, por që në të vërtetë ishte një gjendje shtetrrethimi ushtarako-policor që ishte vendosur në tërë territorin e Kosovës, lëvizjet duhej bërë me kujdes të shtuar. Megjithëkëtë unë vendosa të shkoja në Prishtinë. Kudo pashë policë të armatosur deri në dhëmbë, ushtarë, tanke dhe lëvizje të vazhdueshme të policisë dhe ushtrisë.

Nga shokët që takova, mësova për dhunën e egër që ishte ushtruar kundër demonstruesve dhe se shifrat e lëshuara nga autoritetet jugosllave për gjoja vrasjen e 8, plagosjen e 75 të dhe arrestimin e 807 demonstruesve nuk ishte asgjë tjetër pos një gënjeshtër. Shokët flisnin për shifra të tjera që ishin shumë herë më të mëdha. Shokët flisnin gjithashtu edhe për masivizimin e kërkesave të demonstruesve dhe për përfshirjen e gjithë popullit në lëvizjen për liri dhe barazi.

Shihej qartë se energjitë liridashëse të popullit kishin shpërthyer me vrull të madh. Ky shpërthim dhe kjo gjendje e krijuar para nesh shtronte shumë detyra. Kërkesa "Kosova-Republikë" dukej sheshazi se i kishte pushtuar zemrat e të gjithëve dhe kishte bërë një bashkim të paimagjinueshëm të popullit tonë.

Edhe shokët ishin entuziazmuar nga kërkesa "Kosova-Republikë", ndonëse gjer me tani kishim ëndërruar dhe përpjekur për bashkimin e Kosovës dhe

Viseve tjera Shqiptare me nënën Shqipëri! Për shkak të gjendjes së krijuar, unë isha duke u luhatur! Nuk kisha hequr dorë nga e drejta legjitime e popullit shqiptar për jetë në një shtet shqiptar, por edhe kërkesa që Kosovës t'i njihej statusi i Republikës, më dukej një hap në atë drejtim. Megjithëkëtë, shumë pyetje më silleshin nëpër kokë dhe nuk ishte e lehtë të dije se ç'qëndrim duhet mbajtur?

Një pjesë e madhe e shokëve me të cilët veproja e kishim përqafuar botëkuptimin e materializmin dialektik dhe historik. Unë përpiqesha mbi bazën e këtij botëkuptimi të gjeja përgjigje edhe lidhur me qëndrimin që duhej ta mbanim ndaj kërkesës "Kosova-Republikë". Gjatë debateve, me shokët, vinim në përfundime se kërkesën për Republikën e Kosovës, duhet ta shikonim si një ecje përpara, ashtu siç e kanë parë rilindësit tanë çështjen e autonomisë në kuadër të Perandorisë Otomane. Përndryshe qëndrimi "besnik" i programit të LNÇKVShJ-së dhe mos mbështetja e kërkesës "Kosovës-Republikë" do të na zhyste në pozita dogmatike? Unë e shihja "Kosovën-Republikë" edhe si një mundësi për shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare. Ishte fat i madh që kështu mendonin edhe shokët mi.

Javën e parë të prillit, gjatë një takimi me Ferki Morinën, mora vesh se me 2 prill 1981, ishte arrestuar Xhemajl Pllana! Ky lajm më shqetësoj shumë. Megjithëkëtë, mua dhe Ferkiut nuk na ngelej tjetër pos ta shtonim vigjilencën dhe t'i zvogëlonim lëvizjet.

Mbrëmjen e 8 prillit 1981 , si zakonisht, e hapa Radio Televizionin Shqiptar dhe po i shikoja lajmet. Sapo nisën lajmet folësi i lajmeve të RTSh-së filloi së lexuari shkrimin redaksional të "Zërit të Popullit": *"Pse u përdor dhuna policore dhe tanket kundër shqiptarëve në Kosovë?"* Atë natë e dëgjova edhe njëherë shkrimin e "Zërit të Popullit" në Radio Tiranë. Unë isha i entuziazmuar nga shkrimi i "Zërit të Popullit", i cili në të vërtet ishte një shkrim shumë i matur, i ekuilibruar dhe që bënte thirrje për zgjidhje të çështjes së shqiptarëve të Kosovës mbi parimet e së drejtës që kanë popujt, por që edhe nuk ishte në kundërshtim me Kushtetutën e RSFJ-së. Për mua artikulli i "Zërit të Popullit" ishte një ndihmë e madhe për t'i gjetur detyrat tona dhe për ta kuptuar drejtë kërkesën "Kosova-republikë".

Disa ditë më vonë i kam takuar edhe disa nga shokët dhe me ta kemi biseduar për artikullin e "Zërit të Popullit" dhe kudo kam gjetur po atë entuziazëm dhe besim të madh që kisha edhe unë për Shqipërinë dhe për qëndrimin e saj të palëkundur përkrah luftës sonë për liri.

Me 23 prill 1981, Radio Tirana emitoi shkrimin e "Zërit të Popullit" me titull *"Kush nxit armiqësinë midis popujve të Jugosllavisë?"* që ishte një shuplakë e re në fytyrën e politikës antishqiptare dhe shoviniste që ndiqte udhëheqja jugosllave, por që për mua dhe shokët e mi ishte dhe një shprehje e fuqishme e mbështetjes që i bënte shteti shqiptar luftës sonë për liri dhe barazi me popujt e Federatës jugosllave.

Izolimi

Me 30 prill 1981, u ktheva nga një vizitë tek *Hoxha i Vogël* në Gllavotin. Sapo hyra brenda në shtëpi, nëna ime me njoftojë se policia kishte qenë në shtëpi dhe e kishte kërkuar tim atë , revolen dhe pushkën e gjuetisë!

E çuditshme! As revolen dhe as pushkën e gjuetisë nuk i kishim. Revolen me leje, policia e Beogradit, ia kishte marrë tim atë, gjatë vizitës së fundit të Titos në Kosovë, gjersa ishte duke shkuar në punë, në ndërrimin e tretë.

Meqë lajmi fliste se policia i kishte kërkuar armët, të cilat im atë nuk i kishte, nuk më bëri përshtypje shumë kjo vizitë e papritur e policisë. Mendova se, ndoshta, vizita kishte të bënte me gjendjen e krijuar në Kosovë, pas demonstratave të marsit e prillit? Ndoshta policia e Kosovës, e urdhëruar nga ajo e Beogradit, ka nisur grumbullimin e armëve më leje, që ishin në duar të shqiptarëve, nxirrja përfundime? Meqë, im atë, dikur kishte një revole me leje, mendja me shkoi se policia mund ta ketë shikuar ndonjë regjistër të vjetër të atyre që kishin armë me leje. Shpresoja se vizita e policisë nuk kishte lidhje me veprimtarinë tonë çlirimtare, e sidomos me njohjen time me Xhemën që ndodhej në burg! Pastaj, meqë emri im nuk ishte zënë në gojë, kjo me jepte shpresë se unë nuk do të isha pjesë e këtij aksioni policor.

Në mbrëmje, përsëri dëgjova një trokitje në derën e oborrit dhe unë, pa frikën më të vogël, shkova dhe e hapa derën. Sapo hapa e derën e oborrit, para saj, gjeta dy policë. Ata më treguan se kishin ardhur serish për armët e tim atë! Unë ju thashë se im atë nuk ndodhej në shtëpi dhe se lidhur me armët ata duhej të flisnin me nënën time sepse unë nuk e dija për armët që po i kërkonin.

Shkova në shtëpi dhe e njoftova nënën time se përsëri kishte ardhur policia dhe e luta që ajo të vinte dhe të fliste me ta. Pas pak, nëna erdhi tek dyert e oborrit dhe u shpjegoi policëve se im atë kishte pasur një revole me leje, por ajo i ishte marrë nga policia... Nëna u shpjegoi policëve se pushkën e gjuetisë nuk e kishim blerë asnjëherë. Pas informacionit që morën, policët ikën.

Pas ikjes së policëve unë u çlirova dhe mendova se vërtet e paskan ndërmend t'i grumbullojnë të gjitha armët me leje dhe se ky aksion nuk kishte të bënte me mua . Pas pak, shkova në dhomën e gjumit dhe u shtrira për të fjetur.

Diku pas një ore dhe para se të më zinte gjumi, dëgjova përsëri trokitjen në derën e oborrit! Tani shkova shpejtë e shpejtë tek dera e oborrit dhe e hapa derën. Kur e hapa derën e pashë policin, Beçir *Magjupi,* dhe një koleg të tij. I irrituar e i habitur, njëkohësisht, nga kjo ardhje e tyre e tretë ju drejtova policëve:

– Ç'ka ndodhur? Beha (kështu e quanin ata tim atë) nuk ka ardhur ende nga puna. Nëse keni për të biseduar me atë, ju lutem, shkoni e flisni me të në punë dhe ju lutem shumë të na lini rehat, se është bërë edhe vonë e ka kaluar mesi i natës!

Beçir Magjupi ma ktheu:

– Jo, jo ne e kemi kërkuar gabimisht *babën tënd*. E kishim ngatërruar emrin e tij me emrin tënd, prandaj ti duhet të vish me ne gjer në Stacionin e Policisë në Prelluzhë!

U befasova dhe nuk dija se çka t'ju thosha policëve. U mendova shpejtë e shpejtë dhe ju thashë të më prisnin gjersa të vishesha. Pastaj Beçir Magjupit i thashë që të flisnin edhe me nënën time dhe t'i tregonin edhe asaj se si qëndron puna. Vetë me vete thashë "Ç'ma punuat dhe bëtë tetë me dy!"



RS e Serbisë – KSA e Kosovës
SEKRETARIATI KRAHINOR
I PUNEVE TE BRENDSHME
Nr. 20/81
Prishtinë, 30.04 1981

Në bazë të nenit 47 alineja 1 të Ligjit mbi punët e brendshme ("Gazeta Zyrtare e KSAK" nr. 48/77), e në vështrim të vlerësimit të Kryesisë të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës dhe të Vendimit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSAK nr. _____ të datës 30.04.81 marr

A K T V E N D I M

ASLLAN Behram MUHARREMI urdhëroj qendrim në vend të caktuar, kështu i arrestuari ka për detyrë të qendrojë në _____ _____, duke filluar nga 30.04.1981.

Masa e shqiptuar do të hiqet me aktvendim të veçantë.

A r s y e t i m

Me qenë se Kryesia e KSAK ka konstatuar se kanë lindur rrethanat e jashtëzakonshme të cilat e rrezikojnë rendin publik në bazë të Vendimit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSAK, e duke pasë parasysh faktin se veprimtaria e të emërtuarit kërcënon drejtpërdrejtë se ekziston dyshimi i bazuar se mund të jetë e orientuar në rrezikimin e rendit publik, të emërtuarit i është shqiptuar masa si në dispozitiv.

Këshilla: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSAK. Ankesa nuk e shtyen përmbarimin e aktvendimit.

SEKRETARI KRAHINOR
Mustafa Sefedini

Aktvendimi i arrestimit i lëshuar nga Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme

Pas bisedës me nënën, Beçir *Maxhupi* dhe shoku i tij policë me shoqëruan në Stacionin e Policisë në Prelluzhë dhe pasi më nxorën nga makina, për t'i thënë shefit të tyre se tani e kishin arrestuar atë që po e kërkonin, më dërguan në Stacionin e Policisë në Mitrovicë.

Tek porta e hyrjes së Stacionit të Policisë në Mitrovicë gjetëm një grumbull prej rreth dhjetë policësh me helmeta në kokë dhe të armatosur deri në dhëmbë.

Policët dukeshin se ishin të njësive të policisë speciale federative. Ata më lëshuan një shikim të egër, por me dorë nuk më prekën.

Kishte kaluar ora dy e pas mesit të natës. Në korridorin e katit të dytë, gjeta "miqtë" e mi të vjetër: Faruk Mehmetin dhe Sylejman Arifin. Unë si me shaka ju drejtova:

– Ç'u bë? Nuk ma dinit emrin?

Faruk Mehmeti m'u drejtua:

–Gabojmë edhe ne! Por, megjithëkëtë, kësaj radhe këtu do të qëndroni këtu më gjatë se herën e kaluar!

Pas paralajmërimit të Shefit të UDB-ës, dy policë më shoqëruan në burgut e Mitrovicës. Në një zyrë të vogël brenda portës kryesore të burgut të Mitrovicës më urdhëruan ta hiqja rripin e pantallonave dhe gjithçka që kisha nëpër xhepa. Nga aty, gardianët më morën dhe më futën brenda lokaleve të burgut. Kaluam nëpër korridore me dyer metalike dhe më në fund njëri nga gardianët që më shoqëronin e hapi derën e një dhome dhe më urdhëroi të futesha brenda. Sapo hyra brenda, nga gardiani tjetër, u mbyllë dera e dhomës sonë.

Në dhomë gjeta dy të burgosur. Ata i fërkonin sytë. Më erdhi keq që ua prisha gjumin! I përshëndeta dhe u prezantova se kush jam. Njëri nga të burgosurit, që e gjeta në dhomë, më "përshëndeti" dhe e drejtojë dorën dhe shikimin kah shoku i tij duke më thënë:

– A nuk po e njeh se ky është prof dr. Nexhat Daci?

Unë struka krahët dhe i kërkova falje se nuk po e njihja prof. Dr Naxhat Dacin. Edhe prof. Dr Nexhat Daci, që ishte i përgjumur, u ndie keq nga pyetja që më bëri i burgosuri tjetër, që quhej Ferid Feka.

Të nesërmen, vazhduan ta mbushnin dhomën tonë me të burgosur të tjerë. Në dhomën tonë, që nuk ishte më e madhe se tre metra me katër dhe kishte tetë shtretër, e sollën edhe profesor Mujë Rugovën, magjistër Zenun Gjocajn dhe Kamber Rrukiqin. Pas dy-tre ditësh, në dhomë, na e sollën edhe ushtarin Shahin Peci, të cilin e kishin sjell nga Titogradi. E menjëherë pas tij edhe pronarin e një restoranti në Mitrovicë, që quhej Bajram Voca.

Ditët në vijim, na e sollën edhe vendimin e Këshillit Ekzekutiv të Kosovës dhe motivimin e "qëndrimit në vend të caktuar", që në të vërtetë ishte qëndrim në burg dhe nuk dallonte me asgjë nga burgjet e zakonshme. Në vendim shkruhej, gjithashtu se unë kisha të drejtë ankese. Duke përfituar nga kjo e drejtë, vendosa të ankohem. Ankesën e shkrova, deri diku, duke e shikuar edhe mënyrën e ankesës që bëri, për vetën e tij, profesor Nexhat Daci. Në ankesë e shkrova "se nuk e ndjeja vetën fajtor për asgjë dhe nuk e kuptoja se përse duhej të qëndroja aty."

Disa ditë më vonë mora përgjigje në ankesën time. Nënshkrues ishte njëfarë Kapllan Baruti nga Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës, që nuk ia kisha dëgjuar kurrë emrin. Përgjigja e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës e refuzonte ankesën time dhe e mbronte qëndrimin e mëhershëm: se "qëndrimi në vend të caktuar mbetet në fuqi për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se personi

në fjalë mund ta rrezikoi rendin publik”! O hajde Asllan, hajde, Jugosllavia ta paska frikën! –i thashë vetës sime.

Vendosja në një dhomë, me gjithë ata burra të nderuar dhe që kishin bërë emër me veprën e tyre në shërbim të lirisë, më bënte krenar dhe nderë.

Kënaqësinë dhe nderin që ndjeja se isha në mesin e profesorëve të nderuar, nisi të ma prish, nëpunësi Ferid Feka, i cili i bëri një pyetje të çuditshme Prof Dr. Nexhat Dacit: “Profesor Daci, përse të kanë burgosur?”

Prof Dr. Nexhat Daci me një gjakftohtësi mahnitëse i përgjigjet Ferid Fekës:

– Nuk e di arsyen e arrestimit tim, Ferid. Unë, gjithë jetën time jam marrë me punë shkencore. Para pak ditësh kishim një mbledhje të LKJ-së, në Universitetin e Prishtinës, ku po bëhej një diferencim ideo-politik. Në mbledhje kishte ardhur nga Beogradi edhe Azem Vllasi. Meqë mbi 95 për qind e të pranishmit në mbledhje ishin shqiptarë e luta Azem Vllasin të fliste shqip. Ndoshta, ky mund të jetë shkaku?...

Heshtja e mbuloi dhomën tonë. Asnjëri nuk e tha asnjë fjalë. Gjoksin ma përfshiu një e nxehur dhe më vinte ta përqafoja profesor Dr. Nexhat Dacin. Sa e vështirë ishte ta përmbaje vetën dhe të tregoheshe akull edhe atëherë kur përvëlimi ta kishte pushtuar zemrën?!

Gjatë javës që bëra në atë dhomë u njoha sadopak me të burgosurit e dhomës sime. Prof Dr. Nexhat Daci ishte një burrë shumë i qetë dhe i matur. Mujë Rugova, ishte shumë i heshtur dhe nuk mbaj mend ndonjë fjalë të tij. Zenun Gjocaj fliste fare pak e rrallë. Ajo çka e kam mbajtur në kujtesë nga ajo që ka folur Zenun Gjocaj është tregimi i tij “për mënyrën e mbytjes së pleshtit...” nga i cili tregim alegorik dhe domethënës qeshëm të gjithë.

Ferid Feka, ishte shumë interesant dhe dallonte nga shokët tjerë të dhomës. Ai vazhdimisht bënte pyetje që më irritonin dhe që më bënin të dyshoja se a ishte me të vërtetë një i burgosur! E shante Enver Hoxhën, që kinse po na nxiste ne dhe pastaj, ishim ne ata që, sipas tij, po vuanim për fajin e tij! Në një rast, Ferid Feka, edhe mua më pyeti se ç’kisha bërë dhe se përse më kishin burgosur dhe kur unë i dhashë përgjigje se nuk i di arsyet e burgosjes sime ai ma ktheu: “mos je ndonjë spiun, meqë nuk paskam bërë asgjë?!” Një e nxehur tjetër ma kapi gjithë trupin, por e përmbajta vetën! Sjellja e Ferid Fekës ishte e çuditshme, prandaj unë përpiqesha t’i shmangesha sa më shumë. Por, ku dreqi të shkoja, dhoma ishte shumë e vogël dhe e mbyllur?

Ditën e dytë apo të tretë, nuk më kujtohet me saktësi, në dhomën tonë u vendos edhe ushtari Shahin Peci. Çuditërisht ushtari doli i njohur me Ferid Fekën. Krijova përshtypjen se Shahin Peci ishte një djalë shumë i mirë, por edhe shumë i padjallëzuar. Qysh ditën e parë, Shahin Peci nisi t’i tregojë, Ferid Fekës, për të gjitha poezitë që i kishte shkruar gjatë shërbimit ushtarak, por edhe për ato që nuk ia kishte zënë policia ushtarake! Ndjeja dhembje në zemër për Shahinin, por nuk kisha guxim ta bëja asnjë ndërhyrje. E merrja me mend se edhe ndërhyrja më e vogël, për ta ndihmuar Shahin Pecin, do të mjaftonte që

udbashët të ma kurdisin ndonjë akuzë dhe kështu do të ma zgjasnin qëndrimin në këtë ferrë të mallkuar. Prandaj vendosa: të qëndroja i shtrirë në shtratin tim dhe të mos përzihesha në bisedat e Ferid Fekës dhe Shahin Pecit.

Në një rast tjetër, gjersa po shëtisnim në shëtitoren e burgut dhe unë po ecja në rresht pas Shahin Pecit, përfitova nga rasti dhe e pyeta me zë të ultë se a e kishte marrë malli për nënën? Kisha përshtypjen se Shahini e kuptoi se ç' desha t'i them dhe pas kësaj nuk e kam dëgjuar të ketë folur për poezitë e tij.

Një ditë tjetër, u ngrita në gjunjë nga krevati i katit të dytë dhe po shikoja në drejtim të oborrit të burgut. Dëshiroja të shikoj se mos po e shoh Xhemën dhe këtu të kuptoja se a ishte edhe ai i izoluar apo nën hetime? Nga aty dukej vetëm një pjesë e shëtitores së oborrit të burgut. Arrita ta shoh duke shëtitur Xhemajl Pllanën, së bashku me një grup të burgosurish tjerë. U gëzova shumë kur e pashë se nuk ia kishin qethur flokët. Pas kësaj, shpresoja se edhe Xhema ishte i izoluar, kështu si ne të tjerët.

Ditën e tetë, u hap dera e dhomës sonë dhe dy gardian më urdhëruan t'i merrja me vete gjërat e mia personale dhe më nxorën nga dhoma. Unë edhe nuk kisha rroba të tjera nga ato që kisha veshur dhe një pallto të leshtë. Në korridor gardianët më takuan me Shaqir Selmanin. Shaqa ishte i zbehur. Kur më pa mua u befasua shumë...Pas pak na futën në një dhomë së bashku.

Sapo u futëm në dhomë, Shaqa (Shaqir Selmani) nisi ta shpreh frikën dhe dyshimin se pse na kishin bërë bashkë? Nuk kisha si t'ia shpjegoja Shaqes arsyet e vendosjes në një dhomë, sepse isha i sigurt se mikrofonat e UDB-ës ishin aktivizuar dhe ata e përgjonin bisedën tonë. Shaqa ishte shumë i shqetësuar dhe unë po bëja përpjekje ta qetësoj:

– Syla e di se s'kemi bërë asgjë të kundërligjshme as unë dhe as ti, prandaj na ka bërë bashkë që të mos mërzitemi... Syla (Sylejman Arifi) është një " patriot" i madh! – i thashë Shaqës dhe po përpiqesha t'i them edhe me duar, që të qetësohej se gjithçka do të rregullohej.

Mirëpo, kisha përshtypjen se kjo që po i thosha nuk e qetësonte, përkundrazi po e shqetësonte edhe më shumë. Shaqa nisi të më pyet:

– Ç'janë "Lajmëtari i Lirisë", " Liria" dhe "Këngët e lirisë"?

– Nuk di. Nuk ua paskam dëgjuar kurrë emrin,– i përgjigjem Shaqës.

– Më kanë pyetur për ato. Më thoshin se Asllanin e kemi në dhomën tjetër dhe se ai i ka pranuar të gjitha! – ma ktheu Shaqa.

– Me mua nuk ka folur askush as për ty dhe as për këto që po i zë në gojë. Mua më kanë futur këtu para një jave. Nga shtëpia i ke mirë, – i thashë Shaqës.

Mirëpo kjo nuk po e qetësonte Shaqën. Kisha përshtypjen se ai nuk po më kuptonte se ç'po i thosha! E keqja ishte se unë nuk mund të flisja ndryshe me Shaqën, sepse isha i sigurt se njerëzit e Faruk Mehmetit ishin duke e përgjuar bisedën tonë.

E vërteta ishte se unë kisha biseduar me Shaqën kundër regjimit jugosllav dhe i kisha folur me simpati për Shqipërinë. Gjithashtu Shaqës, i kisha dhënë ndonjë roman dhe librin e Ajet Haxhiut *"Shota dhe Azem Galica"*, por asnjërën

nga ato për të cilat e kishin pyetur. E kuptoja se udbashët ishin përpjekur të zbulojnë nga Shaqa fakte për të më futur në burg dhe për të më dënuar me ndonjë vit burg, por kësaj radhe u kishte shkuar mundi kot. Shaqa ishte treguar burrë dhe për ato çka ka ditur për mua nuk ua kishte thënë asnjë fjalë dhe kjo më gëzonte shumë. Vendi ku ndodheshim nuk më lejonte t'ia sqaroja Shaqës se përse ata na kanë futur në një dhomë.

Të nesërmen, në mëngjes, dy gardian na e hapën derën dhe na urdhëruan të shkonim në nevojtore. Sapo hymë brenda, e lëshova kroin, kinse po i lanim duart, dhe sytë dhe iu ofrova afër Shaqës e i them në vesh :

–Kujdes dhe mos pyet për asgjë në dhomë. Ke parasysh se mund të na përgjojnë. Mua më kanë arrestuar para një jave dhe ato që t'i kanë thënë udbashët janë gënjeshtra e trillime. Mos u shqetëso se s'kanë se çka na bëjnë,–i thashë Shaqës.

Pas bisedës, Shaqa dukej më i qetë! Kur u kthyem në dhomë i treguam njëri-tjetrit shumë histori dashurie të trilluara e dëgjuara nga të tjerët. Kohën e kalonim duke luajtur *degergjik*[7]. Në një pako cigaresh e kishim vizatuar fushën e lojës dhe "kokrrat" e kuqe e të bardha i kishim bërë, gjithashtu në një pako tjetër të cigareve. Shaqa e pinte duhanin "si kovaç"!

Pas një jave, edhe udbashët u mërziten nga historitë tona dhe na larguan nga ajo dhomë!

Shaqën dhe mua na dërguan në *Odën e Madhe*[8], që ishte një dhomë e përshtatur, rishtazi, si dhomë burgu, por që më parë kishte qenë bodrum ku mbahej thëngjilli. Aty gjetëm Ali Aliun, Selatin Novosellën, Asllan Kastratin, Hazir Shalën, Sami Dërmakun, Ali Pecin, Idriz Dakën, Xhemajl Pllanën, Ferki Morinën, Skënder Haradinajn, Azem Haxhën dhe Jakup Rexhepin. Pos Xhemës, Ferkiut dhe Shaqës të tjerët po i takoja për herë të parë.

Pa shiko se ç' nder më kanë bërë duke më futur në një dhomë me ajkën e djalërisë, burrërisë dhe qëndresës shqiptare? Ju faleminderit udbash!– thashë vetë me vete.

Oda e Madhe kishte një dritare të kthyer kah shëtitorja e burgut. Xhamat e dritares ishin të lyer me një ngjyrë që e bënte të pamundur të shihje jashtë. Dallohej se dikush nga të burgosurit, që kishte qëndruar në atë dhomë para nesh, e kishte gërvishtur një vrimë shumë të vogël në ngjyrën e xhamit dhe po ta afroje afër syrin mund t'i shihje të burgosurit në shëtitore. Por unë nuk isha nga ata trima që do ta merrja guximin e t'i afrohesha "vrimës së dritës"... Pastaj unë edhe nuk kisha se çka të shikoja. Xhemën dhe Ferkiun i gjeta në *Odën e Madhe* dhe shokë të tjerë të organizatës sime nuk njihja.

Vendosja në *Odën e Madhe* së bashku me Xhemën, Ferkiun dhe Shaqën më bëri përshtypje. Isha i sigurt se kjo ishte bërë me qëllim. Gjithashtu isha i sigurt se UDB-a e kishte njeriun e saj në dhomën tonë dhe se spiuni do ta hetonte sjelljen tonë në çdo hap. Në rastin tonë, sidomos do të përpiqej të mësonte për lidhjet e mia me Xhemën. Sa për shoqërimin tim me Ferkiun nuk shqetësohesha sepse isha i sigurt se ata na kishin parë së bashku në tren, në fakultet dhe shumë

vende të tjera. Shaqën, e kisha mik shtëpie dhe nuk kishte asgjë sekrete për kontaktet tona.

Edhe me Xhemën, u prezantova ashtu si edhe me të gjithë të burgosurit tjerë. Gjithashtu, me qëllim nuk shoqërohesha me Xhemën, në dhomë, dhe bëhesha sikur nuk e njihja.

Po më tmerronte fakti se të tre ishim në burg. Megjithëkëtë kisha bindjen se ata na kishin futur në burg vetëm për shkak të dyshimeve të vjetra dhe se këlyshët e Faruk Mehmetit nuk kishin asnjë informacion për "mëkatet" tona të pas vitit 1979- të.

Prandaj, më mbante shpresa se një ditë do të marrë fund ky lloj izolimi. Unë e kisha marrë një vendim dhe refuzim të ankesës time, por nuk e kuptoja se çka do të thoshte në praktikë ligji mbi bazën e të cilit ne ishim burgosur. Njëri nga të burgosurit e *Odës së Madhe* na informoi se sipas ligjit, pushteti jugosllav, mund të na mbante në këtë lloj izolimi gjer në tre vite, pa na hedhur në gjyq.

Shaqa, sapo dëgjoi shpjegimin e shokut të dhomës për "ligjin e izolimit", lëshoi një seri mallkimesh me disa "t'u thaftë goja," që na bëri të qeshnim të gjithëve! Shaqa i mallkonte ata që përhapin "gënjeshtra" të tilla! Ai nuk besonte se ligji thoshte se mund të na mbanin në izolim kaq kohë të gjatë.

Unë e kuptoja se Shaqa kishte arsye të mërzitej. Në shtëpi kishte lënë të shoqen me katër fëmijë dhe nuk kishte bërë asgjë "armiqësore".

Qysh gjatë kohës sa isha në "liri", sapo pata marrë vesh se e kanë arrestuar Shaqën, kisha edhe një dyshim se shkak i arrestimit mund të ishte një ndërhyrje e tij tek udbashi Sylejman Arifi, pas arrestimit tim në vitin 1979. E mbaja mend se sapo kishte marrë vesh Shaqa se më kishin arrestuar, e kishte kërkuar udbashin Sylejman Arifi, të cilin e kishte pasur edhe shok klase për dymbëdhjetë vite me radhë, dhe e kishte pyetur për mua. Në atë rast Shaqa më kishte mbrojtur para udbashit se "isha djalë i mirë dhe se më kishin marrë pa bërë ndonjë faj!" Sipas të gjitha gjasave, ma thoshte mendja, se udbashi Sylejman Arifi, duhet ta këtë raportuar "ndërhyrjen" e Shaqës tek shefat e tij. Arrestimi i tij dhe marrja në pyetje lidhur me mua ma shtonte edhe më shumë këtë dyshim. Por, më shkonte mendja gjithashtu, si shkak i arrestimit të tij mund të ishin edhe marrëdhëniet e këqija, që kishte Shaqa, me një kolege të nacionalitetit serb, në vendin e tij të punës në Komunën e Mitrovicës. Serbja, si pjesëtare e popullit "hyjnor" që ishte , mund ta ketë denoncuar Shaqën, si nacionalist?

Në *Odën e Madhe* unë takova dhe u njoha personalisht me figura të mëdha të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës, si Ali Aliu, Hazir Shala, Selatin Novosella, Ali Peci, Sami Dërmaku e të tjerë, që njëherit edhe kishin kaluar vite të tëra nëpër burgjet jugosllave dhe kishin një përvojë të hidhur por edhe shumë të rëndësishme në përballje me UDB-ën.

Një personalitet i madh dhe një njëri i jashtëzakonshëm që pushtetarët e kishin përplasur në bodrumin e thëngjillit së bashku me mua dhe shumë të tjerë, ishte padyshim edhe Ali Aliu. Në *Odën e Madhe* mësova se Ali Aliu ishte pjesëmarrës i Luftës Antifashiste e Nacionalçlirimtare dhe se ai qysh si i ri

kishte marrë pjesë me pushkë në dorë për çlirimin e Shqipërisë, Kosovës dhe Jugosllavisë. Ishte gjithashtu edhe një nga ekonomistët e parë shqiptar në Jugosllavi dhe se para burgosjes disa vite pas mbarimit të luftës antifashiste kishte pasur detyra të rëndësishme në udhëheqjen e Komunës së Preshevës dhe Bujanovcit. Ali Aliu kishte shumë humor dhe na bënte të harronim se ku ishim. Ali Aliun dhe veteranët tjerë të lëvizjes sonë nacionalçlirimtare unë i konsideroja si shembull se si duhet sjell në rrethana burgu, që për mua ishin ende të panjohura.

Por fatkeqësisht në *Odën e Madhe* unë gjeta edhe Azem Haxhën dhe Jakup Rexhepin që ishin dy të burgosur të çuditshëm. Azem Haxha, që mbante mustaqe, mbahej si trim i madh dhe si njëri që e kishte udhëhequr demonstratën e Mitrovicës. Ai shkonte aq larg sa e rrihte gjoksin dhe fliste me krenari për trimëritë e tij dhe se si nuk kishte frik nga as policia dhe as nga burgu! Sjellje të tilla të çuditshme bënte edhe Jakup Rexhepi. Të çuditshëm i bënte edhe fakti se të dy ndonëse ishin nën hetime e të akuzuar për veprimtari armiqësore, policia i kishte futur në një dhomë me veteranë të lëvizjes sonë nacionalçlirimtare!

Azem Haxha, gjatë një bisede që e dëgjonin edhe shokët tjerë të dhomës, me pyeti:

– A e ke parë dramën "Gërsheti i luftërave"?

– Jo nuk e kam parë,– iu përgjigja Azem Haxhës.

– A ke dëgjuar për Azem dhe Shota Galicën?

Ndonëse nuk dëshiroja të flisja, pyetja e tij më nxiti t'ia tregoj dy histori që i kisha dëgjuar në fshatin tim për Azem Galicën:

–Në fshatin tim i kam dëgjuar dy histori për Azem Galicën: sipas historisë së parë, një mbrëmje, Azem Galica, vetë i shtati, vie tek kulla e Mehmet Mustafës në Mihaliq. Në momentin kur vije Azem Galica me shokë, Mehmet Mustafa dhe meshkujt e tij ndodheshin në lamë duke e fshirë grurin, me kuaj të lidhur rreth mullarit. Azem Galica e përshëndet të zotin e kullës dhe i thotë t'ju prijë në kullë. Sapo hyjnë në kullë, Azem Galica e urdhëron të zotin e kullës ta dërgojë një mashkull dhe ta thërret nga një burrë për fis. Pas pak vijnë burrat e fshatit dhe Mehmet Mustafa, ndonëse ishte i kamur, nuk ua pjekë bashkëfshatarëve të tij asnjë kafe! Këtë e heton Azem Galica dhe e urdhëron kafexhiun që t'jua pjekë nga një kafe burrave të fshatit. Në prani të burrave të fshatit, Azem Galica e pyet të zotin e kullës se përse nuk ia kishte dërguar ndihmën që ia kishte premtuar, para më shumë se një viti? Mehmet Mustafa nis të arsyetohet dhe ankohet se nuk kishte pasur mundësi. Atëherë Azem Galica, në prani të fshatit, i thotë Mehmet Mustafës se kishte afat që deri pasnesër me ia dërgu tridhjetë lira tek Kroni i Kishës në Qyqavicë.

Njeriu që ia kishte dërguar tridhjetë lirat Azem Galicës tek Kroi i Kishës në Qyqavicë kishte qenë Veli Goli, i cili asokohe ishte rrogëtar (shërbëtor) në shtëpinë e Mehmet Mustafës. Unë e kam njohur dhe parë disa herë në fshatë gjatë fëmijërisë sime.

Dhe historia e dytë, ka të bëjë me vrasjen e një fshatari të fshatit tonë, i cili asokohe kishte qenë xhandar i Serbisë. Një ditë Azem Galica së bashku me katër – pesë shokë(hipur në kuaj) kalon nëpër fshatin tonë. Xhandari Serbisë, i sheh dhe ua lëshon një thirrje në serbisht, që të ndalen: *Stoj*! Kur e dëgjon Azem Galica ia kthen pushkën dhe e vret..,– ia ktheva Azem Haxhes.

Pas dëgjimit të historive të mia, Azem Haxha më bëri të njëjtën pyetje që ma patë bërë ditën e parë Ferid Feka:

– Përse të kanë sjell këtu e të kanë bërë bashkë me ne? Mos të kanë sjellë për të na spiunuar?!

Pyetja e Azem Haxhës ma çoj në kupë të qiellit tensionin e gjakut, por unë s'i thashë gjë, vetëm i lëshova një shikim dhe vazhdova të bëhesha sikur nuk më bëri përshtypje provokimi i tij.

Selatin Novosella, që e kishte dëgjuar bisedën tonë dhe që ndodhej i shtrirë në shtrat, nën shtratin ku qëndroja i ulur, ma preku këmbën, që në njëfarë mënyre më sinjalizojë që të mos e vazhdoja bisedën...

Pas tregimit të historive të Azem Galicës, në një rast, ndodhesha në një qoshe të dhomës së bashku me Selatin Novosellën, i cili me zë të ultë me thotë:

– Mos i merrja në gojë historitë si ajo e Azem Galicës se të shkallmojnë dru!

Unë e kuptova këshillën e tij dhe iu përgjigja shkurt:

–Ju kuptoj...

Jakup Rexhepi, në anën tjetër, ndonëse me profesion na thoshte se ishte jurist, mbahej nën hetime në Odën e Madhe së bashku me trembëdhjetë të burgosur të tjerë! Ajo që ishte edhe më e çuditshme, Jakup Rexhepi, i drejtohej herë Ali Aliut, herë Selatin Novosellës e herë Sami Dërmakut që ta ndihmonin dhe udhëzonin se si të mbrohej ditën e gjyqit!

Pas tre javësh qëndrimi në izolim, na nxorën nga dhoma grupe-grupe dhe na lejuan të bëjmë dush, në një banjë të burgut.

Diku rreth 14 dhe 15 majit 1981, një nga gardianët e burgut, nëpërmjet dritares së vogël të derës së *Odës së Madhe* e hodhi në dhomë një ekzemplar të gazetës "Rilindja". Dikush nga shokët e dhomës e mori dhe filloi ta lexonte "Rilindjen". Pas pak kohe nisën ta lexojnë edhe të burgosurit tjerë.

I fundit që e lexoi "Rilindjen" ishte Azem Haxha. Sapo lexoi lajmin për përleshjen e Nebih dhe Tahir Mehës me policinë me 13 maj 1981 në Prekaz e lëshoi një thirrje: "Ju lumtë pushka!" Pas kësaj një heshtje e përgjithshme e pushtoi *Odën e Madhe.* Heshtja fliste vet. Ajo nuk kishte nevojë për komente. Ata që kishin kaluar me nga dhjetëra vite nëpër burgjet serbo-jugosllave nuk mund t'i mashtronte aq lehtë një vegël e UDB-ës.

Një paradite, na u hap dera e *Odës së Madhe* dhe na urdhëruan të dilnim në shëtitoren e burgut, ku zakonisht na nxirrnin çdo mëngjes dhe ne e bënin edhe një shëtitje, të rreshtuar njëri pas tjetrit, por edhe i lanim sytë dhe dhëmbët në një krua që kishte aty në oborrin e burgut.

Një gardian me fytyrë të rrumbullakët dhe lëkur ngjyrë të kuqe, që ishte i fshatrave të *Artakollit*[9] më ndaloi në korridor. Të burgosurit tjerë vazhduan drejt oborrit të burgut. Gardiani që nuk ia kam mësuar kurrë emrin më thotë:

– Nga shtëpia i ke mirë!

–Të faleminderit -ia ktheva dhe vazhdova rrugën drejt shëtitores!

Ndonëse, e falënderova për lajmin që ma dha, nuk më pëlqeu mënyra dhe vendi që gardiani kishte zgjedhur për të biseduar me mua. Duke dyshuar se UDB-a kishte njerëzit e saj që na mbanin në mbikëqyrje jo vetëm ne, por edhe gardianët, mendoja se nuk ia vlente që gardiani të rrezikonte aq shumë për një lajm nga shtëpia! Sidoqoftë, i isha shumë mirënjohës gardianit për simpatinë që po tregonte për ne të burgosurit.

Pas katër javësh qëndrimi në izolim, u hap dera e *Odës së Madhe,* dy gardian më dërguan në një dhomë e cila dukej se ishte dhe zyrë hetimesh.

Sapo hyra në dhomë, që si dukej ishte edhe zyrë hetimesh, më shkuan sytë mbi një tavolinë, ku qëndronte një revolver i " harruar" nga dikush! Meqë nuk kishte njëri në dhomë, po qëndroja në këmbë dhe po pritja një hap brenda, te dera. Pas pak erdh afër derës një njeri me rroba civile, që dyshoja se ishte ndonjë udbash, që s'e njihja dhe se kisha parë kurrë. Meqë dera ishte e hapur dhe unë nuk po ulesha, por po qëndroja në këmbë afër derës, udbashi u largua dhe pas pak erdhi përsëri. Si duket i befasuar se unë nuk e kisha prekur revolverin, që e kishte lënë aty, pas pak hyri brenda në dhomë më urdhëroi të zija vend. E mori revolverin dhe e futi në një sirtar të tavolinës që e kishim në mes. Udbashi fillojë të më pyet:

– Kush je dhe përse ndodhesh këtu?!

Unë i dhurova një "buzëqeshje" dhe i thashë:

– Quhem Asllan Muharremi. Jam nga fshati Mihaliq i Vushtrrisë. Nuk di se përse me kanë marrë shokët tuaj, por këtu më është dhënë një vendim i cili shpjegon se përse mbahem këtu! Po, ju kush jeni, ju lutem, a mund të prezantoheni, i them udbashit?

– Jam Ramadan Cana, – u prezantua ai.

Sapo më tha se quhej Ramadan Cana, më doli parasysh shoqja ime e klasës Merita Cana.

– Ju i ngjani shumë një shoqeje të klasës që quhej Merita Cana, – i them Ramadan Canës.

E hetova se kjo që i thashë dhe që në njëfarë mënyre na bëri të "njohur" me njëri-tjetrin nuk i pëlqeu fare Ramadan Canës! Fytyra e tij fliste vet. Ai u skuq!

– Ku e njihni ju Merita Canën?

–Ju thashë e kam pasur shoqe klase për katër vite në Gjimnazin "Silvira Tomazini" në Mitrovicë.

– Më trego se përse je arrestuar në vitin 1979? Me trego se si jeni njohur me Ramadan Pllanën dhe shokët e tij?– më pyeti Ramadan Cana.

Unë nuk dëshiroja të flisja për Ramadan Pllanën. Këtë e kuptoi pas pak kohe edhe udbashi Ramadan Cana, i cili pas rreth një ore marrje në pyetje më ofrojë ta nënshkruaj një dokument.

Dokumentin e lexova dhe e kuptova se në të kërkohej nga unë njëfarë "dhënie bese" se do të isha për "vëllazërim-bashkimin e popujve të Jugosllavisë dhe për socializmin vetëqeverisës jugosllav...". Meqë nga nënshkrimi im e kuptoja se varej edhe lirimi im nga burgu, e nënshkrova afër fundit të deklaratës së shkruar nga unë dhe diktuar nga Ramadan Cana.

Takimi me Ramadan Canën ishte shumë interesant. Mora vesh se ai ishte nip i Faruk Mehmetit, ndërsa Faruk Mehmeti nip i Sefedin Batallit. Çfarë lëmshi spiunësh! Ramadan Cana, hetues i Sherbimit të Sigurimt të Shtetit në Mitrovicë, Faruk Mehmeti shef i Sherbimit të Sigurimit të Shtetit në Mitrovicë, Sefedin Batalli shef i Shërbimit të Sigurimit të Shtetit në Prishtinë. Një zinxhirë spiunësh në shërbim të Serbisë.

Sapo dola nga dera e burgut shkova drejtë tek halla Fazë në Bair të Mitrovicës. Shaqa ngeli në burg, prandaj familjes së tij dëshiroja t'ia përcillja lajmin se ai ishte shëndoshë e mirë dhe se shpresoja se edhe ai do të lirohej shumë shpejtë.

Përsëri në "liri"

Disa ditë pas lirimit tim është liruar edhe Ferkiu. Ndërsa, një javë apo dy pas nesh, është liruar Xhema dhe Shaqa.

Lirimin e shokëve nga burgu e konsideroja si fitore për të gjithë rrethin tonë. Isha i sigurt, se UDB-a na liroi nga izolimi, të treve, sepse nuk kishte asnjë informacion se ne vepronim së bashku. Më gëzonte edhe fakti se asnjë nga shokët e krahut tim: të Xhemës e as të Ferkiut, nuk ishte burgosur. Mos arrestimi i asnjë shoku dhe mos zbulimi i ndonjë fakti, gjatë hetimit që UDB-a kishte bërë me të burgosur të tjerë, fliste vetë, se shumë gjëra i kishim bërë mirë. Përndryshe, isha i sigurt, se UDB-a nuk do të na kishte falur kësaj radhe, asnjërin prej nesh, po të dispononte edhe informacionin më të vogël se ne ishim të organizuar dhe vepronim si pjesëtarë të një organizate ilegale.

Kthimi në "liri", për mua, nënkuptonte se punën e nisur duhej ta vazhdonim me hapa edhe më të shpejtë. Ne kishim shumë detyra para vetës, që po na prisnin. Mirëpo, përkundër kësaj, nuk kishte arsye të nxitohesha. Isha i mendimit se duhej ta bëja një "pushim" të vogël dhe të mos bëja veprime të gabuara!

Një ditë, motra ime Nafija, më njoftoi për telashet që i kishte nxjerrë drejtori i Shkollës Fillore "Vuk Karaxhiq" në Prilluzhë. Ish bashkëfshatari e ish arsimtari im, Rrahman Syla, gjatë kohës sa isha mbajtur në izolim, i kishte marrë në pyetje, në drejtori, të gjitha vajzat shqiptare të shkollës dhe i kishte pyetur ato se "mos i kishte nxitur Nafija" të visheshin kuq e zi?

Kur mora vesh këtë lajm, u mbusha me pezëm në Rrahman Sylën, aq më tepër kur e kujtova një takim të rastësishëm me te, në Stacionin e Trenit në Prelluzhë, pas lirimit, dhe kur më bënte lajka e urata për lirimin tim!

Disa ditë pas lirimit nga arrestimi, në shtëpinë time vije për vizitë Ali Grajçefci së bashku me kushëririn tim Haqif Sadiku. Ali Grajçefcin e kishim nip; ai ishte i biri i Mihanës, bijës së tretë të Beh Mihaliqit. Aliu na vizitonte shumë rrallë. Edhe këtë vizitë të papritur, nipi e prezantoi, si vizitë tek dajët e tij në Mihaliq dhe jo si një vizitë tek unë personalisht.

Megjithëkëtë takimi me Ali Grajçefcin dhe kushëririn tim, u karakterizua nga një bisedë shumë interesante të cilën e kam rikujtuar shumë herë gjatë bisedave me shokë. Ali Grajçefci e filloi bisedën kështu:

– Pse more daja Asllan, po demonstroni dhe po i jepni shkak Serbisë me na i marrë edhe ato pak të drejta dhe liri që i kemi fituar me mund e gjak?! A nuk e kishim bërë edhe ne këtu Shqipëri? A nuk e bëmë Radio Televizionin e

Prishtinës, si atë të Tiranës? A nuk sillnim libra me kamion nga Shqipëria? A nuk nisëm me lëvizë andej e këndej, si asnjëherë më parë?!

E dëgjova me vëmendje të madhe. Ndjehesha paksa i habitur dhe nuk e kisha pritur një bisedë të tillë. Në një anë, më vinte mirë që Ali Grajçevci po bisedonte me mua çështje politike, por meqë unë nuk kisha biseduar asnjëherë me nipin për çështje të tilla, nuk dija se çka t'i thosha. Pyetjet e Aliut ishin njëfarë "akuze" në adresën time dhe të studentëve që po kërkonin që Kosova të bëhej e barabartë me Republikat tjera të Federatës Jugosllave! Megjithëkëtë qëndrimi i nipit më dukej interesant, ndonëse sipas mendimit tim në të kishte edhe shumë kundërthënie. Unë nuk i fajësoja studentët dhe demonstruesit për ndalimin e librave nga Shqipëria, ashtu siç nuk mund t'i fajësoja ata për përkeqësimin e marrëdhënieve me Shqipërinë. Përkundrazi, unë mendoja se serbomëdhenjtë po i përdornin kërkesat e drejta si sebep për heqjen edhe të atyre pak të drejtave dhe lirive që shqiptarët i kishin fituar me shumë sakrifica. Qëndrimi i Ali Grajçevcit më ngjante me qëndrimin e një shtrese të gjerë intelektualësh, që kisha përshtypjen se ishin zënë në gjumë nga kurthet e serbomëdhenjve dhe tani ishin shumë të dëshpëruar e nuk dini si të dilnin nga kjo gjendje.

– Unë nuk kam marrë pjesë në asnjë demonstratë, prandaj UDB-a më liroi. Gjithashtu unë nuk i kam organizuar demonstratat dhe nuk kam lidhje me organizatorët e tyre. Pajtohem me ty se dikush po i përdorë demonstratat për qëllime të tjera dhe për t'ua hequr shqiptarëve edhe ato pak të drejta dhe liri të fituara me aq shumë gjak,– i thashë Aliut.

Ali Grajçevci me shikoi dhe nuk e tha asnjë fjalë më shumë. Unë e kuptova reagimin e tij si një pajtueshmëri mendimesh lidhur me gjenezën e demonstratave dhe interpretimin e qëllimshëm që u bëhej atyre nga ana e serbomëdhenjve.

Ali Grajçevci jetonte në Prishtinë dhe punonte si jurist në Termocentralin "Kosova" në Obiliq. Nga im atë kisha dëgjuar se në vendin e tij të punës punonin edhe një mori intelektualësh të tjerë, të shquar, si Ismail Dumoshi, Ahmet Maloku e të tjerë. Ahmet Malokun e kam takuar disa herë, gjatë rrugës për shkollë, së bashku me Asllan Avdiun. Për qëndrimet e tij të njohura atdhetare kisha dëgjuar nga im atë dhe disa ish nxënës të Shkollës Normale në Mitrovicë.

E mbaj mend një bisedë të tim atë lidhur me punësimin e Shefqet Jasharit në Termocentralin e Obiliqit. Ismet Jashari, e kishte lutur tim atë të fliste me Ali Grajçefcin lidhur me punësimin e Shefqet Jasharit. Kam dëgjuar se Shefqet Jashari ka punuar në Termocentralin e Obiliqit, për një kohë gjersa është burgosur në nëntorin e vitit 1979. Besoj se punësimi i Shefqet Jasharit ka ndodhur për shkak të simpatisë që ka pasur rrethi i Ali Grajçafcit për të burgosurit politik.

Punë e parë që bëra pas lirimit, ishte vënia e kontakteve me shokët. Nga takimet mësoja edhe për gjendjen në terren, por edhe për problemet dhe telashet me të cilat përballej veprimtaria jonë.

Gjatë takimit me Xhafën u shqetësova kur mësova se ai ishte eksponuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë. Xhafa më tregoi se ai kishte qenë organizatori i ndërprerjes së mësimit në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në mesin e marsit 1981, që ishte ngjarje me rëndësi. Gjatë këtij organizimi Xhafa kishte vepruar, në radhë të parë, në mes shokëve që i kishte njohur prej vitesh, në një tjetër masë me studentë tjerë dhe ndonjë profesori që simpatizonte hapur lëvizjen studentore. Në një zhvillim të tillë ngjarjesh, në ditën e parë kur faktikisht një masë e madhe e studentëve ishte në sheshin përballë fakultetit dhe kur është realizuar qëllimi i organizimit, bojkotimi i mësimit në shenjë solidarizimi me studentët e Prishtinës, Luljeta Pula e dërgon shoferin e Fakultetit Xehtaro-Metalurgjik, i cili pa rënë në sy, ia pështpërit Xhafës fjalët e porosinë e Luljeta Pulës që të largohet menjëherë prej aty sepse qëllimi i asaj dite ishte arritur.

Ky ishte një lajm shumë shqetësues. Xhafa ishte një shok shumë i rëndësishëm për mua dhe unë nuk dëshiroja që puna e nisur të ndërpritej kështu. Fatmirësisht ndërhyrja e profesoreshës së tij, Luljeta Pula pati efekt shumë pozitiv për Xhafën dhe rrethin tonë.

Me Xhafën biseduam për gjendjen e krijuar. U pajtuam që të tregohej i kujdesshëm dhe që për një kohë mos qëndronte në shtëpi të tij. Në atë takim, Xhafa më ka njoftuar se disa shokë të tij, ishin arrestuar gjatë demonstratës së 26 prillit 1981 në Mitrovicë.

Diku në fund të qershori 1981, në shtëpi të Xhafës në fshatin Stanofc i Ultë, jam taktuar edhe me Sinan Kastratin nga rrethi i Malishevës, student i Fakultetit Filozofikë- Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, që sapo ishte liruar nga burgu pas një dënimi prej dy muajsh për pjesëmarrje në demonstratat e marsit në Prishtinë. Së bashku me ne ka qenë edhe Xhevat Durmishi, vëllai i Xhafës, i cili ishte student i Fakultetit të Mjekësisë. Në atë rast kemi biseduar për gjendjen e krijuar si dhe kemi shprehur opinionet tona për zhvillimet politike dhe qëndrimin e pushtetit jugosllav kundër demonstruesve dhe kërkesave të shtruara.

Disa ditë më vonë Xhafa është larguar nga Kosova dhe ka kaluar diku në Evropën Perëndimore. Unë nuk kam ditur as ditën e nisjes dhe as destinacionin.

Pas largimit të Xhafës nga Kosova, në shtëpi të *Hoxhës së Vogël* në Gllavotin, për herë të parë e kam takuar Sheremet Saraçin. Sheremet Saraçi ishte arsimtar në Shkollën Fillore "Liria" në fshatin Strofcë. Takimi me Sheremet Saraçin ka qenë i rastësishëm dhe i paplanifikuar. *Hoxha i Vogël* më kishte folur fjalë të mira për Sheremet Saraçin edhe më herët.

Pas takimit me *Hoxhën e Vogël* jemi marrë vesh që ai dhe Sheremet Saraçi ta vazhdojnë miqësinë dhe bashkëpunimin dhe që unë të vazhdoja të takohesha vetëm me *Hoxhën e Vogël*.

Kërkesa "Kosova – Republikë" dhe sfidat

Demonstratat e mars-prillit 1981 dhe sidomos kërkesa që Krahinës së Kosovës t'i njihej statusi i Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave, na hodhën para një sfide shumë serioze. Organizata "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi", pjesë e të cilës ishim edhe ne, në nenin e parë të statutit të saj e kishte të shkruar se "*Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës lufton për çlirimin e të gjitha viseve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me Nënën Shqipëri, gjegjësisht për krijimin e shtetit shqiptar brenda kufijve të vet kombëtar"(* Statuti i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi, Neni 1). Ndërsa kërkesa "Kosova-Republikë" ishte një kërkesë që synonte që Krahina e Kosovës të ngrihej nga statusi i tanishëm, i një krahine në kuadër të Serbisë, me disa elemente konstituive në kuadër të Federatës Jugosllave, në një status ku do të barazohej me republikat tjera në Federatën Jugosllave.

Për ne, nuk ishte një çështje e thjeshtë ta "braktisje" programin e një organizate që luftonte për bashkimin kombëtar dhe të kthesheshe e të luftoje për diçka që nënkuptonte që Kosova dhe viset tjera shqiptare do të vazhdonin të ishin pjesë e Federatës Jugosllave. Në dukje të parë, të krijohej përshtypja sikur ne po luftonim për t'i "graduar" udhëheqësit aktual të Krahinës së Kosovës dhe sikur po hiqnim dorë edhe nga lufta kundër padrejtësive kombëtare dhe shoqërore!

Veç kësaj, ne e konsideronim vetën tonë si revolucionarë dhe përpiqeshim për një rend tjetër shoqëror. Për ne, udhëheqja jugosllave dhe Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, ishte një udhëheqje antipopullore, revizioniste dhe që ishte në shërbim të serbomëdhenjve. Komunistët jugosllav, i kishin të lara duart me gjakun e shqiptarëve, por edhe të revolucionarëve të mirëfilltë të kombeve të tjera, që kishin luftuar për një botë të lirë dhe pa shtypje e shfrytëzim.

Në anën tjetër, përkundër terrorit dhe dhunës së egër serbomadhe, kërkesa "Kosova-Republikë" kishte fituar simpatinë e popullit dhe hapte një perspektivë të re për popullin shqiptar në kuadër të Federatës Jugosllave.

Ne ndodheshim në një gjendje ku qëndrimi ynë ndaj kërkesës "Kosova-Republikë" duhej të ishte i drejt dhe pa paragjykime. Për mendimin tim, ne nuk guxonim të tregoheshim dogmatikë, përkundrazi duhej të tregoheshim dialektik dhe këtë çështje duhej ta gjykonim mbi bazat e teorisë shkencore të materializmit dialektik dhe historik.

Ishin të natyrshme pyetjet që më silleshin nëpër kokë: A ia vlente të luftonim për barazi edhe të shqiptarëve në kuadër të federatës jugosllave? Realizimi i kërkesës "Kosova-Republikë", a do ta avanconte pozitën e shqiptarëve në kuadër të Federatës Jugosllave apo jo? A do të bënim tradhti nëse e përkrahnim kërkesën "Kosova-Republikë" dhe "heqim" dorë nga kërkesa për bashkim kombëtar në këtë periudhë të luftës sonë?

Gjatë disa takimeve, me Xhemën dhe Ferkiun, e kemi shtruar çështjen e kërkesës "Kosova-Republikë", atë të programit të LNÇKVShJ-së, si dhe kemi biseduar për dilemat e sfidat që kishim para nesh. Ne të tre, ishim betuar para flamurit të Gjergj Kastriotit se *"të gjitha aftësitë tona fizike, psikike dhe materiale do t'i vëmë në shërbim të popullit dhe do të jemi të lumtur po që se flijohemi për çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Nënën Shqipëri!"*[10] Nuk kishte mëdyshje se nga ne po kërkohej ta kishim të qartë se nga duhet të ecnim dhe se çka duhet të bënim në atë epokë të luftës sonë? Ne nuk mund të mbyllnim sytë para kërkesë "Kosova-Republikë" dhe para vullnetit të popullit.

Gjatë debateve që bënim lidhur me sfidat që kishim para nesh, Xhema përdorte një dialektikë të shkëlqyeshme, që na çonte tek konkluzionet shumë të drejta dhe që na lëviznin në drejtim të përkrahjes pa hezitim dhe me gjithë zemër të kërkesës "Kosova-Republikë".

-Duhet të veprojmë ashtu siç vepruan rilindësit tanë gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të përqafojmë e luftojmë për realizimin e atyre kërkesave që janë të realizueshme, pa e harruar qëllimin tonë,–na thoshte Xhema.

Por debateve që bënim, ne të tre, si dhe ato që unë bëja në mënyrë individuale me shokët tjerë, një ndihmesë të madhe në këtë kthesë "prapa" na dha edhe Radio Tirana, e cila nëpërmjet valëve të saj nisi të na i përcjellë edhe artikujt e "*Zërit të Popullit*" dhe revistave të tjera nga Shqipëria, që ne i konsideronim edhe si qëndrime edhe të shtetit shqiptar.

Duke marrë parasysh edhe vullnetin e popullit në Kosovë dhe kërkesat e tij të ligjshme, duke marrë në konsideratë qëndrimin e shtetit shqiptar në mbështetje të luftës së popullit tonë për barazi e liri në kuadër të Federatës jugosllave, si dhe duke u mbështetur në mësimet që dilnin nga teoria e materializmit dialektik dhe historik, ne përfundimisht u bëmë përkrahës të zjarrtë të kërkesës "Kosova-Republikë" dhe nisëm përpjekjet për ta dhënë kontributin tonë në realizimin e saj. Pas debateve që bëmë, kërkesën "Kosova-Republikë", e vlerësuam si një kërkesë e drejtë dhe revolucionare dhe që i hapte perspektivë popullit tonë. Prandaj edhe ne ju bashkuam thirrjes "Kosova–Republikë"!

Ne duhej ta kuptonim drejtë kohën dhe hapësirën në të cilën po jetonim dhe mbi këto baza të bënim edhe përpjekjet për të gjetur edhe punët që do të duhej t'i kryenim, me qëllim, që edhe ne të ishim pjesë e zhvillimeve të kohës sonë dhe të përpjekjeve të popullit tonë për liri dhe barazi. Një nga detyrat e para, që "zbuluam", ishte ngritja e organizimit të radhëve tona në një nivel të ri si dhe

përpjekja për zgjerimin radhëve tona. Në këtë mënyrë, e në punë e sipër, shpresonin se do ta arrinim edhe bashkimin e të gjitha forcave dhe energjive revolucionare, që tashmë kishin shpërthyer si një vullkan.

Ishim të vetëdijshëm se kërkesa "Kosova-Republikë" e kishte rritur dhe zgjeruar shumë frontin e luftës sonë dhe se pas kësaj kërkese nuk ishim vetëm ne dhe grupet e organizatat tjera politike që vepronin ilegalisht, por edhe një pjesë e klasës politike shqiptare të Kosovës.

Qëndrimi i Beogradit ndaj kërkesës "Kosova-Republikë" ishte i egër dhe thellësisht antishqiptar. Udhëheqja federative, ishte dorëzuar para presionit serbomadh dhe në Kosovë, jo vetëm që ishin mbushur burgjet me shqiptarë, por drejt Kosovës ishin nisur policia speciale jugosllave dhe emisarë politikë serbë e shqiptarë, me një qëllim të vetëm, që ta thyenin qëndresën e popullit shqiptar dhe luftën e tij për barazi dhe republikë.

I ashtuquajturi diferencim ideo-politik, që kishte nisur menjëherë pas demonstratave të marsit e prillit dhe që synonte t'i përçante shqiptarët dhe frontin e tyre për liri dhe barazi në kuadër të Federatës Jugosllave, po zhvillohej me hov të madh. Kjo e rëndonte edhe më shumë gjendjen edhe ashtu të rënduar.

Politika e represionit të egër serbomadh, që shprehej me burgosje masive dhe dënime shumë të gjata të shqiptarëve, kishte si qëllim jo vetëm "shkatërrimin" e grupeve revolucionare shqiptare, por edhe frikësimin e popullit. Më këtë politikë, serbomëdhenjtë "ëndërronin" ta mashtronin popullin se gjoja ata janë të pathyeshëm dhe se e kontrollonin në përgjithësi gjendjen!

Përballë këtij terrori shtetëror, me punën tonë, ne na duhej t'i tregonim popullit se lufta jonë për liri ishte një kala që nuk pushtohet, se pas çdo burgosje, vrasje e mase represive, nga gjiri i popullit lindnin heronjtë e rinj, që dinë ta çojnë luftën tonë për liri përpara, drejt fitores.

Mirëpo kjo veprimtari ishte shumë e lehtë të thuhej me fjalë, ndërsa ishte shumë e vështirë të realizohej në praktikë. Prej nesh, kërkohej jo vetëm përpjekje e guxim, por edhe zgjuarsi. Ne duhej të bënim punë dhe të mos gabonim e të binim në burg.

Shpërndarja e shtypit ilegal, si "Bashkimi," "Lajmëtari i lirisë", "Liria", librave dhe materialeve tjera propagandistike nuk ishte e mjaftueshme për t'i treguar popullit se ne vepronim dhe nuk zbuloheshim nga UDB-a. Prandaj gjatë një takimi me Xhemën dhe Ferkiun, vendosëm që ta zgjerojmë aktivitetin tonë dhe të fillojmë me shkrimin e parullave, ku do të dominonte kërkesa "Kosova-republikë!" Kërkesa të tjera si ato që ishin të drejtuara kundër revizionizmit jugosllavë dhe tradhtarëve titistë , ishim të mendimit që t'i linim anësh dhe të mos i përdornim në këtë epokë të luftës për liri.

Së bashku me Ferkiun blemë ngjyrë të kuqe metalike dhe vendosëm që t'i shkruanim disa parulla: "Kosova-Republikë" në muret e Shkollë së Mesme "Muharrem Bekteshi" në Vushtrri dhe në muret e shtëpive të tjera nëpër qytet.

Për këtë çështje fola edhe me shokët: Rexhep Ahmeti, Bedri Selmani dhe Vebi Muja. Të njëjtën gjë e kanë bërë edhe Xhema dhe Ferkiu me shokët e tyre.

Një detyrë tjetër, që i kishim ngarkuar vetës ishte edhe ndikimi në familje dhe në rrethin ku jetonim në frymën patriotike dhe revolucionare. Ashtu si edhe shokët e mi edhe unë përpiqesha të ndikoja në familjen time. Unë punoja që Shabani të përgatitej dhe një ditë të kyçej edhe ai në Lëvizje... Skënderi (vëllai im) dhe motrat dhe vëllezërit tjerë ishin ende të vegjël dhe edukimin e tyre në frymën patriotike ia kisha "besuar" RTSh-së! Megjithëkëtë unë "luftoja" që sidomos motrat të shkonin në shkollë dhe në këtë drejtim puna ime ishte e përditshme. Propagandoja për emancipimin e femrës shqiptare dhe për barazinë gjinore në familje e shoqëri, si dhe luftoja zakonet patriarkale të Kanunit të Lekë Dukagjinit. Këtë punë, e bëja edhe unë në mënyrë legale dhe kudo ku hyja e dilja. Një ndihmë të madhe në këtë drejtim na e bënte edhe RTSh-ja. Që të shikohej RTSh-ja dhe të dëgjohej radio Tirana propagandoja nëpër të gjitha ato mese ku kishim ndikim. Dalëngadalë e gjithë shtëpia ishte me mua! Edhe im atë, që ishte anëtar i LKJ-së dhe që besonte se "uji ishte i kthjelltë tek burimi, por vinte duke u turbulluar kur arrinte poshtë tek masa, me kalimin e kohës, ndonëse kishte frikë se do të burgosesha, ishte me mua dhe me shokët e m'i. Kjo kishte rëndësi shumë të madhe për mua.

Mbas një takimi që kam pasur me Xhemën dhe Ferkiun, u pajtuam që Ferkiu dhe unë të bënim një aksion dhe të shkruanim parulla në mbështetje të kërkesës "Kosova-Republikë". Në atë takim zgjodhëm edhe vendin e shkrimit të parullave.

Një mbrëmje, së bashku me Ferkiun, u veshëm me rroba që nuk i përdornim zakonisht si dhe mbathëm këpucë të tjera nga ato që i përdornim vet dhe shkuam në këmbë afër lumit Silnica. Lumin e kaluam në këmbë më qëllim që t'i humbnim gjurmët në rast se policia do të vinte pas gjurmëve tona. Pas pak u futëm në fshatin Lumi i Madh. Shkruam parulla "Kosova-Republikë" dhe "Poshtë tradhtarët!" në muret e Shkollës Fillore të fshatit pastaj u ngjitem deri tek rruga automobilistike Prishtinë-Vushtrri-Mitrovicë dhe edhe aty e shkruam një parullë "Kosova-Republikë" të gjatë sa ishte rruga, pra tërthorazi rrugës, diku katër-pesë metra të gjatë dhe ikëm. Në oborrin e Shkollës Fillore gjendej edhe një kishë ortodokse, por në të nuk shkruam asgjë. Këtë e bëmë sepse me këtë dëshironim t'ju thoshim serbëve nga Kosova se ne nuk kemi asgjë kundër tyre si dhe më qëllim që propaganda serbe të mos e përdorte një akt të tillë si argument për ta nxitur popullatën minoritare serbe kundër nesh.

Njohja me Shyqyri Imerin

Bejtë Mustafa, bashkëfshatari im, gjatë një takimi të rastësishëm në rrugën e fshatit, më njoftoi se gjatë një udhëtimi me tren e kishte takuar një student nga Shtitarica, i cili e kishte pyetur për mua. Bejta më tha, gjithashtu, se studenti që e kishte takuar ishte i *pllanajve* të Shtitaricës dhe e kishte një vëlla të burgosur.

Disa ditë më vonë, gjatë një takimi me Xhemën, mësova se kush ishte takuar me Bejtën. Edhe Xhema ma tregoi historinë e bisedës në tren.

Një kohë të gjatë, pas takimit, sa herë e takoja Bejtë Mustafën, më pyeste për Shokun! Ndonëse nuk e pranoja se takohesha me Xhemën, Bejtë Mustafa më thoshte: "Nëse e takon, të fala shokut!"



Shyqyri Imeri

Një ditë mora vesh se Bejtë Mustafa po e martonte të birin e tij, Kadriun dhe sipas zakonit e kishte ftuar në dasmë gjithë fshatin dhe miq e dashamirë të familjes.

Në dasmë u nisa së bashku me tim atë. Ende pa arritur tek shtëpia e Bejtës dëgjohej defi dhe zëri i vajzave duke kënduar. Para shtëpisë na pritën burrat dhe na urdhëruan të hynim në odën e mbushur plotë me dasmorë, ku buçiste kënga tradicionale folklorike shqiptare. Im atë u lut të ulej në krye të vendit, pranë burrave më të moshuar, ndërsa unë zura vend pranë moshatarëve të mi. Aty jam takuar dhe njohur me Shyqyri Imerin.

Shyqëri Imeri më njoftoi se ishte nga fshati Dumnicë e Ultë dhe se i ati i tij, ishte nip i Bejtë Mustafës. Gjatë dasmës e mora vesh se Shyqëri Imeri ishte një nxënës i Shkollës së Mesme "Muharrem Bekteshi" në Vushtrri. Gjatë bisedës mësova se ai e dëgjonte rregullisht Radio Tiranën, e shikonte Radiotelevizionin Shqiptar dhe se në shkollë shoqërohej me nxënës të mirë.

Në fund të dasmës u ndamë dhe u morëm vesh të takohemi pas një jave në Lum të Madh, aty ku bashkoheshin Llapi dhe Silnica, pranë Vigut.

Gjatë takimit të parë kemi shëtitur bregut të lumit Silnica dhe kemi biseduar për shumë gjëra. Në fund të takimit i kam propozuar që të takoheshim serish në të njëjtin vend dhe të vazhdonim kështu të takoheshim edhe për një kohë. Shyqyri Imerin e kam njoftuar se në të kaluarën policia më ka arrestuar në dy raste dhe se nuk është mirë që nëse takohemi në Vushtrri apo diku tjetër të flasim dhe qëndrojmë së bashku.

Kështu kemi bërë në vazhdim. Me Shyqyri Imerin jemi takuar nëpër vende të ndryshme, ashtu siç jemi marrë vesh, por asnjëherë në Vushtrri, asnjëherë në Prishtinë dhe asnjëherë në Mitrovicë.

Gjatë takimeve me Shyqyri Imerin mësova edhe emrat e mësimdhënësve të tij, si Rrahim Përçuku dhe Zenun Qela.

– Rrahim Përçuku na kërkon, ne nxënëseve, ta mësojmë përmendësh vargjet e poemës së Pashko Vasë Shkodranit "O moj Shqypni e mjera Shqypni". Gjithashtu gjatë bisedave, me ne nxënësit, na flet se ekzistojnë revista dhe libra të ndaluara, të cilat janë shumë interesante! – më tha Shyqa.

Shyqa fliste me simpati të madhe, sidomos, për Rrahim Përçukun.

Lidhur me Rrahim Përçukun, e kështillova Shyqën, të tregohej i kujdesshëm dhe të mos ia hapte zemrën. Gjithashtu, e kështillova që t'i kështillonte edhe shokët e tij që të tregoheshin të kujdesshëm ndaj tij. Shyqyri Imerit i tregova se unë e njihja Rrahim Përçukun dhe se përvoja e shokëve të mi me të na kishte ngjallur shumë dyshime se ai mund të ishte agjent i UDB-ës.

– Unë i njoh disa shokë që kanë pasur kontakte me té dhe ata sot ndodhën ne në burgje, – i thashë Shyqës.

Lidhur me dyshimet që kisha për Zenun Qelën, Shyqës ia dhashë shembullin e Jashar Durmishit:

– Zenun Qela e ka pyetur Jashar Durmishin se kush i ka shkruar inicialet "K-R" në bankën e tij dhe meqë Jashar Durmishi nuk i kishte dhënë ndonjë emër, Zenun Qelaj i jep besën Jashar Durmishit se shkruesi i inicialeve nuk do të ketë kurrfarë pasojash. Pas kësaj, Jashar Durmishi e pranon se është ai vet që i ka shkruar inicialet "K-R". Menjëherë pas pranimit, Zenun Qelaj e lajmëron Jashar Durmishin tek drejtori dhe pas kësaj Jashar Durmishi përjashtohet nga shkolla.

Lajmet që ia dhashë Shyqës e befasuan dhe i mori ato seriozisht. Këtë qëllim kisha edhe unë.

Dhjetor 1981

Që nga vera e vitit 1981 nuk kisha asnjë lajm për Xhafën. E dija se ndodhej diku në Evropën Perëndimore.

Gjatë takimeve me Xhemën e Ferkiun, kisha biseduar, herë pas here, si për rrezikimin e Xhafës ashtu edhe për shpresën që kisha se ai nuk do të vononte e do të kthej përsëri në Kosovë. Largimin e tij e kisha menduar më tepër si përpjekje për t'ju ikur syve të udbashëve gjatë asaj vere dhe jo si një largim për një qëndrimin e tij të gjatë jashtë vendi.

Mirëpo duke e njohur angazhimin e tij në veprimtarinë liridashëse e atdhetare, unë mbaja shpresë se Xhafa, gjatë qëndrimit të tij diku në Evropën Perëndimore, do të krijonte lidhje me ndonjë organizatë revolucionare nga Kosova?! E dija se diku në Evropën Perëndimore botoheshin organet "Bashkimi", "Liria" dhe revista "Lajmëtari i lirisë". Me shokët kisha folur edhe për Jusuf Gërvallën dhe kishim dëgjuar se ndodhej diku në Gjermani. Xhema, gjatë një takimi, më ka pas thënë se gjatë seancës gjyqësore kundër grupit të LNÇKVShJ-së (Shefqet Jasharit, Ramadan Pllanës, Avdi Kelmendit, Avdyl Lahut, Skënder Jasharit, Isa Demajt, Sylejman Qyqallës dhe Hysen Gërvallës) kishte dëgjuar se edhe Jusuf Gërvalla ishte përmendur si anëtar i "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi". Shpresën e mbaja gjallë se Xhafa do të kthehej me lajme të mira, ndonëse nuk e dija a ishte apo jo anëtar i ndonjë organizate politike. Këtë e bëja, ndonëse, Xhafa, asnjëherë nuk më kishte folur për ndonjë organizatë të veçantë, përkundër faktit se kishte vite që e njihja dhe viteve të fundit kisha këmbyer shumë libra dhe të gjitha gazetat ilegale që qarkullonin nëpër Kosovë.

***

Në fillim të dhjetorit 1981, një natë, gjersa isha duke shikuar televizorin, dëgjova një trokitje të lehtë në dritaren e odës. U ngrita shpejtë dhe e hapa pak perden. Para derës së oborrit e pashë dikë që nuk e njihja se kush ishte, ndonëse jashtë shndriste drita e hënës. Dola nga oda dhe shkova ta hapë derën e oborrit. Sapo hapa derën e pashë Sheremet Saraçin!

– Mirëmbrëma! Mirë se vini! Urdhëroni! – e përshëndeta dhe i dëshirova mirëseardhje Sheremetit, që me ardhjen e tij të papritur po më befasonte.

– Mirëmbrëma! Nuk jam vetëm. Më vete e kam Xhafer Durmishin. Bëhu gati dhe eja se sonte do të shkojmë tek unë! – ma ktheu Sheremeti.

U futa shpejtë në odë, u vesha mirë dhe u ktheva tek Sheremet Saraçi që po më priste tek dera e oborrit. Isha shumë i befasuar dhe nuk e prisja se Xhafer Durmishi do të kthehej e do të vinte tek unë së bashku me Sheremet Saraçin.

Së bashku u nisëm në drejtim të përroit, që ishte matanë rrugës. Pasi kaluam rrugën dhe përroin, duke ecur, nga larg, e pashë që po qëndronte dhe priste Xhafa, i cili sapo na pa u nis drejtë nesh. U përqafuam fortë e me mall dhe të tre së bashku, pas rreth një gjysmë ore, arritëm në shtëpinë e Sheremet Saraçit në Bivolak, ku derën e shtëpisë na e hapi, e shoqja e tij, Elhemja.

Atë natë qëndruam së bashku gjer në mëngjes. Xhafa me njoftoi se gjatë kohës së qëndrimit të tij në Gjermani, kishte ra në kontakt me *shokët* dhe se me ta kishte biseduar edhe për mua; se para *shokëve* atje më kishte prezantuar si shok i krahut të Ramadan Pllanës.

Atë natë, për herë të parë, Xhafa më ka njoftuar se ai ishte anëtar "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi".

Po atë natë, nga Xhafa jam njoftuar, gjithashtu, se qëllimi i ardhjes së tij në Kosovë ishte të rivendoste kontakte me shokët e "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" si dhe të bënte punën parapërgatitore për sjelljen dhe shpërndarjen e organit "Zëri i Kosovës" në Kosovë. Xhafa, gjithashtu më propozoi që edhe unë t'i bashkohesha "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi".

Pak pa zbardhur dita me Xhafën u pajtuam të takoheshim përsëri, pas dy-tre ditësh, dhe u largova nga shtëpia e Sheremet Saraçit.

Kthimi i Xhafës më gëzoi shumë. Qysh kur ishte larguar, unë shpresoja se gjatë qëndrimit jashtë ai do të vendoste lidhje me ndonjë organizatë revolucionare dhe kjo kishte ndodhur! Gëzimi ishte edhe më i madh, meqë shoku im, i shumë viteve më parë, më doli se ishte anëtar i LNÇKVShJ-së, organizatës sime, kontaktin me të cilën së bashku me Xhemën dhe Ferkiun, po e kërkonim si i verbëri dritën.. Gjithashtu, u gëzova shumë se nëpërmjet Xhafës u njoha me Sheremet Saraçin, të cilin e njihja si arsimtar të Shkollës Fillore "Liria" në Strofcë dhe e kisha takuar njëherë tek kushëriri dhe shoku im, Hoxha i Vogël.

Mirëpo, për kthimin e shumëpritur, qëllimet dhe propozimet e Xhafës, unë duhej të bisedoja dhe ta merrja mendimin e Xhemës dhe Ferkiut. Ne të tre e konsideronim vetën tonë si një celulë e shkëputur e LNÇKVShJ-së dhe lajmet që po më jepte Xhafa ishin shumë të rëndësishme jo vetëm për mua, por edhe për dy shokët e mi.

Dy-tre ditë më vonë jam takuar me Xhemën dhe Ferkiun. Ata i kam njoftuar për kthimin, për qëllimin e kthimit dhe propozimet e Xhafës. Gjithashtu shokëve jua thashë edhe mendimin tim lidhur me propozimin e Xhafës. Unë isha për përgjigje pozitive në propozimin e Xhafës dhe nuk kisha as dyshimin më të vogël në besnikërinë dhe ndershmërinë e tij.

Edhe Xhema e Ferkiu u pajtuan që unë ta pranoja propozimin e Xhafës. Ata ishin të pajtimit që lidhja jonë të jetë lidhje individuale dhe jo si grup, që nënkuptonte që unë s'do të flisja në emër të shokëve, por në emrin tim personal. Duke pasur parasysh përvojën e hidhur të burgosjes së nëntorit të vitit 1979, kjo

mënyrë e mbajtjes së kontakteve me Lëvizjen, të treve na dukej si mënyra më e mirë për ruajtjen e radhëve tona nga zbulimi.

Me kthimin e Xhafës, ne krijuam lidhje me "Lëvizja Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi", pjesë e të cilës ishim edhe ne. Po fluturoja nga gëzimi.

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare te Kosovës dhe Viseve te tjera Shqiptare ne Jugosllavi

Nr. 1 Nentor 1981

Kosova gjëmëmadhe, trimëresha Kosovë

Xhafa dhe Sheremeti, gjatë një takimi tjetër, e shtruan çështjen udhëtimit në Bled të Sllovenisë, për ta pritur organin e LNÇKVShJs-ë – "Zëri i Kosovës". Për këtë qëllim, ndonjëri prej nesh, duhej ta njoftonte një *Shok* në Gjermani. Këtë detyrë e mora përsipër unë. Në atë rast, Xhafa më tha se " *Shokut* duhet t'i prezantohesh si *Aliu* dhe ta njoftosh për ardhjen e *Skënderit* (Xhafer Durmishit) në Kosovë". Nga Xhafa, e mora një numër telefoni dhe një tekst në gjermanisht. Telefoni ku do të telefonoja ishte i një gjermani, mik e fqinjë i familjes Gërvalla. Gjithashtu, ato ditë, nga Xhafa mora edhe një aparat fotografik të markës *Kodak,* me të cilin do të bëja fotografi, me pamje nga vende dhe objekte të ndryshme nëpër Kosovë. Një detyrë tjetër, ishte edhe mbledhja e informacioneve, fotografive dhe materialeve të tjera me rëndësi për personat e vrarë, të plagosur apo të burgosur gjatë demonstratave të pranverës së vitit 1981 e më vonë.

Për t'ia përcjell *Shokut të Lëvizjes* lajmin e arritjes së Xhafës (Skënderit) në Kosovë më është dashtë të bëjë disa përpjekje. Jam përpjekur ta marrë në telefon *Shokun* nga lokale të postës në Prishtinë, Obiliq, Mitrovicë dhe Vushtrri, por pa sukses. Nuk merrej lidhja telefonike! Në një rast, gjatë thirrjeve, kam pasur ndërhyrje të një zëri i cili më ka pyetur në serbisht: *Sto ti treba? Ocesh pare od njega, ili?* Në atë rast, i kam lëshuar një breshëri të sharash "Zërit" dhe kam dal nga kabina, e kam bërë pagesën dhe kam ikur nga aty. Pas kësaj ndërhyrje e kisha të qartë se UDB-a i përgjonte telefonatat jashtë vendi dhe me siguri këtë e bënte edhe me telefonin e *Shokut.*

Pas shumë përpjekje dhe dështimeve të bëra për ta marrë në telefon *Shokun* në Gjermani, më në fund nga posta e Obiliqit cingëroj telefoni i gjermanit dhe pas pak edhe përgjigja e tij:

– *Alo!...*

Unë ia nisa me gjermanishten time të mësuar përmendësh:

– *Guten tag!*[11] *Kan ich schprehen mitt Herr Gervalla, bitte!*

– *Ein moment, bitte!* – u përgjigj gjermani.

Pas disa minutash heshtje dhe pritje dëgjova një zë:

–**Alo, Gërvalla!**

–"Tungjatjeta! Jam Aliu. Skënderi është shëndoshë e mirë dhe ju bënë shumë të fala!" – ju përgjigja ashtu siç më patë porositur Xhafa..

– **Të faleminderit për telefonatën! Të fala Skënderit!** – ma ktheu Gërvalla dhe linja u ndërpre.



Jusuf Gërvalla

Ndonëse u ndërpre lidhja, isha shumë i gëzuar! Kryesorja ishte se u morëm vesh se ne do ta prisnim "Zërin e Kosovës" në Bled, ashtu siç ishin marrë vesh ***Shoku*** dhe *Skënderi* (Xhafer Durmishi). E bëra pagesën, dola menjëherë nga posta dhe ika për shtëpi.

Po atë mbrëmje shkova tek Sheremet Saraçi, ku e kishte folenë Xhafa dhe i njoha të dy për bisedën me *Shokun* e Lëvizjes(që unë besoja se ishte Jusuf Gërvalla, por atëherë nuk e kam pyetur asnjëherë Xhafën për këtë).

Xhafa më tha:

–Tani duhet të bëhemi gati menjëherë dhe të nisemi për në Bled të Sllovenisë. Sipas marrëveshjes me *Shokun*, "Zëri i Kosovës" do të niset nga Gjermania dhe ne duhet të arrijmë me kohë në Bled. Deri atje kemi bukur shumë rrugë për të bërë.

Atë natë biseduam se kush do të udhëtonte për Bled. Sheremeti dhe Xhafa ishin kundër që unë të udhëtoja në Bled. U pajtuam që të udhëtonte Xhafa dhe një shok i tij, emrin e të cilit nuk e dija.

Mbrëmjen e 17 dhjetorit 1981, Xhafa dhe Bahtir Haradinaj erdhën tek unë në Mihaliq. Po atë natë, nga Xhafa mësova se Bahtir Haradinaj ishte shok i tij i studimeve dhe shoku me të cilin ai kishte udhëtuar në Bled. Xhafa më njoftoi se takimi me shokët, që do ta sillnin "Zërin e Kosovës", nuk kishte ndodhur! Të gjithë ishim të dëshpëruar për këtë "dështim". Xhafa na tha:

–Bisedova me shokët në Gjermani. Ata më kështilluan që menjëherë të largoheshim nga Bledi. *Shokët e Lëvizjes* ishin të shqetësuar se shokët që e kishin sjell "Zërin e Kosovës" nga Gjermania, mund të ishin ndaluar nga policia jugosllave në kufi dhe se ka shumë gjasa që ata ishin arrestuar."

Naser Hajrizi, në këmbë, i dyti nga e majta. (Fotografi e marrë me vete nga Xhafa gjatë kthimit në Gjermani)

Në mbrëmje, e hapa televizorin dhe ne të tre po i shikonim lajmet. Spikeri i RTSh-së komunikoi lajmin se ishte vetëvrarë Mehmet Shehu! Një heshtje e rëndë, na pushtoi. E tmerrshme! Edhe një dëshpërim i ri na u shtua. Ky lajm na duhej më së paku! Një Shqipëri e dobët, me probleme dhe ministra që vetëvriten! Kush e donë vallë një Shqipëri të tillë? Askush pos armiqve tanë, ju përgjigja kokës sime. Kjo që dëgjuam ishte një goditje e rëndë edhe për ne. Ku do të mbështeteshim ne e ku do të qaheshim nëse i ndodh ndonjë e keqe atdheut tonë?! Vallë ç'është duke ndodhur në Shqipëri?! Pa ditur se ç'ka ndodhur dhe ç'motive e kanë shtyrë Mehmet Shehun të vetëvritej, ne e morëm si të vërtetë qëndrimin zyrtar të shtetit shqiptar dhe ju bashkuam atij në "dënimin" e aktit e vetëvrasjes! Nuk kishim kah t'ia mbanim. Ne duhej të vazhdonim t'i dilnim krah Shqipërisë sonë të shtrenjtë!

Gjatë kohës së qëndrimit të Xhafës në Kosovë, falë angazhimit të shokëve nëpër rrethe, arritën të mblidhnim materiale të rëndësishme edhe për organin

“Zëri i Kosovës”. Materialet e mbledhura, Xhafa, do t’i merrte me vete kur të kthehej në Gjermani.

Burim Zagragja, Ferki Morina
dhe Behxhet Ahmeti

Shokët me të cilët mbante lidhje Ferkiu: Behxhet Ahmeti dhe Burim Zagragja na kishin siguruar një fotografi të Naser Hajrizit, të riut që u vra gjatë demonstratave në Prishtinë dhe të Nesim Danës nga Gjakova. Ata dhe shokët

Nesim Dana

tjerë mblodhën emrat e shumë shqiptarëve të vrarë, emrat e shumë të burgosurve si dhe mblodhën edhe shumë materiale të tjera me rëndësi për “Zërin e Kosovës”, por edhe për sensibilizimin e opinionit botëror për dhunën dhe terrorin e egër serbomadh në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi.

Vrasja e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës

Diku kah mesi i janarit 1982, në shtëpinë e Sheremetit, jam takuar me Xhafën. Në atë rast, Xhafa më ka njoftuar se do të shkonte në Prishtinë, sepse kishte një detyrë nga shokët e Lëvizjes dhe duhej ta takonte një shok. Në atë rast jemi pajtuar që të takohemi në Prishtinë në ëmbëltoren e Qendrës së Rinisë.

Paraditen e 19 janarit 1982 arrita në Qendrën e Rinisë. Në ëmbëltore e takova Xhafën. Gjersa ishim duke i pritur kafetë, shkova dhe e bleva "Rilindjen". Duke u kthyer në ëmbëltore ia lëshova sytë "Rilindjes" dhe aty lexova lajmin e tmerrshëm të vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës. Ika menjëherë drejtë ëmbëltores. Sapo u afrova afër Xhafës, ia dhashë ta lexonte "Rilindjen" dhe lajmin e hidhur që kishte aty. Xhafa, e lexoi lajmin, e mbylli "Rilindjen" dhe për një moment nuk tha asnjë fjalë. Mori një pamje të zymtë. Pas pak më tha:

– Nëse ky lajm është i vërtetë, atëherë UDB-a jugosllave na i paskan vrarë shokët! Jusuf Gërvallën dhe Bardhosh Gërvallën i njoh, ndërsa Kadri Zekën nuk po e njoh, si emër. Kadri Zeka mund të jetë një shok që quhej Zeqa. Ai duhet të jetë shoku i OMLK-së, për të cilin më ka folur Jusuf Gërvalla.

E lamë ëmbëltoren dhe duke dalë nga Qendra e Rinisë, Xhafa më tha:

– Qysh nesër duhet të udhëtojë për Gjermani!

Para se të ndahemi u morëm vesh të takohemi përsëri në mbrëmje në shtëpinë e Sheremet Saraçit.

Në mbrëmje, Sheremet Saraçi e vërtetoi lajmin e hidhur të vrasjes së shokëve. Ai i kishte dëgjuar radion *Deutsche Welle* dhe nëpërmjet saj kishte mësuar për vrasjen e shokëve tanë, në afërsi të Shtutgartit. U pikëlluam të tre. Atë natë e kaluam pa gjumë. Ishim të "plagosur" rëndë. Humbja ishte e jashtëzakonshme. E merrja me mend se e gjithë lëvizja jonë nacionalçlirimtare ishte goditur rëndë me vrasjen e shokëve tanë.

Me 20 janarit 1982, herët në mëngjes, Xhafën e kam përcjell gjer në Stacionin Hekurudhor në Fushë Kosovë. Aty ai e ka marrë trenin Selanik- Munih.

Xhafa me vete mori të gjitha ato materiale që kishim arritur t'i grumbullonim. Në mesin e materialeve kanë qenë edhe dy fotografi të dy demonstruesve të vrarë gjatë demonstratave të mars-prillit 1981: Naser Hajrizit dhe Nesim Danës. Mua ma la aparatin fotografik që ia kishte dhënë Jusuf Gërvalla.

Në mbrëmjen e 20 janarit, Radio Tirana transmetoi artikullin e "Zërit të Popullit" me titull "Kosovës po i vriten djemtë nga serbomëdhenjtë".

***

Përcjellja e Xhafës, menjëherë pas marrjes së lajmit për vrasjen e shokëve, ishte një moment tjetër i rëndë për mua. Koha e qëndrimit të Xhafës në Kosovë, iku shpejtë dhe unë nuk kisha arritur të shtroja me te shumë probleme që kishim. Unë dhe shokët kishim nevojë për përvojën e shokëve të udhëheqjes, të cilat shpresoja se Xhafa duhej t'i kishte takuar gjatë qëndrimit në Gjermani.

E merrja me mend se, vrasja e Jusuf Gërvallës, Lëvizjes sonë i kishte dhënë goditje të rëndë. Tashmë e kisha mësuar se prapa tre numrave të "Lajmëtarit të lirisë" e dy numrave të "Zërit të Kosovës, qëndronte vigani Jusuf Gërvalla, se UDB-a jugosllave nuk mund ta duronte punën e tij, prandaj mori vendim, ua zuri pritën dhe i vrau në pabesi! Gjithçka më dukej si një ëndërr trishtuese. Druaja për Xhafën dhe shokët që ishin pranë tij, ndonëse unë nuk i njihja asnjë me emër.

Por dëshpërimit nuk duhej t'i linim vend, sepse këtë e dëshironin armiqtë tanë. Ata na i vranë shokët me qëllim që ne ta ndalnin luftën tonë,-i thosha vetës sime. Ne duhej ta çonim amanetin e shokëve në vend dhe ta vazhdonin luftën për liri, aty ku e kishin lënë Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka. Asnjëherë nuk më ka pas shkuar mendja se UDB-a, që drejtonte Jugosllavinë titiste, do t'i trajtonte ndryshe shokët tanë, sidomos ata që ishin në ballë të luftës sonë për liri, përkundrazi unë e kam pritur se ata do të na e zënë pritën, ashtu siç kanë bërë kundër shumë atdhetarëve të tjerë që luftuan për liri.

Me 5 shkurt 1982, në Shtutgart. Xhafer Durmishi, gjatë ceremonisë së varrimit të Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës.

Mirëpo, kur është në pyetje vrasja në afërsi të Shtutgartit, unë isha i bindur se UDB-a jugosllave nuk ishte e vetme në këtë veprimtari kriminale e antishqiptare! Nuk kam pasur asnjë fije dyshimi se vrasja në Untergruppenbach është realizuar falë mbështetjes që UDB-a jugosllave ka pasur nga forca të caktuara reaksionare të vendeve të ndryshme. Kisha lexuar se pak kohë para se të vritej Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka, në Gjermani kishin

bërë vizita udhëheqës të lartë shtetëror jugosllav. Është vështirë të besohet se gjatë vizitave nuk është zënë në gojë emri i Jusuf Gërvallës. Përndryshe është e vështirë të shpjegohet vrasja në "zemër" të Gjermanisë dhe skuadra vrastare të largohej nga Gjermania pa therë në këmbë!

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

TRE RANË, ME MIJËRA U NGRITËN

Numri i tretë i "Zërit të Kosovës", i redaktuar nga Xhafer Durmishi

Por unë dhe shokët e kishim bindjen e plotë se vrasja e shokëve nuk do ta arrinte efektin që e dëshironin serbomëdhenjtë. Përkundrazi unë besoja se vrasja tinëzare e shokëve në Untergrupenbach do t'i ngrit në këmbë me mijëra djem dhe vajza të tjerë që do t'i bashkohen luftës sonë nacionalçlirimtare.

***

Përkundër faktit se kthimi i Xhafës në Gjermani, menjëherë pas vrasjes së shokëve tanë, ishte një goditje tjetër që i bëhej veprimtarisë sonë në Kosovë, vend për dëshpërim nuk kishte. Gjatë kohës sa qëndroi në Kosovë Xhafa, mua më vuri në lidhje me dy shok të rinj, të krahut të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (Sheremet Saraçin dhe Bahtir Haradinajn) dhe veprimtarisë në shërbim të lirisë i dha vrull të ri.

Lidhjeve të mia me Xhemën, Ferkiun, Rexhën, Bedën, Shyqën, *Hoxhën e Vogël* dhe Vebën ju shtua edhe lidhja me Sheremet Saraçin dhe Bahtir Haradinajn. Meqë kontaktet me shokët i mbaja, me secilin veç e veç, më përjashtim të takimeve me Xhemën dhe Ferkiun, që kohë pas kohe i mbanim të tre së bashku, nga unë kërkohej shumë mund dhe kohë. Veç kësaj, ky volum punësh kërkonte edhe angazhim të madh. Çdonjëri nga shokët kishte rrethin e shokëve të tij, ashtu siç kishte edhe problemet që shtronte puna jonë. Duhej marrë informacionet nga shokët, dëgjuar mendimet e tyre, dhënë mendimin tënd, pastaj duhej shtruar problemet me shokët dhe gjetur zgjidhje të drejta dhe që nuk do t'i çonin shokët në "gojë të ujkut".

Ferkiu i vazhdonte kontaktet e tij me Burim Zagragjen, Behexhet Ahmetin dhe shokët tjerë në Fakultetin Ekonomik dhe fakultetet tjera.

Drita Morina, Mirvete Haliti, Hafije Durmishi, Elhame Haliti ishin gjithashtu një grup studentesh nëpërmjet të cilave Ferkiu përpiqej ta zgjeronte veprimtarinë tonë edhe në fakultet dhe rrethet tjera në Prishtinë e më gjerë.

Veprimtaria e Ferkiut nuk ndalej vetëm me kaq. Ai mbante kontakte me shumë patriotë e liridashës të tjerë nëpër rrethe të tjera dhe kudo i shpërndante literaturën ilegale dhe e përhapte frymën e lirisë.

Gjithashtu, Ferkiu i ruante kontaktet me shokët dhe shoqet e shkollës së mesme, por edhe krijonte kontakte të reja. Edhe çiftelinë dhe muzikën e përdorte jo vetëm për përhapjen e këngës patriotike, por edhe për t'u njohur e miqësuar edhe me figura të njohura të këngës popullore. Pos Fatmir Makollit, ai mbante lidhje edhe me disa këngëtarë dhe anëtarë të ShKA "Shota".

Në një takim me Xhemën dhe Ferkiun vendosëm që ta bëjmë një aksion dhe t'i shkruajmë disa parulla. U pajtuam që shkrimin e parullave ta bëjmë në disa pika. Gjithashtu u pajtuam, që kësaj radhe parulla të shkruanim vetëm unë dhe Ferkiu, si dhe që për këtë aksion të mos flisnim me asnjë shok tjetër.

Mirvete Haliti, Hafije Durmishi, Jashar Durmishi,
Shaban Muharremi dhe Drita Morina

Disa ditë më vonë, së bashku me Ferkiun i kemi bërë të gjitha përgatitjet për shkrimin e parullave në fshatin Lum i Madh.

Gjatë natës, në të gjitha muret e shkollës katërvjeçare e në murin e shitores së fshatit Lumi i Madh dhe në rrugën automobilistike Prishtinë –Vushtrri (në mes fshatit Lum i Madh dhe Stanofci i Epërm), kemi shkruar disa parulla "Kosova-Republikë!", "Poshtë tradhtarët!" etj. Parullat i kemi shkruar me ngjyrë të kuqe metalike dhe ato kanë qenë pothuajse nga një metër çdo germë e shkruar.

Gjatë shkrimit të parullave kemi përdorur dorëza dhe këpucë, që nuk i kemi përdoru asnjëherë më parë. Gjithashtu kemi qenë të maskuar me kapele dhe rroba të vjetra. Pas mbarimit të aksionit të gjitha mjetet e përdorura i kemi fshehur në një vend larg shtëpisë sime.

***

Me Rexhep Ahmetin njiheshim qysh nga shkolla e mesme dhe kishte disa vite që takoheshim e këmbenim literaturë të ndaluar. Shoqëria e miqësia jonë ishte rritur shumë. Rexha rridhte nga një familje fshatare dhe ishte një student i shkëlqyeshëm i Fakultetit Filozofik-Dega e Sociologjisë. Ai ishte i përgatitur në të gjitha drejtimet për t'u inkuadruar në Lëvizje dhe për të milituar në radhët e saj.

Mirëpo, duke ditur gjendjen e vështirë ekonomike të familjes së tij, më dhimbsej ta inkuadroja në radhët e LNÇKVShJ-së, sepse nuk doja që ta rrezikoja e të binte në burg dhe kështu ndoshta edhe t'ia ndërprisja edhe burimin e vetëm ekonomik familjes së tij. Megjithëkëtë pas shumë hezitimesh dhe duke marrë parasysh nevojën që kishte lufta jonë për liri edhe për burra të mendjes, siç ishte Rexha, vendosa t'i propozoj që edhe ai të anëtarësohej në radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi.

Në qershor të vitit 1982, Rexhën e kam njoftuar se unë veproja si anëtar LNÇKVShJ-së dhe në atë rast i kam propozuar që edhe ai t'i bashkohej organizatës sonë. Në atë rast i fola për programin politikë të LNÇKVShJ-së dhe dhe mënyrën e pranimit të anëtarëve të rinj. Rexhës i kërkova ta mendonte mirë këtë çështje dhe të më kthente përgjigje pas një jave. Gjithashtu, Rexhës ia dhashë ta lexonte materialin e LNÇKVShJ-së: "Statuti i Lëvizjes Nacional-çlirimtare të Kosovës".

E dija se Rexha kishte kontakte me një numër studentësh në Fakultetin Filozofik, si Musli Kosumi, pastaj në Mitrovicë së bashku me te vepronte Bedri Selmani, Azem Musliu, Fadil Shyti, vëllezërit e tij Nistret dhe Muhamet Ahmeti, si dhe kushëriri i tij, Salih Ahmeti. Prandaj, unë e gjykoja se inkuadrimi i tij në LNÇKVShJ-ë ishte një përforcim i madh për organizatën tonë në rrethin e Mitrovicës dhe më gjerë.

Pas një jave Rexha më është përgjigjur se e pranon programin dhe statutin e LNÇKVShJ-ës. Në shtëpinë time në Mihaliq, Rexha është betuar para flamurit të Gjergj Kastriotit dhe armës së lirisë (një pushke M-48 që nuk ishte e imja, por që e mbaja në shtëpi kohë pas kohe).

***

Që nga janari i vitit 1982 dhe kthimi i Xhafës në Gjermani, ne kishim ngelur përsëri pa lidhje me LNÇKVShJ-në. Duke pasur parasysh momentet dramatike të menjëherë pas vrasjes së shokëve në Untergurppenbach dhe kthimit të shpejtë të Xhafës ne Shtutgart, për mua ishte e pritshme se do të krijoheshin probleme në kontaktet tona. Unë kisha një numër telefoni të një shoku të Xhafës në

Gjermani, por megjithëkëtë dolën shumë probleme dhe asnjëherë nuk arrita të flas me te. E gjithë kjo më krijonte shqetësime. Megjithëkëtë unë shpresoja dhe po prisja se Xhafa do të lajmërohej dhe kështu do të na vinte në lidhje me Lëvizjen.

Ne kishim nevojë për konsultime me udhëheqjen e LNÇKVShJ-së, por mundësit tona për të udhëtuar jashtë vendi ishin të vogla. Xhema, Ferkiu dhe unë ishim pa pasaportë. Ajo që ishte edhe më keq: Xhema dhe Ferkiu nuk kishin as gjasa minimale për të marrë pasaportë, edhe nëse do t'ju shkonte mendja për një gjë të tillë. Unë e kisha një pasaportë në shtëpi, por e keqja ishte se pasaportës sime i kishte skaduar afati.

Në këshillim me shokët, në fillim të qershorit, e bërë kërkesën për vazhdimin e pasaportës dhe, meqë kishin kaluar disa javë që nga koha e dorëzimit të kërkesës, vendosa të shkoj në Stacionin e Policisë në Mitrovicë dhe të pyes se a më ishte shqyrtuar kërkesa ime apo jo?

Gjersa po prisja në radhë për t'u afruar afër sportelit dhe për të pyetur, tek dera e Stacionit të Policisë, e pashë surratin e udbashit Hajriz Mazhiqi. U bëra kinse nuk po e shoh, por pas pak e kuptova se ai më kishte parë dhe po më afrohej gjithnjë e më afër. Nuk kisha mundësi t'i shmangesha, prandaj e përshëndeta me një "Mirdita" dhe vazhdova të qëndroja në radhë.



Sekretariati për punë të brendshme KK Mitrovicë e Titos, sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 45. al. 2. të Ligjit mbi lejet e udhëtimit për shtetasit e RSFJ-së ("Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 30/79) dhe nenit 202. al. 1. në lidhje me nenin 206. të Ligjit mbi procedurën e përgjithëshme administrative ("Gaseta zyrtare e RSFJ", nr. 32/78), bjen

A K T V E N D I M

I MIRRET pasaporta numër CP-094012 për udhëtim në botën e jashtme ASLLAN MUHARREMIT, nga fshati Mihaliq, KK Vuçitërnë, lëshua nga Sekretariati për punë të brendshme KK Mitrovicë e Titos, më 24.05. 1979.

A r s y e t i m i:

Në bazë të fakteve dhe rrethanave të vërtetuara në procedurë, ky Sekretariat konstatoi se [illegible] sepse pas lëshimit të pasaportës u paraqiten shkaqet nga neni 43. a 1. pika 6. e Ligjit të cekur, për çka u vendos si në shqiptim.

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtojë ankesë Sekretariatit Krahinor për punë të brendshme të KSAK në Prishtinë në afat prej 15. ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Ankesa i dorzohet këtij Sekretariati me taksë prej 20. din. por mund të deklarohet edhe në Proces.

Në vështrim të nenit 21. të Ligjit mbi taksat administrative ("Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 23/79), taksë për këtë aktvendim nuk është pagua.

U VENDOS NË SEKRETARIATIN PËR PUNË TË BRENDSHME KK MITROVICË E TITOS, më 30.06.1982, nën numrin 04/27-3/129/78.

SEKRETARI I SEKRETARIATIT,
Sulejman Arifi

Pas pak hyra brenda dhe u drejtova tek sporteli. Aty pyeta për pasaportën time. Zyrtari që punonte aty më tha të ulesha dhe të prisja.

Diku pas një gjysmë ore, zyrtari me të cilin kisha folur më parë, më ftoi të afrohesha tek sporteli dhe më kërkoi që ta paguaja një taksë për shqyrtimin e kërkesës për vazhdimin e kohës së përdorimit të pasaportës. Pas pagesës, zyrtari më tha të nënshkruaja një dokument dhe pas nënshkrimit ma dha një

dokument, i cili, në të vërtet ishte vendimi i refuzimit të kërkesës për vazhdimin e pasaportës! U bëra tym për paratë që i pagova pa nevojë.

Një vendim të tillë edhe e prisja, por i çuditshëm ishte fakti se zyrtari që kishte marrë vendim për të ma refuzuar kërkesën time për vazhdimin e pasaportës nuk ishte askush tjetër pos udbashit me zile, Sylejman Arifi.

Vendimi për mos lëshimin e pasaportës ishte marrë me 30 qershor 1982(nr i pasaportës që kisha ishte CP-094012), disa ditë para se të shkoja në Stacionin e Policisë në Mitrovicë. Vendimi i marrë nga Sylejman Arifi ishte edhe një dëshmi se Jugosllavia titiste ishte një shtet policor dhe se UDB-a ishte ajo që merrte vendime për gjithçka. Për mua personalisht kjo ishte edhe një arsye më shumë për ta luftuar këtë pushtet antipopullor dhe antidemokratik.

***

Gjatë një takimi Veba, më ka njoftuar se një shok i tij e kishte një makinë shkrimi. Sipas Vebës, makina e shkrimit ishte e shokëve të Gani Sylës, veprimtarit të njohur të OMLK-së, që ishte i dënuar me 14 vjet burg së bashku me Hydajet Hysenin, Berat Luzhën, Mehmet Hajrizin e shumë veprimtarë të tjerë. Me Vebën ishim pajtuar që të na e sillte makinën e shkrimit sa më shpejtë që të jetë e mundur, këndej Qyqavice! Si me shaka, në atë rast, i pata thënë Vehbiut: "Makina e shokëve tanë që dergjen burgjeve serbe nuk duhet të ndjehet mirë nëse rri e fshehur; ajo është me "vajë në buzë" për të zotin e saj që e ka në burg!"

Nuk vonoi më shumë se dy javë dhe mësova se makina ndodhej tek *Hoxha i Vogël*. Po atë ditë, që mora lajmin, shkova dhe mora makinën e shkrimit në Gllavotin.

Duke u kthyer në shtëpi, kalova nëpër pyllin e fshatit tonë. Në një lendinë në mes të pyllit nuk u durova pa e hapur çantën dhe pa e shikuar "bukuroshen" time. Ishte hera e parë që kisha në dorë një makinë shkrimi. Nga kureshtja i afrova sytë pranë shkronjave të çuditshme dhe pa e marrë me mend se çdo të pasonte, e shtypa një shkronjë e cila me shpejtësinë e vetëtimës e "urdhëron" një shkronjë plumbi të më qëlloi në fytyrë! Sytë më lëshuan xixëllonja dhe lot. Veç dhembjes, goditja m'i futi ethet në barkë! Mendova se dikush më qëlloi me ndonjë grusht hundëve! Shikova rreth e rrotull dhe meqë s'pashë njëri i fshiva lotët dhe e futa përsëri në çantë makinën dhe ika në shtëpi. "Ç'dreq makinë qenka kjo,-thashë vetë më vete?!"

Për një kohë, makinën e shkrimit e kam mbajtur të fshehur në një strehimore dikur rreth katërqind metra larg shtëpisë. Në një qoshe të arës sonë, ku dikur ka pasur shumë drunj vidhi, por që tani ishte e mbushur me ferra dhe drunj të tjerë, e kisha hapur një gropë dhe aty e kisha vendosur makinën në një fuçi plastike. Aty i mbaja edhe librat dhe materialet tjera të ndaluara. Ndonjë libër ose material që lexoja, zakonisht e fshihja nëpër duaj të tallës, në pleme dhe shtëpi të vjetër. Kështu pata bërë, gjersa nëna ime, një ditë erdh dhe më pyeti: " se përse po i fshihja librat nëpër duaj talle?!"

Më vonë makinën e shkrimit e kam strehuar për një kohë në shtëpi të bacës Imer (Sadiku), gjersa një ditë Enveri (i biri i baca Imer) më zuri brenda në shtëpinë e tij me makinë në tavolinë (baca Imer banonte në banesën e tij në Prishtinë, por nganjëherë vinte dhe e vizitonte edhe shtëpinë e tij në Mihaliq).

Në murin e shtëpisë së re të bacës Imer, që gjendej poshtë shtëpisë së vjetër dhe përdorej edhe si ahur, e kam pas ndërtuar një strehimore për makinën e shkrimit, të cilën e lëshoja vertikalisht në mur dhe pastaj e mbuloja me dhe të tharë të tullave. Aty e kam ruajtur makinën e shkrimit një kohë të gjatë. Pas zhvendosjes së makinës së shkrimit nga aty kam strehuar libra dhe materiale tjera. Mbajtja e librave në strehimoren e hapur në tokë i dëmtonte librat, prandaj strehimorja në ahurin e bacës Imer ishte shumë me e përshtatshme.

Shumëzimi i "tetë kërkesave të parevokueshme..."

Kishte kohë që e kishim një ekzemplar të numrit të parë të "Zërit të Kosovës," të cilin po e shpërndanim dorë me dorë. Numri i parë i "Zëri i Kosovës", nëntorit 1981, përmbante edhe "tetë kërkesat e parevokueshme të LNÇKVShJ-së", të cilat njëherazi ishin edhe kërkesa programore të organit dhe organizatës sonë.

Duke i konsideruar "tetë kërkesat e parevokueshme..." si busull kah duhej ta zhvillonim veprimtarinë tonë, gjatë një takimi me Xhemën dhe Ferkiun u pajtuam që t'i shumëzojmë dhe shpërndajmë si trakt . Nga shkrimi në "Zërin e Kosovës" u pajtuam që kjo të ishte përmbajtja e traktit me "tetë kërkesat e parevokueshme:

> ***...Në mbrojtje të vullnetit sa e sa herë ndrydhur e të nëpërkëmbur të popullit shqiptar në Jugosllavi,-ne një pjesë e pararojës patriotike e komuniste të shqiptarëve të robëruar, që jemi organizuar në gji të Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi-dalin para popullit tonë, para opinionin jugosllav dhe atij botëror me këto*** *kërkesa minimale të parevokueshme:*
>
> ***1)Pa ju njohur Kosovës statusi i Republikës në kuadër të federatës jugosllave;***
>
> ***2)Pa ju njohur shqiptarëve në Jugosllavi statusi i kombit dhe, rrjedhimisht, e drejta demokratike e leniniste deri në shkëputje;***
>
> ***3)Pa u marrë menjëherë masat konkrete të të gjithë bashkësisë jugosllave që ritmi i zhvillimit të Kosovës të shpejtohet së paku në shkallën e parashikuar dhe të premtuar nga federata-do të thotë 60 për qind mbi mesataren jugosllave;***
>
> ***4)Pa u marrë masa të menjëhershme kundër papunësisë katastrofike në viset shqiptare, që në afatin sa më të shpejtë të inkuadrohet krahu i lirë(ekzistues) i punës dhe të tërhiqen punonjësit tanë të shkapërderdhur në Perëndim dhe nëpër republikat e zhvilluara të Jugosllavisë;***
>
> ***5)Pa shpalljen e amnistisë së përgjithshme, me të cilën do të liroheshin menjëherë dhe pa kusht të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë, që vuajnë dënime të rënda nëpër kazamatet jugosllave;***
>
> ***6)Pa marrë nga populli dënimin e merituar të gjithë ata udhëheqës politiko-shoqërorë, publicistë e njerëz të tjerë, qofshin nga Kosova ose nga republikat e Jugosllavisë, që janë implikuar në një mënyrë a në një tjetër në tragjedinë më të re të Kosovës, në fushatën e tërbuar antishqiptare të serbomëdhenjve, duke i shkaktuar popullit tonë plagë të reja dhe duke ndërsyer kundër tij popujt jugosllavë, të nxitur nga propaganda;***
>
> ***7)Pa formimin e një komisioni të posaçëm, që do të studiojë me themel dhe në hollësi aksionet shtetërore jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve, para e***

pas lufte, gjë që presupozon edhe publikimin e dokumenteve të fshehta shtetërore (të vjetra e të reja), që kanë të bëjnë me aksionin në fjalë; pa marrë dënimet e merituara të gjithë aktorët e gjallë (Çubrilloviçi me shokë) dhe të vdekur(Andriçi, Vukotiçi etj.)të këtij akti barbar të gjenocidit; pa iu marrë e drejta qytetare publike të gjithë atyre letrare (Duçiçi, Laliçi, Çosoçi, Bulatoviçi), kuazishkencore (Gjorgjeviçi, Cvijiçi etj.) e publicistike, në të cilat pasqyrohet përçmimi kombëtar e synimet antishqiptare, dhe mbi to të vihet embargo e përhershme jo vetëm në Kosovë po në mbarë Jugosllavinë;

8)Pa u rivendosur e pa u zhvilluar më tej marrëdhëniet e filluara kohë më parë mes popullit shqiptar(dhe popujve të tjerë) në Jugosllavi me shtetin dhe me popullin shqiptar në RPS të Shqipërisë, të ndërprera në mënyrë të njëanshme arbitrare e me qëllime thellësisht antishqiptare...

VDEKJE FASHIZMIT-LIRI POPULLIT!

KOMITETI QENDROR I LËVIZJES NACIONALÇLIRIMTARE TË KOSOVËS DHE VISEVE TJERA SHQIPTARE NË JUGOSLLAVI"[12]

Për realizimin e zotimit që kishim bërë, gjatë një takimi tjetër së bashku me Ferkiun i ndamë detyrat. Unë e bleva një pako me letër të makinës së shkrimit në librarinë e Mitrovicës. Aty bleva edhe fletët për shumëzim dhe materialin e nevojshëm për makinën e shkrimit. Ato ditë, gjithashtu, e takova Bedën (Bedri Selmanin) dhe i kërkova çelësin e shtëpisë së gjyshit të tij në Cerrnushë.

Disa ditë më vonë u morëm vesh me Ferkiun që të shkonim në Cerrnushë dhe caktuam ditën e nisjes. Unë i mora materialet që kisha, së bashku me makinën e shkrimit" dhe i futa në në çantë. Nga Mihaliqi, u nisa në këmbë, afër vijes hekurudhore Fushë Kosovë – Mitrovicë. Me Ferkiun u bëmë bashkë në Stacionin Hekurudhor në Pantinë.

Pas disa orë udhëtimi në këmbë, arritëm në Cerrnushë. Bënte një ditë e ftohtë dimri, por borë nuk kishte. Brenda në shtëpi, bënte shumë ftohtë. Megjithëkëtë, nga frika se po na diktonte roja e fshatit, nuk guxuam të ndiznim as stufën dhe as oxhakun, që e kishim. Natën e parë e kaluam duke biseduar dhe fjetëm me rroba veshur me rroba veshur dhe të mbuluar me disa jorgan të vjetër që i gjetëm në shtëpi.

Gjatë tre netëve të qëndrimit në Cerrnushë, gjithçka shkoi mirë dhe sipas parashikimeve. Ndonëse shkruanim shumë ngadalë dhe gjatë çdo shkrimi nuk mund të kopjonim më shumë se katër-pesë kopje, arritëm t'i shumëzojmë rreth 80 kopje të "tetë kërkesave të parevokueshme..." Një vështirësi tjetër, ishte edhe pamundësia e korrigjimit të gabimeve. Çdo gabim ngelej në letër.

Ditën e tretë, u zgjova herët nga gjumi dhe dola në oborr. Shtëpia, ashtu si të gjitha shtëpitë e fshatit, ishte ndërtuar në një kodër dhe kishte një oborr të pjerrtë. Nga aty, dukej si në pëllëmbë të dorës pothuajse e gjithë Shala e Bajgorës, gjer tek Maja e Zezë në Veri dhe Malet e Llapit dhe Gollakut në Lindje. Poshtë, nën fshatin Cerrnushë dukej si në pëllëmbë të dorës Gj*yteti*[13]*(* një kështjellë e vjetër ilire) dhe pak më në veri-perëndim fshati i shokut tim, Rexhep Ahmeti. Fshati Cerrnushë më kishte mahnitur, gjithmonë, me bukurinë e tij.

Në fshatin Cerrnushë kisha qëndruar shumë kohë gjatë fëmijërisë sime dhe e njihja si Mihaliqin tim, çdo pëllëmbë të tij. Gjithmonë më kishte mahnitur bukuria e tij përrallore. Cerrnusha ishte e njohur për dardhat e saj. Aty bëheshin disa dhjetra trupa dardhash të moçme dhe të llojeve të ndryshme. Fshatarët e Cerrnushës, që ishin të fisit Gimë, mbaheshin krenar që ishin pasardhës të Nikës. Ishte mëkat i madh që fshatarët e Cerrnushës e kishin braktisur këtë fshat me natyrë të mrekullueshme dhe ishin shpërngulur pothuajse të gjithë në Mitrovicë.

Ditën e tretë, kah mesi i ditës, dhe gjersa po shkruanim, papritur e pashë se erdhi roja e fshatit dhe hyri në oborr të shtëpisë së Bahtir Cerrnushës. E alarmova Ferkiun ta ndërpriste shkrimin dhe ta fshihte nën krevatin prej druri makinën e shkrimit.

Unë dola jashtë në oborr dhe u përshëndeta me Bajram Malokun dhe i thashë se isha së bashku me nipin tim, Idriz Selmainin, por që nuk ndodhej në shtëpi sepse "iku në drejtim të *Livadhit të Ukut*"!

Qëndruam pak kohë në oborr së bashku me Bajram Malokun dhe u përshëndetem me njëri-tjetrin. Unë hyra brenda në shtëpi, ndërsa roja shkoi në drejtim të *Lagjes së Katunit*.[16] Sapo iku roja e fshatit e futëm makinën e shkrimit dhe letrat në një çantë, që e kishim me vete dhe e lamë shtëpinë. Ikëm poshtë nëpër ahishtë dhe pas pak arritëm tek përroi poshtë afër *Gjytetit*. Nga aty, nëpër përrua ecëm gjersa arritëm pas gati një ore afër Smrekonicës. Aty, e kaluam rrugën automobilistike Mitrovicë- Vushtrri, u futëm nëpër ara e livadhe, afër Silnicës dhe vazhduam rrugën në drejtim të Stacionit të Trenit në Pantinë. Pastaj kaluam nëpër Shtitaricë dhe pranë hekurudhës arritëm në Pestovë. Në Pestovë, afër rrugës gjetëm edhe një arë me lakra, fatbardhësisht edhe disa lakra që fshatarët i kishin lënë në ara dhe unë për vete u rashë lakrave gjersa i mbusha brinjët. Diku në mbrëmje arritëm në Mihaliq. Makinën e shkrimit dhe letrat i lamë në një gropë që e kisha përgatitur qysh më herët diku rreth dy-treqind metra larg shtëpisë.

Qysh të nesërmen nisëm shpërndarjen e "Tetë kërkesave të parevokueshme të Lëvizjes.." Disa kopje i shpërndamë nëpër shokë. Diku rreth tridhjetë ekzemplarë së bashku me Ferkiun, i kemi shpërndarë në Amfiteatrin e Madh të Fakultetit Ekonomik. Meqë të gjithë studentët e kishin lënë Sallën e Amfiteatrit dhe kishin dal në pushim, siç ishim marrë vesh paraprakisht, Ferkiu bënte roje tek dera e Amfiteatrit, ndërsa unë i nxora nga xhepi dorëzat e i vesha shpejtë e shpejtë dhe nisa t'i fusë "tetë kërkesat..." nëpër librat e studentëve që i kishin lënë të shtrira mbi banka. Kështu i shpërndamë të gjitha traktet që kishim me vete dhe u larguam nga ligjërata dhe fakulteti. Disa të tjera i kemi shpërndarë nëpër shtëpi(nën dyer të oborrit) në Vushtrri dhe fshatra përreth.

Disa ditë më vonë së bashku me Ferkiun (pas një takimi edhe me Xhemën) e kemi mbështjell makinën e shkrimit dhe vendosur në një gropë në fushë në mes Vushtrrisë , Stacionit Hekurudhor të Vushtrrisë dhe rrugës së Galicës.

Shkrimi i parullave në Lum të Madh

Takimet e shpeshta me Shyqyri Imerin po më gëzonin shumë. Shyqyri Imeri po përparonte me ritëm të kënaqshëm. Gjatë takimeve që mbaja me Shyqën bënim debate për tema nga ma të ndryshmet. Gjithashtu gjatë debateve me të , unë po e kuptoja se ai vepronte në shkollë në përputhje me këshillat dhe sugjerimet e mia dhe ishte bërë emër në rrethin e shokëve të shkollës së tij.

Megjithëkëtë unë nuk dëshiroja që i gjithë aktiviteti ynë të ngelej vetëm në suazat e leximit të librave, shtypit ilegal dhe të debateve. Isha i mendimit që së bashku me Shyqën të bënim aksione dhe kështu me veprime praktike të kaliteshim dhe ta shtonim edhe më shumë besimin tek njëri- tjetri dhe pastaj ta shtroja, me të, edhe çështjen e Lëvizjes, pra t'i tregoja se unë isha anëtar i LNÇKVShJ-së, dhe t'i propozoja edhe atij që edhe ai t'i bashkohet organizatës sonë. Isha i sigurt se ai do ta pranonte me kënaqësi propozimin tim.

Gjatë një takimi të radhës biseduam për ndërmarrjen e një aksioni për shkrimin e parullave. U pajtuam dhe e caktuam vendin dhe kohën ku do të shkruanim parulla dhe se çfarë parullash të shkruanim.

Ashtu siç ishim pajtuar, u takuam tek Vigu ku bashkohen lumenjtë Silnica dhe Llap. Nga aty u futem në fshatin Lumi i Madh dhe pas pak arritëm tek shkolla fillore e fshatit. I ramë rreth e rrotull shkollës dhe pasi nuk pamë njëri as afër e as brenda saj nisëm ta zbukurojmë atë më nga një parullë "Kosova-Republikë" në tre ballinat e saj. Pas mbarimit të punës me shkollën u nisem në drejtim të shitores së fshatit dhe aty e shkruam një parullë "Kosova-Republikë" dhe menjëherë ikëm në drejtim të vendtakimit tonë, tek Vigu mbi lumenjtë Silnica dhe Llap.

Të nesërmen, aty diku rreth orës tetë të mëngjesit unë kalova nëpër fshatin Lumi i Madh dhe pranë shitores së fshatit i pashë duke e shlyer "Kosovën-Republikë" që unë e Shyqa e kishim shkruar para rreth nëntë orësh.

Shyqa, gjatë një takimi tjetër që kam pasur me të më ka njoftuar se ai i vetëm kishte shkruar disa parulla "Kosova-Republikë" në fshatin e tij të lindjes, Dumnicë e Poshtme.

Në atë rast unë i pata thënë Shyqës se nuk e pëlqej shkrimin e parullave në fshatin e tij. Gjithashtu unë i tregova Shyqës edhe historinë e emrit "Tito" të shkruar në një mur betoni në kanalin "Ibër-Lepenc" në fshatin tim. Unë se kisha prekur emrin e satrapit Titos sepse vet shkrimin e saj e kisha konsideruar si provokacion dhe se isha shumë i sigurt se nëse do ta shlyeja apo njollosja,

këlyshët e Burhan Prishtinës, do të dyshonin se unë e kam nxitur dikë për një punë të tillë dhe kështu ata do të më vëzhgonin edhe më shumë. “Ka mjaftë vende ku mund të shkruajmë parulla dhe ku edhe nëse na sheh dikush nuk do të na njeh,– i thashë Shyqës”.

Në fund të dhjetorit 1982, gjatë një takimi me Shyqën, i kam folur për herë të parë hapur se unë isha anëtar i organizatës Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi. Në atë rast Shyqës ia kam ofruar për ta shikuar e lexuar Statutin e LNÇKVShJ-së si dhe i kam propozuar që edhe ai t’i bashkohet organizatës sonë.

Pas një jave, Shyqa i është përgjigjur me kënaqësi propozimit tim dhe ka pranuar programin dhe statutin e LNÇKVShJ-së. Që nga ai takim Shyqyri Imeri ka qenë anëtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi.

Udhëtimi i Sheremet Saraçit në Turqi

Isha për vizitë tek Sheremet Saraçi. Në atë rast, ai më njoftoi se do të udhëtonte në Turqi. U gëzova shumë për lajmin që mora. Sheremetin nuk e kam pyetur se kë do të takonte. As ai nuk më ka folur për ndonjë emër apo adresë. Kemi biseduar dhe jemi pajtuar se cilat çështje janë të rëndësishme të shtrohen, gjatë takimit me shokët në Turqi.

Shpresoja se me udhëtimin e tij do t'i rivendosim lidhjet me Lëvizjen. Sheremeti e njihte gjendjen e krahut tonë të Lëvizjes dhe unë isha plotë shpresë se, ai do të kthehej nga takimi me ndonjë nga udhëheqësit tanë, me ndonjë direktivë, këshillë e udhëzim për punën tonë.

Pas një jave Sheremeti do të duhej të kthehej nga Turqia, prandaj natën e tetë i shkova tek shtëpia e tij dhe i bëra "tre trokitje" në murin e shtëpisë tek dhoma e ditës, ashtu siç bëja zakonisht, sa herë i shkoja për vizitë.

Menjëherë doli Sheremeti dhe ma hapi derën e shtëpisë. U futëm brenda dhe pas përshëndetjes edhe me Elhemen, nisëm bisedën vetëm me Sheremetin.

-Rrugës andej e këndej e kalova mirë. Edhe punët që kisha i kam mbaruar dhe shokun e Lëvizjes e kam njoftuar për gjendjen në rrethin tonë. Mirëpo, gjatë bisedës, Sabri Novosella, më pyeti se "përse unë nuk po bija në burg, ndonëse isha anëtar i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi që nga themelimi i saj?!" Kjo më zemëroj shumë. Jam grindur me Sabriun për këtë çështje. Kurrë mos u pjekshin sytë e tij dhe të mi!- më tha Sheremeti.

Sheremet Saraçi ndjehej i hidhëruar e i fyer dhe ky fakt më shqetësoj shumë.

Në atë rast Sheremet Saraçi më njoftoi edhe për përpjekjet që ishin bërë për bashkim e LNÇKVShJ-së dhe OMLK-së, më herët dhe ato në mes LNÇKVShJ-së dhe PKMLShJ-së më vonë, për problemet që ishin shfaqur gjatë përpjekjeve për bashkimin e të gjitha forcave patriotike e revolucionare, në luftën tonë për barazi dhe Republikë, që nga vrasja e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës me 17 janar të këtij viti në Untergruppenbach të Gjermanisë.

Në fund të bisedës Sheremet Saraçi ma dha një pako cigaresh, të zbrazët, që ishte dhuratë për *Aliun* nga Sabri Novosella, por që për shkak të zemërimit e kishte pirë rrugës! Në atë rast nga Sheremet Saraçi e kam marrë një numër të "Zërit të Kosovës" të cilin ai më tha se e ka marrë nga një shok i Lëvizjes që ndodhej në Kosovë, sapo ishte kthyer nga Turqia.

Udhëtimi i Sheremet Saraçit dhe telashet që i kishin dalë me Sabri Novosellën, mua më hodhën në një gjendje të pazakontë. Sheremet Saraçi kishte udhëtuar në Turqi për ta koordinuar aktivitetin tonë me atë të udhëheqjes së Organizatës sonë dhe ishte kthyer i zhgënjyer! Mua që "rastësia" më kishte gjetur në rolin e një pikë- lidhjeje në mes shokëve të krahut tim, Sheremet Saraçit dhe Lëvizjes, më duhej të veproja për ta ndryshuar gjendjen për të mirë dhe zhgënjimin e Sheremet Saraçit më duhej ta sqaroja deri në fund. Po të merren parasysh rrethanat në të cilat vepronim dhe kushtet e veprimit, në një ilegalitet të thellë, çfarë vepronim ne, ku një gabim i vogël do të çonte në "gojë të ujkut", ishte e domosdoshme ta kuptoja se ç'kishte ndodhur në Turqi.

Pyetjen e Sabri Novosellës, e cila me të drejtë i kishte shkaktuar zemërim Sheremet Saraçit, e konsideroja të pavend dhe të çuditshme! Unë për vete nuk kisha asnjë fije dyshimi në besnikërinë e Sheremet Saraçit, përkundrazi i besoja si vetës dhe shokëve të tjerë me të cilët veproja, prandaj na duhej ta sqarojmë pse-në e shokut në Turqi.

Gjatë takimit, u përpoqa ta qetësoja Sheremetin dhe t'ia zbusja zemërimin. Sheremetit i thosha "se ndoshta Sabri Novosella e ka pyetur me shaka, apo vetëm e ka "provokuar" sa për ta dëgjuar përgjigjen e ti, se pyetje të tilla nuk janë të "ndaluara" të bëhen nëse kemi parasysh faktin se lufta jonë zhvillohet në rrethana shumë të vështira, por as kjo përpjekje nuk e zbuti zemërimin e tij.

Megjithëkëtë, unë isha mjaftë i shqetësuar për takimin e Sabri Novosellës dhe Sheremet Saraçit dhe "grindjen" në mes tyre. Sheremet Saraçin e njihja dhe kisha besim të plotë në besnikërinë e tij, ndërsa Sabri Novosellën nuk e njihja. E njihja vetëm të vëllanë e tij, Selatin Novosellën, të cilin e dija si një lis të madh të luftës sonë nacionalçlirimtare. Megjithëkëtë unë isha i sigurt se Xhafer Durmishi nuk do të na linte në lidhje me Sabri Novosellën, po të mos i besonte. Sidoqoftë unë e shihja të nevojshme që këtë çështje duhej ta sqaroja deri në fund.

Çështjen e udhëtimit të Sheremet Saraçit në Turqi dhe shqetësimet e krijuara pas kthimit të tij e kam biseduar me Xhemajl Pllanën dhe Ferki Morinën. Lajmi u shkaktoi edhe atyre shqetësime. Nga takimi dolëm unik se duhet sqaruar deri në fund këtë çështje dhe unë u ngarkova me detyrën që ta dërgoja një shok në Turqi.

Udhëtimi i Rexhep Ahmetit në Turqi

Në fund të nëntorit të vitit 1982, me qëllim të sqarimit të "problemit" në mes Sheremet Saraçit dhe Sabri Novosellës e kërkova Rexhën dhe e pyeta se a kishte mundësi udhëtimi jashtë vendi? Rexha, si gjithmonë, u tregua i gatshëm të udhëtonte menjëherë .

Rexhep Ahmeti (Rexha)

Meqenëse Rexha po udhëtonte në Turqi, atëherë unë dëshiroja që me një udhë t'i kryejmë edhe disa punë të tjera. Rexhës do t'ia jepja me vete edhe disa materiale për "Zërin e Kosovës". Materialet e shkruara Rexha do t'i fuste në astarin e palltos së tij dhe do t'i qepte para se të nisej.

Në një takim, pas dy ditësh, me Rexhën kam biseduar se në cilin vend duhej të udhëtonte dhe cilat materiale do t'i merrte me vete.

"Problemin" në mes Sheremet Saraçit dhe Sabri Novosellës, Rexhës ia kam prezantuar si një problem në mes dy shokëve, pa ua zënë në gojë emrat e tyre. Ai do ta pyeste shokun Sabri Novosella për *Shokun* që para pak kohësh kishte

udhëtuar jashtë vendi dhe problemet që ishin shfaqur gjatë takimit?!" Rexhës ia kam dhënë adresën ku do të shkonte, të cilën e kisha marrë nga Sheremet Saraçi.

Në fillim të dhjetorit 1982, Rexhën e kam takuar sapo ishte kthyer nga Turqia. Rexha udhëtimin e tij dhe takimin me Sabri Novosellën e ka prezantuar kështu:

– Në Turqi kalova mirë. Lidhur me *Shokun,* Sabri Novosella më tha: se duhet ta vazhdoni punën, sepse ai ka dhënë kontribut të madh në çështjen tonë kombëtare. Organin nuk ua kemi dërguar sepse kemi pasur frikë se po ju rrezikojmë. Aliu të mos bie në burg, në asnjë mënyrë! Gjatë takimit kam krijuar përshtypjen se ne dhe Sabri Novosella kemi botëkuptime të ndryshme për jetën dhe shoqërinë, por tani për tani, kjo çështje, mendoj se nuk ka rëndësi, sepse e kemi të përbashkët luftën për liri. Sabri Novosella më tha se jeni i propozuar të jeni anëtar i KQ të LNÇKVShJ-së! Urime!

U gëzova shumë kur dëgjova se grindja në mes Sabri Novosellës dhe Sheremet Saraçit nuk ishte e natyrës shqetësuese. Të rëndësishme ishin të gjitha lajmet që mora lidhur me veprimtarinë e Lëvizjes në emigracion. I vlerësoja edhe qëndrimet e shokut Rexhë lidhur me përshtypjet e tij për pikëpamjet politike të shokut Sabri Novosella. Ndërsa lidhur me propozimin që kishte të bënte me mua ndjehesha i befasuar dhe nuk më pëlqeu as mënyra e përcjelljes së lajmit. Rexhës, gjatë bisedës, u përpoqa t'ia zbeh rëndësinë e lajmit lidhur me propozimin e shokut Sabri Novosella.

Dy-tre ditë më vonë, i kam takuar Xhemën dhe Ferkiun dhe i kam njoftuar për udhëtimin e Rexhës dhe lajmet që na kishte sjell ai nga Turqia. Edhe ata u gëzuan shumë që u sqarua çështja e "grindjes" në mes Sheremetit dhe Sabriut.

Lidhur me lajmin e propozimit që më ishte bërë mua, nuk e zura në gojë gjatë takimit me Xhemën e Ferkiun. Ç'është e vërteta mua më vinte vështirë t'jua komunikoja shokëve një lajm të tillë. Ne ishim mësuar të punonim, me aq sa kishim mundësi për ta ndihmuar çështjen tonë, dhe asnjëherë nuk kishim biseduar për çështje emërimesh e gradimesh. Lajmi ishte i papritur dhe i pazakontë në praktikën e punës sonë. Në anën tjetër, unë gjithmonë kisha pritur se udhëheqja e Lëvizjes sonë përbëhej nga veprimtarë me përvojë të gjatë në veprimtarinë ilegale dhe vetën time e konsideroja një ushtar të ri dhe të papërvojë në këtë veprimtari.

Dokumentari "Shpëtimtari trenit"

Demonstratat e pranverës së vitit 1981, udhëheqja serbomadhe e Beogradit, i kishte marrë si pretekst jo vetëm për burgosjen e mijëra shqiptarëve, por edhe për heqjen edhe të atyre pak të drejtave dhe lirive që shqiptarët e Kosovës i kishin fituar me mund e sakrifica të mëdha. UDB-ja serbe vazhdonte të organizonte komplote, kurthe, intriga dhe të inskenonte akte kriminale me qëllim të mos zgjedhjes së çështjeve të shtruara nga shqiptarët dhe të mbajtjes së gjendjes nën tension të vazhdueshëm në Kosovë. Në këtë veprimtari kriminale ishin angazhuar edhe shumë serbë nga Kosova. Njerëzit e Beogradit i sulmonin shtëpitë, varrezat, kishat ortodokse dhe vetë banorët serbë të Kosovës me qëllim që pastaj t'i akuzonin shqiptarët se gjoja ata qëndrojnë prapa këtyre akteve të shëmtuara dhe që kurrë nuk kanë qenë në traditën e shqiptarëve.

Një akt i tillë kriminal është edhe dëmtimi i qëllimshëm i binarëve të hekurudhës së trenit në fshatin Mihaliq, në javën e parë të janarit 1983.

Ishte një mëngjes i ftohtë dhe me mjegull kur babai dhe motra ime, Hanifja, ishin nisur në drejtim të Prelluzhës. Babai ishte nisur për në punë, ndërsa motra ime për në shkollë. Sapo dalin nga fshati dhe arrijnë tek hekurudha, shohin se nëpër shinat e hekurudhës kishte kaluar një i madh dhe për pasojë ishin dëmtuar shumë binarët e trenit. Vinçi që ishte duke punuar në Hidro-Sistemin "Ibër-Lepenc" i kishte kaluar binarët e trenit, diku rreth tridhjetë metra më larg vendkalimit dhe kështu i kishte shtrembëruar shinat në dy vende. Gjatë kalimit të hekurudhës, vinçi kishte lënë gjurmët e lëvizjes së tij mbi hekurudhë dhe nëpër ara gjer tek vendi i stacionuar i punës. Çuditërisht, e gjithë kjo kishte ndodhur dhe vinçieri nuk e kishte vërejtur se i kishte dëmtuar binarët e trenit!

Sapo arrin tek hekurudha, im atë vëren se binarët e trenit ishin dëmtuar rënd dhe se treni që do të vinte sapo të arrinte tek vendi i dëmtimit të shinave, do të dilte nga binaret dhe do të pasonte një katastrofë e madhe. Në ato momente dramatike, im atë, e këshillon motrën time që të qëndronte aty dhe nëse sheh trenin duke ardhur, ta sinjalizonte e paralajmëronte me qëllim që treni të ndalej. I vetëdijshëm se treni i udhëtarëve nga Mitrovica në drejtim të Fushë Kosovës, duhej të kalonte atypari edhe 20 minutash, im atë niset me vrap në drejtim të Stacionit të Trenit në Prelluzhë.

Fatbardhësisht im atë arrin me kohë dhe punonjësit e Stacionit të Trenit në Druar dhe Prelluzhë, arrijnë ta ndalojnë trenin para se të nisej në drejtim të vendit ku ishin dëmtuar binarët në Mihaliq.

Im atë ndjehej shumë krenar, që me aktin e tij human kishte arritur t'i shpëtona disa qindra jetë njerëzish. Edhe ne, e gjithë familja, ndjeheshim shumë krenar për këtë akt të tij njerëzor.

Për tim atë dhe të gjithë ne që ishim dëshmitarë të dëmtimit të binarëve, gjithçka ishte e qartë se, binarët ishin dëmtuar më qëllim. Gjithashtu, edhe vendi ku ishte bërë dëmtimi i binarëve ishte zgjedhur me qëllim. Aty treni do të kalonte me një shpejtësi të madhe dhe udhëtarët, sipas të gjitha gjasave, në shumicë, serbë nga Kraleva, Rashka dhe qytete tjera në kufi me Kosovën, do pësonin lëndime dhe shumë prej tyre do vdisnin!

Sipas mendimit tim ky akt kriminal serb, po ta arrinte qëllimin e tij, botën do ta kishte "prekur" nga lotët e krokodilit që do të derdhte Beogradi për viktimat. Mirëpo, për shqiptarët dhe Kosovën do të pasonin edhe masa të egra represive, që shovinistët serbë, do t'i ndërmerrnin kundër "terrorizmit shqiptar"!

Mirëpo, meqë treni dhe qindra udhëtarë në të, shpëtuan, fal heroizmit të tim atë , komplotistët serbë dhe udhëheqja e Beogradit nuk i dha hapësirë të madhe as gjetjes e dëmtuesve të binarëve dhe as aktit heroik të babait tim! Shtypi i Beogradit, sa për ta la gojën, në të përditshmen "Politika" i shkroi dy rreshta në fund të rubrikës së lajmeve, aty ku vështirë do të shihej nga lexuesi edhe sikur të përdorej llupa.

Për dallim nga shtypi i Beogradit një revistë nga Zagrebi e quajtur "Arena" i ka njoftuar lexuesit e saj me heroizmin e babait tim me një shkrim katër-pesë faqesh. Një gazetar i revistës "Arena" ka ardhur nga Zagrebi dhe ka qëndruar një ditë të tërë në shtëpinë tonë në Mihaliq dhe gjatë asaj dite gazetari ka zhvilluar një bisedë shumë të gjatë me tim atë dhe anëtarët tjerë të familjes.

Edhe Radiotelevizioni i Prishtinës e bëri një emision dokumentar dhe e quajti atë "Shpëtimtari i trenit". Komuna e Vushtrrisë i dha tim atë një orë dore dhuratë.

Përderisa politikanët e Komunës së Vushtrrisë nuk guxonin ta përdornin aktin heroik dhe njerëzor të babait tim, "për hir të faktit se ai kishte një djalë që quhej Asllan dhe ishte nën vëzhgimin e UDB-ës", politikanët e Kroacisë po e ngritën lartë e më lartë këtë vepër të tij. Babi u ftua në Zagreb dhe atje ju dhe një mirënjohje: çmimi i dytë, si rasti më i guximshëm i bërë në territorin e Jugosllavisë! Babai së bashku me vëllanë tim, Shabanin, ka qëndruar tre ditë në Zagreb. Sipas babait ceremoninë dhe pritjen shumë të mirë që ju bë atyre nga autoritet kroate, e kishte zbehur vdekja e papritur e Vlladimir Bakariqit, politikanit kroat, me 16 janar 1983. Futbollisti i famshëm kroat, Vlladimir Zajec, ka qenë ai ka i ndarë çmimin babait tim.

Babai më ka treguar se Burhan Prishtina, gjatë solemnitetit të dhënies së orës së dorës, i kishte thënë se "do ta kishim ngritur në qiell rastin tënd, po të mos ishte puna e Asllanit"!

Mirëpo unë nuk isha shumë ngushtë për "ngritjen në qiell të aktit human dhe njerëzor" të babait tim, sepse edhe unë do të kisha bërë si ai për t'i shpëtuar jetët e njerëzve.

Ajo që më tmerronte ishte logjika e pushtetarëve shqiptarë të Kosovës. Ata ishin shumë të mjerë në veprimet e tyre dhe nuk ishin në gjendje të bënin asgjë që nuk pëlqehej nga Serbia. Mendja më shkonte se ç'masa do të kishte ndërmarrë Serbia kundër Kosovës dhe shqiptarëve, po të ishte rrëzuar treni në Mihaliq dhe të kishte rezultuar me qindra viktima? Bota do të kishte dëgjuar për sharjet që do të ishin dëgjuar në adresë të shqiptarëve dhe nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar. Në emër të luftës për zbulimin e aktorëve të këtij akti do të ishin burgosur e torturuar me qindra shqiptarë.

Unë asnjëherë nuk kam dyshuar dhe kam qenë i sigurt se autorët e prishjes së binarëve të trenit kanë qenë serbë dhe ky akt kriminal ka qenë i inskenuar në Beograd. Këtë bindje e ka pasur edhe im atë dhe shumë njerëz që kanë folur me të për këtë rast.

Shpërndarja e organeve dhe revistave ilegale (1979-1983)

Organi i Fronit të Kuq, "*Bashkimi*," është organi i parë i një organizate të ndaluar që e kemi pasur në dorë, diku në vitin 1980-të. Po gjatë atij viti kemi marrë revistën "*Lajmëtari i lirisë*", organin e Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës "*Liria*" dhe në fillim të vitit 1982 organin e LNÇKVShJ-së *"Zëri i Kosovës"*.

Të gjitha organet i kemi shpërndarë nëpër shokë dhe shoqe. Ndonëse "*Bashkimi*" dhe "*Liria"* nuk figuronin se ishin organe të organizatës sonë (edhe pse pjesa e tyre më madhe e kishin autor Jusuf Gërvallën, apo të përgatitura teknikisht në shtëpinë e Jusuf Gërvallës), ne i konsideronim ato organe të organizatave revolucionare dhe që luftonin për lirinë dhe çlirimin e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nga pushtimi serbo-sllavë.

ZËRI I KOSOVËS

Me penë dhe pushkë...

lajmëtari i lirisë

...për liri dhe bashkim me vendin amë: Shqipërinë socialiste!

LIRIA

Bashkimi

ORGAN I FRONTIT TË KUQ POPULLOR

Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur në dorë dhe i kemi shpërnda organet "*Bashkimi"* (katër numra), organin *"Liria"* (pesë numra), revistën *"Lajmëtari i lirisë"* (tre numra), organin *"Zëri i Kosovës"*(dy numra të LNÇKVShJ-së). Gjithashtu kemi pasur dhe shpërndarë dorë me dorë edhe *"Këngët e lirisë".* Veç të tjerave e kemi pasur edhe një ekzemplar të librit të

Enver Hoxhës, "*Vetë-administrimi jugosllav- teori dhe praktikë kapitaliste", "Titistët"*(Libri ka qenë i formatit të xhepit) etj.

Tetë ditë para rrethimit

Nga gjumi u zgjova diku rreth orës tetë të mëngjesit. E rregullova shtratin dhe u afrova pranë dritares. Nga aty, po shikoja në drejtim *të batallakut*[14] dhe pyllit që e kisha përballë. Ishte një ditë me diell. Papritur, e pashë një njëri që doli nga pylli dhe po zhdirgjej teposhtë drejtë shtëpisë sonë. Nuk po e njihja se kush ishte. Meqë andej vinte shpeshherë edhe *Hoxha i Vogël*, vazhdova ta vëzhgoja me kureshtje. Pas pak e njoha. Ishte i vëllai i *Hoxhës së Vogël*, Jakupi.

– Vallë ç'e mirë e ka sjell këtë mëngjes? – e pyeta vetën. Jakupi nuk vinte shpesh tek ne. Duhet të ketë një arsye që e ka shtyrë të vije tek ne, thashë vetë me vete. Një ankth i madh ma pushtoj zemrën. Mos ka ndodhur ndonjë e keqe andej nga *Hoxha i Vogël*, e pyeta sërish vetën time? Dola nga dhoma e gjumit, mbatha këpucët dhe u nisa drejtë dyerve të oborrit për ta pritur Jakupin.

– O, mirë se erdhe! Ejani, urdhëroni! –i thashë Jakupit.

E vërejta se atij filluan t'i dridhen buzët. Pas pak më tha:

– Mirë se ju gjeta! *Hoxha*, të bënë shumë të fala! Ai më porositi t'ju njoftoi se sot në mëngjes e kanë arrestuar Vebën! Sot herët, erdh Rexhepi nga Gllogovci dhe na njoftoi për këtë! Nuk kam kohë të hy brenda. Kaq kisha, – më tha Jakupi.

E falënderova për lajmin dhe u ndava me Jakupin. E mbylla derën e oborrit dhe u nis drejtë shtëpisë.

Pas kthimit në shtëpi, nëna më pyeti se përse ishte kaq herët Jakupi. Ndonëse nuk e kisha ndërmend ta shqetësoja edhe atë për burgosjen e Vebës, i tregova se ç'kishte ndodhur, por nuk ia bëra të madhe. Kur e kuptoi se ç'kishte ndodhur, ajo u mëzit shumë. Më erdhi keq, por isha i vetëdijshëm se këtë lajm nuk do të mund ta mbaja të fshehtë prej saj për një kohë të gjatë.

Lajmi për arrestimin e Vehbi Mujës më shqetësoi shumë. Vallë ç'ka ndodhur, e pyeta vetën? E dija se Vehbi Muja kishte një rreth shokët në Drenicë, por asnjërit prej tyre nuk ua mbaja mend emrat dhe nuk i njihja. Mosnjohja e tyre po më nxirrte nga loja sepse unë nuk mund t'i paralajmëroja apo së paku t'i njoftoja se ishte burgosur Vehbiu. Mbetja me shpresë se ndoshta ata janë të lirë dhe se burgosja e Vehbiut nuk do të ketë pasoja për shokët tjerë.

Arrestimi i Vehbi Mujës erdhi në një kohë kur isha duke menduar t'i propozoja anëtarësimin në radhët e LNÇKVShJ-së. Megjithëkëtë ai i plotësonte të gjitha kushtet për t'u pranuar në radhët e LNÇKVShJ-së. Kishte vite që ishim njohur dhe kishim këmbyer me njëri-tjetrin libra, revista, trakte e organe të ndryshme të organizatave ilegale. Nga Vehbiu e kisha marrë edhe makinën e

shkrimit. Unë kisha besim në besnikërinë e tij dhe përkushtimin e tij për çështjen tonë kombëtare.

Meqë nuk dija se a i është gjetur ndonjë material kompromotues në shtëpi apo jo, shqetësimi ishte edhe më i madh. Mos vallë ka shkelur në dërrasë të kalbur, shoku Vehbi? – pyetja vetën.

Vehbi Muja nuk i njihte asnjërin nga shokët e mi, përpos *Hoxhës së Vogël*. Prandaj, ndjehesha mjaftë i sigurt. Ky fakt më ndihmonte edhe në lokalizimin e pasojave eventuale. Edhe sikur të vendos të flas ai nuk do të mund ta thotë emrin e ndonjërit prej shokëve të mi,-i thosha vetës. Kjo e vërtetë më gëzonte shumë.

E mbaja mend se gjatë një takimi, Vehbi Muja më ka pas pyetur për Ferki Morinën. Ndonëse, nuk e pata pëlqyer fare pyetjen që më pati bërë, nuk më ka pas shkuar mendja asnjëherë se pyetja e bërë ka pasur ndonjë qëllim të keq! Megjithëkëtë, në atë rast Vehbi Mujës i pata thënë: “ Unë e takoj Ferkiun në shkollë dhe kam lidhje familjare me te, por ai nuk merret me këto punë, se që nga koha e burgut, që e ka mbajtur, nuk është i interesuar për këtë çështje dhe unë e respektoj vullnetin e tij.”

Hoxha i Vogël

Isha i vetëdijshëm se njohja ime me Ferki Morinën nuk ishte lajm për UDB-ën, ashtu siç isha i vetëdijshëm se zbulimi i veprimtarisë sime mund ta rrezikonte seriozisht edhe Ferki Morinën. Prandaj, ndjehesha i shqetësuar për Ferkiun. Shqetësimi bëhej edhe më i madh meqë s’kisha asnjë informacion se çfarë kishte gjetur policia gjatë bastisjes së shtëpisë së Vehbiut dhe sa dinte policia për veprimtarinë e tij dhe të shokëve të tij? Në gjendjen që ndodhesha nuk më mbetej tjetër pos të prisja e të mësoja se ç’kishte ndodhur.

Punën e parë që mendoja se duhej ta bëja, duke pasur parasysh gjendjen e krijuar, ishte t'i informoja shokët për arrestimin e Vehbi Mujës. Prandaj, më duhej menjëherë t'i kontaktoja Xhemën dhe Ferkiun. Sheremeti ma merrte mendja se do të informohej nga *Hoxha i Vogël* dhe nëse nuk ka ndodhur kjo, atëherë unë do ta vizitoja sapo të binte terri dhe do ta informoja.

Ndonëse nuk ishim takuar asnjëherë publikisht me Vehbi Mujën dhe besoja se policia nuk kishte njohuri për lidhjet tona, më duhej të isha i kujdesshëm dhe t'i reduktoja lëvizjet. Vehbi Muja ka pasur nëpër duar dhe i ka shpërndarë në rrethin e shokëve të tij të gjitha librat dhe të gjitha materialet tjera propagandistike që kisha pasur nëpër duar edhe unë. Materialet e gjetura mund të jenë prova të mjaftueshme për policinë, më shkoj mendja. Policia aty mund t'i gjej gjurmët e gishtërinjve të mi dhe të Ferkiut. Gjatë shkrimit të traktit "tetë kërkesat e parevokueshme të LNÇKVShJ-së" ne kishim përdorur dorëza, si gjatë shumëzimit ashtu edhe gjatë shpërndarjes, dhe isha i sigurt se aty nuk ishin gjurmët e gishtërinjve tonë, por dorëza nuk kemi përdorur gjatë leximit të librave dhe literaturës revolucionare. Pastaj, çështja e makinës së shkrimit më shqetësonte shumë. Mos ka qenë makina e shkrimit ndonjë kurth e UDB-ës, apo mos ka bërë ndonjë gabim tjetër, shoku Vehbi, -më ngjallej dyshimi? Vehbi Muja më ka pas njoftuar se një shok i tij e kishte makinën e Gani Sylës. Mos vallë makina ka qenë "karremi" i UDB-ës? Mirëpo, të gjitha këto pyetje, mendime e dyshime që më silleshin nëpër kokë ishin vetëm spekulime dhe fantazi sepse edhe më tutje unë nuk dija se cilat materiale i ka zënë UDB-a Vehbi Mujës ditën e arrestimit?

Brenda asaj dite i kam njoftuar Ferki Morinën dhe Shyqyri Imerin për arrestimin e Vehbi Mujës. Në këtë rast, Shyqyri Imerin e kam njoftuar se më është burgosur një shok (pa ia përmendur emrin e Vehbiut) dhe e kam këshilluar që të mos dukej nga shtëpia ime.

Në mbrëmje kam shkuar në shtëpi të Sheremet Saraçit dhe kam fjetur aty. Me Sheremetin jemi marrë vesh që kështu të veproja çdo mbrëmje dhe të mos flija në shtëpinë time, gjersa të kuptonim se si do të bëhet çështja e Vehbi Mujës.

Kështu edhe kam vepruar. Çdo mëngjes herët jam kthyer përsëri në shtëpinë time. Jam kthyer gjithmonë nga drejtimi i Beçukut. Ma merrte mendja se policia, nëse ka ndonjë lajmë për mua, do t'ia mësyj shtëpisë sime në mëngjes dhe kështu nuk do të më gjente në atë rast në shtëpi.

Dy –tre ditë pas arrestimit të Vehbi Mujës e kam takuar *Hoxhën e Vogël*. Ai më ka njoftuar se kishte marrë vesh se ishin burgosur edhe disa shokë të tjerë të Vehbi Mujës në Drenicë. Ky lajm më shqetësoj edhe më shumë.

Diku ditën e katërt, pas arrestimit të Vehbi Mujës, isha në Prishtinë dhe aty qëndrova vetëm disa orë. Atë ditë, i takova Ferkiun dhe Mirvetën, para Bibliotekës Universitare. Mirvetja na fotografoi mua dhe Ferkiun. Me Ferkiun u morëm vesh që të takoheshim më vonë së bashku me Xhemën.

Gjatë takimit, afër hekurudhës në mes Reznikut dhe Shtitaricës, Xhemajl Pllanën e Ferki Morinën i kam njoftuar për burgosjen e Vehbi Mujës dhe shokëve të rrethit të tij. Shokëve u kam folur gjithashtu edhe për sjelljen e çuditshme të Rexhep Mujës (vëllait të Vehbi Mujës), dhjetë-pesëmbëdhjetë ditë më parë, në Stacionin e Trenit në Fushë Kosovë. Në atë rast, Rexhep Muja, papritur më patë folur me "simpati" për regjimin në Shqipëri, që, për mua ishte një befasi edhe për faktin sepse ishte në kundërshtim me përcaktimin e tij politik, të cilin përcaktim, unë e kisha mësuar gjatë bisedave që kisha pasur me Vehbi Mujën. "Kthesa" politike e Rexhep Mujës, po më befasonte edhe për faktin sepse nga Vehbi Muja kisha mësuar se vjehrri i Rexhep Mujës ishte një eksponent i reaksionit shqiptar në Belgjikë. E çuditshme më dukej edhe ardhja e Rexhep Mujës nga Gllogovci në Gllavotin, për ta njoftuar kunatin e tij *(Hoxhën e Vogël)* se i ishte burgosur Vehbi Muja! Dyshoja se prapa këtij "mundi" të Rexhep Mujës fshihej diçka e errët!

Gjatë atij takimi me Xhemën dhe Ferkiun, jemi pajtuar që të vazhdoja me sjelljen taktike, që gjatë ditës të dukesha nëpër fshat, ndërsa gjatë natës të flija tek ndonjë shok. Duke vepruar kështu, ne mendonim se nëse Vehbi Muja, gjatë hetimeve e pranon lidhjen me mua, UDB-a do të bënë përpjekje të më kontaktonte, pra edhe të mësonte se ku ndodhesha dhe pastaj do ta planifikonte arrestimin tim.

Me 4 prill 1983, në Prishtinë së bashku me Ferki Morinën

Ndonëse kisha besim të patundur se Vehbi Muja nuk do ta pranonte gjatë hetimeve se njiheshim me njëri-tjetrin, më duhej të llogarisja se ai nuk do ta përballoi presionin e madh, që do t'i bëhej nga hetues të UDB-ës, për ta pranuar lidhjen tonë. Prandaj, duke pasur parasysh këtë mundësi, çdo ditë qëndroja në

shtëpi dhe shëtisja nëpër fshat, ndërsa sapo binte terri në tokë ikja nga shtëpia dhe natën e kaloja tek ndonjë shok, sidomos tek Sheremet Saraçi.

Edhe natën e pestë, pas arrestimit të Vebës, e kalova tek Sheremeti. Në mëngjes u ktheva në shtëpi. Nëna më njoftoi se gjatë ditës së djeshme me kishte kërkuar Xhevat H. Bajrami! Sipas nënës, Xhevat H. Bajrami më kishte kërkuar me qëllim që ta ndihmoja në përpjekjet e tij për themelimin e një shoqërie muzikore!

Ardhja Xhevat H. Bajramit dhe kërkimi i ndihmës për çështje të krijimit të një shoqërie muzikore, ishte një befasi e madhe që më futi në mendime e shqetësime. A thua pse është drejtuar pikërisht tek unë që nuk isha marrë kurrë me muzikë, e pyetja vetën? Menjëherë, më shkoj mendja se mos fshihet dikush tjetër prapa Xhevat H. Bajrmait? Ndoshta, i thashë vetës sime, në këtë mënyrë, policia do ta di se ku ndodhem, apo mund të ndodh që ndonjë nga ata djajtë e UDB-ës mund të qëndroi prapa kësaj pyetje "pa të keqe" të fqinjit tim?

Natën në mes 5-6 prillit, e kalova përsëri tek Sheremet Saraçi. Me 6 prill 1983, herët në mëngjes u ktheva në shtëpi. Edhe këtë ditë, si zakonisht, dola nëpër fshat. Madje, atë ditë, i takova edhe dy bashkëfshatarët e mi të cilët unë dyshoja se ishin spiunë të UDB-ës. Isha shumë i pasigurt se përse ata kishin dalë nëpër fshat! Xhevat H. Bajramin nuk e takova. Ai nuk shprehu dëshirën për të biseduar me mua për çështjen e shoqatës muzikore! Meqë ishte pranverë, atë ditë e ndihmova nënën time në përgatitjen dhe mbjelljen e perimeve në kopshtin tonë.

Në mbrëmje, i patëm dy mysafirë për darkë: Ajet Osmanin (Buleshi) dhe Mehmet Lacin nga Mihaliqi i Poshtëm!

Gjatë kohës sa i kishim mysafirët, unë shkova në odë, me qëllim që "mysafirëve" t'ju tregoja se ndodhesha në shtëpi! "Nëse mysafirët janë informatorë të policisë , atëherë ata do të lajmërojnë policinë se gjendem në shtëpi dhe menjëherë pas kësaj policia do të më trokasin në derë, -thosha vetë me vete." Mirëpo, meqë unë edhe ashtu e kisha ndërmend të largohesha nga shtëpia, shpresoja se kështu do ta vë në kurth UDB-ën!

Mysafirët qëndruan dy-tre orë dhe unë ngela pa i shikuar lajmet e orës 19.30 që jepte RTSh-ja. Pas ikjes së mysafirëve, vazhdova ta shikoja televizionin dhe po prisja lajmet e fundit.

7 prill 1983–Rrethimi dhe arratisja

Më dukej se Dervish Shaqa po e këndonte këngën e "*Kamer Loshit!"* Sapo hapa sytë, e pashë Skënderin duke me prekur me duar e thirrur, me zë të ultë: "Çohu se policia!" "Çohu se policia!" Nga jashtë dëgjohej edhe trokitja në derën e oborrit e shoqëruar me thirrjen:

– Hape derën, policia! Hape derën, policia!...

E kuptova se isha i shtrirë në shtrat, i mbuluar me jorgan; se më kishte zënë gjumi e kisha fjetur i veshur, në odë, dhe dikush më kishte mbuluar me jorgan. Nuk dija sa ishte ora. U çova menjëherë nga shtrati dhe u ofrova pranë dritares. E largova vetëm pak perden dhe e ofrova kokën për të pa se kush ishte. Jashtë, ishte gjysmë errësirë. Dy tre metra pranë dritares, një polic me automatikë në dorë. Pak më larg, disa policë tjerë dhe një makinë, para dyerve të oborrit, që ishte ndalur në rrugë. I pashë dhe njoha edhe udbashët Zeqir Sadria dhe Enver Maxhuni. E kuptova se ç'kishte ndodhur dhe përse kishin ardhur. E rregullova shpejtë e shpejtë shtratin. Vëllait tim, Skënderit, ju afrova pranë e i thashë:

– Mbylle derën nga brenda dhe shtiru se je duke fjetur! Kur të pyesin për mua, ju thua se nuk di se ku ndodhem.

Edhe më tutje, nga jashtë, dëgjohej zëri që i kërkonte nënës sime, të hapej dera. Më dukej se ishte zëri i udbashit Zeqir Sadria:

– Hape derën, oj Hallë! Hape derën, oj Hallë!...

Dola nga oda dhe eca ngadalë gjer tek fundi i korridorit të saj. Nga aty e pashë se nëna ime e kishte hapur një dritare të një dhome të fjetjes dhe po shikonte në drejtim të dyerve të oborrit. Unë i lëshova një çikë sy oborrit për të shikuar se mos kishte hy policia në oborr. Nuk pashë njëri. Pas pak, e dëgjova zërin e nënës, e cila ju përgjigj me zë të lartë udbashit:

– Nuk e hap derën, se na e keni lodhur shpirtin! Ç'është kjo puna e juaj, kështu? Jemi lodhur nga ardhjet tuaja, përditë. Jeni duke ma marrë djalin, pa asnjë fije faj!

– Vetëm dy fjalë i kemi... Hape derën, oj Hallë! – dëgjohej zëri i udbashit Zeqir Sadria.

Nëna dhe Zeqir Sadria, vazhdonin e grindeshin, nga larg, me njëri-tjetrin. Udbashi i "lutej" nënës ta hapte derën, ndërsa nëna qëndronte në dritaren e dhomës së fjetjes dhe vazhdonte të ishte e vendosur se nuk e kishte ndërmend ta hapte derën.

Meqenëse nuk pashë njëri në oborr, mendova ta kaloja murin e të dilja jashtë oborrit, prandaj u kacavara në një tra të kulmit të odës. Nga aty u ngrita mbi murin që e lidhte odën dhe shtëpinë. Sapo u kacavara mbi mur, e pashë nënën

duke ma bërë me dorë, që të mos shkoja andej. Meqë, nëna ishte më lartë nga unë, e mora me mend se ajo duhet të ketë parë ndonjë policë, prapa murit të shtëpisë. E ktheva kokën në drejtim të arës, prapa shtëpisë, e aty e pashë se ndodhej një polic tjetër i armatosur. Kërceva nga muri përsëri brenda në oborr dhe me vrap dola mbi shtëpinë e re, ku ndodhej edhe një deriçkë tjetër, nëpërmjet të cilës mendoja të largohesha nga oborri i shtëpisë. Sapo e hapa deriçkën, pranë saj e pashë një tjetër polic me armë në dorë. E mbylla deriçkën dhe u nisa në drejtim të shtëpisë së vjetër, e cila ndodhej diku rreth 50 metra përballë shtëpisë ku banonim, por që ishte brenda në oborr.

E mallkova gjumin që më kishte zënë dhe shpejtë e shpejtë ika në drejtim të shtëpisë së vjetër! Së pari, u futa në shtëpinë e vjetër dhe pastaj nëpër hajat kalova në ahur. Aty kishte një dritare të vogël, prej nga mund të kaloja jashtë oborrit, por nuk e shihja se a kishte ndonjë policë, aty afër. Ahurin e braktisa dhe kalova në nevojtore, që e kisha aty pranë dhe që shtrihej në mes shtëpisë së vjetër dhe plemes. Nga nevojtorja shikova në të tri frëngjitë e saj dhe pashë se policë kishte në veri, lindje dhe në jug. Më këtë, e kuptova se isha i rrethuar në të katër anët dhe se largimi nga shtëpia do të ishte shumë i vështirë apo gati i pamundur.

Ndjehesha i zhgënjyer me vetën time dhe sidomos gjumin që më kishte zënë, por nuk e kisha ndërmend të dorëzohesha. Duhej të gjeja një rrugëdalje!

Duke i shikuar policët, nga vrimat e nevojtores, më ranë ndërmend tregimet e hallës Nuri se si ushtarët turq ia rrethonin kullën Beh Mihaliqit dhe se si ai luftonte me shokë dhe anëtarët e familjes, gjithë ditën, gjersa ushtarët turq e braktisnin rrethimin. Mirëpo, unë nuk isha në kullën e Behës dhe këto frëngjitë e nevojtores sonë nuk ishin si frëngjitë e kullës së tij. Prandaj, krahasimi ishte i pavend. Aty për aty më shkoj mendja ta vrisja policin, që nuk e kisha më shumë se katër pesë metra larg, por hoqa dorë nga një ide e tillë. Ai nuk më ka faj që më ka zërë gjumi! Mund të jetë njëri i mirë dhe hallexhi që punon si polic? Mendja më thoshte se edhe nëse e vras, një apo dy policë, nuk isha i sigurt se do të mund të largohesha dhe ta çaja rrethimin! Pastaj çdo të ndodhte me familjen?! Jo, nuk do ta bëjë një budallallëk të tillë. Le të më arrestojnë. Burgjet janë përplot me shokë që e duan lirinë,– mendoja dhe përpiqesha të gjeja një zgjedhje në kokën time.

Nga larg, dëgjohej britma e udbashëve, por edhe zëri i vendosur i nënës sime:

– Nuk e çel derën!

E braktisa nevojtoren. Ende nuk kishte zbardhur dita dhe nuk dija se sa ishte ora? Kalova në pragun e plemes (plevicës). Në pleme e gjeta qenin e shtëpisë të bërë rrotull mbi kashtën e shtrirë dhe që ishte shkapërderdhur nëpër tërë plemen. Aty për aty, më lindi ideja të futesha në kashtë. M'u kujtua se kur isha i vogël e fshihesha në kashtë dhe ata që me kërkonin mua nuk mund të më gjenin derisa dilja vetë nga kashta. Ta provoj e të fshihem,– thashë vetë me vete. Kërceva nga pragu i plemes, rreth dy-tre metra në brendi të saj. Këmbët më sharruan rreth një gjysmë metër afër qenit, i cili për çudi nuk lëvizi nga vendi.

Menjëherë fillova t'i fusë këmbët në kashtë. Pasi futa këmbët dhe e preka tokën, fillova t'i lëviz këmbët në pozitë horizontale mbi tokë dhe nëpër fundin e kashtës. Kur e futa edhe kokën deri në fund të kashtës, me duar fillova ta mbyllë gropën me kashtën që e merrja nga fundi dhe brendia e kashtës. Pas pak minutash u shtrira trupin horizontalisht në fund të kashtës. Nga xhepi i pantallonave nxora dalëngadalë një letër, ku kisha shkruar një trakt të cilin mendoja ta shumëzoja dhe ta shpërndaja së bashku me shokët. Gjithashtu, nga xhepi nxora dhe e lash aty një fotografi të Xhafës. Trakti në xhep dhe fotografia e Xhafës do të m'i "dhuronin" disa vite burg, prandaj, mendova, se bërë mirë që u kujtova dhe i lashë në kashtë.

Nga aty ku ndodhesha, e dëgjoja gërhitjen e qenit. Baloshi nuk kishte lëvizur nga vendi. Edhe unë u sistemova mirë në kashtë. Qëndroja i shtrirë dhe nuk bëja asnjë lëvizje. Çuditërisht, pas pak, qetësia e pushtoi edhe oborrin. Gjithashtu, shteruan edhe britmat e Zeqir Sadrisë. As zëri i nënës sime nuk dëgjohej... Në ato momente mendja nisi të më fluturonte gjithandej. Ma merrte mendja se Zeqir Sadria dhe Enver Maxhuni së bashku me zagarët e tyre ishin futur në oborr dhe shtëpi. Vallë si do të sillen me nënën dhe familjen? Apo ndoshta janë futur në oborr dhe presin se kur do të dal nga zgafellja ime?

Plemja(plevica) ku jam fshehur gjatë rrethimit

Pas një kohe qetësinë dhe rehatin, që kisha gjetur në kashtë, ma prishi një pëshpërimë, që Zeqir Sadria po e nxirrte nga goja dhe po ia drejtonte dikujt, që unë nuk e dija se kush ishte. Nga zëri që po dëgjoja kisha përshtypjen se Zeqir Sadria me shokë e kishin vërë dikë para tyre dhe po më kërkonin nëpër shtëpinë e vjetër, ahur dhe gjetiu. Ata mund t'i kenë vërë përpara nënën, Skënderin apo motrat dhe vëllezërit e mi, – i përgjigjesha vetës. Në atë rast m'u kujtua historia, që e kisha dëgjuar nga nëna ime, për Aziz Zhilivodën... E merrja me mend se u frynte fllad qelbësirave të UDB-ës të më dalin përpara, prandaj i vendosin si mburojë të gjalla nënën time, motrat dhe vëllezërit e mi! – më shkonte mendja.

Kaloj edhe një kohë dhe përsëri e dëgjova një zë të panjohur që po e pyeste Zeqir Sadriun:

– Ku e lëshoi toka?!

Kjo ishte shenjë e mirë dhe që më tregonte se ata nuk më kanë parë se ku isha fshehur. Edhe qenit tim, *Baloshit,* po ia dëgjoja gërhitjen dhe kjo më tregonte se ai nuk kishte lëvizur nga vendi.

Përsëri heshtje. Toka ishte e ftohtë dhe ndjeja se këmbët më ishin mpirë. Nuk guxoja të lëvizja. Mendja ma merrte se ishin në oborr apo duke kontrolluar diku në shtëpi.

Nuk vonoi shumë dhe e dëgjova një ecje mbi kashtë. E dëgjoja zhurmën që lëshonin hapat dhe zhytja e këmbëve të atij nëpër kashtë. Pas pak, ai që ecte nëpër kashtë, u afrua rreth një metër afër meje, por mbi mua nuk shkeli. Qenit edhe më tutje ia dëgjoja frymëmarrjen e tij. Papritur, dëgjoja goditje të vazhdueshme në murin e plemes. E kuptoja se muri i plemes goditej me një mjetë të fortë , që lëshonte një trokëllimë të fuqishme! Po më çudiste se përse nuk largohej Baloshi nga vendi pas gjithë zhurmës që lëshonte goditja në mur dhe prania e njerëzve të huaj në oborr dhe pleme?!

Unë isha bërë një me kashtën. Më dukej vetja sikur e kisha gjetur "birën e miut" për të cilën renegati Fadil Hoxha, menjëherë pas demonstratave të pranverës së vitit 1981, na kishte kërcënuar se do ta kërkonim, por nuk do ta gjenim. Së paku unë e kisha gjetur "birën e miut", madje, përkundër rrethimit që më ishte bërë, mpirjes së këmbëve dhe frikës që kisha se policët mund të vinin e të më gjenin, ndjehesha mjaftë komod në plemen time.

Kishin kaluar katër-pesë orë dhe unë vazhdoja të qëndroja i fshehur në kashtë. Këmbët i kisha vazhdimisht të mpira. Edhe kur e lëvizja këmbën, lëvizjet i bëja me hapa milingonash. Kisha frikë se policët ishin në oborr dhe se ata vetëm prisnin që unë të dilja nga vendi ku isha fshehur. Mendja më fluturonte sa andej e sa këndej. Papritur, një mendje e keqe më hyri në kokë. Mendja me shkoj se policia mund të sillnin aty ndonjë qenë të ushtruar i cili mund të vije deri tek unë me ndihmën e nuhatjes dhe kështu do të më gjente se ku isha fshehur! Qen të llojllojshëm më dolën parasysh. Po erdhën me qen, do të më gjejnë, – i thosha vetës. Po më gjetën, policia do të bëjnë shaka me mua dhe do të thonë se më kanë gjetur, jo në shtëpinë time, por në "birën e miut!" Si të bëja? Të largohesha nga kashta apo të qëndroja aty ku isha? Një mendje tjetër më thoshte se ata qëndronin të fshehur diku në shtëpi, apo diku tjetër, dhe vetëm presin që unë të dilja nga vendi ku isha fshehur. Prandaj, duhej të kisha durim dhe të qëndroja aty ku isha edhe një kohë,–e kështilloja vetën time.

Heshtja dhe mendimet nëpër kokë po më mbysnin. Kishin kaluar disa orë apo ndoshta kishte shkuar dita dhe unë nuk kisha idenë se ç'kohë ishte? Unë pritja, pritja e pritja e vetëm pritja. Heshtja e padurueshme dhe që po më mbyste vazhdonte të ishte kokëfortë dhe nuk dorëzohej. Por kokëfortë isha edhe unë dhe se kisha ndërmend të largohesha nga "bira e miut".

Kaloi gati një orë, që nga koha kur më ishte futur në kokë ideja e qenit, dhe papritur i dëgjoj duke biseduar nënën dhe motrën time, Arifen. Ma merrte mendja se ato ndodheshin diku në oborr. Nuk i dëgjoja mirë se çka flisnin, por

kisha përshtypjen se ato ndodheshin afër shtëpisë së re. Pas pak, më dukej se zëri i nënës dhe motrës, po vinte gjithnjë e më afër meje. Ato i dëgjoja më mirë. Ky ishte një sinjal i mirë. Ndoshta ato po më kërkonin?Ndoshta janë larguar ata maskarenjtë,– thashë vetë me vete? Nuk ma merrte mendja se ato mund t'i detyronte policia të zhvillonin një bisedë të tillë në oborr.

Në ato momente e dëgjova nënën duke e pyetur Arifen:

– Ku mbet, moj?!

Dhe pas pak e dëgjova edhe përgjigjen e motrës.

– Ata janë tek dyert e oborrit!

Sapo dëgjova se *ata janë tek dyert e oborrit*, menjëherë dola nga kashta dhe u nisa në drejtim të nënës dhe motrës, të cilat i pashë se ndodheshin në oborr, në mes plemes dhe shtëpisë së re.

Nëna, sapo më hetoi më tha:

– Rri aty ku ishte se ata janë tek dyert e oborrit!

Unë e vazhdova vrapin në drejtim të nënës, motrës dhe deriçkës që më shpinte të ara mbi shtëpi. E hapa deriçkën. Meqë nuk pashë policë, aty afër, u nisa me vrap arës përpjetë. Nga shtëpia deri në maje të arave të muratëve e kalova për disa sekonda. Po të isha në një garë do të isha shpallur kampion bote, në vrapimin dyqind metra!

Sapo kam arritur në krye të arës, mbi shtëpi, e kam kthyer shikimin në drejtim të shtëpisë, për të pa se mos po më vinte prapa ndonjë policë. Nga aty i kam parë makinat e policisë në rrugë, para dyerve të oborrit. Pastaj kam vazhduar vrapin në drejtim të shtëpive të muratëve.

Mbi malin e halitëve e kam pa Hysenin e muratëve, që ndodhej para shtëpisë së tij. Jam nisur në drejtim të tij dhe pasi e kam përshëndetur i kam treguar se çka më kishte ndodhur. Hysenin e luta të hynte në shtëpi dhe të m'i gjente një palë këpucë apo opinga të vjetra. Hyseni nuk u nis në drejtim të shtëpisë, por menjëherë i zbathi opingat e tij dhe më urdhëroi:

– Merri, e i mbash me shëndet! Mos u dorëzo në dorë të qenve! Ata na e kanë burgosur edhe një nip tonin dhe e kanë dënuar me dy vite burg, para disa muajsh.

Unë i mora dhe i mbatha opingat e tij. E falënderova dhe u përshëndeta:

– T'u rritë nderi e tungjatjeta, baca Hysen!

Nga aty e kam ndërruar drejtimin e ikjes, jam kthyer në drejtim të *Malit të Hajdar Agës*[17]. Pastaj, jam futur në mal dhe kam vazhduar vrapin në afërsi të shtëpisë së prekajve. Pas pak, kam dal mbi shtëpitë e moratëve dhe jam futur përsëri në malin e halitëve. Nga aty kam vazhduar tutje nëpër pyll dhe kam dal poshtë shtëpisë së Shaban Bunjakut. Pas pak, kam dal tek shtëpia e të bijve të Veli Golit dhe kam vazhduar kurrizit në drejtim të Beçukut.

Vazhdimisht, duke ecur e ktheja kokën dhe shikoja prapa. Puna e qenit të policisë m´u kishte ngulitur në kokë dhe ende kisha frikë se policia me ndihmën e qenit do të mund të më vinte prapa. Për shkak të frikës, vazhdoja të ecja nëpër kurriz të kodrës që ndanë Mihaliqin Kaçakë me Mihaliqin e Nemozhëve.

Vazhdoja ta ngushëlloja vetën se nëse policia vije kurrizit të kodrës do ta shihja dhe kështu do ta ndërroja drejtimin e ikjes.

Pas më shumë se një gjysmë ore më doli parasysh shtëpia e Ragip Beçukut në kodrën tjetër. Ragip Beçukun e kisha jo vetëm kushëri, por edhe të besës. Atij do t'i trokitja së pari në derë. Pas pak, kalova afër mullirit të bijve të Sefer Beçukut dhe u ngjita sokakut përpjetë.

Derën e shtëpisë ma hapi i biri i Ragipit, Nysreti. Ai më futi në odë të burrave. Unë i tregova se ç´kishte ndodhur. Për një çast Nysreti nuk nxori fjalë nga goja. Pas pak, ai shkojë ta kërkonte plakun (Ragipin). Në odë e pashë orën e murit. Tek atëherë më ra ndërmend ta shikoja edhe orën time. Ato përputheshin. Ora bënte njëmbëdhjetë e një çerek. Nuk e dija se sa ka qenë ora kur Skenda më ka zgjuar nga gjumi, por duhej të kenë kaluar shtatë-tetë orë.

Në odë, erdhën Ragip Beçuku dhe e shoqja e tij, Elhemja. Ata u shqetësuan shumë pasi morën vesh se çka kishte ndodhur. Nuk vonoi shumë dhe ma shtruan sofrën.

Unë vazhdoja të isha i shqetësuar. Nga dritarja e odës së bacës Ragip dukej rruga nga kisha ardhur, që nga shtëpia e të bijve të Veli Golit. Kohë pas kohe e ktheja shikimin kah dritarja dhe shikoja rrugën nga kisha ardhur. Fatbardhësisht askush nuk po vinte pas meje.

Pas ngrënies së drekës nuk prita shumë dhe e luta baca Ragipin që të ma jepte "lejen" dhe të më tregonte se kah duhej të shkoja për të dal në kurriz të Qyqavicës.

Për një moment baca Ragip doli nga oda dhe nuk vonoi shumë e u kthye përsëri. Nxori nga xhepi një tubë me para dhe më tha:

– Merri se të duhen! Edhe armë, të gjej, nëse të duhet!

–Të faleminderit, baca Ragip, nuk më duhen as paratë e as arma! – i thashë dhe u ngrita.

Pas pak, baca Ragip foli me të birin e tij dhe i tha të më shoqëronte deri në kurriz të Qyqavicës.

Së bashku me Nysretin, u nisëm bjeshkës përpjetë. Pas njëzet-tridhjetë minutash e luta të kthehej. Ai më tregoi se nga duhej të vazhdoja dhe u përshëndetem me njëri-tjetrin. U rrokëm ngrykë si dy vëllezër. Unë vazhdova bjeshkës përpjetë, ndërsa ai u kthye në shtëpi.

Ende pa arritur në kurriz të Qyqavicës, dëgjova gumëzhimën e një helikopteri ushtarak, që po fluturonte ulët mbi fshatrat e Artakollit. Ndonëse, isha disa qindra metra me lartësi mbidetare mbi helikopterin serbo-jugosllav, sapo e pashë helikopterin, u fsheha prapa një druri të madh ahu. Nuk ma merrte mendja se helikopteri po fluturonte për mua, por ec e besoj UDB-ës!? Helikopteri bëri edhe një fluturim në drejtim të Aeroportit të Prishtinës dhe pas pak u kthye përsëri në drejtim të Mitrovicës, nga kishte ardhur.

Nuk e mbaj mend sa kohë më është dashur gjersa kam arritur në kurriz të Qyqavicës? Ishte mesditë. Qyqavica ishte e veshur me dru ahu, ndonjë bung,

qarr apo lis i rrallë dhe barishte të ndryshme. Mugullimi i malit sapo kishte nisur.

U ula në trungun e prerë të një ahu. Nga aty, para veti kisha një pjesë të madhe të Kosovës. Si në pëllëmbë të dorës dukej pothuajse i gjithë Rrafshi i Kosovës. Në të majtë më rrinte Sokolica e Isa Boletinit, një pjesë e Mitrovicës. Pastaj krejt në veri, shihej Kodra e Cerrnushës dhe Shala e Bajgorës. Në veri-lindje,Vushtrria dhe krahina e Llapit.. Në lindje dukej si në pëllëmbë të dorës vendi i Betejës së Fushë Kosovës dhe pak më në juglindje Prishtina, Obiliqi dhe Fushë Kosova. Në të djathtë e në juglindje vazhdonte edhe më tutje Rrafshi i Kosovës, gjersa piqej me malin e Sharrit. Luboteni shndriste nga bora e bardhë. Kalova pak më tutje, nëpër kurriz dhe në anën tjetër dukej e gjithë Drenica. Nga aty nuk e kisha shumë larg Gradicën- vendlindjen e shokut Vehbi, që armiqtë e lirisë së shqiptarëve e kishin futur në burg. Por unë nuk e kisha ndërmend të kaloja andej. Unë e kisha ndërmend të zbrisja poshtë dhe t'ia zë derën shokut tim Sheremet Saraçi.

Në Qyqavicë, qëndrova katër-pesë orë. Rreth një orë e gjysmë, para se të binte terri në tokë, u lëshova teposhtë malit të Qyqavicës, nëpër fshatin Zhilivodë dhe zbrita në fshatin Bivolak. Kur u afrova pranë fshatit, ende ishte dritë. Zura i vend në mes ferrash e drunjë të tjerë dhe nga aty po pritja të vinte muzgu e t'ia mësyja shtëpisë së Sheremetit.

Sapo ra muzgu, u nisa drejtë shtëpisë së Sheremetit. Trokita tri herë, ashtu siç bëja zakonisht. Nuk vonoi dhe doli Sheremeti. U përqafuam dhe më tha:

– Isha duke të pritur, se mora vesh se të kishte rrethuar *shkau*!

Sheremeti më njoftoi se kishte dëgjuar se policia menjëherë pas rrethimit dhe kontrollimit të shtëpisë e kishte marrë me vete vëllanë tim, Skënderin, mirëpo më vonë e kishin liruar. Lirimi kishte ndodhur pas shkuarjes së babait tim në Stacionin e Policisë në Prelluzhë. Policia e kishte akuzuar Skënderin, që ishte shtatëmbëdhjetë vjeçar, se nuk kishte treguar se unë ndodhesha në shtëpi para rrethimit të shtëpisë.

Pas ngrënies së darkës, Sheremeti më tha:

– Shtrati është i shtruar ! Shko dhe pusho, se sot ke pasur një ditë të mundimshme!

Në gjirin e njerëzve të dashur

Të nesërmen, më doli gjumi herët. Kisha pushuar mirë. U çova nga shtrati dhe u afrova pranë dritares, që kishte pamje kah oborri i shtëpisë dhe lindja e diellit. Perdet e dritares ishin të lëshuara. E afrova kokën afër skajit të perdes dhe po shikoja jashtë. Dielli ende nuk kishte lindur, por qielli dukej i skuqur dhe drita e kishte pushtuar natën. U ktheva përsëri në shtrat.

Nuk vonoj shumë kohë dhe drita e diellit u përhap edhe në dhomën time. U çova nga shtrati dhe u afrova pranë vitrinës e po i shikoja titujt e librave që gjendeshin aty. Kryesisht, ishin libra të kohës së studimeve të Sheremetit, por kishte edhe disa libra të tjera. Mora një libër dhe nisa ta shfletoj.

Pas një gjysmë ore, u çova përsëri nga shtrati. E rregullova shtratin dhe u afrova përsëri pranë dritares. Tani dielli kishte lindur dhe dukej se do të kishim një ditë të bukur. Nga aty mund të shikoja një pjesë të Rrafshit të Kosovës. Dukej Termocentrali "Kosova" , madje edhe vetë qyteza e Obiliqit.

Me zotin e shtëpisë isha marrë vesh të mos dilja nga dhoma, pa më paralajmëruar se nuk kishte njeri në oborr. Prandaj, për të evituar zbulimin nga farefisi i Sheremetit, të cilët mund të vinin pa paralajmërim, më duhej të pritja gjersa të vinte i zoti i shtëpisë.

Nuk vonoi shumë dhe dëgjova një trokitje të lehtë në derë. E vura dorën mbi dorezë, rrotullova çelësin dhe hapa derën ngadalë.

– Mirëmëngjesi! A fjete hiq, o kaçak?! – më përshëndeti duke më dhuruar një buzëqeshje dhe pyetje njëherazi, Sheremeti.

Sheremeti u fut brenda në dhomë. Pas pak, ai doli nga dhoma dhe u kthye përsëri. Nuk vonoi shumë dhe u dëgjua përsëri një trokitje e lehtë në derë. Sheremeti e hapi derën. Kësaj radhe ishte Elhemja që u fut brenda dhe në duar mbante një tabaka me ushqimin e mëngjesit.

– Mirëmëngjesi! Urdhëroni, hani mëngjes, ju të dy, se më vonë ua sjellë edhe çajin! – na urdhëroi zonja e shtëpisë, e cila pothuajse menjëherë doli nga dhoma dhe iku tek fëmijët.

Gjithë ditën e parë e kalova i mbyllur në dhomë. Mendja më shkoi tek shtëpia. Vallë, si është nëna? Shpresoja se ajo ndjehet mirë meqë unë arrita të ik nga dora e policisë! Mendja më shkonte edhe tek shokët. Sidomos kisha frikë për Ferkiun. Por, meqë asnjë shoku nuk i kisha folur për lidhjet e mia me atë, besoja se policia nuk mund ta arrestonte Ferkiun, pa pasur asnjë fakt për veprimtarinë tonë.

Në mbrëmje, Sheremeti erdh dhe u futë në dhomë. Biseduam për shumë gjëra. E kuptoja se Sheremeti, ishte i shqetësuar për mua, prandaj më ngushëllonte ta merrja me të lehtë, gjendjen e re!

Jeta në ilegalitet, ishte një botë krejt e panjohur për mua. Gjithçka dija, për këtë "botë", ishin një grusht historish që kisha dëgjuar e lexuar nëpër libra. Mirëpo, historitë që kisha dëgjuar, për rrethimin e kullës së Beh Mihaliqit, për jetën e Shaban e Avdullah Mihaliqit nëpër bunkerët e Qyqavicës, ato për bunkerin e Aziz Zhilivodës, në pusin e shtëpisë së tij, apo filmat për luftën e Çetës së Bajo dhe Çerçiz Topullit si dhe ata të Luftës Nacionalçlirimtare, ku pasqyrohej jeta e ilegalëve, druaja se mund të më hynin në punë. Kjo ishte një kohë tjetër. UDB-a ishte shumë më e organizuar. E merrja me mend se UDB-a do t'i angazhonte informatorët dhe spiunët që kishte për të më zbuluar se ku strehohesha. Sidomos në komunën e Vushtrrisë dhe fshatrave rreth fshatit tim do të bëhej një përqendrim më i madh i spiunëve, si asnjëherë më parë!

I mbyllur në shtëpinë e shokut tim, mendja me fluturonte gjithandej. Situata në të cilën isha përplasur ishte shumë e pazakontë dhe me shumë sfida. Duke u fshehur e dal nga kashta, si Feniksi i përrallës së mitologjisë pellazge, që digjej dhe ripërtërihej nga hiri i vet, unë i kisha dhënë UDB-ës një flakaresh dhe e kisha sjell në një situatë poshtëruese, me të cilën ajo vështirë se do të pajtohej. Prandaj, duhej ta kisha mendjen se ç'veprime do të bëja dhe nuk duhej të gaboja. Sidomos tani që kisha zbritur nga maja e Qyqavicës, me duhej të ecja nëpër tokë dhe të mos shihja ëndrra se jam duke fluturuar! Fitoren e 7 prillit nuk guxoja ta ktheja në disfatë!

Sheremeti dhe Elhamja së bashku me katër fëmijët(Arbëria, Kujtimi Nora dhe Gëzimi) banonin në shtëpinë e tyre të vogël dhe që kishte vetëm dy dhoma dhe një kuzhinë. Unë isha bërë pjesëtari i shtatë i familjes. Ndonëse, familja e Sheremetit ma kishte hapur derën dhe më kishte pranuar si anëtarin e saj të shtatë dhe unë ndjehesha si në familjen time, qëndrimi im aty ishte me rrezik të madh, jo vetëm për mua, por edhe për familjen e shokut tim. Ky fakt më brengoste. Unë e njihja Sheremetin dhe e dija se ai mund të ndjehej i fyer, nëse do të kërkoja të zhvendosesha diku tjetër. Edhe ky fakt më shqetësonte, sepse në ato momente nuk gjeja zgjidhje tjetër.

Sidomos unë s'pajtohesha që unë ta zija dhomën. Isha i gatshëm të qëndroja në pleme të Sheremetit dhe për këtë kisha biseduar, rrotull, me Sheremetin, por e keqja ishte se ai nuk dëshironte që të dëgjonte për këtë çështje!

– Ti e ke dhomën dhe nuk dua të flasim për këtë çështje, – më tha Sheremeti.

Ashtu si isha i vetëm në dhomë, më dukej vetja si personazhi i komedisë "Krevati i perandorit", ku rolin e fshatarit e luante aktori i madh shqiptar, Pandi Raidhi.

Dalëngadalë nisa të përshtatem me rrethanat e krijuara dhe të sillem në përputhje me ato. Zakonisht flija që nga ora pesë e mëngjesit e gjer në drekë. Pasdite, Sheremeti vinte nga puna dhe hynte brenda e rrinte pak kohë me mua. Në mbrëmje së bashku me familjen qëndronim në dhomën e ditës. Pas darkës

vinte koha e gjumit për fëmijët dhe unë kaloja në dhomën “time”. Nga mesi i natës e deri në mëngjes, zakonisht, qëndroja në shtëpinë e re, që kishte vetëm muret e ngritura dhe që ndodhej në oborrin e shtëpisë ku banonte familja. Nganjëherë, kur ndjehesha i lodhur, kohën nga mesi i natës e gjer në mëngjes, e kaloja në pleme të Sheremetit, që ndodhej në fund të oborrit. Gjithmonë me vete e mbaja *parabellin* “tim” dhe pushkën e Sheremetit. Xhepat i kisha të mbushur me fishekë.

Elhame dhe Sheremet Saraçi me fëmijët
e tyre Kujtimin dhe Arbërinë

Shtëpia e re e Sheremetit ishte ndërtuar në një kodër dhe nga aty,si në pëllëmbë të dorës, dukej rruga, nga fshati Bivolak e deri tek ura mbi lumin Silnicë. Meqë nga ai drejtim kisha frikë se mund të vinte policia, unë, gjithmonë qëndroja aty dhe vrojtoja rrugën, i gatshëm për çdo të papritur. Por në anën tjetër edhe uroja që të mos kisha kurrë nevojë ta përdorja pushkën e Sheremetit, sidomos aty afër shtëpisë së tij. E kisha menduar mirë këtë punë. Nëse do të paraqitej ndonjë lëvizje e dyshimtë apo lëvizje të ndonjë makine të policisë, e kisha ndërmend të largohesha nga aty në drejtim të Qyqavicës. Kështu mendoja se policia edhe nëse do të vinte nuk do të më gjente aty dhe kështu nuk do të mund t’i bënte ndonjë të keqe familjes së Sheremetit. Përndryshe unë ndjehesha shumë mirë aty dhe isha i sigurt se UDB-a nuk dinte për vendqëndrimin tim.

Megjithëkëtë UDB-a ishte e paparashikueshme dhe për çdo të papritur unë nuk guxoja të zihesha në gjumë ashtu siç isha zënë me 7 prill 1983.

Një ditë sapo erdhi nga puna, Sheremeti më trokiti në derë dhe pasi hyri brenda më tregoi se kishte dëgjuar se policia e kishte "vizituar" shtëpinë e Ragip Beçukut!

Më erdhi keq për familjen e bacës Ragip dhe shqetësimin që mund t'i kishte shkaktuar atij dhe familjes së tij, vizita e policisë! Meqë nuk më kishte parë asnjë njeri gjersa isha duke hyrë në shtëpi të bacës Ragip e as gjatë kohës sa qëndrova tek ai, nisa të dyshoj se mos baca Ragip ka folur me ndonjë kushëri tjetër dhe i ka treguar për rastin tim. Ndoshta baca Ragip ka folur me ndonjë njeri që mezi ka pritur ta njoftojë policinë?– më shkoj mendja.

Atë natë me Sheremetin kemi folur për jetën e bacës Ragip. Sheremetit i thashë se baca Ragip gjithë jetën është marrë me bujqësi dhe ka jetuar nga puna e tij. Por gjatë asaj bisede unë ia tregova edhe disa histori, nga jeta e bacës Ragip, që na bënë të qeshnim, por, siç dukej, edhe e ngacmuan Sheremetin të m'i lëshonte disa "sharje". Sidomos historia që kisha dëgjuar për bacën Ragip: se si e kishe zënë gjumi duke u falur në xhami dhe se si në atë rast u kishte lëshuar qeve të tij thirrje: "kuqo, kuqo!,- Sheremeti nuk u durua pa më thënë:

– Ah komunisti i dreqit! Të njoh unë ty! Po më tregon histori komuniste!

Qeshëm një kohë së bashku dhe i thamë njëri-tjetrit "Natën e mirë!"

Ndonëse, Sheremeti ishte i zgjedhur në një të ashtuquajtur "Këshilli i Arsimtarëve" që ishte një organ këshillëdhënës në shkollë, nuk besonte në socializmin vetëqeverisës jugosllav dhe Jugosllavinë nuk e konsideronte si vend socialist. Megjithëkëtë, unë dhe Sheremeti kishim botëkuptime të ndryshme për jetën dhe shoqërinë. Unë isha simpatizues i materializmit dialektik dhe historik e besoja se në Shqipëri ndërtohej socializmi i vërtetë, ashtu siç e konsideroja Jugosllavinë një vend kapitalist laraman. Në anën tjetër, Sheremet Saraçi nuk ishte i interesuar shumë për politikë e filozofi; ai më me dëshirë fliste për letërsi e sidomos për veprat e Gjergj Fishtës dhe për veprat e shkrimtarëve të periudhës së Rilindjes sonë Kombëtare. Megjithëkëtë, mund të them, pa hezitimin më të vogël, se ai ishte një nacionalist i ndershëm dhe një patriot i zjarrtë që e donte shumë popullin e vendin e tij.

Dallimet që kishim në botëkuptime nuk ishin pengesë në marrëdhëniet shumë miqësore dhe vëllazërore që mbretëronin në mes nesh, përkundrazi, ato, vetëm e plotësonin boshllëkun e njëri-tjetrit. Për mua Sheremeti ishte një patriotë i madh dhe një shok shumë i dashur dhe i respektuar. Ai kishte mision të jetës së tij çlirimin e Kosovës nga zgjedha serbe dhe bashkimin e saj me nënën Shqipëri. Këtë qëllim e kisha edhe unë dhe kjo na bashkonte dhe na bënte të ndjeheshim jo vetëm si shokë, por edhe si vëllezër.

Ndonëse nuk kisha arritur t'i kontaktoja Xhemën dhe Ferkiun, isha shumë i sigurt se ata ishin të informuar për ditën dramatike të 7 prillit. Sidomos, Ferkiu do të duhej të ketë dëgjuar nga i ati i tij, që punonte në Termocentralin e Obiliqit. Pastaj Ferkiu mund ta ketë takuar Shabanin apo Shabani ndoshta e ka

takuar Dritën, Mirveten apo dikë tjetër dhe lajmi patjetër duhet të ketë shkuar tek ai. E merrja me mend se ata e dinin se ku ndodhesha edhe pa marrë asnjë lajm nga unë. Unë kisha besim të plotë se Xhema dhe Ferkiu nuk do të bien në ndonjë grackë të UDB-ës dhe nuk do të bëjnë ndonjë veprim të gabuar. Kjo më qetësonte dhe më bënte edhe më të vendosur që edhe unë të tregohesha i kujdesshëm. UDB-ën e kisha mundur deri me tani dhe duhet të vazhdoja të mbetesha fitimtar edhe në të ardhmen, – i thosha vetës.

Pas disa ditësh qëndrimi në shtëpinë e Sheremetit e kam vizituar Nusret Pllanën në fshatin Milevc afër Prishtinës. Nusretin e kam njoftuar për ngjarjen e 7 prillit 1983. Në shtëpinë e tij kam qëndruar tre ditë. Gjatë qëndrimit jam njohur me familjen e tij liridashëse dhe mikpritëse.

Nga Milevci, nëpër rrugica të fshatrave dhe arave, pas disa orë udhëtimi në këmbë, jam kthyer përsëri në Gllavotin.

Shpeshherë kur kthehej nga puna, Sheremeti, më sillte edhe lajme të ndryshme që i merrte nga kolegët e tij, por edhe nga shokët dhe të afërmit që i takonte.

Një ditë, Sheremeti sapo erdhi nga puna u fut në dhomën "time". E vërejta menjëherë se ishte i mërrolur dhe se diçka duhet ta ketë shqetësuar! E pyeta se ç'kemi të re dhe ai nisi rrëfimin e tij:

– Demë Jashari më tha se, Asllan Muharremi nga Mihaliqi, është agjent i UDB-ës dhe se ai po shtiret se gjoja është i rrezikuar dhe i përndjekur, por në të vërtet ai është njeri i shitur!

Më shkoi buza në gazë!

– Shoku Demë Jashari i di punët më thellë...Ke kujdes se kë je duke e mbajtur në shtëpi! – ia ktheva Sheremetit.

U zhgënjeva shumë për këtë "xhevahir" të Demë Jasharit. Nuk më kishte shkuar mendja se ai kishte rënë aq poshtë. Nuk më dukej fare miqësor ky qëndrim i tij. Pse vallë po e bënë punën e UDB-ës, shoku Demë Jashari, e pyeta vetën?

Nga shokët kisha mësuar se shoku Demë Jashari, dikur na ishte anëtar i Grupit "Shkëndijat e Kuqe", prandaj po më befasonte shumë përhapja e gënjeshtrave të tilla udbeske!

– Sigurisht se i di shumë thellë punët Demushi, por nuk më ka shkuar kurrë mendja se është kaq burrë i lig!– u përgjigj Sheremeti.

Unë i lëviza krahët dhe i thashë:

– Po befasohem nga këto gënjeshtra udbeske, të shokut Demë Jashari!

Qëndruam edhe një copë herë së bashku dhe Sheremeti më foli edhe për disa punë të liga që kishte dëgjuar për Demë Jasharin.

Pasi i thamë natën e mirë njëri-tjetrit unë u shtriva në shtrat në "dhomën time". Lajmi që më dha Sheremeti për Demë Jasharin i trazoi kujtimet e mia. Përse përhap shpifje të UDB-ës Demë Jashari, vazhdoja ta pyetja vetën time? Mos vallë Demë Jashari ka qenë informator i UDB-ës edhe atëherë kur e kam takuar për herë të parë në Kodrën e Shtitaricës së bashku me Danin, Latën,

Xhemën, Ferkiun dhe Samiun? Nëse kjo është e vërtetë atëherë Demë Jashari duhet të jetë personi që ka dekonspiruar lidhjen time me Danin, por mund të jetë edhe ai që ka zbuluar edhe lidhjen e Danit me Shefqet Jasharin. Deri diku ky lajm e sqaron pse-në e izolimit tim në prill të vitit 1981. Ndoshta UDB-a ka ditur se unë i kam njohur jo vetëm Danin dhe Ferkiun, por edhe Xhemën, Latën dhe Samiun para arrestimit të vitit 1979? Gjatë hetimeve të bëra ndaj meje, ndoshta UDB-a e ka vërtetuar se unë nuk jam treguar i sinqertë dhe nuk ia kam thanë të vërtetën? Ndoshta UDB-a, përkundër kësaj, me ka liruar dhe më ka ruajtur për ndonjë rast tjetër? Përndryshe po të mos kishte fakte se po e fsheh të vërtetën nuk do të më kishte izoluar pranverën e vitit 1981! Përhapja e shpifjeve të tilla nga ana e Demë Jasharit mund të jetë edhe një tregues se sa i duhem UDB-ës?

Ashtu si Sheremeti edhe unë u bëra tym në përhapjen e gënjeshtrave të Demë Jasharit. Atë natë edhe sikur të isha përpjekur të flija nuk do të më zinte gjumi. Por kjo humbje gjumi, s'kishte edhe gjë të keqe, sepse unë edhe ashtu do të vazhdoja të qëndroja i zgjuar derisa të përshëndetesha nga dielli i lindjes së një dite të re.

Të nesërmen, në të kthyer nga puna, Sheremeti më njoftoi se e kishte takuar *Hoxhën* dhe nga ai ishte njoftuar për gjendjen në rrethin e njerëzve me të cilët mbante kontakte, për gjendjen e Vehbi Mujës në burg si dhe për faktin se familja ime kishin vërejtur se policia po e mbante të rrethuar shtëpinë time çdo natë:

– Një natë,– e kishte vazhduar tregimin e tij *Hoxha*,– disa punëtorë të fshatit duke shkuar në punë, në ndërrimin e tretë, në malin e Hajdar Agës, i kishte ndaluar policia dhe i kishte legjitimuar. Gjithashtu edhe në një kodër në mes fshatit Mihaliq dhe Gllavotin, Strofc dhe Beçuk, që quhet *boqovinë*, një fshatar nga Mihaliqi, duke kaluar atypari kishte hasur në tre-katër policë, që ishin futur në një gropë dhe po qëndronin dhe vëzhgonin nga aty gjithë kodrën nga lumi Silnica e deri mbi vreshta në mes Mihaliqit, Beçukut dhe Strofcit." *Hoxha* e kishte njoftuar Sheremetin, në atë rast, gjithashtu, se "im atë ishte ankuar tek udbashi Burhan Prishtina kundër pranisë së policisë rreth shtëpisë dhe se ai madje edhe e kishte akuzuar Burhan Prishtinën se:" mbajtja në rrethim e shtëpisë, po bëhej shkaktare e humbjes së djalit". Pas dëgjimit të ankesë së tim atë, Burhan Prishtina i kishte premtuar se "gabime të tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen!"

Mbi bazën e informacioneve që kisha marrë nga Sheremeti, por edhe të atyre gjatë kontakteve që ai kishte pasur me *Hoxhën*, unë isha i sigurt se afrimi afër shtëpisë time do të ishte fatal për mua. Prandaj duke e ditur këtë unë kisha hequr dorë nga çdo ide e tillë dhe nuk e kisha ndërmend t'ia mësyja shtëpisë sime edhe për një kohë.

Edhe më tutje kontakti me shokët ishte një problem në vete. Kishin kaluar disa ditë dhe Xhemën e Ferkiun nuk kisha arritur t'i takoja. T'i mësyja shtëpitë e tyre, ishte sikur ta mësyja shtëpinë time. Isha shumë i sigurt se edhe ata të dy, por edhe shtëpitë e tyre, ishin në vëzhgim të rreptë të agjentëve të UDB-ës. Të

dërgoja ndonjë shok tek ata ishte punë gjithashtu me shumë rrezik. Sheremetin nuk guxoja ta vë në lëvizje. Prandaj, në gjendjen që ndodhesha e vetmja mundësi që më ngelte ishte të tregohesha gjakftohtë dhe të prisja të ecte koha. Vetëm koha mund ta bënte UDB-ën të lodhej dhe hiqte dorë nga rrethimi i hekurt i shtëpisë sime, – thosha vetë me vete. Tani lufta jonë ishte bërë një luftë nervash! Gjithmonë shpresoja se shokët do ta kuptojnë drejtë gjendjen dhe se ata nuk do të bëjnë ndonjë gabim, që do të ishte shumë i kushtueshëm jo vetëm për mua por për të gjithë shokët e organizatës sonë.

Disa ditë më vonë, Sheremeti më njoftoi se nga *Hoxha*, kishte mësuar se Komandanti i Stacionit të Policisë së Vushtrrisë, Muhamet Meniçi, e kishte thirrur tim atë në një bisedë informative dhe në atë rast e kishte pyetur për farefisin tonë, për adresat e hallave, dajave, kushërinjve dhe të afërmve të tjerë. Im atë, që luante rolin e njeriut që s´di gjë për veprimtarinë time, ia kishte thënë shefit të policisë të gjitha vendbanimet dhe adresat e të afërmve. Në fund të bisedës Muhamet Meniçi i thotë tim atë:

– Unë e njoh Asllanin. Dikur, unë isha kryetar i Lidhjes së Rinisë Socialiste në Vushtrri, ndërsa Asllani ishte Kryetar i Lidhjes së Rinisë Socialiste në Mihaliq. *Si duket Asllani është përzier në këtë punë dhe unë besoi se ai s'rri nëpër këto adresa*!

U entuziazmova nga ky lajm! Unë e dija se shtëpitë e të afërmve mbaheshin të vëzhguara, por më erdhi shumë mirë që Komandanti i Stacionit të Policisë së Vushtrrisë ma kishte dhënë një "këshillë" që të mos dukesha andej, se do të më prangoste. Sido që të jetë unë e merrja këtë si një këshillë dashamirëse, që besa edhe si ndihmë të madhe! Muhamet Meniçi ka mundur të mos ia thotë këtë fjalë tim atë, prandaj unë i isha shumë mirënjohës për këtë! Kjo ishte shenjë e mirë dhe që tregonte se UDB-a nuk i kishte të gjithë në anën e saj, se edhe nga radhët e policisë kishte njerëz që së paku guxojnë të mendojnë në liri dhe ta ndihmojnë lirinë me aq sa munden!

Një ditë papritur erdhi i ati i Sherametit, baca Lif, dhe më zuri në dhomën e ditës. Baca Lif nuk më njihte se kush isha. U prezantova se isha nga Mitrovica dhe se isha ardhur t'i lutesha Sherametit të më ndihmonte për t´u punësuar si mësues në Shkollën Fillore "Liria" në Strofc. Sheremeti bënte shaka dhe më përgjigjej se nuk mund të më ndihmonte pa u "kruar pak". I ati i Sherametit ia ktheu të birit të tij:

– Mos u bërë i keq! Nëse mundesh ndihmoje të punësohet se po më duket se qenka djalë i mirë!

Edhe kjo fjalë ma kujtoj fjalinë e Danit gjatë takimit tonë të parë. Pasi pimë çaj, unë u bëra se po largohesha, u përshëndeta me bacën Lif dhe Elhamen dhe dola e u futa në dhomën tjetër.

Një ditë tjetër Sheremeti kthehet nga puna dhe më tregon një histori interesante që e kishte dëgjuar nga *Hoxha*. Sipas Sherametit, udbashi Burhan Prishtina e kishte thirrur në polici tim atë dhe e kishte kërcënuar:Nëse nuk

dorëzohet Asllani edhe pak ditë do ta publikojmë fotografinë e tij në televizion dhe me ndihmën e popullit do ta zëmë ashtu siç e zumë Paçarizin!

Sheremeti si me shaka më pyeti:

– Athua cilën fotografi do ta publikojnë? Atë të letërnjoftimit, indeksit të Universitetit, të pasaportës apo ndonjërën nga fotografitë që mund ta kenë marrë UDB-a gjatë përpjekjes për arrestim dhe bastisjes së shtëpisë tënde?

Unë e rregullova flokët dhe i thashë me shaka Sheremetit:

– Besoj se në të gjitha dukem bukur!– dhe pastaj qeshëm një kohë të gjatë me përpjekjet dëshpëruese të udbashit Burhan Prishtina.

E kuptoja se në ç'siklet ndodhej Burhan *turku* dhe se kjo ishte vetëm një përpjekje dëshpëruese e tij për ta thyer qëndresën tonë dhe mbështetjen që gëzonte lufta jonë tek populli. Mirëpo kërcënimin e Burhan turkut unë e kuptoja edhe si një presion të madh që i bëhej familjes sime. E kuptoja mesazhin e UDB-ës, por kisha besim të patundur se familja nuk do të thyhej, ashtu siç nuk më shkonte mua mendja të dorëzohesha.

Kishte disa ditë që po binte shi, bënte mjaftë ftohtë dhe si zakonisht netëve të tilla, pas darke, e shtronim çajin e rusit, të cilin Sheremeti e kishte shumë merak dhe e pinte shumë të "rëndë". Ai e donte gjysmën e gotës me çaj të zi dhe gjysmën tjetër me ujë të vluar.

Një mbrëmje, pasdarke dhe gjersa po pinim çaj, Sheremeti filloi të ma tregonte një histori që e kishte dëgjuar nga njëri nga vëllezërit e tij. Sipas vëllait të Sherametit, një polic rezervist nga Vushtrria, gjatë pjesëmarrjes së tij në ushtrimet e policisë rezervë në Gazi Mestan takohet me komandantin e Njësive Speciale Federative, i cili ndodhej aty si vëzhgues i ushtrimeve. Sapo komandanti e merr vesh se nga ishte rezervisti e pyet:

– Çka po bëni ju të Vushtrrisë, që nuk po e zini Asllan Muharremin?!

Rezervisti shqiptar ngelet i habitur dhe e pyet komandantin e policisë speciale:

–Kush është ai?!

– Kështu është puna *"he ta marrsha të keqen*! – më tha Sheremeti.

Më dukej shumë interesant lajmi që mora nga Sheremeti. Megjithëkëtë nuk ma merrte mendja se pyetja e komandantit të Njësive Speciale të Policisë Federative, kishte të bënte me vendndodhjen time. Po ta dinte UDB-a e Kosovës adresën time, një komandant i Njësive Speciale nuk do të bisedonte me një rezervist për çështjen time. Duhet të jetë një rastësi,ma thoshte mendja, që komandanti i policisë dhe rezervisti janë takuar. Se komandanti ia ka thënë emrin tim rezervistit, kjo nuk më befasonte, sepse udbashët e Kosovës e kanë njoftuar eprorin e tyre me emrin tim menjëherë pas dështimit të tyre.

– Të jesh i sigurt se i vëllai im nuk di se ti banon tek ne! –më tha Sheremeti!

Pyetjen e komandantit të Njësive Speciale e kuptoja më shumë si një pyetje hetuese, të bërë, me qëllim zbulimi! Mirëpo kur komandanti i Njësive Speciale i heton rezervistët, kjo nënkuptonte se ai nuk ishte i kënaqur me punën e

shërbëtorëve të tij në Kosovë. Kjo tregonte se UDB-a nuk ishte dorëzuar dhe unë duhej të vazhdoja të tregohesha i kujdesshëm.

Një dite gjersa po bisedonim, Sheremeti më thotë:

–Ti po "lavdërohesh" se nuk po të gjen UDB-a, por Elhemja më tha se e di se kush është Aliu! Aliu po i përngjan nënës së tij-Nailes! Naile Mirena, e bija e Feratit dhe Vahides, nga Hadja është mbesa e bacës Zenun Berisha nga Grabovci! Të ka gjet, Ali, s'ke ku shkon!

– Nuk kemi nevojë ta mbajmë të fshehtë ketë fakt para Elhemes. Flasim bashkë kur të kthehet në shtëpi. Unë i besoj Elhemes, aq më tepër që tani po del se e paskam edhe teze të nënës –i thashë Sheremetit.

Gjatë një bisede tjetër Sheremeti më tha se Kujtimi e kishte pyetur Elhamen se :

– Kur do të shkoi xhaxhi Ali në shtëpinë e tij?

Kujtimi e kishte kuptuar se unë isha duke banuar në shtëpinë e tyre. Ai vinte nganjëherë dhe e luante rezën e derës së "dhomës" sime. Unë e dija se është Kujtimi dhe e hapja derën. Kujtimit ia tregoja librat që kisha në dhomë dhe e pyetja se a dinte ta recitonte ndonjë vjershë. Kur e lutja një copë herë, ai recitonte dhe e zgjatke trupin e qëndronte gatitu e ia niste vjershën që dinte. Pastaj, unë e lutsha të shkonte tek Arbëria, Nora e Gëzimi dhe i shpjegoja se "unë i kisha disa detyra të shkollës që duhej t'i kryeja derisa të vinte Sheremeti nga puna".

Diku rreth dy javë që nga dita e rrethimit jam takuar për herë të parë me Ferkiun. Gjatë takimit biseduam për çështjen e vënies së kontakteve me shokët e LNÇKVShJ-së, jashtë Kosove. Ishim të mendimit se në Turqi duhet ta dërgojmë një shok, i cili do t'i njoftonte shokët me gjendjen e krijuar si dhe të kërkonte nga shokët mendimin se ç'duhej të bëja dhe nga t'ia mbaja?

Çështja e udhëtimit të një shoku jashtë vendi, edhe mua më hodhi para telashesh : se cilin shok do ta nisnim për rrugë? Unë për vete i kisha të kufizuara mundësitë e përzgjedhjes. Rexha ishte ushtar në Maqedoni. Sheremeti, kishte mundësi udhëtimi, por udhëtimi i tij në Turqi, mund të zgjonte kureshtjen e UDB-ës. Madje, ai ishte pyetur njëherë për çështjen e udhëtimit të tij në Turqi. As *Hoxhën* nuk mund ta angazhoja, sepse një udhëtimi i tij në Turqi do të binte në sytë e UDB-ës. Mundësi udhëtimi kishte Shyqëri Imeri, Bedri Selmani, por nuk kisha njohuri se si qëndronin ata me pasaportë? Pastaj këta të fundit nuk i kisha takuar ende.

Mirëpo unë isha i mendimit që Ferkiu ta bisedonte çështjen e udhëtimit me Burim Zagragjën ose Behxhet Ahmetin dhe në këshillim me ata ta bënte përgatitjen e nisjes së njërit prej tyre në Turqi. Për këtë çështje, kështu edhe u pajtuam me njëri-tjetrin. Gjithashtu me Ferkiun caktuam një ditë kur do të takoheshim në Prishtinë dhe unë do të fotografohesha. Duhej të fotografohesha

sepse ishim pajtuar që shoku që do të udhëtonte t'ua dërgonte fotografitë e mia shokëve në Turqi dhe ndoshta ata mund të bëjnë ndonjë pasaportë për mua?

Mëngjesin e ditës kur duhej të shkoja në Prishtinë, u përpoqa t'i rregulloja flokët e mia, por ato i kisha zënë keq, gjatë natës, dhe nuk mund t'i rregulloja e krihja si dëshiroja. Dukesha sikur të kisha lëkur iriqi në kokë! Në Prishtinë arrita me kohë dhe u takuam aty ku ishim pajtuar me Ferkiun. Unë hyra brenda te Foto "*Iliri*" ndërsa Ferkiu qëndronte jashtë dhe bënte roje! Bëra fotografitë dhe e njoftova fotografin se pasdite do të vinte një vëlla i imi dhe do t'i merrte fotografitë.

Më vonë Ferkiu më ka njoftuare se e ka dërguar Shabanin (tim vëlla) për t'i marrë fotografitë. Ferkiu më ka thënë se ka qenë Selatin Novosella që ia ka dorëzuar fotografitë Shabanit.

Shëndeti dhe sfidat e tij

Disa ditë pas kthimit nga Cernusha, kur së bashku me Ferkiun i patëm shumëzuar *tetë kërkesat e parevokueshme,* kisha vërejtur se nga veshi i majtë më kullonin pika gjaku. Megjithëkëtë tek mjeku nuk isha drejtuar. Pas rrethimit të shtëpisë dhe kalimit në ilegalitet, nuk më kishte rënë ndërmend të merresha me veshin dhe hallet e tij.

Mirëpo, ditëve të fundit, ndonëse nuk kisha vërejtur kullim gjaku nga veshi, e ndjeja një dhembje të veshit dhe kokës. Një simptomë tjetër ishte se të gjitha llojet e ushqimeve, që shijoja, më dukeshin shumë të njelmëta. E pyeta edhe Elhemen për njelmësinë e ushqimit dhe nga ajo mora përgjigje që nuk vërtetonte përshtypjet e mia. Elhamja e mori një pjesë të pites, që e kishte gatuar, nga ana e tepsisë që kishte para vete, dhe më luti ta provoja, por unë nuk pashë asnjë ndryshim! Ushqimi vazhdonte të kishte "shumë" kripë!

Ky përkeqësim i papritur i shëndetit tim, i shqetësoi edhe Elhamen dhe Sheremetin. Ata përpiqeshin të më ndihmonin në mënyra të ndryshme, por sa më shumë që kalonte koha, ndjehesha gjithnjë e më keq dhe dhembja sa vinte e më shtohej. Fillova ta humb forcën dhe mezi qëndroja në këmbë. Çuditërisht, "mendjen" e kisha të kthjelltë. Vallë pak e kisha policinë, por tani më duhej edhe kjo sëmundje e mistershme?– e pyesja vetën.

Kaluan dy-tre ditë dhe me Sheremetin biseduam se si t'ia bëjmë. U pajtuam që ta kontaktojmë një mjek, por mjek të njohur nuk kishim. Në bisedë e sipër, na lindi ideja që ta kërkojmë ndihmën mjekësore në Shtëpinë e Shëndetit të Punëtorëve të Termocentralit të Obiliqit dhe, në atë rast, ta përdor librezën shëndetësore të vëllait tim, Shabanit. Termocentrali i Obiliqit kishte rreth tetëmbëdhjetë mijë punëtorë dhe personeli mjekësor nuk i njihte të gjithë punëtorët që i kontrollonte, erdhëm në përfundim. Pastaj, unë gjithashtu thashë vetë me vete: "nëse me zënë policia, le të më zënë me librezë të vëllait!"

Sheremeti më tha se do të përpiqej ta kontaktonte *Hoxhën* dhe ta porosiste që ta vizitonte shtëpinë time dhe të na e sillte librezën shëndetësore. Pak më vonë më ka njoftuar se shpresonte se qysh nesër ta kemi librezën shëndetësore.

Meqë u pajtuam që ta kërkojmë ndihmën mjekësore në Shtëpinë e Shëndetit të Termocentralit në Obiliq, mendja më shkoj që të zhvendosesha, së pari në Hade, tek daja Isë, dhe pastaj me ndihmën e tij ta vizitoja Shtëpinë e Shëndetit. Dajën Isë, qysh i vogël e kisha dëgjuar duke biseduar për demonstratat e vitit 1968, e dija se ai shoqërohej me nipin e tij– Qamil Grajçevcin – dhe dajën tim – Salih Mirena; se ata të tre kanë qenë shokë të pandashëm dhe pjesëmarrës në demonstratat e 1968-tës në Prishtinë. Gjithashtu, me dajën Isë dhe Qamilin,

viteve të fundit, kisha biseduar kohë pas kohe për zhvillimet politike dhe ua kisha dhënë ndonjë gazetë dhe libër të ndaluar.

Të nesërmen, Sheremeti më njoftoi se e kishte marrë librezën shëndetësore. Dikur pasdite, ai erdhi përsëri në dhomë dhe më njoftoi se duhej të bëhesha gati se një makinë po më priste në oborr. Sheremeti më ndihmojë të futesha në makinë.

Pastaj, u nisëm në drejtim të fshatit Hade së bashku me Isuf Saraçin. Kaluam nëpër Hamidi, Leshkoshiq dhe arritëm në Hade. Në hyrje të fshatit Hade u ndamë me Isuf Saraçin, ndërsa unë vazhdova dhe kalova anësh fshatit, nëpër *bashkari** dhe arrita tek shtëpia e dajës Isë(Mirena).

Ç'ishte e vërteta mua më vinte shumë keq, që po detyrohesha t'i shkoja në shtëpi dhe me këtë mënyrë t'i krijoja telashe dajës Isë dhe familjes tij. Mirëpo në atë gjendje që isha, nuk gjeja zgjidhje tjetër.

Daja Isë së bashku me dajën Hajrë dhe e gjithë familja e tyre më pritën krahëhapur. E gjithë familja kishin dëgjuar se ç'kishte ndodhur në shtëpinë time me 7 prill 1983 dhe e dinin se isha duke u kërkuar nga policia!



Daja Isë (Isë Mirena)

Të nesërmen në mëngjes daja Isë së bashku me Qamilin më dërguan në Shtëpinë e Shëndetit të Punëtorëve në Obiliq. Një mjek më kontrolloi dhe pas pak i këshilloi dajën Isë dhe Qamilin që të më dërgojnë në Prishtinë.

Nga Obiliqi me makinën e Qamilit arritëm në Prishtinë.

E mbaj mend se në fillim jam vendosur në shtëpinë e Riza Pllanës në lagjen *Kodra e Trimave* në Prishtinë, ku ishte e martuar e motra e Qamilit- Rifetja.

Nga aty kemi kërkuar ndihmë mjekësore në Klinikën Infektive të Spitalit Universitar të Prishtinës. Më kontrolloi një mjek specialist. Ai kërkoi nga unë që t'i bëja analizat e gjakut. Meqë ai nuk "zbuloi" asgjë të çuditshme, gjatë kontrollit të parë, mjeku më këshilloi të kthehesha në shtëpi! Unë i

shpjegova mjekut se nuk isha aty për pushim mjekësor, por për shkak të dhembjeve të padurueshme që kisha! Pas shpjegimeve të mia dhe marrjes së rezultatit të provave shtesë, mjeku më udhëzoi që të shkoja tek Klinika e Otorinolaringologjisë (Sy-vesh-hundë dhe Fyt).

Në Klinikën e Otorinolaringologjisë u vendosa në Repartin e Veshëve në një dhomë me dy-tre pacientë të tjerë. Mjekët më bënë një provë që ishte një shpim në shpinë. Pas kësaj mjekët nisën menjëherë mjekimin. Ndihma e dhënë pati efekt pozitiv dhe unë fillova të ndjehesha më mirë dhe të kisha më pak dhembje në kokë.

Ditën e tretë të qëndrimit në spital, një pacient i dhomës sime më tha se po më njihte dhe se më kishte takuar, kohë më parë, diku në Mitrovicë! Pacienti, që më tmerroi me lajmin që po më jepte, më tha gjithashtu se ai më njihte, madje edhe se e dinte se quhesha Asllan dhe jo Shaban!

Unë bëra përpjekje t'ia mbushja mendjen se isha duke i përngjarë në ndonjë person tjetër dhe këmbëngulja se unë quhesha Shaban dhe jo Asllan. Çuditërisht pacienti nuk e zgjati më shumë me çështjen e njohjes! Megjithëkëtë mua më kapen "ethet". Mendja më shkonte gjithandej! Për mua çdo njeri i panjohur ishte i dyshimtë!

Ditën e pestë të qëndrimit tim aty, unë fillova ta merrja vetën dhe të lëvizja nëpër korridorin e repartit të mjekimit, pothuajse normalisht. Shëtitjen e bëja nga dhoma ime e deri në fund të korridorit, ku ndodhej një dritare shumë madhe e cila kishte pamje nga oborri dhe vend parkimi i makinave. Duke shëtitur, sapo arrita tek dritarja u ndala dhe i hodha një shikim oborrit. Papritur i shohë Burim Zagragjën dhe Behxhet Ahmetin, poshtë në oborr, tek parkingu i makinave dhe afër derës së hyrjes në repartin tim. Nuk vonova dhe zbrita poshtë në katin përdhes dhe dola tek dera në oborr. U përshëndeta me shokët dhe atyre u tregova edhe për shqetësimin tim që kisha, se një pacient po thoshte se më njihte! U pajtuam që të futesha në makinë. Aty biseduam pak minuta dhe ashtu siç isha ikëm në drejtim të Hades. Pas njëzet-tridhjetë minutash arritëm në hyrje të fshatit Hade. Burimi e Behxheti u kthyen ndërsa unë vazhdova në këmbë deri tek shtëpia e dajës Isë.

Të nesërmen, daja Isë, shkon dhe e takon tim atë në vendin e tij të punës, e porositë të shkonte në Klinikën e Otorinolaringologjisë së Spitalit Universitar të Prishtinës dhe t'ju shpjegonte mjekëve se gjoja unë isha larguar nga spitali për shkak të provimeve që kisha javën e ardhshme!

Të nesërmen në mëngjes, daja Isë më ka njoftuar se, im atë kishte shkuar në spital dhe ua shpjegon mjekëve "arsyet" e ikjes sime nga spitali. Në atë rast mjeku i kishte thënë tim atë:

– Unë isha duke u bërë gati ta njoftoja policinë për largimin e tij, pa leje, nga spitali! Mirëpo meqë ke ardhur dhe po m'i tregon arsyet e largimit të tij, nuk do ta bëjë një gjë të tillë. Ne jemi të shqetësuar për gjendjen shëndetësore të Shabanit! Duhet ta kuptoni se gjendja shëndetësore e djalit tënd është e rëndë dhe ai duhet patjetër të kthehet në spital, sepse shëndeti i tij, tani për tani, është

më i rëndësishëm sesa provimet. Po t'i jap me vete këto barëra, por përpiqu ta bindësh djalin tënd që të vije në spital sepse ai nuk do të shërohet vetëm me këto barëra!

Pasdite daja Isë kthehet nga puna dhe m'i sjellë barërat dhe mendimin e mjekut.

Unë nuk e morra seriozisht mendimin e mjekut. Vazhdova t'i pi barërat që m'i kishte sjellë, por nuk e kisha ndërmend të shkoja përsëri në spital!

Të nesërmen fillova përsëri të ndjehesha keq. Kisha barkë qitje dhe vjellje. Të gjitha simptomat që i kisha pasur para shtrirjes në spital më ishin rishfaqur.

Daja Isë dhe Qamili më dërguan përsëri në spital. Mjekët rifilluan menjëherë trajtimin mjekësor.

Kaluan dy-tre ditë të tjera dhe unë nuk po shihja ndonjë përmirësim. Një mëngjes infermierët më nxorën nga dhoma dhe së bashku me shtratin tim më dërguan në sallën e operacionit.

Pas marrjes së narkozës më ka "zënë gjumi". Pas pak, e kam dëgjuar një zhurmë të ngjashme me krismën që lëshon prerja me thikë e një stofi të fortë. Gjatë operacionit, pa problem e dëgjoja bisedën e kirurgëve Refki Ramku e Hasan Jakupi. Si duket, ata ishin të vetëdijshëm se unë i dëgjoja, prandaj flisnin me njëri-tjetrin gjermanisht! Gjithashtu, gjatë operacionit, i dëgjoja goditjet e çekanit, por nuk ndjeja dhembje.

Pasi më ka lëshuar narkoza, nga salla e operacionit deri në dhomën time, më ka shoqëruar një infermiere që më fliste serbisht. Nuk ia mbaj mend emrin por ajo kishte sjellje shumë njerëzore. "*E sinko moje*[15]...,-më thoshte diçka që unë e dëgjoja si në ëndërr"

Menjëherë pas operacionit fillova të ndjehesha më mirë dhe të këndellesha. Mjeku i kishte urdhëruar personelin e kuzhinës që të më jepnin ushqim shtesë. Dy-tre ditë pas operacionit më dukej sikur nëpër murin përballë, që e kisha në dhomë, po lëviznin milingona në një rresht që s'mbaronte kurrë. Pas disa ditësh nisa serish të ecë nëpër dhomë dhe pak më vonë edhe nëpër korridor të spitalit.

Një ditë një kryeinfermiere me mbiemrin Sokoli erdhi në dhomën time dhe më pyeti se si ndjehesha. Meqë unë i jepja përgjigje se ndjehesha mirë, ajo e gëzuar më tha:

– Po më vjen mirë. Ke pasur një gjendjen të rëndë. Mjekët të kanë hequr kaq qelb nga truri i vogël,- dhe ma tregoi një gotë plastike të vogël sasinë e qelbit që më kishin nxjerrë mjekët. Ke qenë shumë në rrezik dhe pranë vdekjes –vazhdoi me gjithë seriozitet kryeinfermierja Sokoli.

Unë s´dija se çka t'i them, por iu përgjigja informacionit të saj me kokëfortësinë e njeriut që nuk beson në vdekje:

– Nuk e kam pasur ndërmend të vdes! – i thashë kryeinfermieres.

Kryeinfermierja Sokoli më lëshoi një buzëqeshje dhe iku.

Çdo ditë që kalonte ndjehesha gjithnjë e më mirë me shëndet. Nuk ndjeja dhembje dhe vargu i milingonave ishte larguar nga muri! Më ishte shtuar forca dhe ngjitesha nga shtrati e lëvizja nëpër dhomë.

Përmirësimi ma ngacmoj idenë që ta braktisja spitalin sa më parë. Dëshiroja të bëhesha bashkë me shokët dhe njerëzit tjerë të dashur e të shtrenjtë të cilëve kjo sëmundje e mallkuar u nxori aq shumë telashe.

Mirëpo mjekët nuk e bisedonin me mua çështjen e largimit tim nga spitali. Sa herë i pyetja më përgjigjeshin se do të më lirojnë sapo të shërohesha! Përgjigja e mjekëve më dëshpëronte shumë.

Pas disa ditësh, gjersa isha duke shëtitur në korridor, e shoh se po vinte drejtë meje Enver Syla, bashkëfshatari im, nga Mihaliqi. Sapo e pashë mendova menjëherë si të ikë nga korridori. U bëra se nuk po e njihja dhe u ktheva e u futa në dhomë.

Unë nuk kisha guxim t'i afrohesha dhe aq më pak të ndalesha dhe të flisja me të. Fatkeqësisht ndonëse Enver Sylën ishte djalë i urtë, ai kishte kushërinj që ishin ishin të lidhur me pushtetin, madje edhe që punonin në polici, dhe kisha frikë se ai mund të fliste, pa qëllim të keq, me ndonjërin prej tyre dhe pastaj ata mund ta përcillnin lajmin te dhëndëri i tyre, Burhan Prishtina.

Pas këtij takimi të papritur dhe befasues për shkak të frikës nuk kam fjetur gjithë natën. A thua a me ka njohur se kush isha apo jo?

Kisha hyrë në javën e katërt të qëndrimit tim në spital, e megjithëkëtë mjekët asnjëherë nuk e shkruan me mua çështjen e lirimit tim nga spitali!

Çdo mëngjes shkoja në dhomën e trajtimit dhe mjekët ma pastronin plagën. Nga veshi e nxirrnin fashën e ndotur dhe në vend të saj e fusnin një fashë të pastër. Kjo praktikë e tyre, ishte mjaftë e bezdisshme. Kur e nxirrnin fashën nga veshi më dukej sikur ajo po kalonte tejpërtej nëpër kokë, nga veshi i djathë në veshin e majtë!

Nuk kalonte ditë pa më ardhur dikush për vizitë. Nganjëherë më vizitonin dy-tre vizitorë brenda ditës, por e mira në këtë ishte se pothuajse asnjëherë vizitorët nuk vinin të gjithë përnjëherë.

Selvete Grajçevci, që ishte studente e Fakultetit Juridik, më ka vizituar më së shpeshti. Atë e dërgonin daja Isë dhe i vëllai i saj Qamili kur nuk kishin mundësi të vinin vet. Por edhe ata vinin shumë shpesh. Pastaj mjaftë shpesh më kanë vizituar edhe Ferkiu e Mirvetja (Haliti) dhe shokë dhe të afërm të tjerë. Disa herë, pa lejen time dhe të shokëve, ka ardhur edhe babai im, të cilin kur e shihja m´i shtinte njëqind tutë në barkë. Kisha frikë mos po i vije ndonjë spiun prapa. Kur e "qortoja" se përse kishte ardhur, ai më arsyetohej dhe më thoshte se kishte dal nga vendi i punës dhe drejt e në spital dhe se kishte shikuar mos po i vije njëri prapa, por s'kishte parë njëri!

Një ditë më vije në dhomë Xhevat Durmishi, i veshur me mantel të bardhë. Xhevati ishte në vitin e pestë të Fakultetit të Mjekësisë. Ai hyri në dhomë dhe nisi t´i pyeste për shëndetin pacientët me radhë duke filluar me atë që ishte më afër dere. M'u afrua edhe mua dhe nisi të më pyet më gjerësisht se si po ndjehesha.

Unë e kuptoja se ç´brengë kishte Xhevati, që ishte vëlla i Xhaferit. E vërtetë ishte se unë isha shumë më mirë dhe kjo që po ia thosha Xhevatit nuk ishte vetëm përpjekje për t'ia hequr shqetësimin atij dhe familjes së tij.

Megjithëkëtë, Xhevati e lexoi një fletë nga raporti i mjekut që ishte në fund të krevatit tim dhe si duket nga ai e kuptoi më mirë se unë seriozitetin e gjendjes sime. Pas pak minutash Xhevati doli nga dhoma.

U gëzova shumë që e takova Xhevatin sepse e dija se ai do ta informonte edhe familjen e tij dhe kështu nëpërmjet të atit të tij do të merrte vesh edhe Sheremeti se si jam.

Kirurgu Hasan Jakupi, gjatë një vizite që ma bëri në dhomë, më kërkoi që të shkoja në zyrën e tij sepse dëshironte të fliste diçka me mua. Hasan Jakupi, që ishte një nga kirurgët që më kishte operuar, e merrja me mend se e dinte gjendjen time më mirë se kushdo tjetër, prandaj mezi prisja të shkoja dhe të flisja me të.

Shkova në zyrën e tij dhe Hasan Jakupi më thotë:

– Tani që more e vetën, ç'ke ndërmend të bësh?

– Duhet të dal diku jashtë vendi, ndoshta kaloj në Shqipëri,– i përgjigjem.

– Unë jam i mendimit të forcohesh edhe pak dhe të lajmërohesh në polici! Të dënojnë ndoshta disa vjet, por pas burgut kthehesh prapë në shtëpinë dhe vendin tënd. Po dole jashtë do të humbësh. Këtë e duan ata që të kërkojnë. Mos kalo në Shqipëri!

– Nuk mund të dorëzohem në polici. Kjo çështje nuk është aq e thjeshtë. Të faleminderit shumë për këshillat tua,– i thashë dhe u ndamë!

Unë e kuptoja se ç´më thoshte Hasan Jakupi, por unë dhe shokët kishim vendosur që të mos dorëzohesha dhe të largohesha nga Kosova për një kohë. Hasan Jakupi më njihte mua dhe tim atë qysh më parë. Ai shoqërohej me kushëririn tim Haqif Sadiku. E kuptoja se Hasani nuk dëshironte që unë të largohesha nga Kosova dhe për këtë arsye mendoja se nuk kishte asgjë të keqe kështilla e tij, përkundrazi ajo ishte shumë dashamirëse. Qëndrimi i tij ishte miqësor dhe i drejtë. Unë kisha shumë respekt për Hasanin dhe shokët e tij. Për mua Hasan Jakupi dhe Refik Ramku ishin heronjtë e mi dhe unë isha shumë krenar për ta dhe punën e tyre.

Një ditë mjeku më njoftoi se duhet të shkoja për një kontroll në Shkup. Më thanë se në spitalin e Prishtinës nuk mund të bëhej një kontroll i asaj natyre që mund të bëhet në Shkup.

Në mëngjes, me ambulancën e spitalit, së bashku me shoferin dhe një mjek u nisëm për Shkup. Në spitalin e Shkupit pritëm disa orë, por nga aty u kthyem pa kryer punë! Shoqëruesit e mi u hidhëruan shumë nga trajtimi përbuzës dhe jo human që na bënë mjekët e spitalit të Shkupit. Ata nuk na morën në dorë, ndonëse mjekët nga spitali i Prishtinës i kishin paralajmëruar se do t'i vizitonim. Mjeku që më shoqëroi, që nuk e njihja dhe që nuk ia mbaj mend as emrin, m'i tha këto fjalë pasi u kthyem nga Shkupi:

– Shko kah të duash, por mos harro se Prishtina, gjithmonë, do të ngelet Meka jote!

Unë e shikova me habi, por nuk i thashë gjë. Ndonëse e ndjeja vetën ateist dhe përqafoja mendimin shkencor të Karl Marksit se "*feja është opium për popullin"*, ashtu siç admiroja thënien e famshme të Pashko Vasës "*feja e shqiptarit është shqiptaria",* nuk mund të mos ndjeja admirim për një mjek shqiptar, që në rrethana shumë të vështira dhe dramatike në të cilat ndodhesha, po bënte krahasime të tilla. Ndonëse, nuk i kisha të drejtuar sytë as kah Meka e as kah Vatikani apo Athina, unë pajtohesha me mjekun se Prishtina ishte vend i shenjtë për mua, ashtu siç ishte për stërgjyshërit tanë të lashtë -Dodona, Mali i Tomorit e vende të tjera të kultit! Mua po më mahniste "këshilla" që po më jepte mjeku i Prishtinës. Ndoshta, thosha vetë me vete, se edhe ky ma di hallin? Zemra më lëshonte të rrahura pa pushim. Ç'njerëz të mrekullueshëm!

Një ditë, nga mjeku mësova se plaga ime ishte ende e hapur! Ky lajm më shqetësoj mjaft shumë. Ditët e javët kishin kaluar dhe nuk dija se kur do të mund të lirohesha nga spitali, por pas këtij lajmi, sikur dita e lëshimit nga spitali po ikte drejtë një date edhe më të panjohur. Më shqetësonte edhe çështja e kësaj dreq sëmundje, që dashka kaq shumë kohë për t'u dorëzuar ..! Vallë ç'është kjo sëmundje që nuk dorëzohet?

Disa ditë më vonë kirurgu Refki Ramku më thërret në zyrën e tij dhe më thotë:

– Ka katër javë që po luftojmë me sëmundjen tënde dhe ende nuk dimë se a je shëruar plotësisht nga infeksioni apo jo? Këtu në Prishtinë nuk kemi aparaturën nevojshme mjekësore që do të na duhej për një kontroll të tillë, kontroll ky që ti duhet ta bësh patjetër. Mua më duhet të të dërgoj në Beograd,– më tha mjaftë i shqetësuar kirurgu Ramku!

Sapo mbaroi kirurgu Refki Ramku, unë reagova menjëherë:

– Jo, nuk dua të shkoj në Beograd. A ka mundësi të më dërgosh në Zagreb, Lubjanë apo diku tjetër?– e pyeta mjekun.

– Më vjen keq, por unë nuk kam të drejtë të të dërgojë as në Zagreb, as në Lubjanë dhe as diku tjetër. Kështu i kemi rregullat. Ne kemi urdhër t'i udhëzojmë pacientët në Beograd. Në spitalet tjera mund t'i udhëzojmë pacientët vetëm nëse Beogradi nuk ka mundësi pranimi! Por ti nuk ke nevojë të shqetësohesh. Ke parasysh se mjekët në Beograd nuk dinë se kush je. Po të ishe ndonjë figurë e njohur edhe unë do të kisha frikë dhe mundësisht nuk do të dërgoja në Beograd, por ata të dinë si punëtor dhe të shikojnë pa hile,– më dha mbështetje kirurgu Refki Ramku.

Shpjegimi i mjekut ma ktheu mendjen dhe u pajtova të udhëtoja për Beograd.

Të nesërmen, në mëngjes, kirurgu Refki Ramku dhe një infermiere po ma shikonin plagën dhe po më përgatitshin për udhëtim që ishte menduar të realizohej nesër. Refki Ramku i thoshte infermieres:

– Lidhja plagën mirë se ata në Beograd do të thonë: *Eto propala republika*"[16]!

Unë e shikova me habi dhe Refki Ramku sikur ta kuptonte se ç´po më ziente koka më thotë:

– Edhe kjo është me ne!

Çka t'i përgjigjesha? Mendja më iku tek Zeqir Sadria, Enver Maxhuni, Burhan Prishtina, Faruk Mehmeti dhe suita e tyre kriminale. Në vesh më tingëllonin fjalët e tyre se "ata dinë gjithçka" se ne nuk kishim përkrahjen e popullit dhe dokrra të tjera udbeske. Vallë çdo të bënin udbashët se unë gjendesha në spitalin "tim" dhe në mesin e njerëzve të mi,- pyeta vetën? Mora frymë thellë dhe u ngrita nga shtrati dhe falënderova mjekun për ndihmën. Dola nga dhoma e kontrollit dhe ika në dhomën time. Zemra më ishte bërë mal!

Në mëngjesin e ditës së nesërme së bashku me dajën Isë dhe shoferin e ambulancës jemi nisur për Beograd.

Pas disa orësh udhëtimi arritëm në Beograd. Daja Isë dhe shoferi e kanë paraqitur arritjen tonë në sportelin e Spitalit të Neurokirurgjisë në Beograd. Personeli mjekësor që kishte detyrë pranimin e pacientëve të rinj më dëshiroi mirëseardhje! Një burrë rreth të dyzetave dhe me një trup rreth dy metrash gjatësi, i cili u prezantua se ishte mjek me përkatësi etnike malazeze dhe më origjinë nga Kosova, mori udhëzimin mjekësor dhe e lexoi. Pas pak ma kërkoi letërnjoftimin. Unë iu përgjigja se letërnjoftimin nuk e kisha me vete dhe se gjoja atë e kisha harruar në spitalin e Prishtinës! Pas disa hezitimesh dhe pasi e lexojë edhe njëherë udhëzimin mjekësor dhe diagnozën, mjeku i pranimit u pajtua që të më pranonte në spital edhe pa letërnjoftim. Ma lëshoi një shkëndijë "humanizmi" me një:

– Ajde jadni Shabane, ocu da te primim ovog puta, ali drugog puta nemoj da dodes u Beograd bez licnekarte!!!"(Eja Shabani i gjorë, po të pranoi kësaj radhe, por herëve të tjera mos eja në Beograd, pa letërnjoftim).

Unë, daja Isë dhe shoferi e falënderuam për pranimin tim! Menjëherë pas pranimit tim në spital, u përshëndeta me dajën Isë dhe shoferin të cilët u kthyen për Kosovë. Ndërsa unë ngela i vetëm në Beograd, tashmë i çarmatosur, pa letërnjoftim dhe vetëm me një udhëzim mjekësore dhe diagnozën që ishte shumë e gjatë por që niste me *Cerebellum...*[17] dhe vazhdonte me një fjali të tërë që unë se kuptoja asnjë fjalë.

Në spitalin e Beogradit, në repartin e neurokirurgjisë, më vendosën në një dhomë me dy pacientë. Njëri nga pacientët ishte serb nga Beogradi dhe quhej Zoran, ndërsa tjetri ishte boshnjak nga rrethi i Novi Pazarit dhe quhej Enver. Të dy ishin me diagnozë kanceri. Zorani, që si dukej ndjehej shumë i dëshpëruar për diagnozën e tij, dëgjonte muzikë serbe me zë deri në kupë të qiellit. Edhe Enveri mërzitej shumë për sëmundjen që kishte. Mua më vinte keq për ta, sepse të dy ishin të rinj me moshë, rreth të tridhjetave.

Të nesërmen, gjersa po rrinim në dhomë, pacienti serb me pyet:

– A po vijnë refugjatë nga Shqipëria?!

Ç´t'i përgjigjesha?! Unë nuk isha i interesuar fare të përgjigjesha në pyetje të tilla dhe që mund të zgjonin kureshtjen e pacientit nga Beogradi. Pastaj, ku ta dija se kush ishte, se a ishin me të vërtet pacient apo jo?

– Unë jam fshatar dhe kam shkuar në shkollë vetëm tetë vjet,– i përgjigjem Zoranit. Familja ime ka shumë tokë dhe ne kemi një traktor dhe merremi me bujqësi. Në fshatin tonë nuk ka refugjatë nga Shqipëria, po të gjithë banorët jemi vendas. Unë nuk di ma shumë. Im atë më ka thënë se nuk bënë të merresh me politikë, – dhe nxora nga xhepi i këmishës një tubë me letra njëmijë dinarësh dhe ua tregova shokëve pacientë që kisha në dhomë.

Zorani më shikoi e m'i rrahu krahët me dorë dhe më tha:

– Imash pametnog oca..."[18] !

Enveri nuk fliste gjë. Ai vetëm dëgjonte.

Në një rast, kur Zorani nuk ishte në dhomë, Enveri filloi ta shante Zoranin dhe të gjithë serbët! Qëndrimi i tij nuk më pëlqeu. Unë kisha hallin tim dhe nuk dëshiroja të flisja me asnjërin për asgjë tjetër pos për "shëndetin"! Më vinte keq për "vëllanë" nga Novi Pazari, të cilit pushtuesit serbë ia kishin humbur identitetin kombëtar dhe gjuhën e të parëve të tij, por unë nuk mund të flisja! Me Enverin, në rrethana të tjera, me gjithë qejf do të kisha biseduar dhe do t'i kisha thënë se unë jam vëlla i tij dhe se nëpër dejtë e tij ashtu si edhe në të mijat rrjedh gjak ilirë. Do t'i kisha thënë se unë kisha dëgjuar nga im atë dhe kisha lexuar se e gjithë krahina e Tregut të Ri deri vonë kanë folur shqip dhe burrat deri vonë kanë mbajtur qeleshe të bardhë... Por kësaj radhe më duhej ta dëshpëroja atë duke heshtur dhe duke i thënë me heshtjen time se jam krejtësisht i pa interesuar për ato gjëra që ai ishte duke folur. Në anën tjetër nuk më pëlqente edhe sharja e Zoranit, prapa shpine. Unë nuk kisha asgjë kundër Zoranit dhe përkatësisë së tij etnike. Popullin serb dhe qeveritë serbe nuk i kisha futur asnjëherë në një thes. Unë as shokët e mi nuk kishim asgjë kundër serbëve të Kosovës e as atyre të Serbisë. Ne ishim kundër politikës serbomadhe të Beogradit. Unë isha me mendimin e Leninit dhe e mbaja mend një mendim të tij shumë të drejtë se "*Një popull që shtyp popujt tjerë, as vet nuk është i lirë".* Serbët nuk janë të lirë përderisa mbështesin politikën serbomadhe të udhëheqjes së tyre. Nuk ka Serbi të lirë pa Kosovë të lirë apo nuk ka Jugosllavi të lirë pa Kosovë të lirë dhe të barabartë me Republikat tjera!

Ditën e dytë dola nga dhoma dhe u shëtita nëpër korridor si dhe qëndrova në një restorant që ndodhej në kuadër të spitalit.

Dukej qartë se spitali ishte shumë modern dhe i një cilësie tjetër nga ai i Prishtinës. Kjo ishte një mrekulli, por mua më dhimbeshin pacientët nga Kosova që nuk kishin një spital të tillë dhe duhej të vinin për mjekim kaq larg!

Nëpër hapësirën e një vendi për vizitorë, pashë shumë pacientë që kishin kaluar nëpër operacione të ndryshme, disa me kokë të mbështjell me fasha të bardha edhe disa të tjerë me shenja të plagëve nëpër kokë dhe flokë të rruara. Një fotograf, që bënte fotografi të shpejta, m'u ngjit dhe dëshironte gjithsesi të

bëja një fotografi. Unë u pajtova të fotografohesha, ashtu si isha me kokë të lidhur me fashë të bardhë dhe sapo ia pagova paratë ma lëshoj në dorë një fotografi që e nxori nga aparati i tij. Tani u bëra edhe me fotografi,-thosha vetë me veti.

Ditën e tretë më thirren në kontroll dy mjekë specialistë. M´i bënë disa prova të drejtpeshimit dhe të prekjes së majës së hundës me gishtin tregues, sy mbyllur. Në fund, pasi mbaruan punë, njëri nga mjekët i tha shokut të tij:

– *Oni su alla specialisti!*[19]

Mjekët u konsultuan në mes veti më thanë se nuk kisha asnjë të keqe dhe se duhet të kthehesha në Prishtinë.

Ky vendim i mjekëve beogradas, për mua nënkuptonte se kisha udhëtuar kot së koti deri në Beograd. Kontrolle të tille, madje edhe më të mira se këto të specialistëve në Beograd, më kishin bërë mjekët e Prishtinës.

Menjëherë shkova dhe u përshëndeta me pacientët e dhomës dhe ju dëshirova shëndet në të ardhmen. U vesha, dola para pasqyrës e shkova në recepcion dhe e kërkova dokumentin e fletë-lëshimit nga spitali.

Pas disa orësh mora autobusin Beograd-Nish. Në autobusë unë dallohesha se isha pacient. Kokën e kisha të lidhur me fashë të bardhë dhe kjo më krijonte mjaftë siguri...

Në Stacionin e Autobusëve në Nish isha duke e pritur autobusin për Prishtinë. Duke pritur, një udhëtar, që gjithashtu po priste edhe ai autobusin, m'u afrua dhe së pari më pyeti për shëndetin në gjuhen serbe. Sapo mori përgjigje nga unë, si duket për shkak të gjuhës, e kuptoj se isha shqiptar. Ai nisi të flet shqip dhe më tregoi se ishte romë nga Prishtina.

Pas disa orësh udhëtimi nëpër Prokuple dhe Kushumli, arritëm së bashku me mikun tim të ditës në Prishtinë. Para se të ndaheshim dhe të nisesha për spital, mora shumë urime për shëndet nga bashkudhëtari im.

Nga Stacioni i Autobusëve në Prishtinë e mora një taksi dhe shkova deri në Spital. Aty e takova një mjek kujdestar të cilit ia dorëzova fletë-lëshimin nga spitali i Beogradit. Mjekut i tregova se ç'lloj kontrolli më bënë mjekët në Beograd dhe se ç'i kisha dëgjuar ata duke folur gjatë kontrollimit që më bënë. Mjeku i hipi tensioni i gjakut dhe më tha të shkoja në shtëpi dhe të lajmërohesha përsëri nesër herët në mëngjes në spital.

Përshëndetja me njerëz të dashur

Nga Spitali i Prishtinës e mora një taksi dhe pak pa ra terri arrita në Hade. E luta taksistin të ndalej në hyrje të fshatit dhe pasi zbrita nga makina u nisa në drejtim të brendisë së fshatit. Nga aty, kalova nëpër fshat dhe zbrita poshtë në një rrugicë që do të më shpinte nën shtëpinë e dajës Isë. Më duhej të mos kaloja afër shtëpisë së dajës Salih. Kisha frikë se po takoja ndonjë njëri gjatë rrugës do të më njihte, ndonëse mbaja një fashë të bardhë në kokë e bardhë?!

Hyra në oborr të shtëpisë së dajës Isë dhe trokita në derën e shtëpisë. Kur më panë se u ktheva u gëzuan të gjithë. Dajës Hajrë nga gëzimi ju mbushën sytë me lot.

– Kur mora vesh se të kanë dërguar në Beligrad, e pata humbur besimin se do të na ktheheshe i gjallë,– më tha daja Hajrë dhe i fshiu lotët.

Të nesërmen, Qamili ka ardhur me makinën e tij më ka dërguar përsëri në Spitalin e Prishtinës.

Pas kontrollimit që më kanë bërë mjekët më kanë thënë se gjithçka është mirë dhe se sipas mendimit të tyre sëmundja është mundur. Ata m'i hoqën penjtë nga plaga dhe më thanë që përsëri të lajmërohesha për një kontroll pas një jave. U përshëndeta me mjekët dhe u ktheva përsëri në Hade.

Tek daja Isë dhe Hajrë (ata jetonin ende së bashku) i bëmë disa fotografi që t'i kemi si kujtim. Gjithashtu tek daja Isë e kam lënë edhe një fotografi që e pata bërë në Beograd, ku unë e kisha të mbështjell kokën me një fashë të bardhë.

Po atë mbrëmje pata biseduar me Selveten që të më ndihmonte për të rënë në kontakt me Bedri Selmanin në Mitrovicë. Asaj ia pata dhënë numrin e telefonit të shtëpisë së Bedriut. Ditën e nesërme, Selvetja më njoftojë se kishte biseduar me Bedrin dhe ia kishte lënë porosinë.

Ditën e tretë apo të katërt jam larguar nga shtëpia e dajës Isë. Familjes së dajës Isë u premtova se do të kthehesha sërish një natë tjetër para se të merrja udhën e përtej bjeshkëve!

***

Në mbrëmje jam kthyer sërish në Gllavotinë. Sheremetit dhe Elhames ju mbushën sytë me lot nga gëzimi, kur më panë pas njëzet e gjashtë ditësh qëndrimi në spital. Më thanë se vazhdimisht ishin njoftuar për gjendjen time shëndetësore, por tani ndjeheshin shumë të lumtur që po më shihnin të shëruar dhe të ringjallur.

I gëzuar që po më shihte përsëri në këmbë, Sheremeti, nisi të më tregoi:

– Unë e kisha humbur fare shpresën se do ta mbijetoje sëmundjen. Vetëm prisja se kur do të marrë "ora e ligë". Madje kisha bërë plan që nëse vdes të të varros në oborr të shtëpisë sime!

Unë nuk mund ta mbaja vetën dhe fillova të qesh, ndërsa Sheremetit iu mbushën serish sytë me lot.

– Unë për vete se kam pasur ndërmend të vdes,– i thashë Sheremetit, i cili më shikoi me habi dhe dhe m'u bashkua në të qeshurën time.

Sheremetin e kam njoftuar se po afrohej dita e përpjekjes për largim nga Kosova.

Atë mbrëmje Sheremeti më ka njoftuar se si një ditë gjersa po kalonte afër shtëpisë së *Hoxhës së Vogël*, mbi shkollë të Gllavotinit dhe afër një gardhi e gjen *domarin* (mirëmbajtësin) e shkollës, Hajdar Miftarin, duke shikuar në drejtim të shtëpisë së *Hoxhës së Vogël*. Meqë Hajdar Miftari zihet ngusht, Sheremeti e pyet se ç'ishte duke shikuar në drejtim të shtëpisë së *Hoxhës* dhe Hajdar Miftari i përgjigjet: Më kanë thënë me ruajt dhe me shikojë se mos po vjen djali i Beh Mihaliqit, te Hoxha..

Sheremeti më tha: E dija se është një informator ai Hajdar m...

Është interesant të theksohet se Hajdar Miftari nga Beçuku është nip i Zhilivodës dhe tezak i Xhevat H. Bajramit!

Të nesërmen , në afërsi të Bivolakut jam takuar me Ferkiun. Edhe kësaj radhe si zakonisht ai erdhi me kohë në takim. U përqafuam me mall të madh. Ferkiun e njoftova se si kisha kaluar në Beograd dhe se çka më kishin thënë edhe mjekët në Prishtinë. Gjithashtu e njoftova edhe për shëndetin tim dhe se ndjehesha mirë dhe i përtërirë.

Gjatë takimit Ferkiu më ka njoftuar për gjendjen dhe zhvillimet lidhur me mundësinë e largimit nga Kosova:

– Behxhet Ahmeti ka udhëtuar në Turqi dhe e ka rregulluar çështjen e pasaportës. Atje ai i ka lënë dy fotografi. Në shtëpinë e Sabri Novosellës e kishte harruar letërnjoftimin dhe ishte shqetësuar pak, por i thash të mos shqetësohej për këtë. Këto ditë ai duhet ta merr pasaportën nga njeriu i shokëve të Lëvizjes. Ne mendojmë se nuk duhet pritur shumë dhe duhet bërë përpjekje për largimin tënd nga Kosova. Nuk duhet harruar se UDB-a nuk është dorëzuar në përpjekjet e saj për prangosjen tënde. Edhe pas lirimit të Vehbi Mujës dhe shokëve të rrethit të tij, ajo po punon për të ra në gjurmë. Enver Maxhuni dhe Zeqir Sadria nuk janë duke lënë gur pa lëvizur për të të gjetur, por edhe për ta thyer familjen tënde, ndaj të cilës është duke u bërë presion i madh. Behës po i thonë udbashët dhe njerëzit e tyre se "dorëzimi i Asllanit nuk paraqet asnjë rrezik për të dhe të ardhmen e tij! Shokët e tij i kemi liruar dhe me Asllanin i kemi vetëm dy-tri fjalë! Se Asllani nuk ka nevojë të largohet e të humbet nga Kosova e të tjera përralla udbeske".

Me Ferkiun morëm vesh që unë t'i kontaktoja të gjitha shokët dhe të përshëndetesha me ta. Gjithashtu, unë duhet t'i përgatisja shokët se me cilin do të mbanin lidhje pas largimit tim. Ferkiu do të punonte me tim vëlla, Shabanin,

dhe do ta përdorte atë për të mbajtur lidhje me disa nga shokët që gjer me tani kisha mbajtur lidhje unë. Me Ferkiun u morëm vesh se kur do ta takoja edhe Xhemën, pak para largimit tim.

***

Shtëpia e parë që do ta vizitoja para se të largohesha nga Kosova ishte shtëpia e Mustafë Majacit (i ati i Xhafer Durmishit). Kalova nga Gllavotini nëpërmjet urës së Silnicës afër Prelluzhës. Aty e vazhdova rrugën pranë brigjeve të Silnicës, nëpër rrafsh, gjersa e kalova hekurudhën dhe dola në *libar*. Pasi kalova nëpër arat me të të mbjella arrita tek Lagja e Durakëve dhe e kalova urën mbi Llap. Nëpër rrugica kalova deri tek shtëpia e Mustafë Majacit.

Fatmirësisht dera e oborrit qëlloi e hapur dhe u futa brenda në oborr. Trokita lehtë në derën e odës dhe nga oda doli baca Mustafë i cili u gëzua shumë kur më pa. Më futi në odë, por pas pak më tha të shkojmë në shtëpi sepse druante se mos po vinte ndonjë mysafirë i papritur. E ëma e Xhafës, Habibja, u gëzua kur më pa. Ajo më tha:

– Sa mirë bëre, që erdhe edhe tek ne! Kur të pashë, u gëzova, sikur të më kishte ardhur Xhaferi!

Gjatë qëndrimit në shtëpinë e Mustafë Majacit, Xhevati më bëri një kontroll të veshit dhe ma nxori nga veshi një fashë, që ende kishte ngelur aty, dhe që mjekët do të ma hiqnin në vizitën e planifikuar të pas disa ditëve.

Të nesërmen, u përshëndeta me familjen e Xhafës. Deri afër rrugës automobilistike Vushtrri- Prishtinë, që ishte sipër arave, më përcolli baca Mustafë.

Nga aty, kalova në Stanofc të Epërm tek Bahtir Haradinaj, i cili fatbardhësisht qëlloi në shtëpi dhe menjëherë më urdhëroi të hyja në dhomën e miqve. Ky ishte takimi ynë i parë pas disa muajsh. U gëzuam shumë që u takuam përsëri. Bahtiri, kishte dëgjuar se policia ma kishte rrethuar shtëpinë, por nuk dinte asgjë tjetër dhe më kishte pritur se do ta kontaktoja.

Dikur pasdite, u kthye nga puna i vëllai i tij, që nuk më njihte se kush isha. Bahtiri më prezantoi se isha shok i studimeve. Gjatë bisedës, i vëllai i Bahtirit nisi të na e tregonte historinë e rrethimit të shtëpisë sime, që kishte dëgjuar nga një shok i tij:

– Një shok në punë më ka treguar se policia dhe ushtria e kishin rrethuar në tre rrathë një student në fshatin Mihaliq! Përkundër rrethimit, studenti kishte arritur ta çante rrethimin! Ai, sipas shokut, kishte lidhje me Shqipërinë!

Unë dhe Bahtiri i lëshuam një shikim të shpejtë njëri-tjetrit.

– Nuk besoj se e kanë rrethuar në tre rrathë! I rrisim gjërat ne nganjëherë. Nuk besoj se ai Studenti paska lidhje me Shqipërinë?! Edhe kjo duhet të jetë propagandë e UDB-ës,– i thashë vëllait të Bahtirit!

Gjatë qëndrimit në shtëpi të tij, Bahtirin e njoftova për planet që kisha dhe se ndoshta, për një kohë, ky do të jetë takimi ynë i fundit. Bahtir Haradinaj më

përcolli nga fshati. Para se të ndahemi, i nxori nga xhepi dyzetë marka gjermane dhe m'i dha, me zor!

Pas përshëndetjes me Bahtirin u nisa në drejtim të fshatit Dumnicë e Ultë, ku e kishte shtëpinë Shyqyri Imeri. Atë ditë, deri pasdite qëndrova tek Shyqa. I ati tij, baca Emin më priti shumë mirë. Nuk i fola asgjë për hallin që kisha, sepse nuk kisha dëshirë ta shqetësoja se me kë po i shoqërohej i biri.

Gjatë qëndrimit deri pasdite vonë, Shyqën e njoftova me planet që kisha. Atë e njoftova se pas largimit tim nga Kosova, shokët e Lëvizjes do ta kontaktojnë dhe se së bashku me ta ai do ta vazhdon veprimtarinë që e kishim nisur së bashku.

Më përcolli deri në fund të fshatit dhe pastaj unë ika në drejtim të shtëpisë sime, që kishte tre muaj që nuk e kisha vizituar.

Duke u kthyer nga Shyqa e duke kaluar lumin Silnicë, që ishte rritur dhe kishte dal nga shtrati, pas shirave të mëdha të atyre ditëve, në ujë më bie revolja që e kisha më vete. Revolja më ra nga brezi gjatë përpjekjes që bëra për t'i përvjel pantallonat. Ajo ishte e nipit tim, Idriz Selmani. Pas shumë përpjekjeve dhe një kërkimi të gjatë, e gjeta në fund të ujit. Ia fshiva ujin dhe e futa përsëri në brez dhe i lëshova një të sharë trupit tim që më ishte bërë vetëm asht e lëkur dhe që nuk m'i mbante pantallonat e le më këtë revole kaq të rëndë!

Në fushën pranë lumit Silnica, në mes lumit dhe Hekurudhës Mitrovicë-Fushë Kosovë, qëndrova derisa nis të errësohej dhe po e vështroja nga larg fshatin tim të dashur dhe Qyqavicën legjendare që i rrinte fshatit si kurorë. Pothuajse të gjitha arat e mbjella me grurë ishin korrur. Misri ishte rritur sa të mbulonte.

***

Para muzgut u nisa në drejtim të Mihaliqit tim të dashur. E kalova rrafshin dhe hekurudhën dhe ju ngjita kodrës përpjetë. Pas pak dola tek udhëkryqi pranë varrezave të fshatit. Isha i veshur me rroba të punëtorëve të Termocentralit Kosova, që kishin ngjyrë të kaltër dhe e mbaja një kapele të zezë (beretë). Mbaja edhe syze dielli të errëta për çdo të papritur, por edhe shikoja me kujdes mos po hetoj ndonjë njeri, me qëllim që t'u shmangem takimeve me ndonjë bashkëfshatar timin. Kur arrita tek shtëpia e xha Lifit, dëgjova tupanin që po binte në Stanofc të Ultë dhe e kuptova se ishte kohe e *iftarit*. Ma merrte mendja se në atë kohë shumica e njerëzve ishin ulur pranë sofrave dhe po hanin darkën dhe se asnjërit nuk i shkonte mendja të shikonte se kush po lëvizë nëpër rrugën e fshatit. Ndoshta edhe *spiuni* që kishte për detyrë ta përcillte shtëpinë time në atë kohë ishte i zënë,– pyeta vetën time. Vazhdova të ecja me të shpejtë nëpër rrugën kryesore të fshatit dhe shumë shpejtë arrita para dyerve të oborrit. Jam kacavjerrë mbi dyert e oborrit dhe kam hy brenda në oborr. Syzet më ranë dhe u thyen. U ofrova afër shtëpisë dhe nga jashtë i pashë se ishin duke ngrënë darkën dhe se së bashku me ta ishte edhe nipi ynë, Idriz Selmani. Nuk vonoj shumë dhe Shabani doli jashtë në oborr. U përqafuam me njëri-tjetrin dhe më tha të futesha në dhomën e fjetjes.

Takimi me nënën, Skënderi, motrat dhe Idrizin ishte mjaftë i prekshëm. U përqafuam me njëri-tjetrin dhe u gëzuam shumë që po shiheshim pas rreth tre muajsh dhe pas gjithë atyre ngjarjeve që në njëfarë mënyre na kishin prekur të gjithëve.

Nuk vonoi shumë dhe e kuptova se nëna ishte në dijeni për gjendjen time shëndetësore. Ajo fliste më mua dhe nuk m'i ndante sytë. Pas pak, ajo më luti ta ktheja pak kokën, në mënyrë që ajo të më shikonte se, a më ishte mbyllur plaga prapa veshit.

Më vinte keq për të gjitha shqetësimet që i kisha krijuar! I thosha se isha mirë dhe se nuk kishte arsye të shqetësohej për shëndetin tim. Kisha përshtypjen se ajo vazhdonte të ishte shumë e shqetësuar dhe e përfshirë nga një ankth i madh.

Gjatë gjithë kohës sa kam qëndruar në shtëpi, dikush nga familja ka qëndruar në oborr dhe ka shikuar mos po i afrohet ndokush shtëpisë sonë.

Meqë *Rrema*[20] dhe *Nushi*[21] ishin shumë të vegjël dhe unë kisha frikë se ata mund të flasin me ndonjë bashkëmoshatarë të tyre, më duhej t'i shmangesha takimit me ta.

Megjithëkëtë ata kishin diktuar se dikush po fshihej në dhomën e gjumit ku po qëndroja unë. Gjatë një dalje të nënës nga dhoma ku qëndroja unë, *Nushi* kishte bërë përpjekje për t'u futur në dhomë. Nëna e kishte penguar të futet në dhomë, por kjo si duket vetëm se e kishte shtuar edhe më shumë kureshtjen e *Nushit* për t'u futur në dhomë dha ai ju kishte drejtuar nënës:

-Ju po hani diçka aty brenda në dhomë...?

Në atë rast nëna e kishte pyetur se çka kishte dëshirë t'i jepte për të ngrënë, por kjo se kishte ndihmuar. Megjithëkëtë *Nushi* ishte shumë këmbëngulës dhe dëshironte të hynte gjithsesi në dhomë.

Pas pak, nëna hyri brenda dhe më njoftoi se, *Nushi* ishte këmbëngulës dhe dëshironte patjetër të hynte në dhomën ku ishim ne. Atëherë u morëm vesh që nëna të vinte së bashku me *Nushin* në dhomë dhe të qëndronte në dhomë disa minuta, ndërsa unë të qëndroja i fshehur në një dollapë rrobash në dhomë. Kështu edhe bëmë.

Mirëpo ditën e nesërme, *Nushi*, u fut në dhomën e ditës, krejt papritur dhe ballafaqimi me njëri-tjetrin na befasoi të dyve. *Nushi* u befasua aq shumë sa kur më pa se unë kisha lëshuar mustaqe e ktheu kokën në drejtim të derës dhe iku andej nga kishte ardhur. Unë përfitova nga rasti dhe u fsheha prapa një muri që e ndante dhomën e ditës dhe kuzhinën.

Për ta mashtruar *Nushin*, *Skënda*[22] i futi gishtërinjtë në hi dhe ngjyrosi një parë mustaqe dhe i doli *Nushit* në korridor për ta mashtruar se gjoja kishte qenë *Skënda* që kishte qenë dhomë kur *Nushi* e kishte parë me mustaqe dhe jo ndonjë tjetër! *Skënda* më tha pastaj se *Nushi* nuk e kishte pranuar asnjëherë se kishte qenë *Skënda*, por i kishte thënë se ai që e kishte parë kishte qenë *Cani*.[25]

Gjatë qëndrimit në shtëpi nëna ma tregoi një histori të sjelljes së Enver Maxhuni ndaj saj, mëngjesin e 7 prillit 1983, pas hyrjes brenda në shtëpi:

– Çfarë shqiptari i pashpirt ishte, Enver Maxhuni!? Ma tregonte revolen dhe më thoshte se "me këtë revole dhe dorë kam me ta vra Asllanin, sapo ta gjej!"

Nëna lëshoi një frymë të thellë dhe nuk tha tjetër gjë.

Gjatë bastisjes së shtëpisë, Enver Maxhuni i kishte kërkuar nënës që t'ua gatuante një kryelanë dhe nëna ju kishte përgjigjur:

– Ty ta kisha gatuar një kryelanë me zeher!

Nëna ime më ka treguar gjithashtu se menjëherë pas largimit tim nga shtëpia dhe gjersa policia gjendej ende në rrugë para dyerve të oborrit, ajo ishte ofruar afër avllisë dhe në rrugë e kishe parë Xhevat. H. Bajramin, i cili çuditërisht atë mëngjes mbante kapuç të bardh në kokë! Nëna më tha se Xhevat H. Bajrami kishte ardhur nga shtëpia e tij dhe kur ishte ofruar afër shtëpisë sonë u kishte thënë policëve:

– Pse s'po e lini rehat, djalin?! A e dini, se nuk në katund nuk ka djalë ma të mirë se Asllani!

Kështu, "burrërisht" kishte folur edhe Hasan Mustafa atë mëngjes kur "rastësisht" kishte hasur në polici tek dyert e oborrit tonë!

Ardhja e Xhevat H. Bajramit me kapuç të bardhë në kokë ditën e rrethimit dhe kërkimi i tij për të më takuar dy-tre ditë para se të më rrethonte policia, fliste vetë se kjo sjellje e fqinjit tim ishte shumë e çuditshme dhe e dyshimtë.

Shabani më ka treguar edhe dy ngjarje interesante ato ditë sa qëndrova në shtëpi:

– Shefi i UDB-ës në Mitrovicë, Faruk Mehmeti, në përpjekje për të rënë në gjurmë, niset tek shtëpia e burrit të hallës sime, Bahtir Selmani në lagjen e Bajrit. Meqë merr vesh se Bahtir Selmani ndodhej në fshatin Cërrnushë, kryeudbashi e merr me vete edhe zagarin e tij Sylejman Arifi dhe ngjitet përpjetë deri në fshatin Cërrnushë. Pasi arrin tek shtëpia e vendlindjes së Bahtir Selmanit, e pyet njërin nga anëtarët e familjes, që ka qëlluar aty, se ku ndodhej Bahtir Selmani dhe nga ai merr vesh se Bahtiri ishte tek *Livadhi i Ukut*. Farku Mehmeti dhe Sylejman Arifi bëjnë një shëtitje nëpër ahishtë, deri poshtë në Gjytet dhe pastaj kthehen nëpër qarrishtë dhe rrotull e dalin tek *Livadhi i Ukut.*[23]

Sipas Shabanit, në rastin e takimit të shefit të UDB-ës dhe këlyshit të tij me Bahtir Selmanin është zhvilluar ky dialog:

– Bahtir, na ndihmo ta gjejmë Asllanin! Nuk po na duhet shumë, vetëm pak punë kemi me të dhe pastaj e lëshojmë, – i thotë Faruk Mehmeti.

Bahtir Selmani e lëshon një të qeshur dhe ju përgjigjet udbashëve:

– Unë po e kuptoi se po të duhet jo pak por shumë, sepse për pak nuk ishit ngjitur deri këtu, por fatkeqësisht unë nuk mund t'ju ndihmoi, sepse nuk e di se ku ndodhet.

Faruk Mehmeti dhe spiuni i tij e kishin ulur kokën dhe ishin larguar që andej.

Ngjarja tjetër, kishte të bënte me Shabanin. Dy ditë para se të rrethohej shtëpia, Shabani kishte qenë duke shkuar në Prishtinë. Gjersa po e priste autobusin në Obiliq, i ofrohen dy persona të panjohur dhe e kapin për krahu. Shabani i pyet njerëzit e panjohur se kush ishin dhe pas këmbënguljes së tij që të mos vazhdonte të ecte kah e urdhëronin, ata i thonë se janë policë dhe e urdhërojnë që të vazhdonte të ecte në drejtim të Stacionit të Policisë në Obiliq. Arrijnë në Stacionin e Policisë dhe e vendosin në një dhomë. Aty e marrin në pyetje dhe e mbajnë deri në mbrëmje!

Ky lajm, po ma shtonte bindjen se UDB-a ka qenë në kërkimin tim qysh para 7 prillit 1983 dhe, sipas të gjitha gjasave, ky kidnapim i Shabanit është bërë gabimisht, duke më kërkuar mua!

Pak orë para se të largohesha nga shtëpia pata një bisedë në katër sy me prindërit e mi. Atyre u fola për planet që kisha. I njoftova se do të bëja përpjekje për t'u larguar nga Kosova. Gjithashtu, i pyeta se çfarë mendimi kishin për këtë çështje? Ata ishin të një mendje me mua dhe kjo më gëzoj shumë.

Nënës ju afrova dhe e përqafova.

– Gjithçka do të rregullohet,– i thashë.

– Në dorë të Zotit! – u lut nëna dhe mori frymë thellë.

Më në fund erdhi edhe çasti i përshëndetjes me anëtarët e familjes. U përqafova me të gjithë. U thashë t'i përqafojnë dhe puthin në të dyja faqet edhe Rremën dhe Nushin, në vendin tim. Gjithashtu, i inkurajova që të bëhen të fortë sepse një ditë do të kthehem dhe se liria do të vijë patjetër edhe në Kosovën tonë.

Shabani doli nga oborri i shtëpisë, shikoi mirë rreth shtëpisë se mos kishte ndonjë njëri dhe u kthye dhe më tha të ecim dhe ne dolëm nga oborri. E kaluam rrugën dhe përroin dhe u ngjitëm *batallakut* përpjetë, afër e përkrah, *Sokakut Qorr*. Para se të ndaheshim, Shabanit i thashë që t'i vazhdonte kontaktet me Ferkiun...Diku kah mesi i *batallakut* u ndalëm me Shabanin dhe i thashë që ai të kthehej. U përqafuam shumë me njëri-tjetrin dhe u ndamë.

Shabani u kthye në shtëpi, ndërsa unë vazhdova rrugës përpjetë. Para se të hy në pyll e ktheva shikimin kah shtëpia ime dhe po e shikoja... Pas pak çastesh ika dhe u futa në pyll. Diku pas një gjysmë ore arrita në folenë time, tek Sheremeti në Gllavotinë/Bivolak.

***

Ishte fillimi i korrikut. Vera kishte ardhur me të gjitha të mirat dhe natyra kishte marrë një pamje të mrekullueshme. Atë ditë isha në shtëpi të Sheremetit dhe mezi po prisja të vinte nata e ta takoja shokun tim të dashur Bedri Selmani. Bedriut i kisha çuar fjalë ta merrte trenin e fundit nga Mitrovica dhe të zbriste nga treni në Plemetin. Aty i kisha dhënë fjalën se do ta prisja.

Pas orës dhjetë të natës dola nga shtëpia e Sheremetit. *Parabellin* e futa në brez e u nisa në drejtim të Stacionit të Trenit në Plemetin. Nga Gllavotini kisha rreth gjysmë ore udhë.

Treni erdhi me kohë dhe Bedri Selmani zbriti nga treni. Prita gjersa u larguan udhëtarët në drejtimet e tyre dhe eca në drejtim të qendrës së Stacionit të Trenit. Bedriu më pa se ku isha dhe u nis drejtë meje. U përqafuam me mall të madh dhe u larguam nga Stacioni i Trenit afër vijës hekurudhore. Aty gjetëm një vend të përshtatshëm, u ulëm dhe nisëm takimin tonë.

Bedriu, ishte nja pesë-gjatë vjet më i ri nga unë dhe e kuptoja se ajo që më kishte ndodhur mua i kishte shkaktuar shqetësime edhe atij dhe shqetësimi ishte rritur edhe më shumë meqë ai nuk ka ditur se ku ndodhem dhe se a do të arrija të largohesha... Të gjitha këto shqetësime unë po i shihja dhe po i kuptoja nga biseda me të.

Me Bedri Selmanin qëndruam së bashku deri në mëngjes. Atë e njoftova se do të largohesha ditët e ardhshme nga Kosova. Gjithashtu, me Bedriun u pajtuam që ai ta vazhdonte aktivitetin me shokët që kishte, por këtë ta bënte me kujdesin më të madh të mundshëm. Mos të kërkonte lidhje me Lëvizjen, por të priste gjersa të kthehej Rexhep Ahmeti nga shërbimi ushtarak.

***

Të nesërmen isha tek familja e dajës Isë. Ishin mbledhur të gjithë dhe po më prisnin. Pos familjes së daje Isë dhe dajës Hajrë për t'u përshëndetur erdhën edhe Qamili dhe Selvetja.

Pak para se të largohesha, Mirvetja e dajës Isë, më njoftoi se Selvetja kishte diçka për të folur me mua. Të gjithë dolën nga dhoma dhe ngela i vetëm me Selveten.

Isha kureshtar të mësoja se ç'do të më thotë Selvetja. Nuk vonoi shumë dhe Selvetja më tregoi se ç'dëshironte të bisedonte me mua.

– A ka mundësi ta mësojë emrin e shokut për të cilin me ke pas folur dikur, apo ta di adresën e tij, sepse dua të njihem me të?

Unë ngela i shtangur dhe i habitur dhe vetëm po e shikoja! Nuk më kujtohej se për cilin shok kisha folur me Selveten. Pas pak e "gjeta" në kujtesë emrin e shokut. M'u kujtua se me Selvetën kisha biseduar para një viti. Prandaj më duhej të bisedoja me shokun, para se t'ia komunikoja emrin e tij.

– Do të flas me shokun dhe do ta njoftoj për propozimin tënd,– i thashë Selvetës dhe kështu e mbyllëm këtë çështje.

***

Takimet e mia me Xhemën, gjithmonë, kanë qenë të këndshme dhe të rëndësishme për mua. Por, tani që isha ilegalë dhe UDB-a më kërkonte kudo, një takim me Xhemën, për mua, ishte edhe një privilegj. Xhema, gjithmonë më kishte ndihmuar të gjeja rrugëdalje nga situata të ndryshme dhe për këtë arsye e pritja me padurim ta takoja. S'kishte gjë, se do ta takoja natën dhe do të bisedoja me te duke shikuar mos po lëviz ndokush afër nesh... Kështu kishim bërë gjithmonë edhe në të kaluarën dhe për shumëçka kjo nuk ishte risi.

Xhemën dhe Ferkiun do t'i takoja aty ku i kisha takuar edhe shumë herë më parë, afër hekurudhës, në mes fshatit Resnik dhe Shtitaricë.

Nga Bivolaku deri në Reznik eca në këmbë. Në vendtakim arrita pak para kohe. Xhema dhe Ferkiu erdhën së bashku. U përqafuam me mall të madh me njëri-tjetrin dhe biseduam për shumë çështje, por më së shumti për të ardhmen e afërt që na priste. Edhe Xhema më dha mbështetje që të largohesha nga Kosova, së paku për një kohë e gjersa ta merrja vetën me shëndet... Meqë Xhema dhe Ferkiu i njihnin lidhjet e mia dhe e kishin të qartë se me cilët shokë do të vazhdonin punën, u pajtuam që ata t'i mbajnë lidhjet me shokët e krahut tim.

Lidhur me vazhdimin e kontakteve me Vehbi Mujën, shokëve u shpreha mendimin tim që ata të tregoheshin shumë të kujdesshëm dhe të mos e kontaktonin për një kohë. Shokët i njoftova se Vehbi Muja menjëherë pas lirimit më kishte çuar fjalë se kishte shprehur dëshirën të më takonte e të më sqaronte se ç'kishte ndodhur, se për çka e kishte pyetur UDB-a, se çka dinte UDB-a për veprimtarinë tonë, por unë e kisha refuzuar një takim të tillë për shkak të disa lajmeve që kisha mësuar lidhur me të vëllanë e tij, Rexhep Muja.[24]

Selvete Grajçevci dhe Xhemajl Pllana (Gusht 1989,
disa ditë pas lirimit të Xhemës nga izolimi).

Para se të ndaheshim me njëri-tjetrin, Xhemën e njoftova me propozimin e Selvetes. Duke më dhuruar një buzëqeshje, Xhema më dëgjoi me vëmendje. Në fund të rrëfimit tim me pyeti:

– Po, ti ç'i the Selvetës?

– Ajo që i thashë ishte se do ta njoftoj shokun tim për propozimin tënd dhe do t'ia them emrin tënd e pastaj shoku le të vendos se a do t'ju takojë apo jo,– ju përgjigja Xhemës.

– Unë e kisha hallin e shëndetit tënd, ndërsa ti na u paske marrë me shkuesi! – u përgjigj Xhema dhe na bëri të qeshnim të treve.

– Unë kam mendime shumë të mira për Selveten. Të tjerat, ju bie ju t'i njihni e zhvilloni me tutje, - i thashë Xhemës dhe e lamë aty këtë bisedë.

Pas pak u përqafuam shumë e shumë me Xhemën dhe i ngritëm grushtet e u ndamë me njëri-tjetrin. Nuk nxorëm lot, por mua zemra po më rrihte dhe nuk di se si shpëtova pa ia plas vajit si një fëmijë!

Në prag të largimit

Të nesërmen sapo ra terri në tokë, dola nga shtëpia e Sheremetit dhe shkova në drejtim të urës mbi lumin Silnicë, që ishte pranë fshatit Plemetin dhe që lidhte disa fshatra rrëzë Qyqavicës me Obiliqin, Fushë Kosovën dhe Prishtinën. Nuk vonoi shumë dhe aty erdhën Ferkiu dhe Mirvetja. Mirvetja kishte ardhur vetëm për t'u përshëndetur. Pas një qëndrimi të shkurtër u larguan së bashku. Ferkiu do ta shoqëronte Mirvetën deri diku afër shtëpisë së saj në Beçuk dhe do kthehej përseri.

Unë u ktheva përsëri në shtëpi të Sheremetit, për t'u përshëndetur me familjen dhe për t'i marrë rrobat që kisha me vete.

Sikur dhembjet e mia të mos njihnin fund, po vinte koha të largohesha edhe nga shtëpia e Sheremetit që ishte gjithashtu një çast tjetër i rëndë që kisha para vete. Më duhej të largohesha nga një familje e mrekullueshme, e cila më kishte pranuar në gjirin e saj në momentet më të vështira. Sheremeti dhe Elhamja më përcollën deri tek dera e oborrit e nuk i mbajtën lotët, ndërsa unë vazhdoja të " mbahesha burrë" dhe të mos nxjerrë lot nga sytë. U përqafuam me mall dhe u ndamë. Ika me vrap tek vendi ku do të takohesha me Ferkiun.

Ferkiu më njoftoi se pak para mëngjesit do të vinin Burim Zagragja dhe Behxhet Ahmeti dhe pastaj para lindjes së diellit do të niseshim për Shkup.

Me Ferkin biseduam për shumë gjëra nga pak. Ferkiut dhe Xhemës u ngelnin të gjithë punët e mia. Atyre tani e tutje u ngelej barra ta vazhdonin veprimtarinë e luftës sonë nacionalçlirimtare dhe të mbajtjes së kontakteve edhe me shokët e mi. Unë kisha besim të paluhatshëm në ta dhe përkushtimin e tyre. E dija se gjithçka do të shkonte mirë edhe pa mua, se Xhema e Ferkiu do ta çojnë luftën tonë drejtë fitoreve të reja!

***

Ende ishte natë, unë dhe Ferkiu ishim duke qëndruar në afërsi të urës së Plemetinit. Ferkiu më paralajmëroi se tani nuk do të vononin dhe do të vinin Burim Zagragja dhe Behxhet Ahmeti. Ashtu edhe doli. Nga aty ku ishim i pamë dritat e makinës që po lëvizte në drejtim të urës. Më befasuan për njohurit e mira të gjeografisë së Kosovës, sepse Behxhet Ahmeti ishte me prejardhje nga fshati Bervenik, malësia e Gollakut, ndërsa Burim Zagragja nga Prishtina!

Pas një bisede të shkurtër jemi përshëndetur me Burim Zagragjen, i cili u kthye në Prishtinë.

Behxhet Ahmeti, Ferki Morina dhe Burim Zagragja

Diku pas një gjysmë ore e kaluam urën e Plemetinit dhe u nisëm në drejtim të Prishtinës. Kaluam nëpër Prishtinë dhe pas gati dy orë udhëtimi arritëm pa asnjë problem në Stacionin e Autobusëve në Shkup. Ora ishte rreth tetë e mëngjesit. Behxhet Ahmeti shkoi brenda në Stacionin e Autobusëve për të pyetur për orarin e nisjes së autobusit për Stamboll dhe për ta blerë biletën. Qëndruam edhe pak kohë së bashku dhe Behxhet Ahmeti ma dorëzoi pasaportën dhe biletën.

Shokët nuk kishin se çka të prisnim më shumë. Autobusi do të nisej pas disa orësh. Ç'do qëndrim i tyre i mëtejshëm aty ishte me rrezik të madh për ta dhe për mua.

U pajtuam që të përshëndetemi dhe ndaheshim nga njëri-tjetri.

Për mua erdhi edhe një çast tjetër i rëndë i ndarjes edhe nga dy shokë. U përqafuam shumë e shumë dhe i thamë mirupafshim njëri-tjetrit. Ata u futën në makinë dhe u nisën për Prishtinë. I përcolla me sy derisa makina humbi në rrugë në mesin e makinave tjera. Nuk e di se si i mbajta lotët kur u ndava nga Ferki Morina dhe Behxhet Ahmeti?! Nuk kanë thënë kot se "njeriu është më i fortë se guri,- më shkoj mendja tek fjala e urtë e popullit." Isha shumë afër të "koritesha", por qëndrova. E merrja me mend se si e kanë përjetuar edhe ata ndarjen me mua, prandaj, mendova, se bëra mirë që edhe njëherë e bëra zemrën guri!

Disa orë në Shkup

Në Stacionin e Autobusëve në Shkup ngela i vetëm. Njerëz të panjohur vinin dhe iknin në drejtime të ndryshme.

Me qëllim të mos rënies në sy e braktisa Stacionin e Autobusëve dhe kalova në një lagje që quhej Çarshia e Vjetër e Shkupit. Në këmbë eca gjer tek tregu i pemëve dhe perimeve dhe u ktheva përsëri në Stacionin e Autobusëve.

Meqë kisha kohë edhe disa orë vendosa ta kaloj urën e lumit Vardar. Pjesa e qytetit përtej Vardarit dukej shumë e ndërtuar. Ndërtesa të larta dhe të bukura. Edhe rrugët ishin të gjëra dhe të shtruara në asfalt.

Pas një ore shëtitje nëpër pjesën maqedonase të Shkupit u ktheva përsëri në Stacionin e Autobusëve.

Dy pjesët e qytetit të Shkupit ishin si dy botë të ndryshme. Pjesa maqedonase ishte e ndërtuar dhe bashkëkohore, ndërsa ajo shqiptare, që ishte edhe pjesa e vjetër e qytetit, e pazhvilluar dhe me ndërtesa qindravjeçare!

E kisha dëgjuar këtë edhe më parë nga studentët shqiptarë nga Maqedonia, që studionin në Universitetin e Prishtinës, por nuk kisha besuar se dallimet ishin aq të mëdha. Sllavo-maqedonasit e kishin ndarë qytetin e Shkupit, ashtu siç e kishin ndarë edhe vet Maqedoninë! Besimet e ndryshme fetare nga pasardhësit e maqedonasve antik, kishin krijuar dy popuj: maqedonas(të besimit ortodoksë) dhe shqiptar (të besimit mysliman e katolik). Për mua të gjithë këta ishin pasardhës të maqedonasve të lavdishëm, që botës i dhanë Aleksandrin e Madh, të birin e Filipit dhe Olymbisë.

Pak pas mesit të ditës erdhi autobusi dhe unë zura një vend në të.

Kisha përshtypjen se të gjithë pasagjerët ishin shqiptarë. Edhe udhëtari që u ulë pranë meje ishte shqiptar. Të gjithë flisnin shqip, madje edhe shoferi dhe shoqëruesi i tij. E folura shqip ma ngacmoi idenë se vetëm *Babiç Janko*[25], nga Mala Glavica e Prijedorit ishte "serb" nga Boshnjakia!

Autobusi doli në autostradë dhe po ikte me shpejtësi drejtë Stambollit. Unë e futja dorën në xhepin e brendshëm të setrës dhe nxirrja pasaportën e ia lëshoja sytë *Babic Jankos.* "Çuditërisht" më dukej identik me vetën time! Edhe flokët i kishte të ngjashme me flokët e mia, të egra si thera të iriqit, ashtu siç i kisha unë. Po ato mustaqe që i mbaja unë, të rralla dhe aspak të ngjashme me ato të malësorëve! "Ah ç'burri që je ti që m'i ke lëshuar këto mustaqe si bisht miu dhe që s'ke pasur guxim t'i tregosh këto mustaqe në kuvende burrash,"- e ngacmoja Babiç Jankon?

Autobusi ikte me shpejtësi drejt Stambollit. Nuk vonoi dhe e kaluam Kumanovën.

Papritur një dridhmë, frika dhe ankthi më kaploj. E nxirrja pasaportën e *Babiç Jankos* nga xhepi, i lëshoja një "përshëndetje" dhe pastaj e futja përsëri në xhep. Çdo herë që nxirrja pasaportën nga xhepi, e testoja vetën time se, a i mbaja në mend ditëlindjen dhe vendlindjen e Babiç Jankos! Vetën time e pyetja: po më pyeti kufitari se nga isha dhe ç'ditëlindje kam, si do t'i përgjigjesha? E nxirrja përsëri pasaportën e *Babiç Jakos,* e shikoja një kohë dhe fusja përsëri në xhepin e brendshëm të setrës dhe e shihja se ia harroja ditëlindjen dhe vendlindjen e tij!

Autobusi vazhdonte rrugën drejtë kufirit dhe mua më sillej nëpër kokë një mendim i keq: se mos ata që e kanë shitur pasaportën janë bashkëpunëtorë të UDB-ës dhe policia është duke më pritur në kufi? Nganjëherë më shkonte mendja të zbrisja nga autobusi në rastin e parë, sapo autobusi do të ndalej për pushim. Në anën tjetër, mendja më shkonte tek shokët dhe isha i sigurt se nga ata nuk ka mundësi të më ketë tradhtuar ndokush. Kisha besim të plotë në Ferkiun, Behxhetin dhe Burimin. Vetëm këta tre shokë e dinin se kush qëndronte prapa Babiç Jankos. Unë besoja se edhe shokët nga Turqia, që ku ta dija se sa para do të duhej t'i kenë paguar për këtë pasaportë, duhet t'i kenë njohur kontrabanduesit? Fundi i fundit unë ju besoja Xhafës, Sheremetit që na kishte vënë në lidhje me Sabri Novosellën, të cilit gjithashtu i besoja, sepse ishte edhe vëlla i Selatin Novosellës, për të cilin unë dhe shokët kishim respekt të madh.

Duke fluturuar në mendime, herë andaj e herë këndej, arritëm në vendkalimin kufitar të Dimitriogradit. Autobusi u ndal. Shikova nga dritarja dhe pashë tabelat që tregonin se kishim ardhur në kufi. Aty shkruante *Carina* (dogana). Isha i mbushur me ankth, por në anën tjetër përpiqesha ta bëja vetën të fortë. Nuk vonoi dhe në autobus hyri një polic i cili na i kërkoi pasaportat e të gjithëve me radhë. Polici erdhi tek unë dhe unë ia dhashë pasaportën që e mbaja në dorë. E hapi pasaportën, m'i lëshoi sytë mua, pastaj e ktheu shikimin përsëri kah *Babiç Janko* . Si duket i dolëm si "binjak" më pyeti:.

– Ku shkoni?

– Në Stamboll. Do ta vizitoj të vëllanë që është duke studiuar atje, –u përgjigja në serbisht.

–Sa para ke me vete?–më pyeti polici.

Unë nxora nga xhepi një grumbull njëmijë dinarësh dhe dyzet markat që m'i kishte dhënë Bahtir Haradinaj.

Polici vazhdoi t'i kontrollonte pasaportat e të gjithë udhëtarëve. Pasi arriti në fund të autobusit u kthye dhe doli nga autobusi.

Nuk vonoi shumë dhe në autobus hyri një tjetër polic i cili bisedoi me shoferin e autobusit dhe ky i fundit e dërgoi ndihmës shoferin e tij t'i grumbullonte të gjithë pasaportat e udhëtarëve. Pastaj, polici i mori të gjithë pasaportat dhe i vendosi në një tavolinë para zyrës së vendkalimit.

Unë e shikoja me bisht të syrit dhe po përpiqesha ta liroja vetën nga ankthi që kisha. Mendja më shkonte se mos po vije polici dhe po më thërret: Babiç Janko!

Pas pak, një polic trashullak nisi ti vulos pasaportat një nga një. Unë e shihja se ai i hapte dhe vuloste pasaportat pa i shikuar as emrat dhe as fotografitë e tyre. Diku pas dhjetë-pesëmbëdhjetë minutash vije polici trashullak në autobus dhe na i kthen pasaportat.

– Babiç Janko!

E ngrita dorën lartë dhe ju përgjigja:

–*Ja* – në serbisht.

Polici ma lëshoi pasaportën në dorë. Unë e futa menjëherë pasaportën në xhep.

Nuk mori shumë kohë dhe autobusi nisi të gumëzhin dhe u nis drejt Bullgarisë. Oh ç'lehtësi, –thashë vetë me vete!

Autobusi e kaloi zonën neutrale dhe po ikte drejt tokës bullgare. Pas pak autobusi u ndal dhe në autobus hynë brenda dy policë bullgarë. Ishte mbrëmje dhe dielli ende nuk kishte perënduar. Edhe policët bullgarë na i kërkuan të gjithëve pasaportat një nga një. Polici që mori pasaportën time ishte i shtyrë në moshë dhe mbante syze mjaftë të trasha. E shikonte pasaportën time dhe më shikonte mua. Nga xhepi nxori një llupë dhe vazhdoi ta shikonte pasaportën time. Nuk vonoi shumë dhe ma ktheu pasaportën të cilën unë e futa menjëherë në xhep. Pas një gjysmë ore autobusi nis sërish drejt Stambollit.

Rrugës, bashkudhëtari që më ishte ulur në krahun e djathtë më pyeti, në serbisht:

– Për ku je nisur?

Unë ia ktheva përgjigjen:

– Turqi.

Pasagjeri u befasua dhe më pyeti:

– Flisni shqip?

– Po, jam shqiptar.

– Po, unë dëgjova se mbaje një emër serbi apo kroati,– ma ktheu i habitur bashkudhëtari im!

– Emri im i vërtet është *Gjon Babi*.[26] Në Boshnjaki ma kanë deformuar emrin dhe mbiemrin, –iu përgjigja.

– E flisni bukur shqipen! – ma ktheu edhe njëherë i habitur bashkudhëtari dhe bashkëkombësi im.

– Të faleminderit, por unë duhet ta flas shqipen, sepse jam shqiptar. Edhe prindërit e mi janë shqiptarë, ashtu si edhe gjyshërit, gjithashtu, i kam pasur shqiptarë – ju përgjigja edhe njëherë!

– Po, ty nga të kemi, o mik? – e pyeta.

–Jam nga Shkupi.

–Për ku je nisur? – e pyeta.

– Do ta vizitoi hallën time në Stamboll. Ajo është plakë dhe ka shumë vite që është shpërngulur në Turqi. Dua ta gëzoi për *Festën e Bajramit*,– ma ktheu bashkatdhetari im.

– *Me fat Bajrami!* –e urova.

–Të faleminderit shumë! – u përgjigj shkupjani.

E kaluam kufirin bullgar dhe u futëm në territorin e Turqisë.

Në mëngjesin e ditës së nesërme u futëm në qytetin më të madh që kisha vizituar ndonjëherë. Qyteti dukej shumë i madh edhe nga largësia.

Kisha një ndjenjë gëzimi që po arrija në Stamboll. Qyteti, që për disa shekuj kishte mbajtur emrin Konstantinopol, për nder të themeluesit të tij, dardanit nga Nishi -Konstatinit të Madh, ku kishin jetuar e vepruar edhe Gjergj Kastrioti dhe shumë shqiptarë të tjerë të lavdishëm, ishte një qytet interesant për ta vizituar, i thashë vetës sime. Mendja më shkoj gjithashtu se nga Stambolli janë nisur sulltanë dhe ushtri të njëpasnjëshme për t'i nënshtruar shqiptarët të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti dhe ata që erdhën pas tij e luftuan deri në çlirimin e Shqipërisë nga zgjedha otomane. Ndoshta nga ky qytet ka ardhur urdhri edhe për rrethimin, rrafshimin e kullës së Beh Mihaliqit, ashtu siç mund të ketë ardhur edhe vendimi për ekzekutimin e Shaban Kapuçit, shokut dhe bashkëluftëtarit të Isa Boletinit e Hasan Prishtinës, e pyetja vetën?

E mbaja mend se diku para dhjetë viteve e kishte vizituar Stambollin edhe im atë së bashku me kushërinjtë Sadik Sadiku dhe Imer Sadiku. Ata patën vajtur në Stamboll për ta takuar ungjin e tyre–bacën Selim–, i cili kishte ardhur nga Australia për t'u takuar me nipat e tij! Baca Selim ishte i mbijetuari i masakrës së Tivarit dhe nuk guxonte ta vizitonte Kosovën.

Autobusi ikte në drejtim të Stambollit, ndërsa unë mendjen e kisha tek shokët dhe njerëzit e mi të dashur në Kosovë. Isha shumë i lumtur dhe shumë krenar për të gjithë ata shokë dhe njerëz të dashur, falë ndihmës së të cilëve unë e munda UDB-ën në një përballje të pabarabartë, por shumë të ashpër. Isha krenar sepse gjatë gjithë kohës sa ndodhesha në ilegalitet, ndonëse kam pasur kontakt me të gjithë shokët dhe shumë miq e dashamirë, doli se asnjëri nuk ishte me pushtetin jugosllav; se burra të besës ishin edhe ata që e falsifikuan pasaportën time. Fakti se asnjë spiun nuk ka pasur në radhët e organizatës sime dhe në radhët njerëzve që i kam takuar, më mahniste, më trimëronte dhe ma bënte zemrën mal. Nuk duhet harruar se shokët dhe njerëzit që kam takuar, që nga momenti kur jam larguar nga shtëpia dhe që kanë ditur se po më kërkonte policia nuk ishin sa gishtat e një dore, por disa dhjetëra. Të mbaje kontakt me dhjetëra persona dhe asnjëri prej tyre të mos lakmonte për dhuratën e majme që do të mund ta fitonte, ishte diçka madhështore, diçka që mund të ndodh vetëm tek ai popull që ka vendosur t'i thyej prangat e robërisë. Kjo më jepte forcë dhe dhembjet e mia për largimin nga Kosova ime e shtrenjtë, i bënte më të lehta.

***

Arritja në Stacionin e Autobusëve në Stamboll m'i ndërpreu mendimet që më silleshin nëpër kokë. Autobusi u ndal. Zbritëm të gjithë nga autobusi. Udhëtarët ikën në drejtime të ndryshme. Unë ngela i vetëm në Stacion.

U futa brenda në Stacionin e Autobusëve dhe po e kërkoja orarin e autobusëve për Adapazar. U drejtova drejtë sportelit dhe punonjësi me tha diçka në turqisht dhe e drejtoi dorën në një drejtim që mua ma mori mendja se ishte vendi ku duhej t'i këmbeja paratë. E kuptova se nuk mund ta blija biletën me para të huaj...

Stamboll, nga e majta Sadik Sadiku, Selim Sadiku, Behram Muharremi (im atë) dhe Imer Sadiku

Pas pak u vura në kërkim të një zyre apo banke ku do të mund t'i këmbeja paratë që i kisha për ta blerë biletën e autobusit për Adapazar. Dyqanet ishin të mbyllura. U futa në një Agjenci të Udhëtimeve që ishte e hapur dhe po përpiqesha ta pyes se a kishte mundësi t'i këmbeja paratë që po i mbaja në dorë. Këmbyesi, duke e parë se unë nuk dija as anglisht, as gjermanisht dhe as turqisht më foli shqip.

– A jeni shqiptar, – më pyeti?

– Po, shqiptar jam,– ia ktheva. A keni mundësi të më ndihmoni dhe të m'i këmbeni këto marka gjermane apo dinarë në lira turke?

– Dinarët nuk i këmbejmë. Ndërsa markat gjermane, i këmbejmë, por t'i duhet t'i kesh së paku njëqind marka gjermane dhe jo vetëm dyzet marka. Këto

janë shumë pak dhe ne nuk i këmbejmë nën njëqind marka, – ma ktheu agjenti i udhëtimeve turistike, ku ta dija se çka ishte?!

Dola nga zyra. Thashë mos po gjej ndonjë agjenci tjetër, aty afër. U solla përreth dhe nuk gjeta asnjë agjenci tjetër. Pas pak u ktheva përsëri tek agjencia e parë dhe mendova t'i bëja edhe një lutje të m'i këmbente të dyzet markat që kisha dhe që m'i kishte dhënë Bahtir Haradinaj. Pas shumë lutjeve këmbyesi u dorëzua dhe mi këmbeu të dyzet markat. E falënderova shumë dhe ika tek Stacioni i Autobusëve, ku edhe e preva biletën dhe pas pak e mora autobusin për Adapazar.

Rrugës drejt Adapazarit, në karrigen pranë meje u ul edhe një udhëtar. Bëmë një cikë rrugë dhe bashkudhëtari im, që ishte ulur pranë meje, me tha diçka në turqisht. Unë mblodha krahët dhe po ia kthej në shqip:

– Jam shqiptar.

Nuk më dha përgjigje bashkudhëtari im. Pas pak më ra ndërmend se si thuhej në turqisht jam shqiptar dhe i drejtohem:

–Benum arnaut...[27]

Bashkudhëtari lëshoi një seri fjalësh në turqisht dhe unë po e tundja kokën që t'i tregoja se nuk po e kuptoja asnjë fjalë. Ai ma ktheu:

– Benum arnaut, tetovali...

–Aha – ia ktheva – je tetovar?!

–Evet. Evet...tetovali"[28]

Zemra m'u mbush me pezëm. Ç'ka vuajtur vallë kombi im gjatë historisë! Sa shqiptarë janë tretur në turq, grekë, serbë, bullgarë, malazias etj.?

Arritja në Adapazar

Pas një udhëtimi rreth dy orësh, kaluam pranë një liqeni të gjerë e që nuk i dukej fundi. E vazhduam rrugën nëpër një ultësirë, që dukej sikur ishte shtrati i dikurshëm i një liqeni akoma ma të madh, ku në të dy anët e rrugës kishte edhe fusha të mbjella me dru plepi!

Nuk vonoi shumë dhe autobusi hyri në qytet. Bashkudhëtari me prejardhje nga Tetova e pohoi me koke se kishim arritur në Adapazar. Në Stacionin e Autobusëve, bashkudhëtarit, ia tregova adresën që e kisha të shkruar në një letër dhe ai më ndihmoi ta gjeja adresën që po e kërkoja. E falënderova shumë për ndihmën!

Arrita tek adresa që po e kërkoja. Para dere, takova disa fëmijë. Njëri prej tyre hyri brenda dhe pas pak doli një burrë i rreth të dyzetave. Nikoqirin e njoftova se kush isha dhe kë po kërkoja. Avdullah Prekadini, më dëshiroi mirëseardhje dhe më urdhëroi të futesha brenda!

Gjersa po pinim kafe dhe po bisedonim, Avdullahu doli nga dhoma ku po qëndronim. Nuk vonoi shumë i zoti i shtëpisë u kthye përsëri në dhomë dhe më njoftoi se ia kishte përcjell lajmin e ardhjes sime Sabriut:

– Sabriu mund të ndodhet për vizitë tek ndonjë mik i tij, për Festën e Bajramit! – më tha me një shqipe të bukur, Avdullahu.

Nuk vonoi shumë dhe njëri nga fëmijët foli diçka turqisht. Avdullahu tha:

– Arriti Sabriu!”

U ngritëm dhe dolëm në oborr, para dere.

Në shikim të parë, Sabriu më ngjau shumë me të vëllanë e tij, Selatinin. Ai mbante mustaqe dhe ishte veshur me një kostum të bukur.

Ia zgjata dorën dhe u prezantova se kush isha. Sabri Novosella më shikoi dhe më tha:

– Ishim të shqetësuar për ty, Ali! Mirë se erdhe!

Pasa pak minutash u përshëndetëm me Abdullah Prekadinin dhe familjen e tij, të cilin njëherësh e falënderova nga zemra për mikpritjen!

Së bashku me Sabriun shkuan në banesën e tij. Në banesë jam njohur me bashkëshorten e Sabriut, Safeten dhe fëmijët: Vlorën, Diturinë dhe Albanin.

Dy-tre ditët e para kam pushuar nga udhëtimi i gjatë dhe i mundimshëm.

Ndjehesha shumë i lumtur dhe krenar që më ishte dhënë mundësia të vija e të takohesha me Sabriun. Shpresoja se do të mësoja shumë nga përvoja e tij dhe kështu do të mund t’i ndihmoja edhe shokët e Lëvizjes në Kosovë.

Sapo mora vetën, nga udhëtimi i gjatë, Sabriun e kam njoftuar për gjendjen e LNÇKVShJ-së në rrethin nga kisha ardhur. Në mënyrë të veçantë e kam njoftuar

për çështjen e Vehbi Mujës dhe pasojat që ka pasur burgosja e tij në radhët Lëvizjes. Sabriun, gjithashtu e kam njoftuar edhe për veprimtarinë e shokëve që ai ka pasur rastin t'i takonte gjatë vizitave të tyre në Turqi, si Sheremet Saraçi, Rexhep Ahmeti dhe Behxhet Ahmeti, por edhe për veprimtarinë e Xhemajl Pllanës dhe Ferki Morinës, për të cilën veprimtari ai ka dëgjuar për herë të parë.

Gjithashtu, Sabriu më ka informuar për veprimtarinë e LNÇKVShJs-ë në Evropë dhe gjetiu nëpër botë, që nga arratisja e tij dhe Jusuf Gërvallës nga Kosova; për përpjekjet për bashkimin e LNÇKVShJ-së e OMLK-së dhe takimin e mbajtur për këtë qëllim në Stamboll në mes Sabri Novosellës, Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës; për bisedimet që Sabri Novosella dhe Xhafer Durmishi kanë zhvilluar në emër të LNÇKVShJ-së me përfaqësuesit e PKMLShJ-së : Abdullah Prapashtica, Osman Osmani e Faton Topalli; për vazhdimin e veprimtarisë pas vrasjes së Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës si dhe bashkimin e tri organizatave simotra dhe krijimin e "Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi". Sabriu më ka njoftuar edhe për ekzistencën e Komitetit të Degës së LNÇKVShJ-së "Hasan Prishtina" në Turqi.

Në banesën e Sabri Novosellës jam njohur me Ymer Berishën. Edhe Ymeri kishte gati dy vite që ishte larguar nga Kosova dhe qëndronte, pa familjen e tij, nëpër miq e shokë në Turqi. Ymer Berisha ishte fjalëpakë, por shumë miqësor.

Unë dhe Ymeri qëndronim në banesë gjersa kthehej nga puna Sabriu. Në qytet nuk kishim guxim të dilnim sepse unë isha pa dokumente dhe kishim frikë se po na ndalonte policia turke. Mbaj mend se së bashku me Ymer Berishën dhe të birin e Sabriut, Albanin, që kishte katër-pesë vjet, disa herë kemi shkuar tek një liqen që quhej *Sakaria* dhe jemi larë dhe rrezitur. Për mua që nuk kisha dal në diell që nga vera e shkuar kjo ishte shumë e dobishme. Duke dal në diell unë po e mundja edhe zverdhjen që ma kishte mbuluar fytyrën pas mbi dy muajsh të kaluar brenda nëpër shtëpi shokësh ose spital.

Qysh gjatë prezantimit, Sabriu më ka njoftuar se Ymer Berisha ishte gjithashtu anëtar i LNÇKVShJ-së. Gjatë bisedave me Sabriun kam dëgjuar fjalë shumë të mira për veprimtarinë e Ymer Berishës në Kosovë, por edhe për shkathtësinë e tij për t'i kryer shumë punë praktike që ishin shumë të rëndësishme për veprimtarinë tonë. Sabriu më ka njoftuar se Ymeri, nëpërmjet lidhjeve të tij, kishte arritur ta rregullonte pasaportën time dhe se ai nga buxheti i familjes së tij i kishte paguar dymijë marka gjermane për pasaportën e Babiç Jankos.

Dyqani ku punonte Sabriu nuk ishte shumë larg nga banesa e tij, prandaj ai vinte gjatë kohës së drekës dhe drekonte me ne. Edhe takimet e drekës i shfrytëzonim për biseda nga ma të ndryshmet. Shpeshherë këto takime ishin edhe si vazhdim i bisedave që kishim lënë përgjysmë në të kaluarën.

Nga vizitat që kishin bërë Sheremet Saraçi dhe Rexhep Ahmetit, unë i njihja deri diku bindjet politike që përfaqësonte Sabri Novosella, mirëpo nga takimet e përditshme me te, po bindesha gjithnjë e më shumë në drejtësinë e qëndrimeve të shokëve dhe sidomos ato të Rexhep Ahmetit. Sabri Novosella kishte një

botëkuptim idealist mbi jetën dhe shoqërinë. Botëkuptimi i tij ishte shumë më ndryshe nga botëkuptimi im dhe i shumicë së shokëve që kisha lënë në Kosovë. Unë dhe një pjesë e shokëve ishim përkrahës të filozofisë së materializmit dialektik dhe historik. Në këtë çështje, ne ishim krejtësisht të ndryshëm dhe në kundërshtim me njëri-tjetrin.

Mirëpo, përkundër dallimeve që kishim, më befasonte, për të mirë, sinqeriteti i Sabri Novosellës. Ai nuk i fshihte bindjet e tij, por i thoshte ato hapur dhe pa hezitimin më të vogël. Kjo veti e tij më gëzonte dhe i bënte debatet tona shumë interesante dhe të dobishme për veprimtarinë tonë; ato i hapnin rrugë bashkëpunimit tonë që nuk kishte alternativ tjetër.

Nganjëherë kur debatonim për çështje të ndryshme dhe shprehnim pikëpamje krejtësisht të ndryshme, Sabriu nuk ngurronte të më quante shokë i krahut të Ramadan Pllanës apo edhe, si me shaka, ne të gjithëve na quante marksist-leninistët e LNÇKVShJ-së, mirëpo nga frika se mos po hidhërohesha për ndarjen që po bënte më thoshte se nuk ishim vetëm ne të tillë, se i tillë ka qenë edhe Jusuf Gërvalla!

Unë për vete nuk e ndjeja vetën të fyer nga ato që më thoshte Sabriu, përkundrazi isha krenar për bindjet e mia politike. Për mua, bindjet e ndryshme nuk ishin problem dhe këtë ia thosha Sabriut. Por dorën në zemër, kisha përshtypjen se edhe Sabriu na pranonte ashtu siç ishim dhe kjo, në njëfarë mënyre, kishte krijuar një lloj "bashkekzistence paqësore" në mes nesh, që për mendimin tim ishte shumë e rëndësishme për luftën tonë. Gjithë këtë qëndrim e shikoja si një mrekulli dhe madhështi të luftës sonë, ashtu siç e shihja si madhështore edhe qëndrimin e Sabriut.

Edhe disa nga shokët që i kisha lënë në Kosovë, kishin një botëkuptim të ngjashëm me atë të Sabriut. Megjithëkëtë ata, ndonëse kishin një botëkuptim tjetër, i konsideronim si vëllezër lufte. I tillë ishte për mua edhe Sabriu. Ai mbetej një atdhetar i madh dhe që kishte sakrifikuar shumë për lirinë e Kosovës. Veç kësaj Sabriut dhe shokëve u besoja si vetës sime. Asnjëherë nuk më ka shkuar mendja se unë isha më i vlefshëm apo më atdhetarë e patriotë se Sabriu dhe shokët që kishin pikëpamje politike të ngjashme me te. Përkundrazi unë e kisha kuptuar dhe kalitur në kokën time bindjen se lufta jonë, në radhë të parë, ishte një luftë nacionalçlirimtare dhe se liria e çlirimi nga zgjedha serbe kërkonte që ne të lidheshim pas gjërave të përbashkëta dhe jo pas atyre që na ndajnë. Kuptohet se botëkuptimet e ndryshme na ndanin dhe krijonin fërkime, mirëpo koha në të cilën jetonim kërkonte prej nesh që të merremi me ato gjëra që na bashkojnë. Kisha përshtypjen se këtë punë e kishte kuptuar kështu edhe Sabriu dhe se ai gjithashtu bënte gjithçka që ne të qëndronim të bashkuar rreth luftës sonë të përbashkët nacionalçlirimtare.

Disa ditë pas vendosjes në banesën e tij, Sabri Novosella m'i ka ofruar për lexim të gjithë numrat e "*Lajmëtarit të lirisë", "Zërit të Kosovës"(*nr.1-2 të LNÇKVShJ-së dhe të gjitha numrat e LRSShJ-së). Gjithashtu ai m'i ka ofruar

edhe letrat e Jusuf Gërvallës dhe shumë letra tjera nga korrespodenca e tij me shokët që gjendeshin në Evropën Perëndimore dhe gjetiu nëpër botë.

Një kënaqësi të veçantë dhe krenari të natyrshme më kanë dhanë letrat e Jusuf Gërvallës, disa prej të cilave ishin shkruar në formë raportesh në adresë të Komitetit të Degës së LNÇKVShJ-së "Hasan Prishtina" në Turqi dhe disa të tjera në emër të Sabri Novosellës. Duke lexuar letrat unë mësova jo vetëm për aktivitetin e LNÇKVShJ-së në Evropën Perëndimore, por edhe për punën e jashtëzakonshme që kishte bërë Jusuf Gërvalla dhe shokëve që i qëndronin pranë në afirmimin e çështjes sonë kombëtare. Gjithashtu nga letrat e Jusuf Gërvallës unë mësova edhe për veprimtarinë e organizatave tjera politike shqiptare në Evropën Perëndimore dhe gjetiu në botë.

Leximi për herë të parë i letrave të Jusuf Gërvallës, rileximi i tre numrave të "*Lajmëtari të lirisë"* dhe dy numrave të "*Zërit të Kosovës"* si dhe njohja nga ana e Sabri Novosellës me shumë fakte të tjera të veprimtaria revolucionare dhe çlirimtare e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës, gjithnjë e më shumë po më ndihmonte t'i kuptoja arsyet se pse UDB-a jugosllave ua zuri pritën dhe i vrau udhëheqësit e mëdhenj të luftës sonë për liri, me 17 janar 1982. Pas këtij informacioni, gjithnjë e më shumë po bindesha se Jugosllavia titiste, kjo vegël e verbër e serbomëdhenjve, nuk mund ta duronte zërin e së vërtetës që po përhapnin Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla dhe shokët e tyre, prandaj dha urdhër t'i vriste tre bijtë më të mirë dhe më besnik të Lëvizjes sonë nacionalçlirimtare.

Një ditë po bisedonim me Sabriun për qëndrimin e shtetit shqiptar lidhur me përpjekjet tona për liri. Sabriu, që si dukej e kishte pjekur qëndrimin e tij lidhur me këtë çështje, në bisedë e sipër më thotë:

– Shteti shqiptar nuk është i interesuar që ne në Kosovë të kemi një organizatë revolucionare e cila do ta udhëhiqte luftën tonë çlirimtare!

U shtanga dhe vetëm po e dëgjoja i habitur! Nuk u besoja veshëve të mi dhe se një qëndrimi i tillë po dilte nga goja e Sabriut! Më shkonte mendja se ndoshta Sabriu nuk e ka kuptuar drejtë qëndrimin e shtetit shqiptar apo ndoshta atij i duket se ndihma dhe mbështetja që na vije nga Shqipëria është e pakët, e ngadaltë dhe nuk është ajo që pritej,-thosha vetë me vete?!

Unë i shpreha menjëherë rezervat e mia lidhur me këtë qëndrim të tij dhe njëkohësisht i shpreha edhe besimin e patundur që kisha, unë personalisht, në politikën e shtetit shqiptar dhe qëndrimin e tij karshi luftës sonë për liri. Gjithashtu, Sabriut po përpiqesha t'ia shpjegoja edhe qëndrimin e shokëve të mi lidhur me këtë çështje dhe se në radhët tona nuk ka pasur dilema rreth kësaj çështje.

Sabri Novosella më dëgjonte me vëmendje dhe pasi e dëgjonte qëndrimin tim, me rrëfente shembuj nga përvoja e tij personale me shtetin shqiptar. Shihej qartë se kalimi nga Kosova në Shqipëri dhe takimet e dendura me Ajet Haxhiun dhe Sali Shatrin e kishin lëkundur qëndrimin e Sabri Novosellës dhe ndihmuar atë që ta kuptonte të vërtetën e qëndrimit të shtetit shqiptar lidhur me luftën tonë

nacionalçlirimtare. Gjithashtu sjellja e burokratëve të Tiranës dhe gjendja ekonomiko-politike në Shqipëri flisnin në favor të qëndrimeve të tij, ndonëse shteti shqiptar e kishte strehuar përkohësisht në Shqipëri dhe e kishte ndihmuar për të kaluar në Turqi, pas një udhëtimi maratonik nëpër Detin Mesdhe e Detin e Zi, në një anije shqiptare të transportit të mallrave dhe me pasaportë shqiptar.

Nga ajo që dëgjoja dukej qartë se Sabri Novosella ishte shumë i zhgënjyer në politikën e shtetit shqiptar karshi Kosovës dhe luftës sonë për liri. Nuk kishte asnjë fije dyshim se zhgënjim të madh i kishin krijuar atij edhe takimet me Ajet Haxhiun dhe Sali Shatrin, gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri, nga të cilët ai kishte pritur më shumë ndihmë e mbështetje.

– Edhe unë kam menduar kështu si ju para se të arratisesha nga Kosova. Por përvoja ime e këtyre viteve flet për diçka tjetër. Qëndrimi im në Shqipëri dhe përvoja e kontakteve me përfaqësues të shtetit shqiptar e ka lëkundur besimin tim, – më tha Sabriu gjatë një debati tjetër.

Po e dëgjoja me vëmendje. Unë nuk mund të mos merrja parasysh gjithë rrethanat dramatike të kohës kur Sabriu, i ndjekur nga UDB-ës, arratiset në Shqipëri. Ai kishte kaluar në Shqipëri me shpresën se tek shteti shqiptar do të gjente mbështetje për ta vazhduar luftën tonë për liri. Në Shqipëri, Sabriu, kishte gjetur pushtetarë që ishin të interesuar për t'i ruajtur kolltukët e tyre dhe për të pasur me bollëk, siç thoshte Sabriu, "raki rrushi e mish viçi" për klasën e tyre. Sabriu e kishte kuptuar se klasa politike në pushtet nuk ishte e interesuar për t'i rrezikuar, me asnjë çmim, pozitat dhe pushtetin e tyre për hir të Kosovës! E merrja me mend se ky qëndrim i shtetit shqiptar, për njerëz të sakrificës dhe që kanë kaluar një pjesë të madhe të jetës së tyre nëpër burgjet jugosllave, shkaktonte trauma e zhgënjim të madh.

I kisha dëgjuar me vëmendje të madhe, rrëfimet, qëndrimet dhe përvojën e tij me politikën e shteti shqiptar, e megjithëkëtë e kisha të vështirë të besoja se gjithë kjo ishte e vërtetë. Edhe më tutje unë këmbëngulja dhe besoja se e gjithë kjo nuk ishte tjetër pos një keqkuptim dhe se shteti i dalë nga lufta antifashiste dhe nacionalçlirimtare në Shqipëri, nuk mund të mos ishte përkrah luftës sonë të drejtë. Këtë ia thosha Sabriut, pa ngurrim.

Megjithëkëtë një dritë dukej në fund të tunelit. Unë edhe më tutje besoja se e gjithë kjo ishte një keqkuptim nga ana jonë dhe se Shqipëria ishte me ne dhe luftën tonë. Këtë shpresë e mbante gjallë edhe fakti se Sabriu nuk fliste me armiqësi kundër shtetit shqiptar. Ai ishte i pakënaqur me politikën e shteti shqiptar e megjithëkëtë ai shtetin shqiptar e quante *shteti amë*!

Si argument të fuqishëm për mosinteresimin e shtetit shqiptar për t'i dhënë përkrahje luftës sonë, Sabri Novosella e përdorte edhe mosinteresimin e shtetit shqiptar që Jusuf Gërvalla dhe Sabri Novosella t'i këmbenin adresat e njëri-tjetrit:

– Qysh nga vendosja ime në Turqi, një përfaqësuesi të shtetit shqiptar i kam kërkuar që t'ia përcjellin adresën time Jusuf Gërvallës, por ata nuk e bënë një gjë të tillë, – më tha Sabriu.

Argument tjetër ishte edhe qëndrimi që kishte mbajtur shteti shqiptar gjatë bisedimeve në mes LNÇKVShJ-së- të përfaqësuar nga Sabri Novosella dhe Bardhosh Gërvalla dhe OMLK-së, të përfaqësuara nga Kadri Zeka, por edhe gjatë bisedimeve në mes LNÇKVShJ-së, të Sabri Novosella dhe Xhafer Durmishi, dhe PKMLSHJ-së të përfaqësuara nga Abdullah Prapashtica, Osman Osmani dhe Faton Topalli, ku sipas Sabri Novosellës qëndrimi i shtetit shqiptar ka qenë jo dashamirës për luftën tonë!

Pas debateve, nganjëherë edhe të nxehta dhe shumë të rënda, ne nuk gjenim rrugë tjetër nga duhej të ecnim pos asaj të vazhdimit të luftës për liri dhe çlirim nga zgjedha jugosllave. Ishim të një mendje se duhet të luftonim për bashkimin e të gjitha organizatave dhe grupeve politike, pa marrë parasysh bindjet politike që ato kanë, se me punën tonë duhet ta bindim shtetin shqiptar se ne luftonim për liri dhe se armik i yni i vetëm ishte shovinizmi serbomadh.

Unë personalisht qëndrimin e shtetit shqiptar e kisha mësuar nga librat, radio Tirana dhe RTSh-ja. Në bazë të atyre që kisha lexuar e dëgjuar, unë nuk kisha asnjë pikë dyshimi në drejtësinë e qëndrimeve të shtetit shqiptar dhe në përkrahjen e tij ndaj çështjes së luftës sonë për liri. Në anën tjetër isha i vetëdijshëm se nuk e kisha përvojën e Sabri Novosellës as në raport me shtetin shqiptar dhe as në përpjekjet e tij për liri dhe kisha respekt të madh për to. Unë nuk mund t'i mbyllja sytë dhe veshët para qëndrimeve të tij sepse ato ishin qëndrime të një shoku tim të luftës sonë për liri. Vetën time e konsideroja si shumë të vogël në "vallen" e luftës sonë nacionalçlirimtare dhe e kisha parasysh edhe faktin se shumë gjëra nuk i dija.

Një ditë, Sabri Novosella më tha se do të shkojmë në Stamboll dhe do të takohemi me Ibrahim Qavollin, për të cilin më kishte folur edhe më parë. U gëzova, sepse kjo do të ishte hera e parë, që unë do të takoja një përfaqësues shteti shqiptar. Shpresoja se duke biseduar me një përfaqësues të denj, unë do të dëgjoja drejtpërdrejti qëndrimet e shtetit shqiptar lidhur me luftën tonë për liri.

Në Stamboll shkuam Sabri Novosella, Ymer Berisha dhe unë. Në dyqanin e argjendarisë së Njazi Starjës së bashku me Sabri Novosellën u takuam me Ibrahim Qavollin. U përqafuam, si përqafohen vëllezërit që nuk janë parë një kohë të gjatë. Ibrahim Qavollin e njoftova për gjendjen e re politike në Kosovë, për gjendjen në radhët e organizatës sonë politike si dhe për burgosjet dhe represionin e pushtetit serb. Pas rreth dy orësh bisede u përqafuam edhe njëherë dhe u ndamë.

Isha shumë i lumtur që pata rastin ta takoja një përfaqësues të shtetit shqiptar, por isha i kënaqur edhe për çështjet që biseduam dhe rrjedhën e takimit. Për mendimin tim takimi ishte vëllazëror dhe i hapur.

Duke u kthyer, Sabri Novosella, i bëri një koment të "çuditshëm" takimit:

– E dëgjove qëndrimin e shtetit shqiptar?! Dy të puthura në faqe dhe kaq! Po t'i kishe kontaktuar përfaqësuesit e shtetit shqiptar me pasaportën e Babiç Jankos dhe t'ju kishe thënë se je një marksist-leninist (ashtu siç je në të vërtetë!) , atëherë ata do të kishin pranuar krahëhapur dhe do të kishin ofruar vizitë në

Tiranë, duke të ofruar në atë rast çfarëdo ndihme që do të kishe kërkuar prej tyre,- më thotë Sabriu, rrugës për Adapazar!



Asllan Muharremi dhe Sabri Novosella

E dëgjova deri në fund, i mbusha mushkëritë me frymë dhe po mendoja se çka t'i përgjigjem.

– Duhet të bëjmë përpjekje ta kuptojmë drejtë qëndrimin e shtetit shqiptar. Kjo çështje duhet të jetë shumë më komplekse sesa duket në shikim të parë. Ndoshta, ne nuk jemi në nivelin e përgjegjësisë dhe për këtë arsye ata nuk na përkrahin ashtu siç duam ne?! – i thashë Sabriut.

– Ndoshta nuk jemi në nivelin e përgjegjësisë, por këtë qëndrim, shteti shqiptar e ka pasur edhe ndaj Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe bijve të tjerë të Kosovës martire. Pse nuk po i gjen shteti shqiptar ata bijë të Kosovës martire që ka besim në ta dhe nuk po na thotë: Ja këtyre u besojmë ne! Dhe unë jam gati të ec prapa tyre?!– më përgjigjet Sabriu.

Ato që kisha dëgjuar nga Ibrahim Qavolli nuk ishin asgjë më shumë nga ato që kisha lexuar në librat e Enver Hoxhës dhe dëgjuar në artikujt e "Zërit të Popullit" që i kishte emituar Radio Tirana. Ibrahim Qavolli na thoshte se "shteti shqiptar është që shqiptarët e Kosovës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë që gëzojnë popujt e tjerë të Federatës Jugosllave. Pra, shteti shqiptar ishte që Kosova ta fitonte statusin e Republikës në kuadër të Federatës jugosllave dhe të merr fund politika e përndjekjeve dhe pabarazisë". Nga ky qëndrim i shtetit

shqiptar, nëpërmjet Ibrahim Qavollit, unë po e kuptoja se shteti shqiptar nuk përkrahte programin politik të organizatës LNÇKVShJ-së, anëtar i të cilës isha dhe këtë e kisha kuptuar edhe nga artikujt e "Zërit të popullit" dhe qëndrimet që kisha dëgjuar në Radio Tiranë!

Nga e majta: Asllan Muharremi, Njazi Straja, Sabri Novosella
dhe Ymer Berisha

Mirëpo, këto qëndrime që po i bluja në kokë, nuk përmbanin asgjë kundër luftës sonë për liri dhe barazi, përkundrazi, mendoja se qëndrimet tona ndaj luftës së popullit tonë për liri dhe barazi në kuadër të Federatës jugosllave kishin disa defekte. Se ne, nuk e shihnim drejtë këtë luftë, dhe në praktikë ne e kishim të ngatërruar çështjen e luftës për barazi me luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar. Ne flisnim shumë se ishim përkrah kërkesës "Kosova-Republikë", por njëkohësisht ne kërkonim hapur edhe bashkimin me Shqipërinë! Kisha përshtypjen se lëvizja jonë revolucionare ende nuk ishte liruar nga disa qëndrime dogmatike dhe në praktik ne ende nuk ishim dialektik dhe revolucionar të mirëfilltë, ashtu siç pretendonim. Gjithashtu, unë mendoja, se në terren në vend që t'i bashkonim të gjitha energjitë tona për realizimin e "Kosovës-Republikë", ne i kishim shpërndarë ato në disa fronte.

Ndonëse kishim qëndrime diametralisht të kundërta për çështjen e politikës së shtetit shqiptar në raport me organizatat tona politike dhe veprimtarisë sonë atdhetare e çlirimtare, me kalimin e kohës, nisa ta admiroj dhe respektoj edhe më shumë Sabri Novosellën. Për mua, Sabriu ngelej një luftëtar i madh i çështjes shqiptare, që nuk e fshihte mendimin e tij, që këtë e bënte hapur edhe para përfaqësuesve të shtetit shqiptar, ashtu siç e shprehte para meje. Pakënaqësia e Sabri Novosellës ishte e lidhur me përpjekjet e tij për ta vendosur luftën tonë në binarë të drejtë dhe duke pasur parasysh këtë dhe faktin se ai e kishte kaluar një pjesë të madhe të rinisë dhe jetës së tij nëpër burgjet serbe unë gjeja mirëkuptim në qëndrimin e tij. Sabriu kishte pritur nga shteti shqiptar që

do t'i ndihmonte të gjitha organizatat tona politike të bashkoheshin rreth një platforme politike, që shteti shqiptar të merrte në dorë organizimin e kësaj lufte, që të ndihmohej nxjerrja e organit të Lëvizjes "Zërin e Kosovës" me kuadër nga Shqipëria dhe që lufta jonë të ndihmohej edhe materialisht. Meqë kjo nuk kishte ndodhur nga ana e shtetit shqiptar, Sabriu shpërthente dhe e shprehte pakënaqësinë e tij!

Nga Sabri Novosella jam njoftuar edhe për veprimtarinë e Xhafer Durmishit, që nga vrasja e Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe Bardhosh Gërvallës si dhe për rolin e tij në organizimin e veprimtarisë së Lëvizjes në emigracion; për rolin e tij në vazhdimin e nxjerrjes së organit "Zëri i Kosovës" si dhe për veprimtarinë e tij dhe të shokëve tjerë, që kishin vepruar pranë Jusuf Gërvallës.

Sabri Novosella, më ka folur gjithashtu edhe për veprimtarinë e Xhafer Shatrit, Abdullah Prapashticës dhe Ibrahim Kelmendit.

Xhafer Shatrin e admironte dhe e çmonte shumë. Më ka folur me shumë admirim për qëndresën e Xhafer Shatrit nëpër burgjet jugosllave, por edhe për veprimtarinë e tij në emigracion:

– E keqja është bacë se shteti shqiptar nuk po e do! Madje ata të *Shtëpisë së Madhe* [29] janë duke shprehur dyshim në mënyrën e largimit të tij nga burgu, – më tha gjatë një bisede Sabriu.

Ndërsa Abdullah Prapashticën e ka prezantuar kështu:

– Abdullah Prapashtica është një njëri që ka punuar në Shërbimin e Sigurimit të Shtetit Jugosllav, Dega në Prishtinë. Para se të arratisej në Turqi, Abdullah Prapashtica, ka qenë hetues, veç të tjerëve, edhe i grupit të shokëve të LNÇKVShJ-së, gjatë arrestimeve të nëntorit dhe dhjetorit 1979. Për motive që është vështirë të kuptohen, Abdullah Prapashtica, i le shokët e organizatës së tij në burg, e merr me vete gruan e tij, një ish e burgosur në nëntor 1979, Osman Osmanin dhe nipin e tij, Faton Topallin dhe largohet nga Kosova!

Lidhur me Ibrahim Kelmendin dhe punët e tij, Sabri Novosella, më ka thënë:

– Ibrahim Kelmendin nuk e kam takuar asnjëherë. Unë i kam kërkuar Jusuf Gërvallës që ta ofronte, por Jusuf Gërvalla në letrat e tij më ka bërë të jem i kujdesshëm. Jusuf Gërvalla nuk ia ka pasur besën. E ka ndihmuar në nxjerrjen e organit "Bashkimi" për hir të lexuesve. As shokët tjerë, që e njohin, nuk kanë simpati për punët e Ibrahim Kelmendit.

– Po përse u bashkuat me Abdullah Prapashticën? A e dinit se ai ishte njëri i Shërbimit të Sigurimit të Shtetit Jugosllav, para se të vinte në Turqi? – e pyeta Sabri Novosellën?

– Po bacë, e dija se ku kishte punuar dhe vetë fakti se i kishte lënë të gjithë shokët në burg dhe kishte ikur i vetëm me "udhëheqjen" e PKMLSHJ-së, më kishte ngjallur shumë dyshime. Mirëpo problemi ishte se përfaqësuesi i shtetit shqiptar na e imponoi bashkëpunimin dhe bashkimin me Avdullah Prapashticën, – më përgjigjet Sabri Novosella!

Asgjë s'po merrja vesh. Gjithçka më dukej si një lëmsh që s'ia gjeja fillin. Unë kisha dëgjuar në Kosovë për burgosjen e grupit të PKMLSHJ-së dhe për dënimet e rënda që kishin marrë anëtarët e saj nga Gjykata e Prishtinës, por nuk kisha lexuar asgjë nga materialet e tyre programore dhe nuk kisha takuar asnjëherë ndonjë anëtar të kësaj organizate. Ku ta dish se në çfarë rrethanash i ka rekrutuar Abdullah Prapashtica në partinë e tij gjithë ata djem e vajza?!– më fluturonte mendja.

Në Adapazar. Nga e majta: Ymer Berisha, Asllan Muharremi, Sabri Novosella, Abdullah Prekadini dhe Sabri Kosova

Gjatë qëndrimit tek Sabri Novosella jam takuar edhe me Abdullah Prekadinin, Sabri Kosovën të cilët banonin në Adapazar dhe Njazi Strajen me banim në Stamboll, që ishin edhe anëtarë të LNÇKVShJ-së dhe Komitetit të Degës "Hasan Prishtina". Ata ishin burra shumë të mirë dhe mbaheshin krenar për përkatësinë e tyre kombëtare. Njazi Straja, kishte një lokal të argjendarisë në Stamboll dhe ishte i dënuar në mungesë nga një Gjykatë jugosllave për bashkëpunim dhe bashkëveprim në kuadër të "Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve."

Adapazari ishte një qytet i madh dhe kishte disa mijëra shqiptarë me origjinë nga Kosova, Shqipëria dhe Çamëria. Një pjesë e të moshuarve e njihte gjuhën shqipe, ndërsa brezi i dytë dhe i tretë ishin asimiluar plotësisht. Gjatë bisedave me Sabriun dhe të tjerët kam dëgjuar shumë histori rrëqethëse të bashkatdhetarëve tanë të tretur në dhe të huaj, për mallin dhe dhembjen e madhe që ata kishin për atdheun e tyre...

Përkundër numrit të madh të gjakut shqiptar, ndikimi i Komitetit "Hasan Prishtina" tek shqiptarët në Turqi ishte shumë i vogël. Veç kësaj Turqia ishte një diktaturë ushtarako-policore. Në Turqi nuk lejohej veprimtaria e Degës së Komitetit "Hasan Prishtina". Çdo aktivitet në dobi të çështjes sonë bëhej në

mënyrë ilegale, pothuajse si në Kosovë. Edhe veprimtaria e Sabri Novosellës ishte e kufizuar për shkak të qëndrimit që kishte shteti policor e ushtarak i Kenan Evrenit (një fashist me origjinë shqiptare, që ishte në krye të Ushtrisë Turke) ndaj veprimtarisë së lirë politike dhe demokracisë.

Një ditë në banesë , Sabriu u kthye nga puna së bashku me një burrë të moshës rreth tridhjetëvjeçare, me një shtatë mesatar, me flokë ngjyrë bionde dhe pamje serioze, të cilin Ymer Berisha e prezantoi se ishte Shukri Demiri. Shkuri Demri fliste një shqipe që nuk dallonte fare nga ajo e njerëzve që jetonin në rrethin e Karadakut të Gjilanit. Unë mendova se mos ka ardhur ndonjë vizitor nga Kosova?

Në atë rast mësova se Shukri Demiri ishte me prejardhje nga fshati Izvor i Karadakut të Kumanovës dhe pas vdekjes së të atit të tij, qysh në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, së bashku me të ëmën, një vëlla dhe dy motra ishin shpërngulur në Turqi. Pas vendosjes në Turqi dhe ndërrimit të mbiemrit, nis shkollën e mesme të policisë dhe pas mbarimit të saj edhe punën si policë në Stamboll.

Pas shkuarjes së Shukri Demirit, nga Ymer Berisha kam mësuar historinë e tentim-kidnapimit të Sabri Novosellës nga ana e UDB-ës jugosllave, disa muaj pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës në Untergruppenbach të Gjermanisë.

UDB-a jugosllave angazhon oficerin në pension, Branko Rulla nga Kumanova për kidnapimin e Sabri Novosellës.

Për ta realizuar kidnapimin, Branko Rulla, nis në Turqi Rrahman Zylfihun nga fshati Debecë afër Kumanovës së bashku me një agjent tjetër jugosllav.

Në Stamboll, Rrahman Zylfihi i afrohet Shukri Demirit dhe i ofron një shumë marramendëse parash, nëse do "ta ndihmonte për ta dërguar një hajdutë bankash deri në kufi me Greqinë".

Një nga detyrat e Shukri Demirit ishte pikërisht ndjekja e kriminelëve ekonomikë, punë kjo që ai e bënte me pasion të madh. Qysh në fëmijëri nga prindërit e tij, ishte edukuar për ta luftuar të keqën dhe padrejtësinë dhe gjatë moshës së pjekurisë ai ishte përcaktuar për të qëndruar përkrah vegjëlisë dhe drejtësisë. Në shtëpinë e tij ai fliste vetëm shqip dhe dëgjonte vetëm këngë shqiptare.

Mirëpo, meqenëse Rrahman Zylfisit i ishte ofruar "detyra" e kapjes së një "hajduti të bankave" dhe me qëllim të njohjes me "hajdutin e bankave", e merr me vete një shok të tij dhe shkon në Adapazar. Pa vështirësi e gjen edhe dyqanin e Sabri Novosellës dhe sapo hynë brenda nis bisedën në gjuhën turke. Pas pak Shukriu e kupton se turqishtja e Sabri Novosellës nuk ishte e rrjedhshme dhe për këtë arsye e pyet se nga cili vend ishte me prejardhje?

– Jam shqiptar nga Kosova,– i përgjigjet Sabri Novosella.

–Pse ke ikur nga Kosova? Mos ke vjedhur ndonjë bankë? – e provokon Shukri Demiri.

– Jo, nuk jam hajdut. Kam luftuar për *bajrak*![30] – i përgjigjet Sabri Novosella.

Përgjigjeja e Sabri Novosellës e befason Shukri Demirin, i cili vazhdon ta pyet se kush ishte dhe cilat ishin arsyet e ardhjes së tij në Turqi? Pas shpjegimeve të Sabri Novosellës se ka qëndruar në burg për flamur e liri, ashtu si edhe një vëlla i tij dhe shumë të tjerë, Shukri Demiri, i shpjegon se kush ishte dhe se cili ishte qëllimi i ardhjes së tij në dyqanin e tij, nga Stambolli.

Menjëherë pas kësaj bisede, Shukri Demiri e kontakton policinë turke në Adapazar.

Policia turke merr përsipër mbrojtjen e Sabri Novosellës dhe familjes së tij. Gjithashtu policia turke nis hetimin e rastit dhe e futë në lojë Shukri Demirin.

Pas ndjekjeve disaditore, policia sekrete turke prangos Rrahman Zylfihin dhe gjatë hetimeve ai e pranon se kush e ka dërguar dhe se kush ka qenë i përfshirë në këtë plan kriminal. Rrahman Zylfihi me banim në rrethin e Kumanovës dhe i vëllai i tij Rabit Zylfioglu, me banim në Stamboll, dënohen me nga katër vjet burg, ndërsa dy agjentë të tjerë jugosllav arrijnë të largohen nga Turqia.

Gjatë procesit gjyqësorë mësohet se Branko Rulla, një ish partizan dhe oficer i UDB-ës në pension, ishte organizatori i këtij tentim kidnapimi të Sabri Novosellës.

Gjykata e Stambollit u jep dënime prej 4 vjet e gjashtë muaj dy spiunëve të UDB-ës (Rrahman Zylfihit dhe Rabit Zylfioglu).

***

Në javën e fundit të gushtit 1983, në shtëpi të Sabri Novosellës në Adapazar vije një burrë rreth të dyzetave, që mbante mustaqe dhe që me vete e kishte të shoqen e fëmijët e tij si dhe një shok, që i shoqëronte!

Burri që na erdhi nga Kosova, Sabri Novosella e prezantoi se ishte Teki Dërvishi, të cilit ia kisha dëgjuar emrin dhe e njihja si shkrimtar, dramaturg dhe gazetar, por nuk e njihja më shumë. Sabri Novosella më tha se Teki Dervishi është shok i "Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" dhe se ardhja e tij në Turqi nuk ishte e rastësishme, por e parapërgatitur qysh pas vrasjes së Jusuf Gërvallës.

– Do të flas me Ukën (Xhafer Shatrin) dhe jam i mendimit që Teki Dërvishi dhe familja e tij, të vendoset në Zvicër. Në Zvicër, Teki Dervishi do të merret me organin e LRSShJ-së "Zëri i Kosovës",– më tha Sabri Novosella.

Gjatë kohës sa qëndroi në banesën e Sabri Novosellës në Adapazar, Teki Dervishi është njoftuar për gjendjen dhe veprimtarinë e LRSShJ-së në emigracion si dhe për qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj përpjekjeve tona për liri. Sabri Novosella e ka njoftuar Teki Dervishin edhe për mos mbështetjen financiare të shtetit shqiptar të veprimtarisë sonë.

Ditën e tretë, Teki Dërvishi së bashku me të shoqen e tij, fëmijët dhe shokun (Ferid Kabashi) që i shoqëronte u nisën për Zvicër. Ata do të vendoseshin diku në Zvicër, afër redaksisë së "Zërit të Kosovës" që ishte në Gjenevë tek Xhafer Shatri. Së bashku i përcollëm dhe ju dëshiruam udhë të mbarë!

Sabri Novosella e njoftoi Xhafer Shatrin dhe Xhafer Durmishin për nisjen e Teki Dërvishit nga Turqia në Zvicër.

Unë isha shumë i lumtur dhe krenar që isha njohur me Teki Dërvishin, por edhe shumë krenar që redaksia e "Zërit të Kosovës" do ta kishte në gjirin dhe ballin e saj një personalitet të tillë të letrave dhe mendimit shqiptar. Krenar dhe i lumtur ndjehej edhe Sabri Novosella.

Pas disa ditësh erdh Sabri Novosella dhe më njoftoi se kishte marrë vesh se Teki Dërvishi nuk e kishte vazhduar rrugën për Zvicër, por ishte kthyer në Kosovë! Një zhgënjim i madh na pushtoi të gjithëve.

– Shteti amë nuk na ndihmoi materialisht dhe unë për këtë arsye nuk arrita t'i përmbush premtimet e mia që i kisha bërë Teki Dërvishit. Ai e kuptoi të vërtetën e qëndrimit të shtetit shqiptar karshi luftës sonë për liri dhe i demoralizuar nga ky qëndrim, u kthye në Kosovë, – më tha Sabri Novosella.

Largimi nga Turqia

Sipas ligjit, në Turqi , turistët mund të qëndronin pa u lajmëruar tek organet policore dy muaj. Pak para skadimit të afatit duhej lëshuar vendi. Kështu kishte bërë Ymer Berisha. Gjatë gjithë kohës së që qëndrimit të tij në Turqi, çdo dy muaj ai kishte kaluar në Bullgari dhe pastaj ishte kthyer përsëri në Turqi.

Po afronte dita e gjashtëdhjetë e qëndrimit tim në Adapazar. Gjatë bisedave që kisha bërë me Sabriun dhe Ymerin, ishim pajtuar që disa ditë para skadimit të afatit të ditës së hyrjes sime në Turqi, të largoheshim në drejtim të Evropës Perëndimore. Turqia nuk ishte vend për ne dhe nuk kishte punë për ne. Shqiptarët që ishin aty, në masë të madhe ishin asimiluar dhe mundësitë tona të zhvillimit të veprimtarisë politike nga aty, ishin shumë të vogla. Këtë e pohonin edhe vetë Sabriu dhe shokët e Komitetit "Hasan Prishtina". Sabriu, mezi arrinte të mbijetonte ekonomikisht nga puna që bënte në dyqanin e tij të rrobaqepësisë. Edhe Sabriu kishte mendime të largohej nga Turqia.

Meqë aty isha me pasaportë të falsifikuar dhe qëndroja me rrezikun e përditshëm të ndalimit nga ana e policisë turke, që mund të ishte fatal për mua, unë mezi po pritsha të largohesha nga Turqia. Gjithashtu në Turqi nuk më rrihej. Asgjë nuk më lidhte me atë vend, pos kujtimeve të hidhura që kisha nga halla e tim atë dhe ato që kisha lexuar për trajtimin e shqiptarëve gjatë shekujve nën pushtimin e Perandorisë Osmane.

Me 12 shtator 1983 jemi përshëndetur me shokët e Degës së Komitetit "Hasan Prishtina" dhe familjen bujare dhe të mrekullueshme të Sabri Novosellës.

Për mua ajo ditë ishte një ditë përzier me çaste gëzimi dhe hidhërimi. Në një anë gëzohesha që po largohesha nga Anadolli, por në anën tjetër më vinte keq për shokët dhe miqtë që po ngeleshin aty. Sidomos më vinte keq për Sabri Novosellën që po ngelej aty me një grusht shokësh. Ai edhe ashtu ishte i lodhur dhe dërmuar nga jeta nëpër burgje dhe jeta larg familjes së tij. As ai nuk ndjehej mirë dhe rehat në Turqi. Në Kosovë, Sabri Novosella i kishte lënë jo vetëm nënën Naile, për të cilën fliste me admirim të madh, sa herë e zinte në gojë, por edhe vëllezër e motra si dhe dy djemtë: Ilirin dhe Dardanin, të cilët nuk i kishte takuar që nga largimi i tij nga Kosova në vitin 1979.

Nga Adapazari u nisëm së bashku unë dhe Ymer Berisha. Rrugën deri në Stamboll e kaluam pa folur shumë në mes veti. Heshtja na kishte pushtuar të dyve. Ymer Berisha po largohej nga Adapazari pas dy vitesh qëndrimi. E kuptoja se e përjetonte më rëndë se unë këtë ndarje. Edhe ai, ashtu si edhe unë

po niseshim drejt Evropës Perëndimore, pa ditur se ku po shkojmë. Të vetmin njeri që e njihnim nga Kosova ishte Xhafer Durmishi.

Në Stamboll u takuam me një mik të Ymer Berishës i cili do të na ndihmonte ta merrnim autobusin për Sofje.

Nuk pritëm shumë dhe vendosëm bagazhet tona dhe hymë e zumë vende në autobusë.

Ymer Berisha, pas bisedës me mikun e tij, më njoftoi se ne do të udhëtonim me autobusë deri në vendkalimin kufitar në Edrene. Sipas rregullave që kishin linjat e autobusëve, numri i pasagjerëve që hynë në Bullgari, duhet të ishte i njëjtë me numrin e atyre që dalin nga Bullgaria. Prandaj, meqë ne do të udhëtonim deri në Sofje, duhej të zbrisnim dhe ta kalonim kufirin Turqi-Bullgari ose në këmbë ose me ndonjë mjetë tjetër udhëtimi.

Pas një copë udhëtimi arritëm në Edrene. Sipas marrëveshjes që kishim zbritëm nga autobusi, morëm bagazhet tona dhe u nisëm drejtë pikës turke të kontrollimit të pasaportave dhe të doganës.

Në sportel, ku kontrolloheshin pasaportat, unë dhe Ymer Berisha shkuam veç e veç. Këtë e bënim kinse nuk njiheshim me njëri-tjetrin dhe për çdo të papritur. Mendonin se nëse më ndalon mua policia, që kisha pasaportë të falsifikuar, të mos pësonte Ymer Berisha.

Pas kontrollimit të pasaportës së Babiç Jankos, shikimit të fotografisë së tij dhe shikimit të fytyrës sime, polici ma hodhi para duarsh pasaportën, të cilën unë e mora dhe pa ngurrim e futa në xhep dhe u largova menjëherë nga aty.

Nuk vonoi shumë dhe përsëri u bëmë bashkë me Ymer Berishën. Ndodheshim, në një zonë neutrale, as Turqi e as Bullgari. Autobusi do të na priste, në parkingun e një restoranti, brenda në Bullgari. Të shkonim këmbë deri në pikën e kontrollimit të pasaportave, dyshonim se do ta zgjonim kureshtjen e policëve bullgarë dhe ata do të na kontrollonin, e ndoshta edhe do të më zbulonin se isha me pasaportë të falsifikuar? Nga t'ia mbanim vallë? Si të bënim? Papritur, e shohim një makinë të parkuar me regjistrim të Shkupit. Brenda në makinë, qëndronte ulur një burrë i ri i moshës sonë. Ymerit i thashë të shkonte dhe ta pyeste se mos na merrte në makinën e tij, gjer në anën bullgare. Ymeri shkon dhe kthehet e më thotë se nuk do të na merr me vete. Pas pak bisedojmë me Ymerin dhe pajtohemi që t'i ofrojmë njëqind marka gjermane. Përsëri kthehet Ymeri tek unë më sjell përgjigje negative. Diku pas një gjysmë ore dhe pasi Ymer Berisha i ofron treqind marka gjermane, "vëllai" nga Shkupi pranon të na merr në makinë. I futëm çantat tona në *Ladë* dhe u nisëm drejt pikës së kontrollit. Para se ta ndalonte makinën, Ymeri ia dha shoferit pasaportat tona. Shoferi e ndaloj makinën, e hapi dritaren dhe ia dorëzoj pasaportat kontrolluesit bullgar. Pas pak, shoferi ia dha një kuti me çamçakëz kontrolluesit. Kontrolluesi i pasaportave, ia kthej pasaportat dhe shoferi e nisi makinën e tij në drejtim të restorantit ku na priste autobusi.

Sapo dolëm në anën bullgare, ende pa arritur tek restoranti, shoferi i *Ladës* na i kërkoj treqind markat e premtuara. Ndonëse më dhimbeshin t'ia jepnim

treqind marka për katërqind metra udhë (sepse edhe e dija se paratë ishin të Ymer Berishes dhe ato të dërguara nga familja e tij në Kosovë), shoferit i thashë të mos bëhej merak se parat do t'ia japim sapo të arrijmë tek restoranti.

– Besa është besë, ne jemi të besës,– i thashë shoferit.

Nuk vonojë shumë dhe arritëm tek restoranti, Ymer Berisha, nxori nga xhepi treqind marka dhe ia dha shoferit të *Ladës*. E falënderuam për ndihmën e i uruam udhë të mbarë!

Në Sofje arritëm pas disa orësh udhëtimi. Autobusi na la afër Stacionit Hekurudhor të Sofjes.

Nga Sofja, e morëm trenin Sofje-Mynih, i cili kalonte nëpër Bukuresht, Budapest dhe Vjenë.

Unë e kisha pasaportën e Babiç Jankos dhe ndjehesha mjaftë i lehtësuar meqë kaluam dy kontrolle kufitare, ndërsa Ymer Berisha e kishte pasaportën e tij të rregullt dhe nuk kishte asnjë arsye për shqetësim!

Meqë, kishim emra me "kombësi" të ndryshme në pasaportat tonë dhe kjo mund të binte në sy të kontrolluesve të pasaportave, u morëm vesh që nëpër vendkalime të mos qëndronim të ulur në të njëjtin vagon. Kalkulonim, që në rast, se nëse policia e zbulon pasaportën time të falsifikuar, unë do të përfundoja në Beograd, dhe kështu dëshironim të evitonim rrezikun që atje të përfundonte edhe Ymer Berisha.

Në vendkalimin në mes Bullgarisë dhe Rumanisë, ashtu siç ishim marrë vesh, u ndamë në vagon të ndryshëm. Nuk vonoj dhe policia kufitare hyri në vagonin tim. Unë nxora pasaportën nga xhepi dhe ia dhashë kontrolluesit të pasaportave. Ai i bëri një shikim të shpejtë dhe ma ktheu pasaportën. I gëzuar për këtë, unë e përshëndeta kontrolluesin me kokë dhe e futa me shpejtësi pasaportën në xhep.

Nuk vonoi shumë, dhe e pashë se në kabinën time, së bashku me kontrolluesin e pasaportës, erdhi edhe Ymer Berisha! Një e nxehtë ma kaploj trupin!

Polici na pyeste se përse ne "jugosllavët" nuk po rrinim ulur në një kabinë, por ishim të ndarë në vagonë të ndryshëm?!

Unë i thashë në serbisht se nuk e njihja personin që e kishte sjell aty.

Polici ma kërkojë përsëri pasaportën time dhe nisi ta shikojë me një llup, që e nxori nga xhepi. Gjithashtu, – ai e kontrollonte edhe pasaportën e Ymer Berishës dhe pas pak na i mori të dy pasaportat dhe e la kupenë tonë.

Një frikë e madhe më mbërtheu. I shqetësuar ishte edhe Ymer Berisha. Po prisnim me ankth të madh kthimin e policit që na i kishte marrë pasaportat.

– Mund të jetë ndonjë taktikë policore, – i thashë Ymerit – Ai mund ta ketë zbuluar se pasaporta ime është e falsifikuar, por qëllimisht na thotë se gjoja dyshon se pasaporta jote është e falsifikuar!

Ymer Berishën dhe mua na kishte mbuluar heshtja. Unë isha shumë i shqetësuar. Rumunët mund të më dorëzonin duarlidhur në Jugosllavinë fqinje! Marrëdhëniet e dy shteteve "komuniste" ishin të shkëlqyeshme.

Nuk vonoi shumë dhe erdhi polici me dy pasaportat në dorë. Një shenjë e mirë ishte fakti se ai ishte i vetëm dhe nuk kishte me vete edhe policë të tjerë.

– Përse udhëtoni nëpër Bukuresht dhe jo nëpër Beograd, që i bie shumë më shkurt?– na pyeti polici.

Unë i thashë se kisha dëshirë ta shihja Rumaninë dhe Hungarinë. Ymeri nuk tha gjë.

I shikoi edhe pak pasaportat tona, u mendua diçka dhe nuk vonoi shumë dhe na i ktheu pasaportat dhe u përshëndet me ne.

– O ç'gëzim! Shpëtuam edhe njëherë! – thamë pothuajse njëzëri Ymeri dhe unë.

Kufirin Rumani- Hungari e kaluam pa probleme.

Në kufirin Hungari-Austri arritëm natën vonë. Polici hungarez një burrë që ishte rreth të tridhjetë e pestave ishte një njëri i hareshëm dhe gazmor. Ai na përshëndeti dhe pasi e kontrolloi pasaportën time më kërkoj që ta përshëndetja me një "mirupafshim" në gjuhën time. Unë i shtanguar nga frika që kisha në brendi të trupit time ia kthej në gjuhën shqipe.

– Mirupafshim!

Polici kufitar nuk po e njihte përshëndetjen time dhe kërkonte nga unë që ta përshëndetja me *dovidenja*[30]!

Pas pak ai nisi ta kërkoj në kujtesën e tij se si thuhet dhe po më thotë vetëm fillim e fjalës së gjuhës së Babiç Jankos.

– *Dovi...*

– Aha, dovidenja! – i thashë, sepse e kuptova se ai dëshironte ta përshëndetja serbokroatisht.

– *Dovidenja*! – ma ktheu dhe e mbylli derën e kabinës dhe iku tutje në vagon.

– Uh... – nxora nga mushkëritë e mia gjithë frymën që kisha.

Nuk vonoi shumë dhe në kabinën time hyri edhe polici austriak. Edhe ai ma kërkoi pasaportën. Austriaku, e hapi pasaportën dhe pasi e shfletoi dhe e shikoi Babiç Jankon dhe mua, ma ktheu pasaportën duke më përshëndetur me një:

– *Auf Wiederschen!*[31]

Hyrja në Austri më shkaktoj lehtësim të madh. Tani nuk shqetësohesha fare nëse policia do të më ndalonte pa arritur në Gjermani. Nëse do të ndodhte një gjë e tillë, e kisha ndërmend të kërkoj strehim politik dhe t'jua them të vërtetën se kush isha dhe përse kisha ikur nga Kosova.

Kufirin Austri- Gjermani e kaluam pa telashe. Ishte diku në mesë orës katër e pesë të mëngjesit. Sapo hyra në Gjermani u futa edhe njëherë në tualetin e trenit, i lava sytë dhe u ula përsëri bashkë me Ymer Berishën në kabinën tonë.

Në Shtutgart

Pasditen e 15 shtatorit arritëm në Shtutgart. Në mbrëmje, u takuam me Xhafer Durmishin (të cilin të gjithë e njihnin si Skënder). Isha shumë i gëzuar.

Shtutgarti ishte një qytet i madh. Nga shokët mësova se në Shtutgart e rrethinë, kishte një numër të madh bashkatdhetarësh, që vinin nga viset e ndryshme të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare.

Ditët e para, Xhafa (Skënderi) na ka folur për gjendjen në emigracionin shqiptar në Gjermani dhe vendet tjera të Evropës Perëndimore. Gjithashtu Xhafa na ka njohur edhe me shumë bashkatdhetarë, të cilët ishin edhe veprimtarë të shquar të luftës për liri, si Remzi Ademaj, Faridin Tafallari, Hafiz Gagica, Mehdi Rexha, Shaban Bobaj, Nami Ramadani e të tjerë.

Shumica e bashkatdhetarëve të rrethit të Shtutgartit, që kam pasur rastin t'i takoj, ishin mërgimtarë të viteve të shtatëdhjeta dhe ishin në marrëdhënie pune. Mirëpo, vetëm një numër i vogël i tyre i kishte me vete edhe familjet. Disa prej tyre nuk mund të udhëtonin tek familjet e tyre, në Kosovë dhe viset tjera shqiptare, për shkak të pjesëmarrjes së tyre në veprimtari liridashëse, përkrah Jusuf e Bardhosh Gërvallës.

Bashkatdhetarët e rrethit të Shtutgartit kishin edhe një lokal që e quanin Odë, ku ata takoheshin, sidomos gjatë ditëve të pushimit nga puna. Ky lokal ishte kryesisht për atë pjesë të bashkatdhetarëve që nuk udhëtonin në Kosovë. Ata mblidheshin aty qysh nga koha kur ka qenë i gjallë Jusuf e Bardhosh Gërvalla.

Në Odën e rrethit të Shtutgardit, e kam takuar për herë të parë edhe Milaim Zekën, i cili ato ditë ishte arratisur nga Kosova. Milaim Zeka atë mbrëmje për të pranishmit recitoi një vjershë patriotike me motive nga Lidhja e Prizrenit.

Në Mynih tek Muharrem Gjocaj

Qëndrimi disaditor në rrethin Shtutgartit, ma dha mundësinë të njihesha me shumë bashkatdhetarë. Në Shtutgart kishte një numër të madh bashkatdhetarësh dhe unë me shumë dëshirë do isha ndaluar aty. Mirëpo Xhafa kishte biseduar me shokët dhe ata ishin pajtuar, qysh para ardhjes sime në Shtutgart, që unë të vendosesha në Mynih. Unë nuk ua bëra dy fjalë për këtë. Isha i gatshëm të shkoja e të veproja aty ku do të ishte nevoja.

Largimi nga Shtutgarti, ishte një moment tjetër i dhimbshëm. Ymer Berisha do t'ia mësynte Francës. Unë kisha nevojë për ndihmën dhe përvojën e Xhafës dhe kisha dëshirë të qëndroja pranë tij. Ndonëse, sapo kisha ardhur në Gjermani, kisha filluar ta kuptoj se veprimtaria jonë në radhët e emigracionit, ishte shumë më e ndryshme nga ajo në Kosovës dhe se ajo për mua kishte shumë të panjohura për mua.

Në fund të shtatorit 1983 me ndihmën e shokëve të Shtutgartit u vendosa në Mynih.

Muharrem Gjocaj, nga rrethi i Junikut, ma hapi derën e banesës së tij dhe më dëshiroi mirëseardhje! Ai jetonte dhe punonte prej shumë vitesh në Munih. Për shkak të bashkëpunimit me Jusuf e Bardhosh Gërvallën, kishte disa vite që kishte rënë në sy të UDB-ës dhe nuk guxonte ta vizitonte familjen e tij në Kosovë.

Që nga dita e parë e njohjes me te, sa herë e shikoja Muharremin, me dukej se e kisha parë diku, por nuk arrija ta gjeja se ku e kisha parë! Ditën kur më tha se e kishte një vëlla që kishte qëndruar në izolim dhe se vëllai i tij quhej Zenun Gjocaj, gjithçka u bë e qartë- ata ishin vëllezër dhe i ngjanin shumë njëri-tjetrit. U gëzuam shumë që dolëm të njohur.

Muharrem Gjocaj nuk kishte ndonjë shkollim të lartë, por jeta në mërgim kishte qenë një shkollë e madhe për të. Ai kishte njohuri të shkëlqyeshme për emigracionin tonë politikë dhe jo politikë, në Munih dhe më gjerë.

Pas vendosjes sime në Munih, fillova të njihem me qytetin dhe shqiptarët që jetonin aty. Muharremi punonte gjithë ditën dhe unë e kaloja kohën duke lexuar apo duke bërë ndonjë shëtitje të vogël afër banesë së tij. Kur vinte nga puna me Muharemin bisedonim për çështje të ndryshme. Ai po më mahniste me zgjuarsinë dhe modestin e tij. Nuk m'u deshtë shumë kohë që të bindesha se ishte një privilegj i madh të bisedoje e t'i dëgjoje mendimet e tij të zgjuara për shumë çështje të luftës sonë.

Qysh në Turqi isha marrë vesh me Sabriun që sapo të vendosësha diku në Evropën Perëndimore, qoftë edhe përkohësisht, ta kontaktoja Ukën (Xhafer Shatrin) dhe kështu do ta nisja bashkëpunimin tim me te.

Sabriu më kishte njoftuar se bashkëpunimi në mes Ukës (Xhafer Shatrit) dhe Skënderit (Xhafer Durmishit) nuk kishte shkuar aq mirë dhe se kjo, sipas tij, nuk kishte ndodhur për fajin e Skënderit. Përkundër kësaj, Sabriu ishte i mendimit që bashkëpunimi në mes dy krahëve të lëvizjes sonë nacionalçlirimtare, të vazhdonte dhe forcohej.

– Ti bacë i ke "nervat e kalit", prandaj përpiqu të bashkëpunosh me Ukën për hir të çështjes sonë kombëtare,– më pati porositur Sabriu kur më përcolli për Evropë!

Një mbrëmje, u drejtova tek një automat telefonash, meqenëse Muharremi nuk kishte telefon në banesë, dhe e mora në telefon Ukën.

Uka më priti mirë dhe u tregua i gatshëm ta nisnim bashkëpunimin, ashtu siç ishin pajtuar ai dhe Mërgimi (Sabri Novosella).

Pas telefonatës së parë, me njëri-tjetrin ndërruam disa letra dhe bëmë disa biseda telefonike. Unë isha i kënaqur me Ukën dhe gjithashtu kisha përshtypjen se edhe ai ishte i kënaqur me ato çështje që i kisha shkruar dhe ato që i kisha thënë gjatë bisedave telefonike.

Një mbrëmje tjetër shkova tek kabina e telefonit dhe e mora përsëri në telefon Ukën. Gjatë bisedës ai më propozoi që të bashkëpunoja edhe me një shok të tij që banonte në Munih. Uka më foli fjalë shumë të mira për shokun e tij. Unë e pranova me kënaqësi propozimin, madje edhe e falënderova për besimin dhe gatishmërinë e tij për të bashkëpunuar me mua!

Sapo u ktheva në banesë iu drejtova Muharremit dhe e pyeta se a e njihte shokun e Ukës dhe se si mund ta gjeja e të takohesha me te?

Kur e zura në gojë emrin e personit që po e kërkoja, Muharremi u ndje shumë i habitur për lidhjen e propozuar nga ana e Ukës dhe menjëherë më pyeti:

– A e njeh mirë, këtë njeri, shoku yt në Zvicër?

U befasova dhe nuk dija se çka t'i përgjigjesha Muharremit. Reagimi i tij më më bëri kureshtar të dija më shumë për personin që më kishte propozuar ta takoja Uka. Prandaj, Muharremit i bëra shumë pyetje lidhur me aktivistin e Ukës. Nga përgjigjet e tij mësova se personi në fjalë ishte një njeri i shthurur dhe që njihej si njëri që frekuentohej me elementë të ekstremit të djathë shqiptarë, të cilët mund të ishin edhe në shërbim të UDB-ës!

Ndoshta Uka nuk e njeh sa duhet shokun e tij në Munih, – –i thashë vetës? Qëndrimi i Muharremit më bëri të mos ngutesha me takim me aktivistin e Ukës, madje edhe të tregohesha shumë i rezervuar edhe lidhur me vënien në kontakt të një shoku tim në Kosovë, me shok të Ukës, ashtu siç isha marrë vesh me Mërgimin në Turqi.

Një të shtune së bashku me Muharremin e vizituam Bibliotekën e qytetit të Munihut, e cila ishte shumë e madhe dhe shumë e pasur me literaturë nga e gjithë bota. Aty gjetëm edhe revistën "Jeta e Re" dhe në të edhe romanin e Adem Demaçit "Gjarpinjtë e gjakut" për të cilin kisha dëgjuar, por që nuk kisha pasur rastin ta lexoja në Kosovë. E luta Muharremin ta huazonte revistën "Jeta e re" në emër të tij dhe pas leximit e njoftova dhe Ukën për librin dhe ai m'u lut t'ia dërgoja menjëherë me postë në Zvicër. Disa ditë më vonë, pas kopjimit, Uka ma ktheu librin dhe ne e dorëzuam në Bibliotekën e qytetit të Munihut. Uka, pas pak kohe e dërgoi në shtyp dhe e botoi librin "Gjarpinjtë e gjakut". E kam çmuar shumë punën e Ukës për botimin e librit të Adem Demaçi, simbolit të qëndresës dhe luftës sonë për liri.

Gjithashtu gjatë kohës së qëndrimi tim në Munih, për disa ditë ishte i hapur një panair i librit, ku merrte pjesë edhe Ndërmarrja e Përhapjes së Librit nga Tirana. Në mesin e librave e pashë edhe romanin "Rrotull" të Jusuf Gërvallës, i cili sapo kishte dalë nga shtypi. Meqë përfaqësuesit e "Ndërmarrjes së Përhapjes së Librit", pjesëmarrës në panair, e kishin vetëm një ekzemplar të librit, unë i luta ata që të ma mundësonin ta merrja me vete librin, pas mbylljes së panairit, pasdite vonë, dhe jua dhashë besën se do t'jua ktheja librin ditën e nesërme, herët në mëngjes. Kështu edhe bëra. Romanin "Rrotull" e lexova, për herë të parë, brenda një nate.

Pas disa ditësh, një mbrëmje i telefonova përsëri Ukës. Ai edhe gjatë kësaj bisede e shtroi çështjen e kontaktit të një shoku të tij me *Gjonin* në Kosovë. Unë nuk e refuzova kërkesën e tij, por pas ofertës që më kishte bërë për të bashkëpunuar me shokun e tij në Munih, isha shumë i rezervuar dhe i thashë *Ukës* :"Para se ta jap emrin dhe adresën e *Gjonit* në Kosovë, më duhet ta njoftoj *Gjonin* se një shok i imi dhe i Lëvizjes do ta kontaktonte. Fatkeqësisht unë nuk kam arritur ta kontaktoj *Gjonin* dhe për këtë arsye duhet të presim gjersa të arrij ta bëjë një gjë të tillë. *Gjoni* është i përndjekur nga UDB-a dhe ai nuk pranon të lidhet me dikë që nuk e njeh."

Uka e pranoi shpjegimin tim dhe kështu e mbyllëm, përkohësisht, këtë çështje, për mua, shumë të ndjeshme.

Ndonëse isha i rezervuar lidhur me lidhjen e shokëve në Kosovë, asnjëherë nuk kam dyshuar në besnikërinë e *Ukës*. Nuk dija se kush do ta kontaktonte *Gjonin* dhe shokët në Kosovë nuk guxoja t'i rrezikoja në asnjë mënyrë. Fundi i fundit kjo ishte një nga arsyet që më kishte shtyrë ta lëshoja Kosovën.

Një mbrëmje, si zakonisht, dola përsëri tek kabina e telefonit, që e kisha disa qindra metra larg banesës, dhe e marrë në telefon *Ukën*. Ai, dukej shumë i gëzuar! U gëzova edhe unë për gëzimin e tij. Vetë me vete thashë se mos ka ndonjë lajm të mirë nga Kosova! Nuk vonoi shumë dhe *Uka* e barti telefonin tek një shok që ishte i pranishëm në banesën e tij, pa e prezantuar fare se kush ishte! E përshëndeta *Shokun* dhe nisa ta pyes për shëndetin. Zërin nuk po ia njihja. Pas pak nisa edhe ti kërkoj falje, sepse vetëm me ndihmën e zërit nuk po e gjeja se cili ishte! Nuk vonoi shumë dhe *Mërgimi* lëshoi një të qeshur,

karakteristike, dhe pikërisht fal të qeshurës së tij e gjeta se cili ishte. *Mërgimi* ishte shumë i gëzuar dhe shumë i lumtur që kishte ardhur tek *Uka*. U gëzova edhe unë sepse i kuptoja se ç'gëzim ndjen njeriu kur e takon një shok që se ka takuar një kohë të gjatë, ashtu siç nuk ishin takuar *Uka* dhe *Mërgimi* (Sabri Novosella më kishte folur shumë fjalë të mira për Xhafer Shatrin dhe më kishte treguar edhe për kohën që kishin kaluar së bashku nëpër burgjet serbe). Pas pak u përshëndetëm dhe unë u ktheva shumë i gëzuar në banesë tek Muharrem Gjocaj.

U gëzova që *Mërgimi* kishte ardhur nga Anadolli në Evropë. Shpresoja se ardhja e tij do të na ndihmonte në zgjidhjen e shumë problemeve që kishte Lëvizja jonë. Vizitën e Sabri Novosellës tek Xhafer Shatri, e shihja edhe si një mundësi të mirë që ata t'i shtronin e diskutonin, me njëri-tjetrin, disa çështje shumë të rëndësishme të veprimtarisë sonë dhe sidomos disa vërejtje lidhur me vijën politike të "Zërit të Kosovës", që ishin shprehur edhe nga përfaqësuesit e shtetit shqiptar në Turqi.

Të nesërmen, e mora në telefon Ymer Berishën në Francë. Më këtë desha ta pyes se si po kalonte dhe si ishin duke shkuar punët në rrethin e Parisit, por edhe për ta njoftuar për ardhjen e Sabri Novosellës në Zvicër. Ymer Berisha, menjëherë pas përshëndetjes, dhe ende pa arritur ta njoftoj për ardhjen e Sabri Novosellës më thotë:

– Kam folur me *Baci* (kështu e quanim Sabri Novosellën) dhe ai më tha se Xhafer Shatri është agjent i UDB-ës! Madje, *Baci* kishte edhe fakte për këtë!

U befasova shumë! Nuk po u besoja veshëve për atë që po dëgjoja.

– Mbrëmë kam folur me Bacin dhe Ukën. Ata ishin shumë të lumtur që ishin bashkë! Si ka mundësi që sot të del se Xhafer Shatri na qenka agjent i UDB-ës?! Dje, *Baci* nuk më dha asnjë shenjë, se nga Turqia kishte sjellur fakte, dokumente...Kjo është e pabesueshme, – i thashë Ymer Berishës?!

Pas shpjegimeve të mëtejme që më bëri Ymer Berisha, për bisedën që kishte pasur me Sabri Novosellën, u përshëndetëm me njëri-tjetrin. E lëshova receptorin e telefonit, e lash kabinën dhe ika i dëshpëruar në banesën e Muharrem Gjocajt. E tmerrshme! E pabesueshme! Si është e mundur që Xhafer Shatri të jetë agjent i UDB-ës, – e pyetja kokën time?

Më vonë, e mora në telefon Xhafën dhe i shpjegova për ato që kisha dëgjuar nga Ymer Berisha. Ai nuk dinte gjë për përplasjen në Gjenevë dhe për akuzat që kishte ngritur Sabri Novosella kundër Xhafer Shatrit. Edhe Xhafa u befasua nga lajmi i jashtëzakonshëm që po i përcillja. Ai më tha:

– Do të bisedoi me Sabriun dhe shokët në Zvicër dhe do të përpiqem të mësoi se ç'ka ndodhur...Por, në luftën tonë asgjë nuk është e pamundur,– më tha Xhafa, në fund të bisedës!

Akuza që kishte ngritur Sabri Novosella në adresë të Xhafer Shatrit ishte shumë e rëndë. Unë e kisha shumë të vështirë ta kuptoja të vërtetën. Qysh në Turqi, unë kisha dëgjuar, nga Sabri Novosella, se përfaqësuesit e shtetit shqiptar, gjatë kontakteve që ai kishte pasur me ta, i kishin shprehur rezerva dhe dyshime

lidhur me arratisjen të "pamundur" të Xhafer Shatrit nga burgu i Prishtinës. Edhe shokët tjerë që kishin pasur kontakte me përfaqësues të shtetit shqiptar u ishte shtruar pyetja :

– *Si e mbajnë derën e burgut, jugosllavët?! Të hapur?!*

Lidhur me këtë çështje edhe unë kisha biseduar me Sabri Novosellën në Turqi. Ai e kishte shpjeguar arratisjen e Xhafer Shatrit kështu: "Xhafer Shatrit i kishin ngelur edhe pak muaj burg nga dënimi i gjatë që kishte. Ishte një praktikë e zakonshme që të burgosurit që e kanë vuajtur shumicën e kohës së dënimit, të angazhohen në punë edhe jashtë burgut. Duke punuar jashtë burgu, Xhafer Shatri, sapo ka pasur rastin është arratisur."

Meqenëse edhe vetë kisha bërë një arratisje të pamundur, unë nuk shihja si të pamundur dhe versionin e shpjeguar për arratisjen e Xhafer Shatrit nga burgu. Në anën tjetër, Sabri Novosella asnjëherë nuk më kishte shprehur qoftë edhe dyshimin më të vogël lidhur me besnikërinë e Xhafer Shatrit. Përkundrazi, ai më kishte thënë se kishte besim të plotë në të. Sabri Novosella, për shkak të besimit të madhe që kishte në Xhafer Shatrin, më kishte propozuar që *Gjoni* (Xhemajl Pllana) të vihej në lidhje me një shok të Xhafer Shatrit. E vetmja gjë negative që Sabri Novosella më kishte folur me një çikë dyshim, ishte çështja e vijës politike që shfaqte Kryeredaktori në organin e LRSShJ-së "Zëri i Kosovës", sidomos lidhur me kërkesën "Kosova-Republike" dhe çështjen e bashkimit të trojeve shqiptare. Mos e ka këtu zanafillën përplasja në mes këtyre dy gjigantëve të Lëvizjes sonë,– e pyetja vetën time?

Një ditë më vonë, u njoftova për rrjedhën e përqafimeve dhe akuzave të ndërsjella në mes të Sabri Novosellës dhe Xhafer Shatrit. Ajo që kishte ndodhur, ishte për keqardhje. Sabriu ishte nxituar dhe shpërthyer, pa arritur të zgjidhte problemet që ishin të pranishme në radhët tona, sidomos ato që kishin të bënin me vijën politike të organit "Zëri i Kosovës". Gjaknxehtësia e treguar dhe sharjet e fyerjet, që Sabri Novosella i kishte bërë Xhafer Shatrit, në shtëpinë tij, nuk kishin ndikuar, për të mirë, në rrethin e shokëve tanë dhe as të rrethit të shokëve të Xhafer Shatrit. Me këtë kishte filluar të thellohej akoma më shumë çarja në mes nesh. Shokët e Lëvizjes ishin pozicionuar, disa përkrah Xhafer Shatrit dhe disa të tjerë, përkrah Sabri Novosellës. Unë për vete kisha frikë se agjentët e UDB-ës do t'i përdornin të gjitha mjetet e tyre, për t'i thelluar edhe më shumë dallimet tona.

Dy-tre ditë më vonë mora vesh se ishte mbajtur një takim ku kishin marrë pjesë: Xhafer Shatri, Sabri Novosella, Ibrahim Kelmendi, Hasan Mala, FaridinTafallari, Haxhi Berisha dhe ndonjë tjetër dhe ishin pajtuar për uljen e gjakrave dhe vazhdimin e nxjerrjes së "Zërit të Kosovës" mbi bazat e një vije tjetër politike e cila do t'i merrte parasysh vërejtjet e shprehura nga Sabri Novosella.

Uroja që përplasja e "gjigantëve" të Lëvizjes sonë të mos na përçante edhe më shumë! Për këtë qëllim mbaja kontakte të vazhdueshme me Xhafën dhe shokët tjerë. Qëndrimet e shokëve dhe sidomos ato të Xhafës, që bazoheshin

mbi përvojën e tij personale me Xhafer Shatrin, më jepnin pak shpresë se nga kjo përplasje do të dalim më të fortë, ashtu siç ishin të vogla shpresat se Xhafer Shatri do të reflektonte.

Dyshoja se shpërthimi i Sabri Novosellës, akuzat e tij kundër Xhafer Shatrit dhe vijës politike që ishte shfaqur në faqet e organit "Zëri i Kosovës", nga ana e Xhafer Shatrit dhe shokët e tij do ta përdoreshin, jo për të reflektuar pozitivisht dhe për të nxjerrë mësime nga gabimet, por për ta thelluar edhe më shumë përçarjen në mes të ish OMLK-së dhe LNÇKVShJ-së. Sinjalet e para të kësaj tendence ishin përpjekjet e Xhafer Shatrit për ta interpretuar qëndrimin e Sabri Novosellës si sulm personal kundër tij dhe jo kundër vijës politike, që ai e kishte shpalosur botërisht në organin "Zëri i Kosovës"!

Javën e fundit të nëntorit jam zhvendosur nga Mynihu në rrethin e Shtutgartit. Një kohë kam qëndruar në banesën e të atit të Hafiz Gagicës. Së bashku me Hafizin kam pasur takime të shpeshta me Remzi Ademajn, Faridin Tafallarin, Mehdi Rexhajn, Shaban Bobajn, Ismet Klaiqin, Nami Ramadani e veprimtarë të tjerë.

Së bashku me disa nga shokët dhe veprimtarët e rrethit të Shtutgartit i kam vizituar edhe varret e heronjve të Kosovës: Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla.



Remzi Ademaj, 28 nëntor 1983

Me rastin e 28 nëntorit, ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, shokët e rrethit të Shtugardit kanë organizuar një mbrëmje përkujtimore. Remzi Ademaj ka mbajtur fjalën e rastit.

Kontaktet e përditshme me rrethin e shokëve të Jusuf Gërvallës dhe Bardhosh Gërvallës, ishin një rast shumë i mirë që të debatonim për qëndrimet tona politike, sepse përplasja në mes Xhafer Shatrit dhe Sabri Novosellës kishte krijuar edhe paqartësi e mëdyshje tek një pjesë e mërgimtarëve tanë. Shumë veprimtarë politikë nuk shihnin ndryshim në mes të qëndrimeve të Sabri Novosellës dhe Xhafer Shatrit. Ata i konsideronin si njërin, ashtu edhe tjetrin, veprimtarë të mëdhenj të çështjes sonë kombëtare. Asnjëri nuk e pëlqente këtë përplasje dhe nuk kishte dëshirë që ajo të thellohej më shumë. Të gjithë, me të drejtë, kërkonin rrugën e afrimit dhe bashkimit.

Gjendja e krijuar ishte shumë e ndjeshme dhe për, mendimin tim, nga ne kërkohej që të ishim shumë parimor në qëndrimet tona. Bashkatdhetarëve tanë duhej t'jua shpjegonim se përse nuk ishin të drejta qëndrimet e Xhafer Shatrit, se ku ishin dallimet në mes qëndrimeve të tij dhe atyre të shokëve tanë? Përgjigja në pyetjet që shtronin bashkatdhetarët tanë kërkonin kohë durim të madh.

Gjatë bisedave me shokë dhe bashkatdhetarë, demaskimi i vijës politike të Xhafer Shatrit, ishte një veprim që nuk mund të shmangej. Prandaj, gjatë bisedave me shokët e bashkatdhetarë, unë merrja, si shembull, një nga numrat e fundit të "Zërit të Kosovës" në të cilin, Xhafer Shatri, para përplasjes me Sabri Novosellën, i kishte shkruar. Aty ai kishte bërë thirrje që "Jugosllavia të bëhej pluhur e hi", kërkesë kjo në kundërshtim me luftën e popullit tonë dhe që me të drejtë e kishte nxitur edhe reagimin e shtetit shqiptar. Ky qëndrimi i Xhafer Shatrit, ishte jo vetëm në kundërshtim me kërkesën për Republikë në kuadër të Federatës Jugosllave, por edhe në kundërshtim me "tetë kërkesat e parevokueshme të LNÇKVShJ-së të shpalosura botërisht në numrin e parë të "Zërit të Kosovës" që udhëhiqej dhe redaktohej nga Jusuf Gërvalla.

Nëpër takime të ndryshme me bashkatdhetarë, shfaqeshin qëndrime nga ma të ndryshmet në të cilat kishte përpjekje për prezantimin e mospajtimeve tona me qëndrimet e Xhafer Shatrit si mospajtime bajraktarësh për interesa grupore apo partiake!

Mbi bazat e njohurive që kisha, shokëve përpiqesha t'jua shpjegoja arsyet që e kishin shtyrë Sabri Novosellën ta kundërshtonte vijën politike të Xhafer Shatrit. Gjatë takimeve, unë dhe shokët, bashkatdhetarëve ua shpjegonim se mospajtimet tona nuk kishin asgjë personale dhe se e vetmja gjë që po kërkohej prej nesh, pro jo vetëm i Xhafer Shatrit, ishte korrigjimi i gabimeve të shfaqura në "Zërin e Kosovës".

Gjatë kontakteve me shokë, kisha vërejtur se asnjëri prej tyre nuk kishte asgjë personale kundër Xhafer Shatrit. Përkundrazi, ata e çmonim dhe respektonin atë dhe shokët e organizatës së tij. Ky qëndrim më mahniste.

Shokët e Lëvizjes i kishin kuptuar shumë drejtë devijimet politike të shpalosura nga Xhafer Shatri në "Zërin e Kosovës". Ata, përkundër gjaknxehtësisë së shfaqur nga ana e Sabri Novosellës, ishin përkrah tij, sepse çështja e shtruar ishte e drejtë dhe parimore. Ne nuk mund të luftonim, thoshin shokët, edhe për Republikë në kuadër të Federatës Jugosllave, me një rend

shoqëror tjetër dhe të ngjashëm me atë në Shqipëri! Në radhët e shokëve tanë, mbretëronte mendimi se ne nuk duhej të lejonim që ne të vazhdojmë të jemi pjesë e një vije politike që ishte në kundërshtim me interesat e luftës së drejtë të popullit tonë për barazi në kuadër të Federatës jugosllave. Ata kërkonim që Xhafer Shatri të reflektonte pozitivisht dhe që ta shihte drejtë çështjen e shtruar. Fatbardhësisht këtë qëndrim, pas ftohjes së gjakrave, e mbante edhe Sabri Novosella.

Qëndrimi ynë ndaj kërkesës "Kosova-Republikë" ishte i lidhur edhe me çështjen e qëndrimit që duhej ta mbanim edhe lidhur me klubet e mërgimtarëve tanë. Edhe në këtë çështje, qëndrimet e Xhafer Shatrit, Ibrahim Kelmendit e kompani dhe ato të shokëve tanë, ishin diametralisht të kundërta. Sidomos Ibrahim Kelmendi dhe disa që ishin përkrah tij mbante qëndrimin që klubet e mërgimtarëve tanë të shndërroheshin në klube të LRSShJ-së, pra që aty të flitej hapur për Republikën e Kosovës e të shpërndaheshin hapur libra, gazeta dhe organi "Zëri i Kosovës"!

Ne kishim qëndrimin që klubet e mërgimtarëve të mos i kthejmë në klube të LRSSHJ-së dhe që ne të mos ekspozoheshim hapur në mesin e punëtorëve. Këtë e bënim sepse e dinim se UDB-a kishte njerëzit e saj nëpër klube dhe prania e veprimtarëve të LRSShJ-së aty, e rriste numrin e mërgimtarëve "politikë" shqiptarë. Edhe ashtu, numri i atyre që merreshin në pyetje nga UDB-a, që burgoseshin dhe që ngeleshin pa pasaportë nuk ishte i vogël, prandaj ne ishim absolutisht kundër krijimit të refugjatëve politikë nga radhët e mërgimtarëve tanë. Ishim për një veprimtari ilegale, nëpër klubet shqiptare, edhe në shtetet e Evropës Perëndimore dhe gjetiu, ashtu siç vepronim në Kosovë. Pra ne mendonim se në Evropën Perëndimore kishte shumë mundësi të pashfrytëzuara. Puna ishte se ne duhej t'i gjenim ato mundësi dhe t'i shfrytëzonim ato në të mirë të luftës së popullit tonë për liri.

Në Zvicër

Qysh gjatë kohës kur ndodhesha në Turqi, me shokët e kishim biseduar edhe çështjen e mundësisë së vendosjes sime në Zvicër. Mirëpo vendimin përfundimtar që ta mësyj Zvicrën e mora së bashku me shokët në Gjermani, Francë dhe Zvicër.

Shteti gjerman mbante një politikë të ashpër ndaj kërkuesve të azilit politik. Përkundër faktit se me vete kisha disa dokumente që vërtetonin se isha i përndjekur politik, përvoja e shokëve fliste se gjasat për ta fituar statusin e refugjatit politik në Gjermani ishin të vogla apo minimale. Gjithashtu, edhe nga shokët e Zvicrës kishim marrë përgjigje se gjasat që autoritetet zvicerane do ta trajtonin çështjen time të strehimit në mënyrë më të drejtë ishin po ashtu të vogla.

Faridin Tafallari

Megjithëkëtë pasditen e *Natës së Krishtlindjeve* të viti 198,3 së bashku me Faridin Tafallarin, jemi nisur nga Shtutgarti në drejtim të qytetit të Konstanz, që ishte qytet kufitar në mes Gjermanisë dhe Zvicrës.

Kufirin e kaluam pa ndonjë problem. Në tokën zvicerane u takuam me Haxhi Berishën. Pimë nga një kafe së bashku dhe pas një ore u përshëndetem me Faridin Tafallarin, i cili nga aty u kthye në Gjermani, ndërsa ne vazhduam rrugën për qytetin e Amriswilit, ku banonte Haxhi Berisha.

Haxhi Berishën nuk e kisha takuar asnjëherë më parë. E mbaja mend se nga Kosova kisha zhvilluar një bisedë telefonike me te, pas vrasjes në Untergruppenbach dhe pas kthimit të Skënderit(Xhafer Durmishit) në Gjermani. Nga shokët kisha dëgjuar se Haxhi Berisha kishte vepruar pranë Jusuf Gërvallës, që nga arratisja e tij në Gjermani. Edhe nga Xhafer Durmishi kisha dëgjuar se Haxhi Berisha, me porosi të Jusuf Gërvallës, i kishte dërguar në Kosovë numrat 3 dhe 4-5 të organit *"Liria".*

Haxhi Berisha në mesin e bashkatdhetarëve në Zvicër

Haxhi Berisha kishte disa vite që jetonte dhe punonte në Zvicër dhe kjo i kishte dhënë mundësinë të njihej e të krijonte lidhje bashkëpunimi e bashkëveprimi me shumë mërgimtarë dhe klube mërgimtarësh shqiptarë që vepronin aty. Pjesëmarrja aktive në shumë aktivitete, por edhe bashkëpunimi me veprimtarë të ndryshëm, e kishte ndihmuar Haxhi Berishën të njihte shumë për afër qëndrimet e Xhafer Shatrit dhe veprimtarëve të tjerë që vepronin në Zvicër dhe vendet tjera. Haxhi Berisha, duke vepruar afër Jusuf Gërvallës dhe shokëve të tij, kishte mësuar shumë edhe nga dialektika e jetës në mërgim, dhe kjo e fundit e kishte ndihmuar të bëhej një militant dhe veprimtar i shquar në radhët e emigracionit tonë.

Në St. Gallen vepronte edhe Klubi Shqiptar "Xheladin Zeçiri" i cili tubonte rreth vete mërgimtarët shqiptarë nga Kosova dhe viset tjera shqiptare. Haxhi Berisha ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm si në themelimin, ashtu edhe në mbajtjen gjallë të aktivitetit të Klubit "Xheladin Zeçiri". Sa më gjatë që po qëndroja në Zvicër, gjithnjë e më shumë po bindesha se Haxhi Berisha ishte boshti "kurrizor" i krahut të LRSSHJ-së dhe veprimtarisë sonë në shërbim të lirisë në këtë vend.

Gjatë kohës sa kam qëndruar tek Haxhi Berisha dhe nëpërmjet tij jam njohur me veprimtarët tjerë të shquar si Elmaz Ademi, nga Tetova, Demë Mustafaj nga Deçani, Xhemil Beçiri nga Tetova (që kishte dy vëllezër të dënuar politikë e me dënime të gjata në Maqedoni), Xhemajl Dauti nga Tetova, Isen Zyberi nga

Tetova, Alush Tahiri nga Ferizaj, Januz Mustafa nga Prekazi i Skënderajt si dhe shumë veprimtarë të tjerë të LRSShJ-së që vepronin në Zvicër.

Mirëpo kur arrita në Zvicër, Sabri Novosella ishte kthyer në Turqi dhe veprimtaria jonë zhvillohej në një gjendje shumë të tendosur. Kjo gjendje e rëndë, ishte jo vetëm në Zvicër, por kudo nëpër botë ku veprohej për lirinë e Kosovës.



Së bashku me Haxhi Berishën

Në ndërkohë nga Turqia nisën të na vinin materiale e komunikata të ndryshme në emër të KQ të LRSShJ-së! Në materialet e KQ të LRSShJ-së, shkruhej dhe thirrej për një vijë politike më ndryshe nga ajo që ndiqte Xhafer Shatri dhe që ishte shpalosur nga ana e tij në organin "Zëri i Kosovës"! Unë dhe shokët nuk dinim se kush ishin autorët e vërtetë të këtyre materialeve dhe komunikatave që na i dërgonte Sabriu nga Turqia. Ne i lexonim dhe shpërndanim ato, duke shpresuar gjithmonë se prapa tyre qëndronte KQ i LRSShJ-së (pra krahu i KQ i LNÇKVShJ-së) në Kosovë, ashtu siç na kishte shkruar e thënë Sabri Novosella!

Në kohën kur po na vinin materialet e KQ të LRSShJ-së, nga Stambolli më ka marrë në telefon Njazi Straja, i cili gjatë bisedës, në mes të tjerash m'i ka përcjell edhe përshëndetjet e Ibrahim Qavollit :

– E takova shokun Ibrahim dhe ai më pyeti për Ty! Më tha bisedo dhe pyete Aliun, se ç'është duke bërë ai dhe shokët e tij dhe se përse janë duke i lejuar të gjithë ato mbrapshti, që po shkruhen në "Zërin e Kosovës?!

Përshëndetja e Ibrahim Qavollit, nëpërmjet Njazi Strajës, ishte shumë domethënëse për mua. Ajo nuk ishte ndërhyrje e thjeshtë, por thirrje e hapur për ta mbështetur qëndrimin e Sabri Novosellës.

Pas bisedës telefonike me Njazi Strajen dhe bisedave që kisha pasur unë dhe shokët me Sabri Novosellën, më krijohej përshtypja se prapa qëndrimeve të Sabri Novosellës, lidhur me vijën politike që duhej ta ndiqte "Zëri i Kosovës", të cilën ne e kishim përqafuar pa hezitim, qëndronte edhe shteti shqiptar. Për të

gjithë ne përzierja e shtetit shqiptar në këtë çështje, kishte një rëndësi shumë të madhe.

Gjatë një tubimi përkujtimor për heronjtë janarit, që u mbajt në Sant Gallen, pata rastin ta takoja, veç të tjerëve, edhe Xhafer Shatrin dhe Hasan Malën. U shpreha ngushëllimet e mia dhe të shokëve për vrasjen e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës në Prishtinë, pak ditë më parë! Xhaferit dhe Hasanit u thashë se vrasja e Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës ishte një humbje të madhe për gjithë lëvizjen tonë nacionalçlirimtare. Me këtë përpiqesha t'jua përcjell edhe mesazhin se armikun e kemi të përbashkët dhe se Rexhep Mala e Nuhi Berisha ishin edhe shokët tanë, ashtu siç ishin edhe shokët e tyre. Gjithashtu, gjatë takimit, që pata me Xhafer Shatrin dhe Hasan Malën, unë ua përsërita qëndrimet e mia dhe të shokëve, ashtu siç i kisha shfaqur ato edhe në një fjalim të shkurt që mbajta atë mbrëmje, lidhur me vijën politike që do të duhej ta ndiqte edhe lëvizja jonë në përgjithësi dhe organi "Zëri i Kosovës", në veçanti. Mirëpo krijova përshtypjen se Xhafer Shatri ishte më shumë i interesuar për qëndrimin tim rreth sjelljes së Sabri Novosellës, gjatë përplasjes me te, se sa rreth kritikës së drejtë që i kishte bërë Sabri Novosella dhe shokët tanë, lidhur me vijën politike të organit "Zëri i Kosovës". Xhafer Shatri më shumë merrej me dallimet sesa me gjërat që na bashkonin. Isha i indinjuar nga ky qëndrim i tij. U përshëndetëm dhe u ndamë nga njëri-tjetri, fatkeqësisht, me pak shpresë se do të takoheshim përsëri.

Haxhi Berisha, Demë Mustafaj dhe
Asllan Muharremi

Ky qëndrim i Xhafer Shatrit më brengoste shumë. Unë nuk e kisha kuptuar kritikën kundër tij si përpjekje për likuidimin e tij nga skena politike, por si një kritikë për të mirën e luftës sonë. Vallë pse nuk e kuptonte kështu kritikën tonë edhe Xhafer Shatri, e pyetja vetën ? Nuk gjeja përgjigje në këtë qëndrim të tij, por qëndrimet e shokëve lidhur me veprimtarinë e Xhafer Shatrit, po më dilnin shumë të drejta dhe parimore. Ishte Xhafer Shatri që do të duhej të reflektonte dhe ta rishikonte qëndrimin e tij lidhur me luftën tonë për barazi dhe Republikë

në kuadër të Federatës jugosllave dhe jo ne që përkundër nxitimit të Sabri Novosellës nuk po kërkonim asgjë më shumë sesa vendosjen e vijës sonë politike në binarë të drejtë. Në këtë pikë nuk mund të bënim kompromis.

Përkundër çarjes së madhe që i kishte ndodhur lëvizjes sonë, qëndrimi ynë ishte që ta vazhdimin bashkëpunimin, sidomos me grupin e shokëve të Xhafer Shatrit dhe Hasan Malës. Edhe sa isha në Kosovë, OMLK-në, që tani e përfaqësonte Xhafer Shatri, dhe LNÇKVShJ-në i kisha parë si dy degët e një trungu. Personalisht nuk kam njohur ndonjë anëtar të OMLK-së, por kisha dëgjuar dhe lexuar për dënimet e rënda dhe të gjata që u dhanë Hydajet Hysenit, Mehmet Hajrizit, Berat Lluzhës, Gani Sylës, udhëheqësve dhe anëtarëve të tjerë të OMLK-së dhe kisha lexuar e shpërndarë si "Lirinë", ashtu edhe "Këngët e lirisë", ashtu siç i kemi shpërndarë dhe lexuar dhe "Lajmëtarin e lirisë" dhe "Zërin e Kosovës" dhe për mua programet e tyre politike kanë qenë shumë të ngjashme. Unë dhe shokët e mi, anëtarët e OMLK-së i konsideronim si shokë idealesh. Edhe tek Sabri Novosella në Turqi, por edhe tek shokët e rrethit të shokëve të Jusuf e Bardhosh Gërvallës në Gjermani dhe tek shokët tanë në Zvicër e kisha hasur kudo këtë frymë. Shokët më kishin njoftuar edhe për qëndrimet e Jusuf Gërvallës rreth shokëve të Kadri Zekës, për ndihmën e pakursyer që ai u kishte dhënë daljes së organeve "Bashkimi" dhe "Liria", duke rrezikuar edhe shokët e tij dhe dërguar ato në Kosovë.

Ne ishim të vetëdijshëm se përçarja do të çonte ujë në mulli të armikut tonë, se armiku ynë do t'i përdorë të gjithë njerëzit e tij, që mund t'i ketë në radhët e organizatave tona apo pranë e jashtë tyre, për ta thelluar edhe më shumë përçarjen tonë. Prandaj nga ne kërkohej maturi e madhe, me qëllim që përçarja, të mos bëhej e pariparueshme dhe të mos thellohej më shumë. Njëkohësisht, ne ishim të vetëdijshëm se lufta jonë nacionalçlirimtare, por edhe kjo pjesë e luftës për barazinë e shqiptarëve në kuadër të Federatën Jugosllave, nuk mund të bëhej pa bashkimin e të gjitha grupeve politike që luftonin për arritjen e këtij qëllimi.

***

Në fillim të shkurtit kam biseduar me shokët Haxhi Berisha, Elmaz Ademi dhe Demë Mustafaj dhe jemi pajtuar që të paraqitesha tek organet policore zvicerane dhe ta shtroja kërkesën për strehim politik. Si vend ku do të paraqitesha zgjodhëm qytetin e Olltenit.

Haxhi Berisha më përcolli deri në Stacionin e Policisë së Olltenit dhe unë hyra dhe e paraqita kërkesën për strehim politik pranë organeve zvicerane. Sapo e shkrova kërkesën policia zvicerane më mbylli në burg. Për tre ditë më radh më mbajtën të vetëm në një dhomë burgu, ku edhe ushqimin e futnin nëpërmjet një biruce, që e kishin hapur në fund të derës!

Kjo ishte një befasi e madhe dhe që binte ndesh me shpresat që kisha për trajtimin që do t'i bënin kërkesës sime organet zvicerane.

Ditën e katërt nisën hetimet. Hetuesi, me vete kishte edhe një përkthyese të gjuhës serbe! Përkundër protestës sime hetuesi nuk e ndërroi përkthyesen, por

më detyroi të flisja serbisht, gjuhë kjo të cilën e flisja, por jo në atë nivel që të mund të shprehesha lirshëm si në gjuhën shqipe!

Ajo që më befasoj, qysh në fillim, ishte se gjatë marrjes në pyetje, hetuesi, përdorke një gjuhë shumë të egër dhe fyese ndaj meje. Ai nuk ngurronte të më quante terrorist, bandit dhe të më dhuronte etiketime të tjera fyese! Madje në një rast kur më pyeti se si do të jetoja në Zvicër, më konkretisht, se nga sa orë do të punoja dhe unë iu përgjigja se do të jetoja nga puna ime dhe se do të punoja nga tetë orë në ditë, hetuesi më quajti komunist, që kisha ardhur në Zvicër për të përhapur tek punëtorët zviceran idetë komuniste! Ndonëse unë përpiqesha të mbahesha i qetë, sjellja e hetuesit më solli buzë shpërthimit. Nga ato që po dëgjoja nga goja e hetuesit sikur të gjitha ato që kisha lexuar dhe dëgjuar në Radio Tiranë për trajtimin që u bëhej njerëzve në botën kapitaliste, sikur po më "dilnin" në vendin kur e kisha bërë kërkesën për t'u strehuar!

Gjatë marrjes në pyetje unë ia prezantoja hetuesit arsyet e mia për strehim. Atij i thosha se isha shqiptar nga Kosova, se unë dhe shokët e mi, ashtu si edhe populli ynë, kërkojmë që Kosovës t'i njihet statusi i republikës në kuadër të Federatës Jugosllave. Hetuesi bëhej sikur të ishte i shurdhër dhe nuk dëgjonte ato që po i prezantoja dhe kalonte tek çështja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, tek regjimi i Enver Hoxhës e të tjera çështje që unë nuk i kisha marrë në gojë, gjatë parashtrimit të arsyeve të mia për strehim politik!

Mënyra e hetimit dhe trajtimi që më bëhej më bënte ta ndjeja vetën jo vetëm të fyer, por edhe i zhgënjyer në drejtësinë zvicerane. Megjithëkëtë më duhej ta ruaja gjakftohtësinë. Hetuesit ia përsërita disa herë se unë po i kërkoja strehim politikë shtetit zviceran, i cili ishte nënshkrues i Konventës së Gjenevës dhe konventave të tjera mbi të drejtat e njeriut dhe të drejtat e refugjatëve, dhe jo atij (hetuesit) personalisht. Kjo hetuesit nuk i pëlqente dhe ma përsëriste kërcënimin se kurrë nuk do të më njihej e drejta e strehimit politik në Zvicër!

Dyshoja se kontribut të madhe në tensionimin e hetimit kishte dhënë edhe përkthyesja serbe, e cila nuk isha i sigurt se a përkthente gjithçka kisha prezantuar gjatë shtrimit të kërkesës sime.

Pas mbarimit të hetimeve treditore, të fyerjeve dhe të sharjeve të hetuesit zviceran, më vendosën në dhomë me një të paraburgosur tjetër që ishte nga Afrika. Ishte hera e parë që po takoja një afrikan. Afrikani kishte të lyer flokët me një krem e cila lëshonte një aromë të çuditshme dhe të panjohur për mua. E merrja me mend se edhe ai duhej të ishte një hallexhi si unë, por ne nuk mund të komunikonim me njëri-tjetrin dhe kjo ishte një fatkeqësi për ne të dy. Ai fliste vetëm frëngjisht, ndërsa unë të vetmet fjalë që dija në gjuhën frenge ishin fjalët e motos së revolucionit francez: *liberté égalité fraternité*[33] dhe ato të titullit të librit të famshëm të Viktor Hygos *Les miserables.*[34] Kur ia thashë fjalët bashkë-hallexhiut tim në gjuhën frënge, ai e lëshoi një të qeshur dhe tha diçka, që unë nuk e kuptova kurrë se ç'kuptim kishte.

Pas dy-tre ditësh me angazhuan të punoja në burg dhe ky ishte një lehtësim i gjendjen sime. Ditën e dhjetë më liruan dhe vendosën në një kamp refugjatësh në Salzach të Solloturnit.

***

Xhafer Shatri kishte vepruar me shpejtësi nëpër të gjitha rrethet dhe përçarja e LRSSHJ-së ishte, de facto, një çështje e kryer. E keqja ishte edhe më e madhe sepse LNÇKVShJ-ja dhe OMLK-ja e dikurshme ishin përçarë dhe gjendja ishte ashtu siç kishte qenë para bashkimit të pas vrasjes së shokëve në Untergrupenbach. Shumica absolute e ish anëtarëve të LNÇKVShJ-së u rreshtuam përkrah qëndrimeve të Sabri Novosellës, ndërsa shumica absolute e ish anëtarëve të OMLK-së u rreshtuan përkrah Xhafer Shatrit dhe Ibrahim Kelmendit.

Mirëpo, Sabri Novosella që e kishte nisur këtë ndarje, ishte kthyer në Turqi dhe dukej qartë se "grindja" dhe akuzat e ndërsjella në mes Sabri Novosellës dhe Xhafer Shatrit kishin hedhur në "fushën e betejës" problemet e grumbulluara të lëvizjes sonë kombëtare. Duke pasur parasysh edhe shkapërderdhjen tonë, nëpër vende të ndryshme të Evropës, zgjedhja e problemeve që kishim para vetes , ishte një çështje shumë më e komplikuar sesa dukej në sipërfaqe.

Ndonëse ishim të shkapërderdhur nëpër shumë vende të Evropës Perëndimore dhe gjetiu nëpër botë dhe kishim shumë vështirësi për t'u takuar me njëri-tjetrin (për shkak se shumë prej nesh nuk kishim dokumente udhëtimi); ndonëse ishim, shumica prej nesh, të një moshe shumë të re dhe me moshë mesatare nën njëzet e pesë vjeç, në radhët tona mbretëronte një qartësi e jashtëzakonshme se nga duhej të ecnim. Kjo ishte një mrekulli e madhe dhe që të krijonte kënaqësi të ishte pjesë e një rrethi të tillë shokësh.

Krahu ynë që kishte në ballë Sabri Novosellën, Xhafer Durmishin, Faridin Tafallarin, Remzi Ademin, Haxhi Berishën, Elmaz Ademin Hafiz Gagicën dhe shumë veprimtarë të tjerë në Gjermani, Zvicër, Francë, Suedi, Belgjikë, ShBA, Australi e Turqi e kishte të formuar qëndrimin politikë që duhej ta mbanin në këtë epokë të luftës sonë për Republikë dhe barazi me popujt tjerë të Jugosllavisë.

Kjo qartësi ishte me rëndësi shumë të madhe për të ecur më tutje në luftën tonë si dhe për të hedhur themelet e rindërtimit të organizatës sonë politike mbi themele të reja. Luftë pa kompromis i shpallëm qysh në fillim sektarizmit dhe njëkohësisht po kërkonim rrugët që do të na shpinin kah rritja e Lëvizjes sonë, duke shfrytëzuar të gjitha format e veprimtarisë legale dhe bashkërendimin e tyre me veprimtarinë ilegale. Gjatë kësaj kohe kemi mbajtur takime intensive nëpër rrethe dhe vende të ndryshme, por edhe kemi këmbyer letra dhe mendime për programin e ri definuar dhe përpunuar që do ta kishim si udhërrëfyes në luftën tonë për liri dhe barazi.

***

Në kampin e refugjatëve në Salzach, të gjithë refugjatët, gjatë javës, kishim disa ditë pune të detyrueshme. Puna që na kërkohej ta bënim, ishte punë në përgatitjen e ushqimit për banorët e kampit. Për këtë punë shpërbleheshim me diku rreth tetëdhjetë franga zviceran në muaj, që ishin të mjaftueshme për të blerë ndonjë zarf, apo artikull të higjienës personale.

Një ditë, gjersa isha duke punuar në kuzhinë, erdhi një refugjatë dhe më thotë se dy burra shqiptarë janë duke e kërkuar një shqiptar që banon këtu dhe që quhet *Ali*!

– A e njeh shqiptarin që quhet *Ali* dhe që banon në kampin tonë?! – më pyeti, i habitur Hasani nga Kurdistani.

Edhe unë u bëra se nuk po njihja *Aliun* që po e kërkonin dy burrat e panjohur. Së bashku me Hasanin u nisa në drejtim të burrave që po qëndronin tek dera e shtëpisë së kampit. Kur u afrova afër tyre u prezantova se kush isha dhe njëri nga burrat u prezantua se ishte Albani (pseudonimi i Musa Hotit), ndërsa tjetri ishte Qamil Zekolli! E kuptova se kush po më kërkonte.

Nuk më mbeti tjetër pos të kërkoja leje nga personeli i kampit, për ta ndërprerë punën dhe për të shkuar e pirë nga një kafe me zotërinjtë, që në të vërtetë, me ardhjen e tyre të papritur, po më befasonin shumë edhe për faktin se Musa Hotin(Albanin) e dija se ndodhej në burg, diku në Belgjikë!

Musa Hotin sapo e pashë e njoha sepse e kisha parë në fotografi gjersa isha duke qëndruar tek Sabri Novosella në Turqi, ndërsa shokun e tij s'e kisha parë asnjëherë. E dija se ata e kishin krijuar një Komitet të Degës së LRSShJ-së në Belgjikë që quhej "Murat Mehmeti" si dhe kishin nxjerrë një revistë që quhej "Republika". E dija, gjithashtu, se gjithë kjo punë ishte mbështetur, sidomos nga Sabri Novosella, i cili mbante kontakte prej kohësh me Musa Hotin. Sabri Novosella më kishte vënë në lidhje me Musa Hotin dhe unë i kisha shkruar disa letra në adresë të tij. E merrja me mend se përkundër përdorimit të nofkës, Musa Hoti e dinte se kush isha dhe ndoshta edhe nga isha?! Qysh nga Turqia, nëpërmjet Belgjikës, unë ia kisha dërguar një kartolinë familjes sime në Kosovë. Pra kartolinën që ia kemi dërguar së pari Musa Hotit në Belgjikë, ai duhej ta ketë lexuar dhe pastaj e ka nisur për Kosovë.

Sa isha në Kosovë nuk e njihja Musa Hotin. Në Kosovë kisha dëgjuar edhe për rastin e vrasjes në Belgjikë dhe zhurmës që bënte televizioni dhe shtypi jugosllav rreth saj. Rezerva rreth angazhimit të tij në LRSShJ-ë, i kisha shprehur edhe Sabriut sa isha në Turqi. Shokët, që i kisha pyetur për Musa Hotin, nuk më kishin thënë ndonjë fjalë të mirë për te. Flitej se vendi ku e kishte kryër vrasjen e një punonjësi të Ambasadës Jugosllave në Bruksel, kishte qenë një kafe bixhozi dhe se vrasja kishte ndodhur nën ndikimin e alkoolit! Të gjitha ato që kisha dëgjuar nga shokët më bënin të isha i rezervuar lidhur me Musa Hotin, ndonëse ato mund të mos ishin të vërteta apo të ishin shpifje të UDB-ës. Mirëpo, për mua vet akti i vrasjes, që kishte bërë Musa Hoti, nuk më pëlqente. Aktet e

tilla, për mendimin tim, nuk ishin në dobi të çështjes sonë kombëtare. Prandaj, këto arsye më bënin Musa Hotin të mos e kisha as hero dhe as shembull që do të duhej ta ndiqnim në përpjekjet tona për liri. Isha i vetëdijshëm se mund të isha i padrejtë ndaj tij dhe t'i hyja në hak pa të drejtë, por kështu unë e shihja punën e tij.

Shkuam dhe u ulëm në një restorant së bashku me Musa Hotin dhe Qamil Zekollin. Pas pak, e kuptova se ata ishin informuar për mua më tepër se ç'do të duhej! Kisha përshtypjen se mysafirët nga Belgjika ishin shumë kureshtar të dinin se si ishin duke shkuar punët pas përplasjes në mes Xhafer Shatrit dhe Sabri Novosellës, se ku isha unë dhe rrethi i shokëve në çështje të organizimit e çështje të tjera? Kjo nuk më pëlqente. Dorën në zemër unë nuk dëshiroja të flisja me mysafirët e befasishëm për çështjet që i konsideroja si probleme të shokëve që i kisha më afër se sa Musa Hotin. Megjithëkëtë, mysafirët nga Brukseli vazhdonin të më pyesnin dhe ta shprehnin edhe përkrahjen e tyre të parezervë për punën e shokëve tonë! Pas rreth dy orësh, pasi e mbaruam drekën dolëm nga restoranti, Qamil Zekolli m'i la në dorë 200 franga zvicerane, përkundër kundërshtimit tim! U përshëndetem me njëri-tjetrin dhe unë u ktheva në kamp.

Pas këtij takimi të papritur me mysafirët nga Belgjika ndjehesha shumë i dëshpëruar në Sabri Novosellën dhe futjen e Musa Hotit në "punët" tona. Tani po bindesha gjithnjë e më shumë se të gjitha materialet e lëshuara në emër të KQ të LRSShJ-së , pa dijen e shumicës së shokëve, ishin shkruar nga Sabri Novosella dhe redaktuar nga Musa Hoti! Kisha përshtypjen se ishte e njëjta makinë e shkrimit që i kishte shkruar materialet e KQ të LRSSHJ-së! Dërgimi i materialeve tek Musa Hoti, pa u këshilluar me asnjërin nga shokët e KQ të LRSShJ-së, dega jashtë atdheut, ishte një gabim trashanik që kishte bërë Sabri Novosella dhe një keqpërdorim i rënd i emrit të KQ të LRSShJ-së. Asnjëri nga shokët (me përjashtim të Sabri Novosellës dhe Musa Hotit) nuk ka ditur se kush qëndronte prapa shkrimeve në emër të KQ të LRSShJ-së.

Prita ndaj Hysen Zymberit (Isen Ziberit)

Hysen Zymberi, ashtu si edhe shumë bashkatdhetarë nga Tetova dhe viset tjera shqiptare në Maqedoni, kishte përqafuar vijën e krahut tonë politik. Nëpër tubime që bëheshin me bashkatdhetarët tanë në Zvicër, luftën për liri, veç të tjerash, Hysen Zymberi e bënte me çiftelinë e tij dhe këngët patriotike që këndonte. Kudo ku mbaheshin tubime të shqiptarëve, buçiste zëri dhe çiftelia e tij.

Një mbrëmje, e mora në telefon Haxhi Berishën në Amriswil dhe nga ai dëgjova për tragjedinë që kishte ndodhur në Heerbrugg: "Dje Hysen Zymberi është sulmuar nga tetë-nëntë persona të panjohur. Fatkeqësisht, një nga sulmuesit ka mbetur i vdekur, ndërsa Hysen Zymberi gjendet në spital dhe është në gjendje të rëndë. Sulmuesit tjerë kanë ikur nga vendi i krimit dhe nuk dimë se cilët janë,-më tha Haxhi Berisha!"

Haxhi Berisha ishte shumë i shqetësuar. Lajmi i hidhur më shqetësoj shumë edhe mua. Më vinte keq për viktimën, ndonëse viktima ia kishte zënë pritën shokut tonë dhe nuk dija se kush ishte dhe nga ishte. Mirëpo më vinte shumë keq edhe për Hysen Zymberin, shokun tonë, që ishte bërë cak i sulmit të kriminelëve të panjohur!

Asllan Muharremi dhe Hysen Zymberi

Mirëpo kjo që i kishte ndodhur Hysen Zyberit mund të na ndodhte edhe çdonjërit prej nesh. Një ditë më parë, i është zënë prita Hysen Zymberit, nesër

mund të më zihej prita edhe mua. Pasnesër, shokut tjetër! Prita në Heerbrugg fliste qartë se në ç' gjendje ndodhej lëvizja jonë politike! Ishte e qartë se ishte një gjendje skajshmërisht e rrezikshme. Këtë gjendje e kishin ëndërruar armiqtë tanë. Isha i bindur, se askush më shumë se UDB-a jugosllave nuk dëshironte që shqiptarët të vriten me njëri-tjetrin! Unë nuk kisha fije dyshimi se autorët e këtij krimi ishin nxitur nga njerëz të UDB-ës dhe se kjo zënie prite, pa marrë parasysh se si është motivuar, ka si qëllim vëllavrasjen tonë dhe shkatërrimin e Lëvizjes sonë.

Sapo gjeta mundësin shkova tek Haxhi Berisha në Amriswil. Aty i kam takuar edhe me Elmaz Ademin, Demë Mustafajn dhe shokë të tjerë. Nga shokët mësova më shumë për tragjedinë e Heerbruggut. Ata, kishin marrë vesh se viktima ishte një shqiptar nga Kosova dhe shokët dyshonin, se sipas të gjitha gjasave, edhe sulmuesit tjerë ishin shqiptarë. Gjithashtu, shokët më shpjeguan se Hysen Zymberit ia kishin zënë pritën tetë-nëntë persona të panjohur në një nënkalim, gjersa ai ishte duke shkuar për vizitë tek Xhemil Beçiri. Hysen Zymberi ishte grushtuar e goditur me mjete të forta. Gjatë sulmit ai kishte bërë përpjekje të largohej nga vendi ku ishte sulmuar. Në një rast ai kishte arritur të largohej, por sulmuesit e kishin zënë dhe futur përsëri në nënkalim dhe kishin vazhduar ta qëllonin. Edhe disa gra zvicerane, kalimtare të rastit, ishin përpjekur t'ua largojnë Hysenin nga dora sulmuesve, por pa sukses. Në përpjekje, për jetë a vdekje, Hysen Zymberi, e ka nxjerrë nga xhepi një brisk dhe e qëllon sulmuesin më të afërm, i cili pas goditjes së tij bie në tokë. Pas kësaj sulmuesit tjerë kanë ikur nga vendi i krimit duke e lënë të shtrirë për toke shokun e tyre dhe të sulmuarin. Pas pak kohe në vendin e tragjedisë ka ardhur policia dhe ambulanca e i ka marrë dhe i ka dërguar në spital të dy: shokun e sulmuesve dhe Hysen Zymberin.

Disa ditë ma vonë mora vesh se Xhafer Shatri i kishte bërë një komentim për keqardhje të ngjarjes tragjike të Heerbruggut. Sipas Xhafer Shatrit fajtor për vdekjen e sulmuesit na qenkan shokët e krahut tanë politik! Ky qëndrim i Xhafer Shatrit më dëshpëroj shumë, sepse nuk ishim ne që ia kishim zënë pritën viktimës, përkundrazi, ishte i vdekuri dhe shokët e tij që ia kishin zënë pritën Hysen Zymberit. Pas këtij qëndrimi të Xhafer Shatrit, në mesin tonë janë shtuar dyshimet se njerëz afër tij, qëndronin prapa vëllavrasjes në Heerbrugg!

Pas vrasjes në Heerbrugg marrëdhëniet tona me krahun e Xhafer Shatrit u tensionuan shumë. Aktivistët e krahut të Xhafer Shatrit vazhdonin të krijonin ngatërresa dhe i kërcënonin veprimtarët e krahut tonë, duke u dhënë, praktikisht, edhe fund përpjekjeve tona për t'u afruar dhe për gjetur një gjuhë të përbashkët në përpjekjet tona për liri.

“Zëri i Kosovës”, organ i LRSShJ-së

Çarja në mes të krahut tonë dhe atij të Xhafer Shatrit ishte nisur me rrëmbim dhe me gjaknxehtësi, por të gjithë ne që ishim përkrah kritikës së Sabri Novosellës, ishim të një mendje se bëhej fjalë për dy vija të ndryshme politike. Xhafer Shatri përfaqësonte krahun dogmatik dhe që nuk ishte në dobi të luftës së popullit tonë për liri dhe barazi, ndërsa Sabri Novosella, përfaqësonte krahun revolucionar , që po kërkonte që lufta e popullit shqiptar për barazi me popujt tjerë të Federatës jugosllave të binte në binarë të drejtë.

Që nga ardhja e Sabri Novosellës në Zvicër dhe përplasja me Xhafer Shatrin, shokët kishin bërë përpjekje për afrimin e qëndrimeve. Ata kishin mbajtur takime e kontakte të vazhdueshme me Xhafer Shatrin dhe gjithmonë e kishin mbajtur të shtrirë dorën e pajtimit. Mirëpo përkundër kësaj, sjellja e Xhafer Shatrit ishte dëmshme dhe në kundërshtim me frymën e pajtimit dhe bashkimit tonë.

Pas përplasjes me Sabri Novosellën, redaksia e “Zërit të Kosovës” ishte në kontroll të plotë të Xhafer Shatrit, i cili nuk po jepte as simptomën më të vogël të reflektimit dhe të rishikimit të politikës që kishte ndjekur. Asnjë autokritikë dhe asnjë përpjekje për t’i kuptuar drejtë qëndrimet tona nuk ishte bërë nga ana e tij. Përkundrazi, Xhafer Shatri, vazhdonte të mbronte me fanatizëm vijën e tij politike, e cila, për mendimin tonë, ishte në kundërshtim me kërkesat e popullit për barazi dhe republikë në kuadër të Federatës jugosllave!

Të ndodhur në një gjendje ku mundësia e ndikimit në vijën politike të organit “Zëri i Kosovës” ishte bërë e pamundur dhe duke parë të domosdoshme shprehjen e qëndrimeve tona politike, vendosëm ta nxjerrim organin e Lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi “Zëri i Kosovës” me adresë në Suedi.

Me një pëlqimin e të gjithë shokëve në Gjermani, Zvicër dhe vendet tjera, Xhafer Durmishi u ngarkua me përgjegjësinë e nxjerrjes së organit “Zëri i Kosovës”, që dilte në Suedi. Xhafer Durmishi, që kishte vepruar pranë Jusuf Gërvallës dhe që më herët kishte pasur përgjegjësinë e redaktimit të “Zërit të Kosovës”, para se me një detyrë të tillë të ngarkohej Xhafer Shatri, i kishte të gjitha përgatitjet intelektuale dhe ideologjike për ta kryer me përgjegjësi këtë detyrë. Ne të tjerët do ta ndihmonim organin, me shkrime, por edhe me punë të

tjera praktike siç ishin shpërndarja, ndihma materiale si dhe propagandimi dhe përhapja e vijës sonë politike në terren, në mesin e bashkatdhetarëve tanë.

Në kohën kur po bënim përgatitjet për publikimin e numrit të parë të "Zërit të Kosovës", Xhafer Durmishi, kishte kaluar nga Franca dhe ishte vendosur në Suedi. Ai me ndihmën e shokëve tanë në Suedi, kishte siguruar adresën e organit "Zëri i Kosovës" dhe një rreth shokësh që do ta ndihmonin daljen e organit dhe shpërndarjen e tij.

Dalja e numrit të parë, që ishte një shpartallim i vijës politike që ndiqte Xhafer Shatri, i cili ndihmohej tani edhe nga Ibrahim Kelmendi, zgjoi interesim shumë të madh në radhët e emigracionit tonë ekonomik dhe politikë, kudo në botë. Ky numër është pritur mirë edhe nga përfaqësues të shtetit shqiptar. Në të njëjtën vijë vazhdoi edhe numri i dytë.

Mirëpo pas daljes së numrit të dytë të "Zërit të Kosovës", që botohej në Suedi, qëndrimi i diplomacisë shqiptare ndryshoi për 360 shkallë. Shokët që kishin pasur kontakte me diplomatët shqiptarë në Stamboll, Vjenë e gjetiu, kishin dëgjuar edhe kritikat e para kundër daljes së dy "Zërave të Kosovës"! Tani nuk flitej kundër vijës politike që kërkonte ta bënte "shkrumb e hi Jugosllavinë titiste", por kritikohej "përçarja" që kishte ndodhur në radhët e lëvizjes sonë! Çuditërisht ata që na kishin "ndihmuar" ta ruajmë "Jugosllavinë nga bërja shkrumb e hi", tani po na thoshin se ishin nxituar dhe po i përçanim masat!

Kjo akrobaci e diplomacisë shqiptare, nuk mund të neglizhohej dhe mos merrej parasysh. Madje, akrobacia e diplomacisë shqiptare na nxori shumë telashe. Ne ishim të shpërndarë nëpër shtete të ndryshme dhe shumë prej nesh nuk kishim mundësi të takoheshim për shkak të mungesës së dokumenteve të udhëtimit. Megjithëkëtë na është dashur të takohemi, të shkruajmë shumë letra tek njëri-tjetri e të bëjmë shumë biseda telefonike. Dhe nga të gjitha takimet, bisedat dhe letërkëmbimet kemi dal të një mendje se vija jonë ishte e drejtë, përkundër politikës ditore, të pamëshirshme dhe të pandershme që bënte ndaj nesh diplomacia shqiptare.

Sabri Novosella, që ishte nismëtar i kësaj vije politike, ndjehej jo vetëm i tradhtuar, por edhe i zhgënjyer tej mase. Ne të tjerët që e kishim përkrahur atë të bindur se kishte të drejtë, vazhdonim ta përkrahnim punën e Xhafer Durmishit të shprehur dhe shkruar në dy numrat e "Zërit të Kosovës".

Vizita e Rexhep Ahmetit në Zvicër

Pas rreth dy muaj qëndrimi në kampin e refugjatëve në Salzach, falë kontakteve të personelit të kampit, fillova punën si pjatalarës në një restorant në një fshat që quhej Bucheg dhe që shtrihej në mes Solloturnit dhe Bernit. Aty kisha edhe një dhomë gjumi.

Disa muaj më vonë më vije për vizitë Rexhep Ahmeti. Gëzimi ishte i madh. Ky ishte kontakti im i parë me shokët në Kosovë, që nga largimi im nga atje para afër një viti.

Rexhep Ahmeti me njohu me gjendjen politike që mbretëronte në Kosovë, sidomos për gjendjen e veprimtarisë së Lëvizjes në rrethin ku vepronin shokët tanë. Ai më njoftoi se pas kthimit të tij nga ushtria, lidhjet me Lëvizjen i kishte mbajtur nëpërmjet vëllait tim, Shabanit.

Udhëtimi i Rexhep Ahmetit kishte karakter konsultativ. Nëpërmjet Rexhës, shokët e Lëvizjes në Kosovë, dëshironin të njiheshin me gjendjen e Lëvizjes në emigracion si dhe ndihmën që mund t'i ofronim veprimtarisë brenda në Kosovë.

Gjatë javës, sa qëndroi në Zvicër, Rexhep Ahmetin e kam njoftuar me gjendjen e Lëvizjes në emigracion, në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë me problemet që kishin dal pas përplasjes në mes krahut tonë dhe krahut të Xhafer Shatrit e Ibrahim Kelmendit. Gjithashtu, Rexhep Ahmetin e kam njoftuar edhe me qëndrimin e shtetit shqiptar lidhur me luftën tonë për barazi në kuadër të Federatës jugosllave dhe të veprimtarisë në përkrahje të kësaj lufte nga emigracioni. Rexhep Ahmetit ia kam prezantuar edhe organin "Zëri i Kosovës" me adresë në Suedi, numri i dytë i të cilit sapo kishte dal nga shtypi dhe ia kam shprehur mendimin tim lidhur me programin e tij politik.

Duke e njohur, shokun e ardhur nga Kosova, me gjendjen në emigracion, unë dëshiroja që shokëve në Kosovë t'jua përcillja një pasqyrë sa ma reale të kësaj gjendje, me qëllim, që pastaj , shokët në përputhje me situatën, t'i nxjerrin detyrat që i presin. Kishte një vit që isha larguar nga Kosova dhe unë nuk mund të jepja detyra, se çka duhet të bënin shokët e Lëvizjes atje. Gjithashtu unë dëshiroja që shokët të njiheshin me gjendjen e vërtetë në emigracion dhe me punët që mund të bëheshin në emigracion, por edhe që ata ta kuptonin se veprimtaria nga emigracioni ka një rol të rëndësishëm për luftën tonë, por jo atë

vendimtar, se lufta për liri duhet të bëhet në Kosovë. Unë isha që Lëvizja në Kosovë të ngrihej dhe të bëhej e zonja që të ecte vetë në këmbët e veta e pa ndihmën tonë dhe që duke njohur më mirë se ne mundësitë dhe rrethanat edhe të nxirrnin detyrat e veprimit. Unë dhe shokët ishim për ndërtimin e një organizate në Kosovë që nuk do të drejtohej nga emigracioni, por që do ta bashkërendonte veprimtarinë me te.

Rexhep Ahmeti, që asokohe ishte mësimdhënës, në Gjimnazin e Mitrovicës, ishte shoku më i përshtatshëm nëpërmjet të cilit unë dëshiroja ta përcillja këtë mesazh e frymë tek shokët tjerë në Kosovë. Ai si veprimtarë i devotshëm i çështjes sonë, kishte kapacitetin intelektual për ta kuptuar drejtë qëndrimin tim dhe të shokëve të mi në emigracion.

Ndodhesha në bodrum për të marrë pije dhe po e prisja tek dera ashensorin. Krejt papritur shoh se sapo u hap dera e ashensorit , nga dera doli një polic! Pas përshëndetjes sime, polici nisi të më qortonte dhe tregonte se nuk kisha të drejtë të mbaja njerëz të huaj në dhomën time! Polici, gjithashtu më kërcënoi se nëse e përsëritja këtë gabim do të kisha pasoja në të ardhmen.

Së bashku me policin e morëm ashensorin dhe arritëm në restorant, ku edhe punoja. Polici u largua dhe shkoi. Unë ngela i vetëm me shefin tim, i cili me sjelljen e tij, më zhgënjeu shumë. U ngrita lartë në dhomën time dhe pashë se Rexhep Ahmetin e kishin detyruar ta linte dhomën time dhe e kishin shoqëruar në drejtim të panjohur! Sipas policit që më erdhi në bodrum, Rexhep Ahmetin do ta detyronin të largohej nga Zvicëra.

U ngjita shpejtë në dhomë dhe pashë se Rexhep Ahmeti ishte detyruar të kthehej! Zbrita përsëri poshtë dhe e pyeta punëdhënësin tim se përse e kishte thirrur policinë, meqë as unë e as shoku ime nuk kishim bërë asgjë të kundërligjshme, sepse shoku im kishte ardhur me dokumente të rregullta dhe unë e paguaja dhomën time? Punëdhënësi im e mbante kokën të ulur dhe nuk fliste asnjë fjalë.

Mirëpo, shqetësimi për Rexhep Ahmetin, më nxiti të bëhesha joracional në të menduar dhe menjëherë e dhashë dorëheqjen nga puna. “Tungjatjeta,-i thashë punëdhënësit, shkova në dhomën time, mblodha rrobat që kisha dhe ika drejtë e në Selzah, ku kisha qëndruar edhe më parë në kampin e refugjatëve.

Isha shumë i shqetësuar për fatin e Rexhep Ahmetit. Policët më kishin thënë se e kanë kthyer në Jugosllavi!

Në mbrëmje e mora në telefon Haxhi Berishën dhe nga ai mësova se Rexhep Ahmeti ishte ndalur tek ai në Amriswil. U gëzova shumë dhe menjëherë u nisa për Amriswil.

Gjatë qëndrimit në Amriswil Rexhep Ahmeti më njoftoi, se gjersa po lexonte, një burrë e kishte hapur derën e dhomës dhe pa thënë asnjë fjalë, e kishte mbyllur përsëri derën dhe ishte larguar. Pas, rreth një gjysmë ore, në dhomën e tij kishte trokitur policia e cila ia kishte kërkuar pasaportën dhe e kishte shoqëruar deri tek Stacioni i Trenit në Solloturn.

Pas dy ditësh të qëndrimit në Amriswil e përcollem Rexhep Ahmetin për Kosovë.

Disa javë më vonë fillova punën si pjatalarës në një restorant tjetër në fshatin Krigshtetten, që ishte afër Bernit. Edhe aty punoja gjithë ditën(07.00-23.00 me një pushim nga ora 11.00 deri në ora 14.00) dhe isha i lirë vetëm ditën e hëne dhe ditën e marte.

Puna ishte një pengesë në vete për veprimtarinë time politike. Por sidomos orari i punës ishte pengesa kryesore. Unë isha i zënë gjithë ditën dhe mbrëmjeve, por edhe ditëve të fundjavës kur shumica e mërgimtarëve tanë ishin të lirë dhe kjo e pamundësonte veprimtarinë time.

Përkundër vështirësive dhe largësinë e madhe gjeografike që kisha nga shokët, zakonisht ditët e lira i kaloja tek shokët, sidomos tek Haxhi Berisha në Amriswil dhe tek Demë Mustafaj në Zug. Aty vinin edhe shokët tjerë ose së bashku i vizitonim shokët nëpër rrethet të ndryshme.

Në Zvicër kishim një rreth të gjerë shokësh dhe pas konsultimeve edhe me Sabri Novosellën dhe Xhafer Durmishin, ishim pajtuar që ta krijonim Degën e LRSShJ-së në Zvicër. Për ndërtimin e Degës së LRSShJ-së në Zvicër punonin këta shokë: Haxhi Berisha, Elmaz Ademi, Demë Mustafaj, Januz Mustafa, Xhemajl Dauti dhe unë.

Xhemajl Dauti, Demë Mustafaj, Asllan Muharremi dhe Elmaz Ademi

Shokët e krahut të Lëvizjes për Zvicër kishin ndikim të madh në rrethet e ndryshme. Ata mbanin takime të vazhdueshme dhe shumë të shpeshta me bashkatdhetarët tanë dhe e propagandonin vijën tonë politike.

Meqenëse krahu ynë politikë në programin e tij politikë e kishte shpalosur botërisht se ne luftonim që Krahinës së Kosovës t'i njihej statusi i Republikës brenda Federatës Jugosllave, krahu i Xhafer Shatrit, bënte përpjekje të ngjallte huti në radhët e shqiptarëve nga viset shqiptare jashtë territorit të Kosovës se gjoja ne kemi tradhtuar idealet e bashkimit kombëtar, por edhe interesat e shqiptarëve të atyre anëve!

Mirëpo, bashkatdhetarët tanë nga trojet shqiptare në Maqedoni si Elmaz Ademi, Xhamajl Dauti, Xhemil Beçiri etj. e kishin kuptuar drejtë luftën tonë dhe faktin se të luftosh për "Kosovën-Republikë" nënkuptonte se je duke luftuar për të drejtat e të gjithë shqiptarëve në Federatën Jugosllave, se Republika e Kosovës u jepte statusin e kombeve shtet-formues edhe shqiptarëve të Federatës Jugosllave.

Nga shokët kisha dëgjuar se Elmaz Ademi gjatë takimeve më mërgimtarë kur ishte pyetur se përse po luftonte për Republikën e Kosovës përderisa jashtë territorit të saj do të ngeleshin viset shqiptare ishte përgjigjur: "Unë jam në përkrahje jo vetëm të kërkesës që Krahina e Kosovës ta fitoj statusin e Republikës brenda Federatës Jugosllave, por do të dal në përkrahje edhe të një qyteti të vetëm shqiptar që do ta shtronte një kërkesë të tillë, pa marrë parasysh se a do të hynte në kuadër të asaj republike Tetova ime!"

Ndjehesha i mahnitur nga ky qëndrim shumë i zgjuar dhe largpamës i Elmaz Ademit.

Ardhja e Hysen dhe Avdyl Gërvallës në Zvicër

Gjatë pranverës së vitit 1985, nga shokët dëgjova se në Zvicër kishin ardhur Hysen e Avdyl Gërvalla, dy vëllezërit e Jusuf e Bardhosh Gërvallës! Më erdhi keq që e kishin lëshuar Kosovën, por njëkohësisht edhe u gëzova që do t'i kishim në mesin tonë. Haxhi Berisha dhe Demë Mustafaj kishin edhe një lidhje familjare me ta dhe unë shpresoja se kjo lidhje do ta ndihmojë afrimin tonë me vëllezërit e Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës. Gjithashtu, nga shokët mësova se Hysen dhe Abdyl Gërvalla ishin vendosur në qytetin Delemont, ku banonte dhe punonte edhe shoku ynë Xhemajl Dauti.

Së bashku me shokët Elmaz Ademi, Haxhi Berisha, Demë Mustafaj shkuam dhe i vizituam Hysen e Avdyl Gërvallën në Delemont. Atyre u shprehem gëzimin që i kishim në mesin tonë, ashtu siç u folëm edhe për veprimtarinë tonë politike dhe përpjekjet që bënim për lirinë e Kosovës.

Nuk vonoi shumë kohë dhe Hysen Gërvalla na e shpjegoi se qëllimi ardhjes së tij në Evropën Perëndimore ishte: t'i bashkonte të gjitha organizatat politike shqiptare! Gjithashtu Hysen Gërvalla aludonte se nuk ishte i vetëm në këtë mision dhe se prapa tij qëndronte dikush tjetër, që i dinte më mirë këto punë!

Ndonëse nuk e thoshin hapur, na e merrte mendja se Hysen dhe Avdyl Gërvalla kishin kaluar nga Kosova në Shqipëri dhe pastaj nga Shqipëria në Evropën Perëndimore.

Mirëpo ndonëse edhe ne pajtoheshim se bashkimi i të gjitha forcave politike shqiptare nuk kishte alternativ tjetër, ne nuk na pëlqente euforia e Hysen Gërvallës lidhur me çështjen e bashkimit të organizatave politike dhe aq më tepër nuk na pëlqente aludimi se prapa tij, dhe misionit të tij, qëndronte dikush tjetër!

Nganjëherë, gjatë bisedës, më krijohej përshtypja se Hysen Gërvalla nuk e kuptonte se çështja e bashkimit nuk ishte një çështje aq e thjeshtë, se bashkimi ynë nuk mund të arrihej vetëm me fjalë të bukura dhe premtime boshe!

Gjatë takimeve të vazhdueshme me shumë veprimtarë të Degës së Lëvizjes në Zvicër, por edhe shokët që gjendeshin në vendet tjera, kanë zhvilluar biseda me Hysen e Avdyl Gërvallën. Hysenit, kam bërë përpjekje t'jua shpjegojnë qëndrimin tonë lidhur me bashkimin e organizatave politike shqiptare.

Një ditë, së bashku edhe me disa nga shokët tanë ndodhesha në Delemont tek Xhemajl Dauti dhe aty gjendeshin edhe Hysen dhe Avdyl Gërvalla. Gjatë qëndrimit në banesë të Xhamajl Dautit, nga Suedia, thërret në telefon Sabri Novosella , i cili në atë rast zhvillon një bisedë të gjatë me Hysen Gërvallën. Ne të tjerët vetëm po prisnin fundin e bisedës së tyre, por Hysen Gërvalla ma dorëzoi mua receptorin e telefonit, pas mbarimit të bisedës. Në atë bisedë Sabriu më thotë kështu: "Prej sot do të fle rehat! Hyseni është shok i Organizatës sonë (LNÇKVShJ-së) dhe unë e propozoj atë për anëtar të KQ të Lëvizjes...!"

Xhemajl Dauti, Elmaz Ademi, Demë Mustafaj, Hysen Gërvalla dhe Asllan Muharremi

Pas largimit nga banesa e Xhemajl Dautit i kam njoftuar shokët për bisedën me Sabriun dhe për propozimin e tij.

Në çështjen e bashkimit të organizatave tona politike dolën edhe problemet e para në mes organizatës sonë edhe Hysen Gërvallës. Ne nuk ishim kundër bashkimit të organizatave politike shqiptare, por nuk ishim as për përqafime e bashkime sa për sy e faqe. "Zëri i Kosovës" që botohej në Zvicër dhe "Zëri i Kosovës" që botohej në Suedi, ishin përfaqësues të dy rrymave të ndryshme politike. Krahu ynë politik i Lëvizjes, kishte nxjerrë tetë numra të "Zërit të Kosovës" dhe kështu kishte shpalosur vijën tonë politike. Ne kishim nisur ndërtimin e organizatës sonë politike dhe po punonim për ndërtimin e degëve të saj nëpër vende të ndryshme. Veç kësaj, veprimtarisë dhe organizatës sonë i ishin bashkuar një numër i madh veprimtarësh dhe ne nuk mund të dilnim para anëtarëve të organizatës sonë e ta përkrahnim iniciativën për bashkim, pa u shpjeguar, edhe njëherë, se pse ishim ndarë dhe çka kishte ndodhur, e pse duhej të bashkohemi përsëri? Në përpjekje për bashkimin e shqiptarëve rreth platformës për Republikën e Kosovës, ishte derdhur gjak dhe dikush duhej të përgjigjej, veç të tjerash, bie fjala, për vrasjen në Heerbrugg?

Përkundër qëndrimeve tona, Hysen Gërvalla, na thoshte se ai i ka kontaktuar përfaqësuesit e të gjitha grupimeve politike dhe se të gjithë ishin për bashkim, se ne nuk do të duhej të bëhemi pengesë e bashkimit!

Hysen Gërvalla ishte shumë shpirtçiltër në misionin e tij. Ai dëshironte t'i bënte bashkë të gjitha organizatat politike shqiptare dhe t'i vinte në ballë të luftës për liri burrat e kombit! Asgjë të keqe nuk kishte kjo iniciativë. Në anën tjetër, krerët e organizatave tjera politike ishin treguar shumë "zemërgjerë" dhe e kishin "shtrirë" dorën e pajtimit. Të vetmit "pengues" të bashkimit dilnim ne që thërrisnim për maturi dhe bashkim pas platformës sonë politike.

Ky qëndrim i bacës Hysen më zhgënjente, ashtu siç më zhgënjente edhe përshtypja që kisha se ai na konsideronte si çiliminj që nuk duhej t'ia prishnim terezinë për asgjë, madje as në sjelljen e tij si kryeplak dhe burrë zakoni!

Ishte shumë dëshpërues edhe qëndrimi i Hysen Gërvallës lidhur me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës.

Duke ditur se shokët e krahut tonë, disa prej të cilëve kishin qëndruar e vepruar pranë heronjve Jusuf e Bardhosh Gërvalla, qysh në fillim të takimeve tona me të, Hysen Gërvalla kishte shprehur pakënaqësinë e tij për punën tonë për zbulimin e vrasësve të Jusufit, Bardhit dhe Kadriut? Ai jo vetëm që ishte i pakënaqur me punën tonë në zbulimin e vrasësve të shokëve tanë, por madje edhe aludonte sikur qëllimi i arratisjes së tij nga Kosova na ishte qenë pikërisht edhe zbulimi i vrasësve! Qëndrimet tona se Jusufin, Bardhin dhe Kadri Zekën i ka vrarë Beogradi dhe se vetëm udhëheqja e UDBës e di se kush ua ka zënë pritën dhe kush e ka bërë vrasjen, nuk i pëlqenin bacës Hysen! Kjo na befasonte të gjithëve.

Disa javë pas ardhjes së Hysen Gërvallës në Zvicër dhe vendosjes së tij së bashku me vëllanë e tij në Delemont, nga autoritetet zvicerane më erdhi përgjigja, përfundimtare, lidhur me të drejtën e strehimit politik dhe vendimi shumë i padrejtë se duhej ta braktisja Zvicrën.

Ishte hetuesi që më kishte marrë në pyetje për tre ditë rresht, që më kishte fyer dhe sharë gjatë hetimeve, i cili më dha një muaj afat për ta lëshuar Zvicrën, se për ndryshe, do të më dërgonte duarlidhur në Beograd! Ç'të bëja unë? Me zor nuk mund të rrija në Zvicër! Më duhej të vazhdoja të rrokullisesha si guri që ka lënë vendin e tij.

E kontaktova avokatin tim dhe ju drejtova për ndihmë, por ai nuk tregohej i interesuar të merrej me çështjen e azilit tim! Ndonëse unë kisha disa dokumente të rëndësishme dhe që vërtetonin se unë ish një shqiptar i përndjekur nga regjimi jugosllav, as policia e Bernës dhe as avokati im nuk shprehën interesin për përkthimin e tyre. Këtë e konsideroja si një padrejtësi që po më bëhej.

Përkundër faktit se unë mendoja se më ishte bërë e padrejtë dhe se unë i plotësoja të gjitha kushtet që i kërkonte Konventa e Gjenevës, paragrafi tre, drejtësia zvicerane nuk qante kokën për mua dhe hallin tim. Edhe unë u pajtova që ta braktisja një vend që nuk tregon mirëkuptim për hallin tim.

Disa ditë pas marrjes së vendimit dhe ultimatumit të shefit të policisë së Solloturnit për ta braktisur Zvicrën, i kam njoftuar edhe shokët në Zvicër dhe me shokët kemi biseduar se nga t'ia mësyja. Jemi pajtuar që në fillim të kaloja në Gjermani dhe pastaj t'i shohim mundësit e qëndrimit aty apo të kalimit në ndonjë vend tjetër.

Nga shokët që po punonim për ndërtimin e Degës së LRShJ-së në Zvicër, leje pune dhe qëndrimi kishte Demë Mustafaj, Elmaz Ademi dhe Jonuz Mustafaj. Pa leje qëndrimi ishte Haxhi Berisha dhe Xhemajl Dauti.



Jonuz Mustafa

Një mbrëmje maji 1985, shokët më përcollën deri në Bazel. Me Haxhi Berishën, Demë Mustafajn, Elmaz Ademin, Xhemajl Dautin dhe Januz Mustafën pimë një kafe së bashku në një restorant që gjendej shumë afër një ure të rrugës hekurudhore mbi lumin Rajnë, që ishte edhe kufi në mes Gjermanisë dhe Zvicrës.

Pas kalimit të një treni u përshëndeta me shokët, u nisa në drejtim të urës mbi lumin Rajnë dhe e kalova shpejtë e shpejtë gjersa arrita në anën gjermane. Pastaj, me vrap, i kalova disa kilometra gjersa arrita në një fshat që dukej se ishte brenda në territorin gjerman. Në mesin e disa ferrave e kalova natën deri në muzgun e ditës së re. Në mëngjes e mora trenin në drejtim të Freiburgut. Nga aty ia zura derën Hafiz Gagicës në Shtutgart.

Në Francë

Pas një qëndrimi tre-katër javor tek Hafiz Gagica në Shtutgart dhe qëndrimit disaditorë tek Ismail Hoxha në Saarlouis-Roden, me ndihmën e këtij të fundit, kam kaluar në Francë.

Në Francë kam qëndruar në shtëpi të Ibush Bytyçit, që ishte me prejardhje nga Ferizaj dhe që banonte, prej vitesh, së bashku me familjen e tij në Limeil Brevannes rrethi i Parisit.

Shtëpia e Ibush Bytyçit ishte një nga pikat më të rëndësishme të LRSShJ-së në rrethin e Parisit. Familja Bytyçi kishte strehuar me dhjetëra veprimtarë të LRSShJ-së dhe vazhdonte t'i ndihmonte të gjithë ata që kishin nevojë për mbështetje, qofshin veprimtarë apo të strehuar rishtazi në rrethin e Parsit.

Po në atë mes gjendej edhe Ymer Berisha, i cili gjithashtu kishte bërë përpjekje maksimale për strukturimin e Degës së LRSShJ-së në Francë.

Në shtëpinë e familjes së Ibush Bytyçit jam njohur me Xhevat Halitin, që kishte strehim politik dhe banonte në të njëjtin qytet. Xhevat Haliti ishte nga fshati Orllan,që shtrihej buzë Liqenit të Batllavës, pas mbarimit të Shkollës së Mesme të Mjekësisë në Prishtinë, gjatë demonstratave të vitit 1981, bie në sy të policisë dhe detyrohet të largohet nga Kosova. Gjatë takimeve që kam pasur me të në Limeil Brevannes më kanë lënë përshtypje shumë të mira modestia dhe atdhedashuria e zjarrtë e Xhevat Halitit.

Pak para largimit tim nga Franca, kam pasur një takim me një përfaqësues të Ambasadës Shqiptare. Ky ishte takimi im i parë me një diplomat shqiptar, pas takimit që kisha pasur me Ibrahim Qavollin në Stamboll. Gjatë takimit që zgjati dy-tre orë, biseduam rreth veprimtarisë sonë në Zvicër e në mënyrë të veçantë rreth organit "Zëri i Kosovës", që redaktohej dhe udhëhiqej nga Xhafer Durmishi. Qëndrimi i diplomatit shqiptar ishte po ai që e kisha dëgjuar edhe nga shokët tjerë. Nuk pëlqehej vazhdimi i nxjerrjes së organit "Zëri i Kosovës" në Suedi.

Pas takimit, për mua, gjithçka ishte e qartë: shteti shqiptar ishte kundër vazhdimit të daljes së organit "Zëri i Kosovës" që e nxirrte krahu ynë. Edhe kësaj radhe qëndrimi i shtetit shqiptar motivohej me "përçarjen" që po i shkaktonte masës së mërgimtarëve dalja e dy organeve!

Ndjehesha shumë i zhgënjyer më këtë qëndrim të përfaqësuesve të shtetit shqiptar. Megjithëkëtë isha i bindur se vija politike që kishte ndjekur "Zëri i Kosovës", që botohej në Suedi, ishte e drejtë dhe plotësisht në përputhje me interesat dhe përpjekjet e popullit tonë për liri dhe barazi në kuadër të Federatës Jugosllave. Mirëpo, fatkeqësisht kjo punë nuk shihej kështu nga shteti shqiptar dhe këtu qëndronte e keqja!

Ndonëse isha i bindur se vija jonë politike ishte e drejtë, unë nuk mund t'i mbyllja veshët dhe sytë pas një qëndrimi të tillë të shtetit shqiptar. Edhe më tutje mendoja se shteti shqiptar duhet ta gjykojë më drejtë se unë këtë çështje dhe se veprimtaria jonë duhej të zhvillohej në përputhje dhe bashkërendim me interesat edhe të shtetit shqiptar, se ne nuk duhet të bëjmë veprime që janë në kundërshtim me këto interesa.

I "dërmuar"shpirtërisht nga biseda me përfaqësuesin e Ambasadës Shqiptare në Paris dhe qëndrimet e tij lidhur me veprimtarinë politike në emigracion dhe sidomos rreth daljes së "Zërit të Kosovës", shokëve në Zvicër, Gjermani dhe Suedi u kam propozuar që ta ndërpresim daljen e "Zërit të Kosovës" dhe të mendojmë për krijimin e shoqërive patriotike apolitike e cila pastaj do të nxirrte ndonjë organ apo revistë të saj! Propozimin tim e kam motivuar se dalja e organit po shkakton "përçarjen e masave" në radhët e mërgatës sonë...

Letra ime dhe propozimi i saj është kundërshtuar nga shokët Xhafer Durmishi, Haxhi Berisha, Elmaz Ademi dhe Demë Mustafaj. Shokët e kanë quajtur propozimin tim "historik" "absurd" dhe të papranueshëm. Në dy letra që kam marrë: një nga Xhafer Durmishi dhe një tjetër nga Elmaz Ademi, Haxhi Berisha dhe Demë Mustafaj është treguar vendosmëria e shokëve për vazhdimin e daljes së "Zërit të Kosovës" dhe është kundërshtuar propozimi im. Shokët me argumente të shumta e kanë mbështetur domosdoshmërinë vazhdimit të daljes së "Zërit të Kosovës"dhe vazhdimin veprimtarisë sonë në shërbim të lirisë.

Përkundër faktit se unë kisha dal me propozimin për ndërprerjen e "Zërit të Kosovës" që botohej në Suedi, qëndrimin e shokëve e konsideroja të drejtë. Unë e dija se ata besonin, ashtu si unë, se vija jonë politike ishte e drejtë. Këtë e kisha dëgjuar nga shokët, por këtë e kishte shprehur edhe shoku ynë, Xhafer Durmishi, nëpërmjet shkrimeve të tij në "Zërit të Kosovës".

Mirëpo, për mua, kjo nuk ishte e mjaftueshme, sepse qëndrimi i shtetit shqiptar peshonte më rëndë se sa drejtësia e qëndrimit tonë! Unë mendoja se nuk ishte e mjaftueshme që vetëm ne të kishim drejtë, sepse mendoja se të drejtë në punën tonë duhej të na jepte edhe shteti shqiptar. Edhe më tutje mendoja se diplomatët shqiptarë na "mbanin në grusht" dhe mund të na e "ndalnin" frymën kur të dëshironin! Mjaftonte ta takonin një nga shokët tanë dhe brenda pesë minutave, në të gjithë botën, të përhapej "lajmi" se ky apo ai shok ishte i dyshimtë, i çuditshëm e të tjera. Diplomatët shqiptarë mund të na bënin hero, krye-hero e të na çonin në kupë të qiellit, jo vetëm ne që ishim me mendje e shpirt me ta, por edhe ata që me të vërtetë ishin kundër luftës së drejtë të populli

tonë për barazi, liri dhe çlirim! Gjithnjë e më shumë më shkonte mendja e "mbrapsht" se shteti shqiptar na trajtonte ne siç ia donte "pazari i ditës"dhe se "çmimi i vlerës" sonë ishte në përputhje me interesat e politikës ditore shqiptare!

Unë për vete po e kuptoja gjithnjë e më shumë se kështu si po sillej me ne, diplomacia shqiptare, ishte sjell edhe ndaj Sabri Novosellës, Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës dhe shumë e shumë veprimtarëve të tjerë, prandaj duke mos dashur të mos bëjë asgjë që nuk e pëlqente shteti shqiptar, unë pata dal me propozimin që ne "t'i dorëzojmë" armët! Unë për vete nuk gjeja forcë e as energji të bëja diçka që nuk i pëlqente shtetit shqiptar.

Unë e kisha dëgjuar nga Sabri Novosella qëndrimin e diplomacisë shqiptare edhe ndaj Jusuf Gërvallës dhe Kadri Zekës. E kisha dëgjuar edhe qëndrimin e shtetit shqiptar, para përplasjes sonë me Xhafer Shatrin. E njihja qëndrimin që kishte mbajtur shteti shqiptar menjëherë pas daljes së numrave të parë të "Zërit të Kosovës" në Suedi, por po e dëgjoja qëndrimin e tanishëm, pas numrit të tetë, që ishte krejtësisht i ndryshëm! Kisha përshtypjen se diplomatët shqiptarë ne na shikonin edhe si mundësi, edhe si pengesë edhe si vëllezër edhe si armiq...!

Mirëpo unë kisha dëgjuar nga shokët se Sabri Novosella, gjatë ditëve të qëndrimit tij në banesë të Haxhi Berishës në Zvicër, shpeshherë, gjatë vizitave në banjë, ishte dëgjuar duke lëshuar të shara me zë të lartë në adresë të "bandës kriminale të Tiranës", por pas kthimit në dhomën e ditës shokëve u kishte thënë: "Rroftë Partia e Punës dhe shoku Enver!" Gjithashtu nga shokët kisha dëgjuar se Jusuf Gërvalla ishte përlotur pas takimeve me diplomatë të shtetit shqiptar. E kisha kuptuar gjithashtu se as Xhafer Durmishi nuk i takonte me entuziazëm të madh diplomatët shqiptarë. Vallë kah t'ia mbanim? Ngado që mendja më thoshte, të nisesha, shikimin e mbaja kah Shqipëria. Nuk kishte alternativë tjetër. Edhe unë vazhdoja të thirrja "Rroftë Partia e Punës dhe shoku Enver!"

Megjithëse i kisha "dorëzuar armët" nuk e kisha ndërmend t'i ndërprisja kontaktet e me shtetin shqiptar. Kah dreqi t'ia mbaja?! Të gjitha dyert e botës më dukeshin të mbyllura! Askush nuk na e qante hallin tonë!

***

Pas kalimit të serishëm në Gjermani dhe qëndrimit disaditor në Shtutgart tek Hafiz Gagica, me ndihmën e Ali Ademit nga fshati Pestovë e Vushtrrisë, që ishte një veprimtar i shquar i Lëvizjes në Hamburg të Gjermanisë dhe jetonte e punonte aty prej shumë vitesh, u nisëm për Suedi. Nga Hamburgu në Kopenhagë kaluam pa asnjë problem. Ali Ademi ia dorëzoi konduktorit të trenit në Hamburg dy pasaporta dhe kur erdhën policia kufitare daneze ne ishim "shtrirë për të fjetur". Ata vetëm e hapën derën e kabinës dhe sapo panë se ishin duke fjetur dy udhëtarë e mbyllën derën dhe shkuan më tutje. Të nesërmen në mëngjes, pak pa arritur në Kopenhagë, Ali Ademi ju drejtua konduktorit dhe i mori pasaportat tonë.

Nga Danimarka në Suedi unë hyra pa pasaportë. Në vendkalim u rreshtova pas turmës së pasagjerëve që zbritën nga trageti Kopenhagë- Malmo dhe pa e ditur se ai rresht ishte vetëm për nënshtetasit e vendeve Skandinave kalova në

Suedi pa më pyetur njeri. Ali Ademit në rreshtin e të huajve ia kërkuan pasaportën dhe u takova përsëri me të brenda në territorin suedez.

Kalimi në Suedi

Në Stacionin e trenit në Stokholm, dolën dhe më pritën Xhafer Durmishi e Shukri Demiri. U përqafuam dhe gëzuam që u bëmë bashkë përsëri. Me Xhaferin, ky ishte takimi i parë pas atij të Shtutgartit, para mbi një viti e gjysmë. Edhe Shukriun po e takoja pas gati dy vitesh.

Kisha vizituar disa kryeqytete të vendeve evropiane, por asnjëri prej tyre nuk më ishte dukur më i bukur dhe më atraktiv se sa Stokholmi, qytet ky që po më mahniste me bukurin e tij. Njeriu mund të banonte në një skaj të qytetit e megjithëkëtë brenda disa minutave mund të arrinte, me ndihmën e metros, në qendër të qytetit. Qyteti kishte disa biblioteka dhe ato ishin shumë të pasura me libra në shumë gjuhë të botës. Nëpër biblioteka kishte edhe një numër të konsiderueshëm të librave në gjuhën shqipe.

Pas disa ditë qëndrimi e pushimi në Stokholm, falë ndihmës së Xhafer Durmishit dhe konsultimeve të tij me avokatin Kjell Jönsson, u drejtova tek organet policore dhe e bëra kërkesën e strehimit politik.

Ndonëse, pas parashtrimit të kërkesës për azil politik isha vendosur në një hotel në St. Eriksplan, me Xhafer Durmishin dhe Shukri Demirin takohesha çdo ditë. Takimet dhe bisedat e gjata me Xhafer Durmishin dhe Shukri Demirin i konsideroja si një ndihmë të madhe edhe për ta kuptuar më drejtë gjendjen e Lëvizjes sonë dhe veprimtarinë e saj në emigracion. Xhafer Durmishi kishte një përvojë të jashtëzakonshme në këtë fushë. Nga ai kam mësuar shumë nga veprimtaria e Jusuf Gërvallës, përvoja e tij me personalitete të tjera të emigracionit tonë, por edhe nga përvoja e tij e kontakteve me diplomacinë shqiptare.

Qysh para përplasjes në mes Sabri Novosellës dhe Xhafer Shatrit, bashkatdhetarët tanë e merrnin në gojë shtetin shqiptar dhe qëndrimin e tij lidhur me luftën tonë, por edhe lidhur me drejtësinë e qëndrimeve të krahut të Sabri Novosellës dhe atij të Xhafer Shatrit. Nuk ka dilemë se ashtu si për bashkatdhetarët tanë, ashtu edhe për mua dhe të gjithë shokët e mi, qëndrimi i shtetit shqiptar ishte i rëndësisë së jashtëzakonshme. Kështu unë e kuptoja këtë punë dhe tek kjo çështje unë nuk shihja asnjë të keqe. Mirëpo interpretimi sipas politikës ditore, i përpjekjeve tona, por edhe i të gjithë veprimtarëve, pa marrë parasysh krahun që përfaqësonin, ishte një çështje shumë e bezdisshme. Punonjës të përfaqësive diplomatike shqiptare, i interpretonin veprimet tona, jo

gjithmonë ashtu siç ishin, por në përputhje me direktivat që merrnin nga Tirana apo në përputhje me interesat e politikës ditore shqiptare që gjithashtu diktohej nga Tirana.

Shokët tanë kudo që ishin kërkonin nga ne që të konsultoheshim me "Shtëpinë e madhe" dhe të mos bënim asgjë pa marrë mendimin e saj! Ky qëndrim krijonte probleme të paparashikueshme dhe shumë telashe në përpjekjet tona për liri.

Sa isha në Zvicër e Gjermani, shokët tanë që kishin qenë për vizitë në Shqipëri apo që kishin takuar ndonjë punonjës të ndonjë ambasade shqiptare sillnin tek ne mesazhe të ndryshme, të cilat shpeshherë ishin edhe të pakuptueshme. Kështu, bie fjala, një shok i yni gjatë një vizite apo kontakti me përfaqësues të shtetit shqiptar, ishte pyetur për Xhafer Durmishin: ku ndodhet, me çka po merrej dhe pyetje të tjera? Pastaj shokët vinin me vrap dhe na pyesnin përse nuk po i kontakton Xhafer Durmishi-Skënderi ata të "Shtëpisë së Madhe"?! Pse po e nxirrni organin "Zëri i Kosovës" pa u konsultuar me shtetin shqiptar e të tjera e të tjera pyetje, që fatkeqësisht nuk ishin vetëm pyetje?

Sabri Novosella pas përplasjes me Xhafer Shatrin thoshte se e ka përkrahjen e shtetit shqiptar. Edhe shokët e krahut të Xhafer Shatrit e thonin të njëjtën gjë!

Kjo krijonte një konfuzion dhe dëshpërim të madh të masa e mërgimtarëve tanë. Thashethemet krijonin huti edhe tek shokët tanë. Me fjalë të tjara, Ambasadat Shqiptare, në njëfarë mënyre, na "mbanin" në grusht dhe gjithçka varej prej qëndrimit të tyre. Ajo mund të na ngrehte në qiell, por edhe të na fuste "nëntë pash nën dhe"! Mjaftonte të na e bënin me gisht dhe e "pat puna jonë"! Ti mund të ishe njëqind për qind me çështjen shqiptare, të ishe shkrirë për lirinë e popullit e vendit tënd, por kjo nuk mjaftonte, sepse një fjalë e "shtëpisë së madhe", të bënte jo vetëm të dyshimtë, por edhe "antishqiptar"!

Shteti shqiptar dhe përfaqësuesit e tij nëpër botë, nga përkrahës të një vije tjetër politike në "Zërin e Kosovës", para përplasjes në mes Sabri Novosellës dhe Xhafer Shatrit, pas daljes së dy numrave të parë të "Zërit të Kosovës" me adresë në Suedi dhe pas jetësimit të përçarjes në mes nesh, ndërrojnë "mendje" dhe bëhen kritikues të "përçarjes"! Ky qëndrim shkaktoi shumë telashe në radhët tona! Unë nuk lëshova të shara publike për këtë "lojë" të shtetit shqiptar, por pati nga ne të atillë, si Sabri Novosella që duke e ndier vetën të tradhtuar, ua shaloj "nënën kriminelëve të Tiranës"! Sabri Novosella ishte nisur nga Stambolli për Gjenevë, pas këshillimeve me Ibrahim Qavollin. Ai kishte të drejtë të ndjehej i mashtruar e tradhtuar nga shteti shqiptar dhe politikë bërësit e tij.

Sabri Novosella banonte rreth 700 kilometra në Jug të Suedisë dhe ne nuk kishim kontakte me njëri-tjetrin. Shkak i përplasjes së tij me Xhafer Durmishin, Haxhi Berishën, Elmaz Ademin, mua dhe shokët tjerë, ishte qëndrimi i tij i ri ndaj "Zërit të Kosovës" në Suedi. Dikush i kishte thënë Sabri Novosellës se "Zëri i Kosovës" që po botohej në Suedi është një organ që po citon Sitpe Shuvarin dhe në mënyrë indirekte e kishte akuzuar edhe Sabri Novosellën, se

ishte në përkrahje të tij dhe identifikuar atë me titizmin! Si dukej Sabriu e kishte "gëlltitur karremin" dhe kjo ishte për keqardhje!

Shumica e shokëve e "dënuan" ketë sjellje të Sabri Novosellës dhe ishin të mendimit se "Zëri i Kosovës" që redaktohej nga Xhafer Durmishi, të vazhdonte të ishte zëri i vërtetë i Kosovës dhe luftës së drejtë të popullit tonë për barazi në kuadër të Federatës jugosllave. Edhe unë isha përkrah Xhafer Durmishit dhe punës së tij të madhe dhe të drejtë në organin "Zëri i Kosovës".



Në Stokholm, së bashku me Xhafer Durmishin

Përkundër faktit se "Zëri i Kosovës" ndiqte një vijë të drejtë politike dhe në përputhje me interesat e luftës së popullit tonë për liri dhe barazi në kuadër të Federatës jugosllave, largimi i Hysen dhe Avdyl Gërvallës nga Kosova dhe manipulimi i përfaqësuesve të shtetit shqiptar me ta, në lojën e përpjekjeve për bashkimin e të gjitha grupeve politike, nuk ngeli pa gjurmë edhe në grupimin tonë politikë dhe në vazhdimin e nxjerrjes së "Zërit të Kosovës". Shumë shokë u lëkundën dhe nisën të përkrahin "nismën" e Hysen Gërvallës për bashkimin e të gjitha grupeve politike shqiptare. Shokët në Zvicër, Gjermani dhe nëpër vende të tjera kërkonin nga Xhafer Durmishi dhe ata që ishin pranë tij që t'i bashkoheshin thirrjeve të Hysen Gërvallës.

Xhafer Durmishi kishte një përvojë të gjatë, por edhe të hidhur me udhëheqës si Xhafer Shatri, Ibrahim Kelmendi dhe Abdullah Prapashtica dhe

nuk hidhej lehtë në grackë, ashtu siç po hidhej Hysen Gërvalla dhe shumë përkrahës të tij. Ai nuk priste se do të dilte diç e mirë nga përpjekjet për bashkim që i kishte "iniciuar" Hysen Gërvalla, prandaj pas një letre që i dërgon Hysen Gërvallës e kundërshton një bashkim të tillë. Qëndrimi i shokëve rreth kësaj letre ishte i ndryshëm, por shumica u rreshtuan pas Hysen Gërvallës. Me këtë pushoi edhe mundësia e daljes së organit "Zëri i Kosovës" që botohej në Suedi.

Nuk kaloj shumë kohë dhe shokët që besonin në bashkimin e propozuar nga Hysen Gervalla e kuptuan drejtësinë e qëndrimeve të Xhafer Durmishit. Megjithëkëtë, për shkak të shumë faktorëve "Zëri i Kosovës" që lexuesve shqiptarë në tetë numrat e tij ua përcolli mesazhin e lirisë, nuk u aktivizua asnjëherë.

Vizita e Rexhep Ahmetit në Stokholm

Në fillim të vitit 1986, pas një udhëtimi të gjatë, së pari nga Kosova në Francë e pastaj nga Parisi në Stokholm, më vije për vizitë shoku im Rexhep Ahmeti. Kjo ishte vizita e dytë e tij në shërbim të përpjekjeve tona për liri dhe i dërguar nga shokët në Kosovë.

Rexhep Ahmeti na njoftoi mua dhe Xhafer Durmishin për gjendjen e radhëve të Lëvizjes në krahun e shokëve që kisha lënë në Kosovë dhe që kishin si fushë veprimi Mitrovicën, Vushtrrinë dhe Prishtinën. Rexhep Ahmeti përcolli tek ne edhe qëndrimet e shokëve të Lëvizjes në Kosovë lidhur me veprimtarinë në vend, por edhe lidhur me ndihmën që i duhej asaj nga emigracioni.

Rexhep Ahmeti

Gjatë javës sa qëndrojë tek ne në Stockholm, Xhafer Durmishi dhe unë e njoftuam Rexhep Ahmetin lidhur me gjendjen e organizatës sonë dhe pasojat e përçarjes që kishin plasur para dy vitesh.

Gjatë qëndrimit të Rexhep Ahmetit në Stockholm, e kam kërkuar një takim me Alçi K. dhe Zenel M. që ishin punonjës të Ambasadës Shqiptare në Stockholm.

Duke e takuar shokun nga Kosova me përfaqësues të shtetit shqiptar unë dëshiroja që Rexhep Ahmeti të dëgjonte drejtpërdrejtë qëndrimin e shtetit shqiptar. Gjithashtu me këtë takim dëshiroja që shteti shqiptar të informohej për zhvillimet në Kosovë e Jugosllavi.

Pas një jave qëndrimi në Stokholm, Rexhep Ahmetin e përcolla për Kosovë. Kisha besim të plotë në të dhe se ai do t'jua përcillte shokëve qëndrimet tona si dhe kështu do t'i ndihmonte ata të nxirrnin konkluzione të drejta për drejtimet e veprimtarisë që do të zhvillonin në Kosovë.

Vizita e Shyqyri Imerit në Stokholm

Me 4-5 maj 1986, disa muaj pas vizitës së Rexhep Ahmetit, nga Kosova vije përsëri Shyqyri Imeri. Edhe Shyqyri Imeri vije me porosi të shokëve, nëpërmjet vëllait tim Shabanit, i cili vazhdonte të mbetej lidhje e shokëve Xhemajl Pllanës, Ferki Morinës dhe shokëve tjerë. (Kishte ndodhur një gabim dhe Shyqëri Imeri, së pari ishte nisur nga Kosova në Francë dhe pas një pushimi të shkurtër në familjen e Ibush Bytyqit dhe ndihmën e tij niset për Stokholm.)

Qëllimi i vizitës së Shyqyri Imerit ishte vazhdimi i bisedës me Rexhep Ahmetin dhe shpjegimit, deri në detaje, të çështjeve që kishim shtruar gjatë takimit me te. Shokët në Kosovë (Xhemajl Pllana dhe Ferki Morina dhe shokët tjerë të cilët Shyqa nuk i njihte me emra) kërkonin qartësimin e gjendjes së Lëvizjes në emigracionin, sidomos gjendjen e LRSSHJ-së dhe sidomos qëndrimin e shtetit shqiptar lidhur me luftën tonë.

Shaban Muharremi dhe Shyqyri Imeri

Gjatë javës sa qëndroi tek unë, Shyqyri Imerin, e informova për të gjitha çështjet që kishin shtruar shokët në Kosovë. Shokët i informova edhe për përçarjen në radhët emigracionit, ashtu siç i informova edhe për gjendjen e

rëndë organizative të krahut tonë të LRSShJ-së si dhe për vazhdimin e qëndrimit të shtetit shqiptar në raport me veprimtarinë tonë politike.

Shyqyri Imerin gjithashtu e kam takuar me Alçin K. dhe Zenel M. Me qëllim që përfaqësuesit e shtetit shqiptar të informoheshin drejtpërsëdrejti për gjendjen politike në Kosovë, por që edhe shoku im ta dëgjonte drejtpërsëdrejti nga goja e tyre qëndrimin e shtetit shqiptar lidhur me përpjekjet tona për liri.

***

Verën e vitit 1986, Suedia, ma njohu statutin e refugjatit politik, sipas paragrafit 3 të Konventës së Gjenevës. Me këtë mori fund sorollatje ime nëpër Evropë dhe pasiguria që më shoqëroj që nga dita kur u largova nga Kosova ime e shtrenjtë. Tani kisha një vend qëndrimi dhe pune, ku do të mund të nisja jetën time larg atdheut tim.

Meqë gjatë kohës së pritjes, për përgjigje në kërkesën time, unë kisha ndjekur kursin e mësimit të gjuhës suedeze dhe falë edhe njohjes së pakët të gjuhës gjermane, e mësova gjuhën suedeze sa për komunikim me njerëzit dhe për të përcjell zhvillimet në vendin që më kishte pranuar në gjirin e tij.

Menjëherë pas marrjes së lejes së qëndrimit dhe punës, u lajmërova në Entin e Punësimit dhe pas pak ditësh arrita ta gjej një punë. Punoja si drejtues i një makine që prodhonte gypa të gomës për kamionë. Detyra ime ishte të bëja bashkimin e telave të hollë metalikë dhe një shtrese me gomë dhe pastaj t'i lidhja me një litar dhe t'i fusja në një furrë ku goma shkrihej dhe telat metalikë ngelshin në brendinë e saj. Nuk m'u deshtë shumë kohë dhe u bëra specialist i kësaj pune!

Pas disa ditësh në vendin tim të punës me erdhi një burrë që ishte para pensionimit dhe u prezantua se ishte emigrant i moçëm nga Shqipëria. U gëzova që takova një vëlla. Një ditë më pas u paraqit edhe një vëlla tjetër nga Shqipëria. Të dy më pyesnin se nga isha dhe përse isha larguar nga Kosova?

Disa ditë më vonë, një mëngjes, hyra në dhomën e ndërrimit të rrobave dhe aty e gjeta bashkatdhetarin tim nga Shqipëria. E përshëndeta me "Mirë mëngjes!" Ai nuk ma ktheu përgjigjen! Pas pak ia përsërita edhe njëherë përshëndetjen dhe ai u kthye nga unë dhe më tha:

– Mos më përshëndet! Unë e di se kush je! Ti je shok i Adem Demaçit e Jusuf Gërvallës. Ju jeni me Shqipërinë dhe komunistët..!

I habitur e shikoja dhe nuk dija se ç't'i them. Në krahun e majtë të gjoksit, për herë të parë ia pash, se e kishte varur një emblemë të flamurit kuq e zi pa yllin me pesë stepa!

– Në rregull. Ne luftojmë për "Kosovën-Republikë",– i thashë dhe u largova nga dhoma.

Pak kohë pas vendosjes sime në Stokholm së bashku me shokët e mi, Xhafer Durmishi dhe Shukri Demiri, kohë pas kohe e vizitonim Shoqatën e Miqësisë Suedi-Shqipëri. Në lokalet e Shoqatës së Miqësisë kam pasur nderin të njihem

personalisht me shumë veprimtarë të devotshëm, në mesin e të cilëve edhe njohësit e shkëlqyeshëm të gjuhës shqipe Ullmar Qvick dhe Lars Morin.

Shoqata e Miqësisë Suedi-Shqipëri e nxirrte edhe një revistë që quhej "*Albanien och Vi*" e cila lexuesin suedez e njihte me historinë e popullit shqiptar, por edhe zhvillimet dhe gjendjen në Shqipërinë e kohës sonë. Në faqet e revistës prezantoheshin edhe shkrimtarë të shquar shqiptarë, shkrime historike dhe përshtypje të vizitorëve suedez nga udhëtimet nëpër Shqipëri.

Në fillim të vitit 1987, gjatë një vizite që i bëmë Shoqatës së Miqësisë Suedi-Shqipëri, së bashku me Shukri Demirin, mësuam se gjatë verës që do të vinte, për vizitorët nga vendet Skandinave do të bëhej një udhëtimi turistik në Shqipëri.

Meqë kisha punuar disa muaj dhe e kisha krijuar mundësin materiale për ta realizuar ëndrrën time të kahershme për ta vizituar Shqipërinë, së bashku me Shukri Demrin biseduam dhe vendosëm që edhe ne ta vizitojmë Shqipërinë. Disa ditë më vonë shkuam në Shoqatën e Miqësisë dhe u regjistruam si vizitorë të mundshëm.

Diku kah mesi i qershorit 1987, e kemi bërë pagesën dhe marrë vesh se Shoqata e Miqësisë Shqipëri-Suedi, i kishte rregulluar edhe vizat për ne.

Udhëtimi i parë në Shqipëri

Pas një fluturimi të gjatë, nga Stokholmi në Cyrih dhe Cyrihu në Tiranë, aeroplani ateroi në Aeroportin e Rinasit. Rreth njëzet udhëtarët, sa ishim në aeroplan, zbritëm nëpër shkallët e aeroplanit dhe ecëm nëpër pistë deri në ndërtesën e aeroportit.

Doli ashtu si na paralajmëroi stjuardesa në aeroplan, në Rinas bënte shumë nxehtë. Stokholmin e kisha lënë vetëm plus 15-16 gradë celsius dhe unë isha i veshur si për pranverë. Trupi m'u bë qull nga djersët.

Nuk voni shumë dhe kalova nëpër kontrollin e bagazheve. Aty pranë, u takova më Kristaqin e Shyqëriun, që ishin duke më pritur. Mora bagazhin dhe së bashku me nikoqirët e shoferin e tyre u nisëm në drejtim të Tiranës.

Në fillim, pa zbritur nga makina, bëmë një shëtitje nëpër Tiranë. Pastaj zumë vend në Hotel Tirana, ku pimë nga një gotë konjak *Skënderbeg*. Më vonë u bëmë një vizitë varrezave të dëshmorëve dhe monumentit "Nënë Shqipëri". Për një çast u ndalëm edhe para varrit të Enver Hoxhës, ku bënin roje dy ushtarë.

Pa ra terri në tokë, u nisëm për Durrës dhe aty u bashkova me grupin e turistëve nga Skandinavia.

Gjithçka më dukej si një ëndërr. Isha shumë i lumtur dhe krenar që kisha ardhur në Shqipërinë time të dashur, por ndjehesha edhe i "dehur" nga gëzimi për realizimin e vizitës së shumëpritur. Shikoja e shikoja dhe sikur nuk dija të ngopesha së shikuari! Ndonëse kisha kaluar vetëm nga Aeroporti i Rinasit deri në Tiranë dhe nga Tirana deri në Durrës, si dhe isha shumë i lodhur nga udhëtimi i gjatë, isha përpjekur të shikoja gjithçka që ndodhej përreth: rrugët, shtëpitë, fushat dhe njerëzit.

Mirëpo, për hir të së vërtetës duhet thënë se, Shqipëria ime, po më dukej më ndryshe nga ajo që e kisha përfytyruar. Fasadat, rrugët, hotelet, ndërtesat dhe shtëpitë më dukeshin të vjetra e të lëna pas dore. Njerëzit më dukeshin të veshur keq, të paushqyer mirë dhe kisha përshtypjen se ata nuk ishin as të lumtur!

Kristaqi dhe Shyqëriu më shoqëruan gjer te Hotel "Apollonia" në plazhin e Durrësit. Aty u bëra bashkë me Shukri Demirin dhe grupin e turistëve nga Skandinavia. U rehatuam nëpër dhoma dhe pas pak dolëm nga dhomat dhe

zbritëm në restorant ku na priste darka. Pas darke, i gjithë grupi shkuam në Hotel "Adriatik" ku do të kishim rastin të njiheshim me njëri-tjetrin dhe të pinim ndonjë gotë raki e të dëgjonim muzikë shqiptare.

Gjersa u kthyem në dhomë, unë dhe Shukriu, nuk ndërruam ndonjë fjalë. Edhe kur u kthyem në dhomë, një heshtje e pakuptueshme e pushtoi dhomën tonë. Kisha përshtypjen se as Shukriu nuk dëshironte të fliste për përshtypjet e tij dhe se edhe ai ndjente po atë dhembje që ndjeja unë. Ç'është e vërteta, për shumë gjëra edhe s'kishte nevojë të flisnim, sepse për shumë çështje fliste vet gjendja në Hotelin "Apollonia" por edhe jashtë tij. As Hoteli "Adriatik", që konsiderohej i një klase më të lartë, nuk ishte kushedi më mirë se sa Hoteli "Apollonia", ashtu siç nuk dukej në një gjendje më të mirë Tirana nga Durrësi!

Megjithëkëtë unë sapo kisha zbritur në Shqipërinë time të dashur dhe sapo kisha nisur ta prekja e njihja më për afër këtë pjesë të atdheut, që në opinionet dhe përfytyrimet e mia e konsideroja si pjesën e atdheut, ku klasa punëtore, fshatarësia dhe inteligjenca përparimtare ishte në pushtet; sapo kisha zbritur në atdheun tim ku unë shpresoja se drejtësia, barazia e vëllazëria në mes njerëzve kishte shtrirë mbretërinë e saj në çdo cep të jetës! Prandaj, meqë unë sapo kisha ardhur në Shqipëri, më duhej të mos nxitoja e të nxirrja përfundime të shpejta, ende pa njohur mirë gjendjen e vërtetë që mbretëronte në atdheun tim,–i thosha vetës sime.

Kisha dëgjuar se Shqipëria që nga mbarimi i Luftës Nacionalçlirimtare e Antifashiste kishte bërë transformime të mëdha shoqërore dhe ekonomike, se Shqipëria e re nuk ishte si ajo e kohës së Ahmet Zogut, se ishin hapur dyert e shkollave në qytet e fshat, se gruaja shqiptare ishte çliruar nga zakonet patriarkale e prapanike, se gruaja shqiptare, ashtu siç kishte marrë pjesë në luftë për çlirimin e vendit, po merrte pjesë edhe në ndërtimin e shoqërisë së re, se vendi ishte elektrifikuar dhe se ishin bërë hapa të mëdhenj në industrializimin e vendit dhe zhvillimin e bujqësisë. Dhe në ato që kisha dëgjuar e lexuar kishte shumë të vërteta. Shqipëria dhe shqiptarët kishin bërë hapa të mëdhenj përpara. Kudo shiheshin ndryshime, përparime, transformime. Shqipëria nuk ishte si ajo e poezive të Migjenit, as e viteve të para të pas çlirimit nga hordhitë fashiste.

Megjithëkëtë, ndonëse ishin bërë ndryshime, përparime e transformime, kisha përshtypjen, sikur "gjithçka" ishte ndalur në vend dhe sikur vendi dhe shoqëria shqiptare ndodhej në një udhëkryq! Kjo gjendje më mbushte me plotë ankth.

Se në atdheun tim mbretëronte një gjendje e vështirë ekonomike, deri diku, e kisha marrë me mend edhe më parë, e kisha kuptuar edhe nga ato pak kontakte që kisha pasur me njerëz nga Shqipëria, por asnjëherë nuk kisha menduar se gjendja ishte kaq e rëndë. Kisha përshtypjen, madje, se gjendja ishte shumë më rëndë nga ajo që kisha dëgjuar nga njerëz të ndryshëm. Më vinte shumë inat, sepse shumë nga ato që kisha dëgjuar e lexuar, i kisha konsideruar si propagandë të armiqve të Shqipërisë socialiste, dhe nuk e kisha marrë me mend se shumë nga ato që kisha dëgjuar për gjendjen ekonomike, ishin të vërteta!

Por, ç'është e vërteta, nuk e pritja se gjithçka do ta gjeja të përsosur dhe ashtu siç e kisha lexuar nëpër libra, gazeta e revista dhe siç e kisha parë në televizor. Pushtimet e gjata dhe të ndryshme nëpër të cilat kishte kaluar Shqipëria, kishin lënë gjurmë e pasoja. Pastaj, e merrja me mend, se ndërtimi i Shqipërisë së re, kërkonte edhe mund, përpjekje dhe kohë.

Mirëpo, meqë sapo kisha ardhur në Shqipëri dhe ndonëse ato që kisha parë nuk premtonin shumë se pjesa tjetër e Shqipërisë, që do ta vizitoja ditët e ardhshme, do të ishte më ndryshe, më duhej të tregohesha i matur dhe të përpiqesha të kuptoja se përse është katandisur Shqipëria në këtë gjendje?

Nga aq sa shihja dhe dëgjoja, nga njerëzit që takoja, ma thoshte mendja se shumë gjëra kanë mundur të ishin bërë më ndryshe dhe më mirë, se kjo gjendje nuk mund të justifikohej me "arsyetimet" e PPSh-së se gjendja ekonomike në Shqipëri "ishte rezultat i bllokadës imperialiste dhe revizioniste", ashtu siç nuk justifikohej as me sloganin demagogjik: " se ne hamë barë, por parimet nuk i shkelim"!

Unë nuk mund të gjeja fajtorë të tjerë, për këtë gjendje, pos Partisë së Punës, e cila siç po më dukej, kishte kohë që e kishte ndarë shtetin nga populli; se Partia e Punës në vend që të ishte në shërbim të popullit, dalëngadalë, ju kishte varur popullit në qafë!

Ndonëse e kisha marrë me mend se në përpjekjet për ndërtimin e shoqërisë socialiste, rruga nuk ishte e shtruar me lule dhe se vështirësitë në këtë rrugëtim ishin të panumërta, prapëseprapë, unë mendoja se fajet për këtë gjendje binin mbi Partinë e Punës së Shqipërisë. Gjendja ekonomike dhe politike në Shqipëri, fliste qartë se Partia e Punës së Shqipërisë, kishte bërë gabime të vazhdueshme dhe sipas përshtypjeve të mia ajo asnjëherë nuk ishte përpjekur për të nxjerrë mësime prej gabimeve të saj! Ndoshta, këtu duhet kërkuar shkaqet e kësaj gjendje të krijuar?– i thosha vetës sime.

Një nga gabimet më të mëdha që kishte bërë PPSh-ja, për mendimin tim, ishte shndërrimi i teorisë së materializmit dialektik nga një teori revolucionare në një teori dogmatike. Ky krim, i bërë mbi teorinë e materializmit dialektik, për mendimin tim, e ka sjell socializmin në Shqipëri në shtratin e vdekjes. Prandaj, nga ajo që po shihja me sy, unë isha skeptik në të ardhmen e Shqipërinë socialiste të udhëhequr nga PPSh-ja. Zemra m'u mbush me vrer dhe pikëllim! Unë që vetëm disa ditë më parë shumë gjëra nuk i merrja me mend, tani po e kuptoja se pushtetarët në Shqipëri nuk kishin asgjë të përbashkët me heronjtë e Luftës Nacionalçlirimtare që derdhen gjakun për një botë të re, të lirë dhe pa shtypje e shfrytëzim.

Megjithëkëtë, unë jetoja në një vend të largët dhe isha i mendimit se ecja e Shqipërisë, në përpjekjet e saj për ndërtimin e një shoqërie socialiste dhe të bërat e të pabërat e saj, nuk ishin punë që unë mund t'i ndryshoja apo korrigjoja. Përkundrazi, unë mendoja, se ato ishin, në radhë të parë, punë të popullit shqiptar, sepse vetëm populli shqiptar kishte të drejtë ta gjykojë udhëheqjen e tij për punët që ajo ka bërë, gjatë këtyre viteve të pas mbarimit të Luftës

Nacionalçlirimtare. Unë nuk "guxoja" ta merrja rolin e mësuesit dhe t'ju tregoja vëllezërve të mi se nga do të duhej të ecnin?

Ndonëse ndjehesha i turbulluar dhe ndjeja dhembje për gjendjen në të cilën e gjeta Shqipërinë, mendja më shkonte tek Kosova ime e dashur dhe populli im që e kisha lënë nën thundrën serbe. Po sikur ta dinin gjendjen e vërtetë në Shqipëri, populli dhe shokët e mi të luftës në Kosovë, vallë ç'do të bënin dhe si do të vepronin ?

Unë po e shihja se Shqipëria jonë e shtrenjtë kishte hallet e saj dhe se ajo nuk ishte e zonja të merrej me vetën e saj, e le më, ta ndihmonte luftën tonë për liri!

Duke u përballur me realistin e hidhur në Shqipëri, ndonëse po tmerrohesha dhe isha i mbushur me ankth, në kokën time, gjeja një lloj "mirëkuptimi" për qëndrimin e shtetit shqiptar lidhur me luftën tonë! Udhëheqja shqiptare, ia di hallin veti, prandaj nuk do që ne t'i nxjerrim telashe të tjera,– i thosha vetës sime.

Nga ajo sa kisha lexuar e studiuar materializmin dialektik dhe historik e kisha kuptuar si teori shkencore, të gjallë dhe që shënon zhvillim të përhershëm. Prandaj, gjithë thirrjet e Partisë së Punës së Shqipërisë, për luftë kundër revizionizmit jugosllav, rus, kinez e të tjera, unë i kisha menduar se bëheshin për çështje parimore dhe për hir të interesave të popullit dhe të klasës punëtore. Mirëpo kur e shihja gjendjen në të cilën ndodhej Shqipëria, qëndrimet e PPSh-së edhe në këtë çështje, po më dilnin qëndrime dogmatike dhe në kundërshtim me teorinë e materializmit dialektik dhe historik.

Jugosllavia titiste ishte një diktaturë e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, e cila në gjirin e saj kishte futur shovinistë, nacionalistë e fashistë serbë dhe tradhtarë të popujve të tjerë! Titoja dhe Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, qysh gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e Antifashiste, kishte tradhtuar idealet e lëvizjes çlirimtare të popujve të Jugosllavisë. Në emër të luftës kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, Jugosllavia e Titos, kishte ushtruar terror të egër kundër shqiptarëve, por edhe kundër të gjitha forcave përparimtare e revolucionare në Jugosllavi. Këto ishin arsyet e mia dhe të shokëve të mi që na kishin shtyrë t'i shpallnim luftë Jugosllavisë titiste dhe politikës së saj antishqiptare.

Ditët e para në Durrës, unë dhe shumica e turistëve nga vendet Skandinave, i kemi kaluar të shoqëruar nga aroma dhe shija e konjakut të mrekullueshëm shqiptar "Gjergj Kastrioti- Skënderbeg". Gjatë gjithë kohës, kemi qëndruar në Hotel Apollonia, ndonëse kohë pas kohe kemi bërë vizita nëpër qytete të tjera.

Durrësi me plazhin e tij të pafund, me detin e kaltër dhe natyrën e mrekullueshme përreth, më pëlqeu shumë.

Përshtypje më bëri edhe vlugu i madh i vizitorëve nga të katër anët e Shqipërisë, që kishin ardhur për t'i kaluar pushimet në Durrës. Më mbushej zemra mal kur shikoja gjithë ata njerëz që kishin ardhur për t'i kaluar pushimet bregdet të mrekullueshëm shqiptar.

Gjatë qëndrimit në plazh, bisedoja me vizitorët vendorë dhe ajo që më bënte përshtypje ishte se sapo u tregoja bashkëkombësve të mi, se isha nga Kosova dhe se jetoja në Suedi, ata tregoheshin shumë kureshtarë për të mësuar për Suedinë dhe Kosovën. Mirëpo, kur e dëgjonin qëndrimin tim për Suedinë dhe botën kapitaliste (qëndrim ky që ndofta atyre u dukej identik me qëndrimet e Partisë së Punës së Shqipërisë), vëllezërit e mi heshtnin apo e shmangnin temën e bisedës e nuk e zgjatnin bisedën me mua! Më krijohej përshtypja se njerëzit druanin nga unë dhe ku ta dija se për çfarë më merrnin?

Së bashku me Shukri Demirin

Grupi i turistëve nga Suedia, Norvegjia dhe Danimarka përbëhej prej rreth pesëdhjetë vetash. Gjatë bisedave që bëja me turistët e vendeve Skandinave ata më pyetnin se a po më pëlqente Shqipëria dhe kur unë ua ktheja se po më pëlqente shumë ata më pyetnin se a isha i gatshëm të kthehesh dhe të jetoja përgjithmonë në Shqipëri?! Ndonëse turistët e vendeve Skandinave ishin anëtarë apo simpatizantë të shoqatave të miqësisë me Shqipërinë apo anëtarë e simpatizantë të organizatave e grupeve revolucionare marksiste-leniniste, përkrahëse të PPSh-së, asnjëri prej tyre nuk tregonte gatishmërinë time për t'u kthyer dhe jetuar në Shqipëri. Këtë ma thoshin pa hezitim. Në këtë pikë unë gjithashtu kisha mirëkuptim për qëndrimin e tyre. Shqipëria ime e dashur dhe vendet Skandinave ishin shumë larg njëra-tjetrës si në aspektin e zhvillimit kulturor, ashtu edhe atë ekonomik.

Ne kishim katër ciceronë të cilët na shoqëronin dhe që flisnin shkëlqyeshëm gjuhën angleze, gjuhën gjermane dhe franceze. Mbrëmjeve unë shoqërohesha me ciceronët tanë dhe me ta bisedonim për shumë çështje. Djemtë dhe vajzat që na shoqëronin ishin shumë të zgjuar dhe me kulturë të gjerë, por veç kësaj ata ishin edhe shumë të kujdesshëm në ato që thoshin! Ky kujdes i njerëzve të Shqipërisë sime të lirë, më mbyste dhe ma zinte frymën! Unë nuk e kisha marrë me mend se njerëzit në Shqipëri duhej të mateshin shtatë herë, si thotë fjala e

urtë popullore, para se të flisnin. Kështu e kishim edhe ne në Jugosllavi, ku ligjin bënte Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë!

Njëri nga djemtë që na shoqëronte quhej Gëzim Gjata. Ai u prezantua se ishte inxhinier. Gëzimi ishte një burrë i zgjuar dhe që i kishte kaluar të tridhjetat.

Një ditë, në bisedë e sipër, e pyeta Gëzim Gjatën se a kishte familje dhe se a ishte i fejuar apo i martuar? Gëzim Gjata më dha një përgjigje të shkurtër, por shumë interesante:

– Jo – më tha Gëzimi – nuk jam as i fejuar e as i martuar. Jeta jonë këtu ka disa probleme të cilat, ti, Asllan, e ke të vështirtë t'i marrësh me mend!

Nuk i thashë asnjë fjalë më shumë. E kuptoja se ta pyetja më tepër ishte e bezdisshme për te.

Së bashku me turistët nga Skandinavia kemi vizituar Muzeun Historik në Tiranë, Muzeun Historik dhe Amfiteatrin Antik të Durrësit, Kështjellën e Gjergj Kastriotit në Krujë, Vendvarrimin e Gjergj Kastriotit në Lezhë, Qytetin mijëravjeçar të Beratit pa harruar Onufrin e mrekullueshëm, Rozafatin në Shkodër etj..

Unë isha i entuziazmuar nga përshtypjet që më bëri vizita në Kështjellën e Krujës. Shteti shqiptar kishte ndërtuar një kështjellë muze që ishte një pune e shkëlqyeshme. Edhe vendvarrimi i Gjergj Kastriotit ishte ndërtuar bukur. Më impresionuan edhe vizita në Rozafat dhe Shkodër, si dhe vizita në Beratin e lashtë me shtëpitë e bukura dhe të kthyera kah dielli. Mbresa të veçanta më la aty vizita në Kishën Onufrit.

Një pasdite, duke ecur pranë plazhit së bashku me Gëzim Gjatën, e shoh shkrimtarin Ismail Kadare, i cili ishte i ulur, po pinte kafe dhe bisedonte me një mik të tij para Hotelit "Adriatik". E njoha menjëherë dhe i tregova shoqëruesit tim. Gëzimin e luta t'i afrohej dhe ta pyeste Imail Kadarenë se a mund të shkoja pranë tij dhe vetëm t'ia zgjatja dorën.

Gëzim Gjata shkoi dhe ia shprehu Ismail Kadaresë dëshirën time dhe u kthye e më tha:

– Nuk ka problem mund të shkosh e të përshëndetesh me Ismail Kadarenë.

Shkova dhe ia zgjata dorën shkrimtarit tonë të madh, të cilit ia kisha lexuar shumicën e veprave, qysh kur isha në Kosovë.

Ismail Kadare e prezantoi edhe mikun e tij, që rastisi të ishte ministër i Kulturës së Algjerisë! Gjithashtu Ismail Kadare i tha mikut të tij se unë isha shqiptar nga Kosova. Për mua ishte e mjaftueshme që u zu në gojë emri i Kosovës!

I kërkova falje që i ua ndërpreva bisedën dhe u përshëndeta me ta dhe u largova.

***

Gjatë qëndrimit në Durrës, disa herë e kam takuar Zamir Matin, autorin e pikturës së vajzës së veshur me flamurin kuq e zi. Zamir Mati dukej një burrë i urtë dhe artistë i shquar. Ai në takimin e fundit, në mes nesh, ma dhuroi një libër të Alfred Uçit *"Labirintet e modernizmit"* dhe brenda më bëri edhe dy skica të dy pikturave të tij.

Gjatë vizitës në Shkodër së bashku me vizitorët nga Skandinavia, u futëm brenda në Hotel dhe së bashku me ciceronin u drejtuam tek recepcioni i hotelit. Meqë burri që na pranoi, siç dukej, na kishte dëgjuar duke folur shqip mua dhe



Skicë dhuratë nga Zamir Mati

ciceronin tanë, ai kishte menduar se ne të dy ishim shqiptarë, ashtu siç edhe ishim në të vërtetë, dhe duke mos i shkuar fare mendja se unë isha shqiptar që po vija së bashku me turistët na drejtohet:

– Ç'janë gjithë këta njerëz? E dini se po më krijoni probleme me njerëzit këtu?!

Ciceroni përpiqej ta sinjalizonte se unë nuk isha shqiptar si ai, por burri, që si shkonte mendja se unë mund të isha një kosovar, vazhdonte të na bërtiste dhe të na kërkonte llogari për telashet që i kishim nxjerrë! Unë u largova nga aty që t'ia

lija mundësin ciceronit ta sqaronte se si ishte puna dhe se unë isha shqiptar turistë në Shqipërinë time!

Gjatë javës së dytë së bashku me grupin e turistëve e kemi vizituar edhe Muzeun Historik në Tiranë.

Pas çdo vizite, që bënim gjatë ditës, në mbrëmje ktheheshim në Hotel Apollonia, që ishte në afërsi të plazhit të Durrësit. Aty, ditët kur nuk vizitonim qytetet tjera, i hanim të tri racionet e ushqimit. Në mbrëmje, pas darke, shkonim edhe në Hotel Adriatik ku kishte edhe një orkestër muzikore e cila kur e merrte melodinë e këngës "Qengji i vogël" miqtë nga vendet Skandinave i nxirrte në valle dhe i bënte të duartrokasin...



Skicë dhuratë nga Zamir Mati



Mysafir i Komitetit për Marrëdhënie me Botën e Jashtme

Në fillim të javës së dytë të qëndrimit tim në Shqipëri, papritur, mora vesh se më kishte kërkuar Kristaq Parodini. Gjatë takimit Kristaqi më njoftoi se nëse isha dakord mund të më zgjatej edhe për dy javë vizita në Shqipëri. Natyrisht se e pranova me kënaqësi ofertën që më ishte bërë nga Komiteti për Marrëdhënie me Botën e Jashtme.

Në fund të vizitës u përshëndeta me Shukri Demirin dhe miqt nga grupi i turistëve të vendeve Skandinave. Pas largimit të turistëve dhe së bashku me Kristaqin, Shyqëriun dhe shoferin e tyre u nisëm në drejtim të Tiranës.

Ditët e para, si mysafir i Komitetit për Marrëdhënie me Botën e Jashtme qëndrova në Hotel Tirana. Gjatë ditës isha në shoqëri me Kristaqin dhe Shyqëriun. Në mbrëmje ata iknin në shtëpitë e tyre ndërsa unë ngelesha i vetëm në dhomën time. Nga kati i gjashtë i Hotel Tiranës e shikoja qendrën e qytetit. Përballë më qëndronte busti i Gjergj Kastriotit, në të majtë Shtëpia e Operës dhe Baletit, në të djathtë Banka Shqiptare dhe Muzeu Historik Kombëtar.

Natën bënte shumë vapë, prandaj i mbajta të hapura dritaren dhe derën e ballkonit. Pas orës dhjetë të natës mbretëronte një qetësi absolute. Sheshi i Tiranës ishte i zbraztë. Nganjëherë dëgjoja vetëm të lehura sporadike të qenve që vinin nga diku larg.

Në mëngjes herët, gjumin ma prishi gumëzhima e kamionëve, autobusëve dhe makinave që kalonin atypari. Pas pak njerëz në këmbë dhe biçikleta e kalonin qendrën e qytetit dhe iknin në drejtime të ndryshme.

Zgjimi herët nga gjumi më ka pëlqyer gjithmonë. E pëlqeja ketë vrap të njerëzve drejtë vendeve të tyre të punës! Kështu kisha bërë gjatë dy viteve të gjimnazit në Mitrovicë. Edhe mua më duhej të zgjohesha herët, qysh në ora katër e mëngjesit, për ta marrë trenin dhe për të arritur me kohë në mësim, që fillonte në ora shtatë e mëngjesit.

Nga ora katër e mëngjesit e derisa vinte koha e ngrënies së mëngjesit, unë për më shumë se gjysmën e kohës qëndroja në dritare duke shikuar sheshin e Tiranës dhe lëvizjet e njerëzve.

Kristaqi dhe Shyqëriu, gjatë qëndrimit me mua më pyetnin për veprimtarinë time politike në Kosovë dhe në Evropën Perëndimore. Në njëfarë mënyre biseda

me ta ma kujtonte kohën e arrestimit dhe izolimit në vitin 1979 e 1981, ndonëse unë isha i sistemuar mirë nëpër hotele dhe kudo ku gjendesha i kisha sofrat e shtruara me të gjitha të mirat.

Si më dukej, ata ishin të përgatitur për punën që bënin dhe bisedën me mua e merrnin shkruar dhe me ngadalë. Unë për vetën time nuk i kurseja me përgjigje dhe pas çdo pyetje përgjigjesha me sinqeritetin më të madh. Informimin e shtetit shqiptar me çdo të dhënë që mund të kishte rëndësi për sigurinë e Shqipërisë, unë dhe shokët e mi e konsideronim si një detyrë me rëndësi dhe si një akt patriotik. Prandaj zemra ime ishte e hapur, më përjashtim të emrave të shokëve të mi në Kosovë të cilët nuk dëshiroja t'ia tregoj asnjërit, pra as këtyre dy nikoqirëve të mi!

Tiranë, qershor-korrik 1987

Një ditë pasdite pas ndarjes nga Kristaqi dhe Shyqëriu, e lash Hotelin Tirana dhe dola në drejtim të Sheshit të Tiranës dhe u futa pak më në thellësi të qytetit. Kisha dëshirë të shkoja tek ndonjë librari e afërt për të shikuar ndonjë libër që dëshiroja ta blija dhe merrja me vete. Nuk gjeta ndonjë librari dhe duke u kthyer u futa në një kafe të zakonshme. Këtë nuk e bëra për hir të etjes së madhe që kisha, por për të parë se si dukej një kafe popullore, që populli i Tiranës e frekuentonte përditë. Pashë se kafeja popullore ishte shumë më ndryshe nga hotelet ku unë kisha kaluar dy javët e mia në Shqipëri! Kjo, tashmë edhe nuk po më befasonte. Edhe në Kosovë dallonin, kafet popullore prej atyre që ishin për turistë. Edhe në këtë pikë po më dilnin të ndryshëm populli dhe pushtetarët, ashtu siç po më dilnin të ngjashëm në trajtimin e popullit regjimet në Shqipëri dhe Jugosllavi! Vallë a kishin luftuar partizanët shqiptarë për një rend shoqëror që do të jetonte mbi kurrizin e popullit,-pyeta vetën? As ky dallim nuk më pëlqeu.

Në njëfarë mënyre bisedat me Kristaq Parodinin dhe shokun e tij, pas disa ditësh, nisi të më bëhej monotone. Ndonëse bisedat tona ishin të këndshme e

vëllazërore dhe ne po hanim e pinim nëpër hotele të mira, unë nuk ndjehesha mirë. Përkundrazi më vinte të villja. Mendja më shkonte tek koha kur vijoja gjimnazin dhe gjersa kthehesha nga shkolla nuk futja kafshatë buke në gojë, ashtu siç më kujtohej koha kur studioja dhe së bashku me Ferki Morinën e plaknim ditën me nga një byrekë me djathë!

Gjatë kohës kur po drekonim në Parkun e Gjuetisë në Lezhë, në një tryezë me gjitha të mirat- Kristaq Parodini më thotë:

– Në këtë park, shoku Enver Hoxha i ka përgatitur punimet e Kongresit të Pestë të PPSh-së!

E shikova dhe po e dëgjoja me vëmendje. Kuptohet se unë u isha mirënjohës për vazhdimin e vizitës sime dhe për nikoqirllëkun që po tregonin me mua, mirëpo nuk ndjehesha mirë kur e shihja se ne na ishte mbushur tryeza plotë, e me të gjitha të mirat, ndërsa jashtë parkut unë e kisha parë se si ushqehej dhe jetonte populli. "Nëse është ushqyer kështu si ne shoku Enver Hoxha dhe shokët e Partisë, paçin faqen e zezë,-thashë vetë me vete!" Ndoshta, më shkonte mendja, se Kristaqi dhe Shyqëriu, ashtu si edhe shokët e tyre kënaqen kur e vizitojnë këtë park dhe ulen në këtë tavolinë, ku shoku Enver Hoxha e ka përgatitur raportin e Kongresit të Pestë të PPSh-së. Por për mua, që vija nga një fshat i Kosovës dhe që në Kosovën time kisha lënë popullin tim të robëruar dhe nën thundrën serbe, këto tavolina të shtruar me të gjitha të mirat, nuk më bënin përshtypje, përkundrazi më ngjallnin neveri. Parasysh më dilnin udhëheqësit shqiptarë të Kosovës që bënin jetë tjetër nga ajo e popullit. Unë që isha me prejardhje fshatare dhe që e kisha ngritur zërin kundër pabarazisë nacionale dhe klasore në Jugosllavinë titiste, nuk mund të gëlltitja padrejtësitë që po i shihja në shtetin shqiptar. Unë e kisha paramenduar shtetin socialist shqiptar, si shtetin e së drejtës, ku mbretëronte liria dhe barazia në mes njerëzve, pra si një shtet në shërbim të popullit dhe jo si një shtet mbi popullin. Jo unë nuk kisha luftuar për diçka të tillë!

E paharrueshme, në kujtesën time, ka ngelur edhe vizita në qytetin mijëravjeçar të Gjirokastrës. Qyteti i shtëpive të ndërtuara me gurë, me çati të mbuluara me rrasa gurësh dhe rrugë me kube gurësh, kishte një pamje përrallore dhe që nuk ngopesh asnjëherë duke e shikuar.

U vendosa në një dhomë të Hotelit "Çerçiz Topulli". Edhe kësaj radhe , pas darke, shoqëruesit e mi më sistemuan në hotel dhe vet nuk e di se nga ia mbajtën?! Dhoma ime kishte pamje nga rruga që të shpinte tek kalaja e Gjirokastrës, që pushteti popullor e kishte shndërruar në Muze të Armëve. Isha me fat sepse dy –tre breza shtëpish më poshtë kishte një dasmë. Unë u pozicionova në dritare të dhomës sime dhe po e vëzhgoja dasmën nga një lartësi rreth tridhjetë metra. Gjithë natën e kalova duke dëgjuar këngët e bukura gjirokastrite dhe vallet e mrekullueshme pogonishte të cilat unë i kisha parë vetëm në RTSh.

Të nesërmen e vizituam qytetin dhe Kështjellën e Gjirokastrës, ku pos shumë armëve që nga Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri, pashë edhe një

aeroplan ushtarak amerikan, për të cilin më thanë se forcat ajrore shqiptare e kishin detyruar të ateronte meqë ai kishte cenuar hapësirën ajrore shqiptare. Gjithashtu Kështjella e Gjirokastrës, gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte përdorur si burg nga ushtritë pushtuese italiane e gjermane dhe se nëpër "labirintet" e saj ishin mbajtur e torturuar shumë luftëtarë të luftës nacionalçlirimtare.

Pasdite arritëm në Sarandë.

Saranda ishte një perlë tjetër e bregdetit shqiptar që shtrihej në brigjet e Detit Jon. Qyteti përballë ishullit të Korfuzit më pëlqeu shumë. Pjesa veriperëndimore e qytetit ishte shndërruar në një kantier ndërtimi. Ndërtoheshin shumë apartamente, fakt që gjithashtu më gëzoj shumë .

Të nesërmen e vizituam Ksamilin që ishte jashtëzakonisht i bukur dhe që ishte përplot me ullinj, portokaj dhe fruta të tjerë që rriteshin në tokën shqiptare.

Nga Saranda e vizituam edhe Butrintin e lashtë, ku kisha lexuar se kishte lindur dhe ishte rritur e ëma e Aleksandërit të Madh– Olympia.

Pas dy ditësh jemi kthyer nëpër Llogora, Ujin e Ftohtë dhe Vlorë. Më bënë përshtypje të jashtëzakonshme plantacionet me ullinj, mandarina, portokaj, fiq, shegë e pemë të tjera që e hijeshonin aq shumë Shqipërinë time të dashur. "O ç'natyrë e mrekullueshme!"

Bisedat e gjata me Kristaqin dhe Shyqëriun me kalimin e kohës filluan të bëhen të bezdisshme për mua, por atyre nuk ua shprehja këtë. Sidomos pyetjet për shokët në Kosovë, përpiqesha të mos përgjigjesha, duke u arsyetuar në harresë dhe duke u treguar paditur! Unë po hetoja se bashkëbiseduesit e mi, ishin të interesuar të përfitonin gjithçka, gjë që deri diku unë nuk kisha asgjë kundër, por kur ishte në pyetje çështja jonë kombëtare, çështja e veprimtarisë sonë politike dhe sidomos çështjet e organizatave tona politike, ata tregoheshin indiferent dhe të pa interesuar!

Gjatë një bisede, Kristaq Parodini më pyeti se a e njihja Sami Dërmakun. Meqë Sami Dërmakun e njihja prej vitesh, i fola fjalët më të mira për te.

– Ne kemi informacion se Sami Dërmaku është bashkëpunëtor i UDB-ës,– u përgjigj Kristaqi!

– S'e besoj kurrë, –e kundërshtova.

–Sami Dërmakun e kishim këtu dhe ai vetë me gojën e tij e ka pranuar një gjë të tillë, – u kundërpërgjigj Kristaqi.

Kunja të tillë më lëshonin edhe për Sabri Novosellën. Edhe bacën Sabri përpiqeshin të ma hidhnin në koshin e spiunëve! Edhe për Sabriun unë u thashë se: "Pajtohem se Sabriu nuk beson në rendin socialist, por ai nuk është njeri UDB-ës. Unë i vë të dyja duart në ujë të vluar për Sabriun dhe atij i besoj si vetës sime!"

Ky qëndrim i mbjelljes së dyshimit për shokët po më tmerronte. Këtë unë nuk e konsideroja si këshillë apo ndihmë, por si përpjekje të mbjelljes së dyshimit dhe përçarjes në radhët tona!

Qëndrime të tilla unë i kisha dëgjuar edhe më parë nga goja e Alçi K. dhe Zenel M. në Stokholm. Një vit më parë, pas vështirësive të mëdha dhe rrezikut permanent për t'u zbuluar nga UDB-ja jugosllave, nga Kosova më vijnë në Stokholm dy shokë: Rexhep Ahmeti dhe Shyqyri Imeri. Unë i takova shokët me Alçin dhe Zenelin me qëllim që shteti shqiptar të merrte informacion të dorës së parë për gjendjen në Kosovë. Pas kthimit të tyre në Kosovë, në një takim tjetër, Alçi më pat lëshuar një kunj dhe më patë thënë se njëri nga shokët e mi ishte njeri i dyshimtë! Në atë rast pata shpërthyer nga zemërimi, ndërsa Alçi më qëllim që të më qetësonte nisi të mi rrah krahët dhe ma pat lëshuar një kunj tjetër duke më thëne se "Partia ka informacion dhe nuk shpreh dyshime pa baza!"

Fatkeqësisht edhe vizita ime në Shqipëri po përdorej, nga shteti shqiptar, jo për ta ndihmuar luftën tonë, ashtu siç e pritja unë, por për t'i përçarë radhët tona dhe për të na bërë pikë e pesë!

Ato që kisha dëgjuar nga Sabri Novosella në Adapazar për qëndrimin e shtetit shqiptar, si në çështjen e lidhjeve të Sabri Novosellës me Jusuf Gërvallën, pas largimit të tyre nga Kosova, ashtu edhe gjatë bisedimeve për bashkimin e organizatave politike shqiptare po më dilnin këmbëkryq e të vërteta.

Gjithnjë e më shumë po krijoja përshtypjen se shteti shqiptar ishte më shumë i interesuar për informatorë nga Kosova sesa për veprimtarë besnik të çështjes shqiptare. Kisha përshtypjen se shteti shqiptar i donte këta veprimtarë si individë që informojnë, por në asnjë mënyrë nuk i donte si të organizuar në një organizatë politike!

Pas një muaj qëndrimi në Shqipërinë time të dashur, i entuziazmuar nga bukuria e atdheut tim, i mbushur me mbresa nga ata që kisha parë e dëgjuar, por edhe i dëshpëruar për gjendjen ekonomike dhe shpirtërore të shqiptarëve si dhe i dëshpëruar për qëndrimin e shtetit shqiptar karshi veprimtarisë sonë politike po kthehesha përsëri në Suedi.

Çka do t'u thosha shokëve kur të kthehesha? Nëse do t'ua them të vërtetën, si do të më kuptojnë ata? A do të më shpallin tradhtar?

Unë vendosa të kthehesha tek shokët e mi, i veshur me ato rroba që kisha veshur kur kisha ikur në Shqipëri! Do të vazhdoja t'ju flisja mirë për Shqipërinë. Këtë nuk do ta bëja vetëm për shokët, duhet të jem i sinqertë, por edhe për vetën time. Unë nuk mund të flisja keq për Shqipërinë dhe shtetin shqiptar! Të flisja keq për Shqipërinë dhe shtetin shqiptar më dukej sikur të pështyja lartë dhe të gjithë e dimë se ku përfundon pështyma që hidhet lartë!

Nga vizita njëmujore në Shqipëri unë mësova shumë gjera që si kisha ditur deri atëherë dhe që i kisha menduar krejt më ndryshe. Shqipëria ime kishte bërë ndryshime të mëdha që nga çlirimi. Ekonomia kishte marrë hovë të madh zhvillimi dhe kishte shënuar hapa të mëdhenj përpara, ashtu si edhe shoqëria shqiptare që ishte transformuar nga një shoqëri e prapambetur në një shoqëri relativisht të zhvilluar. Pastaj, familja shqiptare kishte braktisur familjen patriarkale dhe kishte filluar ndërtimin e një familje moderne; gruaja shqiptare

ishte nxjerr nga muret e familjes patriarkale dhe kishte zënë vendet e saj të merituara në shkolla, fabrika dhe udhëheqje të vendit.

Përkundër zhvillimit e përparimin të shënuar, kisha përshtypjen se treni i ecjes përpara, kishte ngelur pa lokomotivë dhe sikur gjithçka ishte ndalur dhe ndodhej para një udhëkryqi të madh; se shteti i diktaturës së proletariatit, që kishte bërë revolucion në shoqërinë shqiptare, kishte nisur të vjetrohej dhe ndodhej në "shtratin e vdekjes"! Ndërsa shoqëria shqiptare që kishte nisur të mësohej me transformime të mëdha dhe të shpejta nuk mund të duronte para vete një udhëheqje që frenonte ecjen drejt së ardhmes. Unë kisha bindjen e plotë se një popull që është mësuar të ecën përpara nuk mund të ndalet në rrugën e tij drejtë zhvillimit të mëtejmë dhe se se ky proces shoqëror është i pandalshëm, se nga ky zhvillim i shoqërisë njerëzore nuk mund të përjashtohen as ne shqiptarët.

Duke e ndier vetën si pjesë e atij populli dhe vendi unë nuk mund të mos i shihja me shqetësim zhvillimet që kisha parë në Shqipëri. Gjatë një bisede me Kristaqin dhe Shyqëriun u pata thënë si me rrotull: "Pushteti që ka mbështetjen e popullit nuk ka forcë që e rrëzon..." dhe ata menjëherë m'u përgjigjen se "uniteti parti popull është i çelikosur", që më "gëzoi" edhe mua!

Gjatë vizitës, kisha fituar bindjen se shteti i diktaturës së proletariatit ishte në prag të vdekjes, se Shqipëria dhe ekonomia e saj, nuk kishte as gjasa teorike për ta përballuar presionin e botës kapitaliste. Veç kësaj udhëheqja e vendit kishte bërë aq shumë gabime të cilat kishte kohë që popullin e kishin bërë simpatizant të botës kapitaliste. E kuptoja se shqiptarët e kishin kthyer shikimin përtej Adriatikut dhe kufijve të Shqipërisë.

Unë që isha përpjekur për lirinë e popullit tim nuk kisha shumë mundësi për të zgjedhur, prandaj u hodha menjëherë në përkrahje të popullit shqiptar e aspiratave të tij dhe u distancova nga veprimet e udhëheqjes shqiptare. Vëllezërit e mi shqiptarë kishin derdhur gjakun për liri dhe ndërtimin e një shteti të së drejtës. Dështimi i përpjekjeve për ndërtimin e një shteti të së drejtës duhet të jetë një mësim për brezat e ardhshëm. Populli nuk mbahet gjallë me "parime", por duke i krijuar të ardhme. Gabojnë ata udhëheqës që mendojnë se populli ha bar për hir të "parimeve" të udhëheqjes !

Pas kthimit tim nga Shqipëria dhe përballjes sime me atdheun e ëndrrave dhe idealeve të mia në kujtesën time gjeta një mendim interesant të Engelsit që ka të bëjë me filozofinë materialiste : *"...nuk ka asgjë një herë e përgjithmonë të vendosur absolute dhe të shenjtë."* Ky mendim filozofik i njërit nga mendimtarët më të mëdhenj të njerëzimit mund të krahasohet edhe me atë që ka thënë populli ynë se : *ujë që nuk ecë, nuk pihet* . Fatkeqësisht shteti shqiptar ishte bërë si ujë që nuk lëvizë dhe kishte kohë që i kishte shkëputur lidhjet me popullin dhe lëvizjen përpara.

Shpërngulja në rrethin e Malmos

Pranverën e vitit 1987, gjersa po bëja përpjekje për të gjetur një banesë dhe punë në afërsi të Malmos, krejt papritur, më telefonoi Ismet Bicaj. Ismeti më njoftoi se sapo ishte kthyer nga një vizitë në Zvicër, me ç'rast, e kishte takuar Sami Dërmakun, i cili e kishte njoftuar se jetoja në Suedi dhe nëpërmjet tij më kishte dërguar të fala. Ismeti ma dha numrin e telefonit dhe shprehu dëshirën që në të ardhmen t'i vazhdonim kontaktet. Në fund të bisedës, unë i tregova Ismet Bicajt, se isha i interesuar për t'u shpërngulur nga Stokholmi, diku në jug të Suedisë.

Të nesërmen Ismet Bicaj më mori përsëri në telefon dhe më tha se kishte biseduar me punëdhënësin e tij dhe nëse vazhdoja të isha i interesuar, mund të filloja punën menjëherë. Unë e falënderova për interesimin dhe u tregova i gatshëm të udhëtoja ditët e afërta në Malmö!

Të nesërmen e kam kontaktuar Entin e Inkuadrimit dhe e kam njoftuar se kam gjetur një mundësi punësimi.

Disa ditë më vonë kam udhëtuar nga Stokholmi dhe me ndihmën e Ismet Bicajt kam krijuar marrëdhënie pune në Saab Scania AB në Arlöv.

Mirëpo, meqë unë e kisha planifikuar udhëtimin tim në Shqipëri, me punëdhënësin u morëm vesh që punën ta filloj me 4 gusht.

Disa ditë pas kthimit tim nga udhëtimi në Shqipëri, u shpërngula në Arlöv, në banesën e Ismet Bicajt dhe nisa punën me 4 gusht si montues në SAAB Scania.

Shpërnguljes në jug të Suedisë dhe punësimit iu gëzova shumë. Isha i kënaqur që isha njohur edhe me Ismet Bicajn. Mirëpo qysh gjatë qëndrimit në Stokholm, nëpërmjet Xhafer Dumishit isha njohur edhe me Imer Baqajn nga Drenishta e Deçanit dhe Hasan Rrahmanin nga Podujeva. Me të dy mora kontakt.

Në Malmö banonte edhe Sabri Novosella, por marrëdhëniet tona ishin të tendosura dhe kishte kohë që nuk kishim kontakte me njëri-tjetrin.

Gjatë takimeve me Imer Baqajn mësova për kontaktet e tij me Jusuf Gërvallën–nëpërmjet letrave dhe bisedave telefonike– si dhe për vizitën që i

kishte bërë Bardhosh Gërvalla, gjatë qëndrimit të tij në kampin e refugjatëve në Itali. Imer Baqaj fliste me krenari për bisedat telefonike dhe letërkëmbimin që kishte pasur me Jusuf Gërvallën.

– Unë vetëm po prisja se kur do të vijë Bardhi apo ndonjë shok i tij dhe do të ma sillte një pasaportë që të largohesha nga Italia, por fatkeqësisht para ardhjes së tij erdhi lajmi se UDB-a jugosllave na i vrau shokët tanë, – më tha në një rast Imer Baqaj.

Edhe takimet me Hasan Rrahmanin ishin shumë mbreslënëse. Hasan Rrahmani, kishte bërë një rrugëtim të gjatë nëpër Turqi dhe Europë gjersa ishte vendosur në Malmö.

Gjatë një takimi me Hasan Rrahmanin, mësova se ai kishte qëndruar një kohë në rrethin e Shtutgartit, se gjatë asaj kohe ishte takuar Jusuf e Bardhosh Gërvallën dhe kishte qëndruar në shoqëri me rrethin e shokëve të tyre.

Në shtëpinë e Jusuf Gërvallës, shkurt 1982,
Xhafer Durmishi, Hasan Rrahmani,
Agron Sela dhe Hafiz Gagica

Hasan Rrahmani i kujtonte me dhembje të madhe ditën kur e kishte marrë lajmin e vrasjes së Jusuf Gërvallës, Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës:

– Së bashku me Naim Haradinajn kishin shkuar tek vendi i punës së Bardhit, me qëllim, që pas mbarimit të punës, së bashku me te, të shkonim në banesë tek Jusufi. Duke pritur, para Zyrës, aty arrin Misim Mavraj nga Munihu,

i cili, i përlotur, na njoftoi se natën që shkoi, ishin vrarë Jusufi, Bardhi dhe një shok i tyre!

Gjatë një takimi tjetër, duke më folur për qëndrimin e tij në rrethin e Shtutgartit dhe për takimet e kontaktet që i ka pasur me Jusuf dhe Bardhosh Gërvallën, Hasan Rrahmani më ka njoftuar edhe për pjesëmarrjen e tij në një përpjekje për futjen e organit "Zëri i Kosovës" në Kosovë, e cila përputhej me kohën kur edhe Xhafer Durmishi dhe Bahtir Haradinaj ishin nisur nga Kosova për Bled të Sllovennisë:

– Një ditë dhjetori të vitit 1981, Bardhi më njoftoi se ishte duke e kërkuar Hysen Spahiun dhe më pyeti se mos e kisha parë ndokund? Meqë unë i thashë se nuk e kisha parë, së bashku me Bardhin e kemi kërkuar Hysen Spahiun nëpër disa adresa të ndryshme në rrethin e Shtutgartit. As disa bashkatdhetar, që i takuam dhe pyetëm, nuk dinin se ku ndodhej Hysen Spahiu!

Në atë rast Bardhosh Gërvalla më ka pyetur:

– Hasan, a je i gatshëm të udhëtosh në Kosovë dhe t'i futësh brenda "Zërin e Kosovës?

– Po, i gatshëm jam – i thashë Bardhit.

Të nesërmen, së bashku me Bardhosh Gërvallën dhe M. G., jemi nisur nga Untergruppenbachu në drejtim të Austrisë. Gjatë rrugës, Bardhi na i ka ndarë detyrat. M. G. do të zbriste nga makina e Bardhit në Stacionin e Trenit në Vilah të Austrisë dhe do ta merrte trenin në drejtim të Rozenbachut. Detyra e tij ishte ta vëzhgonte kontrollimin e udhëtarëve nga ana e policisë jugosllave. Në Stacionin e Rozenbachut, M. G. do të dilte e qëndronte në dritare, të vagonit që do të kontrollohej nga policia kufitare jugosllave . Në do ta prisnim në Stacionin e Trenit në Rozenbach dhe do t'i vendosnim në vagonin ku do të qëndronte M.G dy çanta me organin e "Zërit të Kosovës".

Kështu edhe bëmë. M.G e lamë në Stacionin e Trenit në Vilach dhe ne e vazhduam rrugën, me makinë, në drejtim të Stacionit të Trenit në Rozenbach. Aty e pritëm ardhjen e trenit.

Treni arriti në Rozenbach dhe ne po e kërkonim me sy se në dritarën e cilit vagon ndodhej M.G. Udhëtarët zbritën nga treni dhe ne nuk po e shihnim askund M.G. Atëherë, Bardhi më tha të hynim në tren dhe të nisesha i vetëm me bagazhet për Kosovë. Dy çantat me Organin, i vendosëm brenda në vagon. Para se të nisej treni, Bardhi më pyeti edhe njëherë se a isha ende i gatshëm të udhëtoja, i vetëm? Pasi mori përgjigjen time se unë isha i gatshëm, i pyeti përsëri disa udhëtarë shqiptarë se a ishte kontrolluar vagoni në të cilin gjendeshim? Njëri nga udhëtarët u përgjigj: "Jo ende nuk është kontrolluar"! Bardhosh u mendua pak. Pas pak më tha t'i merrnim çantat e të zbrisnim nga treni.

I morëm çantat dhe zbritëm nga treni. Edhe më tutje po e kërkonim M.G.

Treni u nis. Pas pak, e pamë se edhe M. G. kishte zbritur nga treni. Bardhi i tha edhe atij të vinte me ne në makinë. I vendosëm çantat në makinë dhe u nisëm në drejtim të Untergruppenbachut. Rrugës nga Rozenbachu gjer në

Shtutgart, Bardhi nuk e tha asnjë fjalë. Me asnjë fjalë të vetme nuk e qortoi M.G. Pas ndarjes me M.G-në, dhe kthimit në Untergrupenbach, Bardhi m'i dha njëqind marka gjermane..."

***

Me Ismet Bicajn, nga fshati Vrellë e Istogut, punonim në të njëjtën ndërmarrje të prodhimit të automjeteve, SAAB-SCANIA në Arlöv. Gjatë dy muajve të qëndrimit në banesë të tij, ne u bëmë shokë të pandashëm.

Me ndihmën e Ismet Bicajt fillova edhe kontaket me Shoqatën Kulturore Shqiptare "Kosova" në Malmo, por edhe me shumë bashkatdhetarë dhe veprimtarë që banonin në Malmo me rrethinë si dhe u kyça në aktivitet e politike dhe kulturore të bashkatdhetarëve tanë.

Udhëtimi i dytë i Shyqyri Imerit në Suedi

Në nëntor të vitit 1987, nga shokët e krahut të Xhemajl Pllanës dhe Ferki Morinës (edhe kësaj radhe lidhja mbahej nëpërmjet vëllait tim Shaban Muharremi) vije përsëri në Suedi, Shyqyri Imeri, i cili gjatë javës sa qëndroi tek unë në Arlöv, më njoftoi me veprimtarinë e shokëve në Kosovë si dhe m'i përcolli qëndrimet e tyre lidhur me çështjet e shtruara gjatë takimit të kaluar në Stokholm. Gjithashtu, Shyqyriun e kam njoftuar për gjendjen e krahut të Lëvizjes sonë në emigracion, për qëndrimin e shtetit shqiptar lidhur me veprimtarinë tonë politike, sidomos në emigracion. Nëpërmjet Shyqyri Imerit shokëve ua kam përcjell qëndrimet e mia personale lidhur me veprimtarinë e tyre në Kosovë, sepse ç'është e vërteta Organizata jonë politike në Evropën Perëndimore ishte shkapërderdhur dhe nuk ishte aktive në veprimtarinë e saj politike.

Shyqyri Imerin e kam njoftuar edhe për vizitën time në Shqipëri dhe përshtypjet e mia atje. Më duhet të them se nuk kam qenë i sinqertë me shokun tim dhe nuk ia kam shprehur zhgënjimin e madh që më kishte kapluar pas vizitës në Shqipëri. Nuk doja që edhe ai dhe shokët të përfshiheshin nga zhgënjimi im!

Bashkëpunimi me Shoqatën Kulturore Shqiptare "Kosova" në Malmo

Nga shokët dhe bashkatdhetarët tanë jam njoftuar për historikun e Shoqatës "Kosova", e cila deri vonë kishte qenë një Shoqatë e Lidhjes së Shoqatave Jugosllave. Nga përvoja kisha mësuar se shoqatat e mërgimtarëve, Jugosllavia i kishte shndërruar në çerdhe agjentësh të UDB-ës dhe veprimtaria aty duhet bërë me kujdes të madh. Për hir të pjesëmarrjes së mërgimtarëve duhej vepruar me qëllim të mbajtjes gjallë të kulturës shqiptare si dhe ndihmuar çështjen tonë kombëtare me aq sa mund të ndihmohet në rrethana të tilla veprimi.

Në Malmo banonin një numër relativisht i madh shqiptarësh. Një pjesë e madhe e shqiptarëve ishin mërgimtarë të viteve 60-70-ta, por kohëve të fundit vërehej një rritje e numrit të mërgimtarëve të rinj.

Nga Ismet Bicaj dhe bashkatdhetarët tjerë kam mësuar për historikun e Shoqatës Kulturore Shqiptare "Kosova" në Malmö.

Nuk kishte kohë të gjatë që veprimtarët shqiptarë në Malmö e kishin shkëputur Shoqatën Kulturore Shqiptare "Kosova" nga Lidhja e Shoqatave Jugosllave që vepronin në Suedi.

Për shkak të dhunës dhe represionit policor serbomadh, numri i shqiptarëve që shpërngulej nga Kosova sa vinte e shtohej.

Me shtimin e shqiptarëve në Suedi dhe Malmö, shtohej edhe aktiviteti i Shoqatës Kulturore Shqiptare "Kosova". Dalëngadalë lokali i ShKSh "Kosova" nuk ishte më vetëm një vendtakim i shqiptarëve, por edhe një qendër e rëndësishme kulturore dhe politike shqiptare. Në lokalin e ShKSh "Kosova" krahas aktiviteteve kulturore zhvillohej edhe një veprimtari e fuqishme në mbështetje të luftës së popullit shqiptar për liri. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim kanë dhënë edhe seksionet e ndryshme që kanë vepruar në kuadër të ShKSh "Kosova", si seksioni i të rinjve që merrej me muzikën shqiptare, ekipi i futbollit, Radio "Kosova" dhe revista letrare "Dëshira". Gjithashtu në gjirin e ShKSh "Kosova" janë organizuar demonstrata në përkrahje të kërkesave të popullit në Kosovë dhe është afirmuar çështja shqiptare tek opinioni suedez në Malmö dhe më gjerë në Suedi.

Gjatë angazhimit tim pranë veprimtarisë së ShKSh "Kosova", veç të tjerash, jam ngarkuar me detyrën e kryeredaktorit përgjegjës të Radio Kosovës. Lidhur me veprimtarinë e Radio Kosovës kam bashkëpunuar me shumë veprimtarë si Ibrahim Egriu, Ramadan Osmani, Imer Baqaj, Ismail Rugova, Haxhi Haxhija, Bajram Kabashi e të tjerë.

Në kuadër të Shoqatës “Kosova” publikohej edhe revista letrare e Klubit Letrar “Jusuf Gërvalla” e cila bashkonte në gjirin e saj shumë letrarë që jetonin dhe vepronin në Malmö dhe më gjerë. Revista “Dëshira” është redaktuar nga Hajdin Abazi (kryeredaktor), Samir Hajdari, Ymer Vokshi (Imer Baqaj), Shenasi Ahmedi dhe veprimtarë të tjerë.



KOSOVA

SHOQATA KULTURORE SHQIPTARE ALBANSKA KULTURNA DRUSTVO

Me rastin e shënimit të 10 vjetorit të fillimit të emisionit të radios në gjuhën shqipe,
Kryesia e Shoqatës "Kosova" i shpreh

M i r ë n j o h j e

Z. Asllan Muharremi

Për kontributin dhe ndihmën e tij të jashtëzakonshme si kryeredaktor dhe bashkëpunëtor i palodhshëm i këtij radio emisioni.

KOSOVA MALMÖ V

Kryetari i Shoqatës "Kosova"
Bajram Kabashi

Malmö, 5 maj 1996

Fal bashkëpunimit të Hajdin Abazit me Shoqatën “Kosova” dhe revistën “Dëshira” gjithashtu ka pasur edhe bashkëpunim të kohëpaskohshëm edhe me Shoqatën “Liria” e cila ishte një shoqatë shqiptare e formuar nga aktivistë të “Lëvizjes Popullore të Kosovës”. Gjatë kontakteve të mia me Hajdin Abazin dhe veprimtarët tjerë të Shoqatës “Liria” jam përpjekur në afrimin e këtyre dy shoqatave të cilat shpeshherë ishin të ndikuara nga rrymat politike që vepronin edhe në emigracionin tonë.

Këshilli Iniciativë për themelimin e Degës së LDK-së në Suedi

Sipas përshtypjeve të mia, gjendja e politike në Kosovë po keqësohej nga viti në vit. Me 23 mars 1989, qarqet antishqiptare në Serbi, me ndihmën e tankeve, ia hoqën Kosovës autonominë e fituar me mund e gjak. Shqiptarët, me minatorët e Trepçës në ballë dhe punëtorët e studentët protestuan ashpër kundër këtij akti të dhunshëm të shovinistëve serbë, por politika antishqiptare e Beogradit vazhdoi me ritme të pandërprera. Kosova humbi edhe ato të drejta dhe liri që gëzonte me parë.

Lajmet që vinin nga Kosova ishin shumë shqetësuese dhe kërkonin mobilizim, afrim dhe bashkim të shqiptarëve. Unë mendoja dhe shprehesha, kudo ku kisha mundësi ndikimi, se bashkimi i shqiptarëve, pa dallim klase, krahine, besimi fetar apo bindje politike, ishte e vetmja shpresë për ne dhe lirinë e vendit tonë.

Shtatë muaj pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, me 23 dhjetor 1989, u themelua Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kryetar i saj u zgjodh Ibrahim Rugova. Pa ditur shumë për LDK-në dhe se ç'program politik kishte partia e re, u gëzova dhe isha plotë shpresë se do të vijnë ditë më të mira për Kosovën dhe popullin tonë.

Për kryetarin e LDK-së, Ibrahim Rugova, e dija se ishte kryetar të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, se dikur kishte qenë anëtar i LKJ-së dhe sekretar i LKJ-së në Institutin Albanologjik. E mbaja mend pjesëmarrjen e tij në trajtimin e temave politike mbi nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar, pjesëmarrjen e tij në diferencimin politik pas demonstratave të vitit 1981, ashtu si e mbaja mend për një polemik të gjatë për çështje të letërsisë me Rexhep Qosjen. Gjithashtu nga bashkatdhetarët tanë kisha dëgjuar se shovinistët serbë ia kishin vrarë të atin, Ibrahim Rugovës.

Përkundër kundërthënieve që barte me vete bagazhi i së kaluarës politike i kryetarit të sapozgjedhur të Lidhjes Demokratike të Kosovës, unë isha i mendimit se organizimi i rezistencës aktive dhe bashkimi i të gjitha forcave politike shqiptare kundër politikës serbomadhe, ishte e vetmja rrugë e drejtë. Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe rritjes së terrorit policor kundër shqiptarëve, organizimi politik i shqiptarëve, nuk kishte alternativ tjetër.

Nga shokët e mi në Kosovë, në ndërkohë, isha informuar se themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës kishte ngjallur mobilizim dhe shpresë në popull. Gjithashtu, isha njoftuar se Lidhjes Demokratike të Kosovës ju kishin

afruar pothuajse të gjitha rrymat politike, duke përfshirë edhe shumë ish të përndjekur dhe të burgosur politik. Isha informuar se shumë nga shokët e mi, të para largimit tim nga Kosova, ishin regjistruar në listat e anëtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Të gjitha këto lajme më gëzonin dhe mbushnin plotë shpresë se Lëvizja jonë kombëtare po shënonte ngritje në përpjekjet e saj për heqjen qafe të zgjedhës serbe.

Themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe shtimi masiv i radhëve të saj, pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, nga Serbia e Millosheviqit, e nxori në një rrafsh të ri luftën e shqiptarëve të Kosovës për liri, barazi dhe pavarësi. Unë personalisht shpresoja dhe prisja se themelimi i LDK-së, ishte një moment i shumëpritur nga të gjitha forcat revolucionare dhe liridashëse, të organizuara në organizata të ndryshme politike.

Së bashku me Imer Baqajn patëm biseduar lidhur me themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe rëndësinë e themelimit të Degës së LDK-së në Suedi. Pas disa bisedave jemi pajtuar që ta kontaktojmë Ibrahim Rugovën dhe ta pyesnim për qëndrimin e tij lidhur me themelimin e Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Suedi.

Disa ditë më vonë Imer Baqaj, nëpërmjet kontakteve që ka pasur në Kosovë, ka arritur ta gjej telefonin e Ibrahim Rugovës dhe të zhvillojë një bisedë me te.

Lidhur me bisedën me Ibrahim Rugovën dhe përmbajtjen e saj, Imer Baqaj më ka njoftuar se Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës gjatë bisedës i kishte thënë:

– Lidhja Demokratike e Kosovës është një iniciativë e re dhe bënë përpjekje që çështja e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi të zgjidhet në mënyrë paqësore.

Imer Baqaj, ishte ndarë i kënaqur nga biseda që kishte zhvilluar me Ibrahim Rugovën dhe mbështetja që kishte gjetur tek ai lidhur me themelimin e Degës së LDK-së në Suedi.

Ato ditë, e kam takuar edhe Hajdin Abazin dhe e kam njoftuar për iniciativën e themelimit të Degës së LDK-së në Suedi. Hajdin Abazi më ka thënë se:

– Lëvizja Popullore e Kosovës nuk do t'i bashkohet LDK-së, por ai dhe shokët e tij në Malmö do ta përkrahin pranin time në radhët e lëvizjes së re politike!

Të frymëzuar nga vepra e Jusuf Gërvallës, për bashkimin dhe afrimin e të gjitha forcave politike rreth një qëllimi e programi të përbashkët, së bashku me Imer Baqajn ju kemi bashkuar iniciativës për themelimin e Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Suedi.

Me 23 maj 1990 u formua Këshilli Iniciativë për Themelimin e Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Suedi. Këshilli Iniciativë përbëhej nga pesëmbëdhjetë anëtarë : Zeqir Rama(kryetar), Muhamet Shatri, Ragip Reçica, Sabri Novosella, Ramadan Osmani, Ibrahim Egriu, Ibrahim Krasniqi, Shefki

Ollomani(sekretar), Asllan Muharremi, Ismail Rugova, Imer Baqaj, Imer Rexha (arkatar), Nurijet Zhuta, Enver Camaj dhe Aziz Osaj.

Nga Kosova, Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës, dërgoi anëtarët e saj Milazim Krasniqi dhe Basri Çapriçi në mbledhjen e promovimit të Degës së LDK-së për Suedi.

Unë u kisha deklaruar anëtarëve të Këshillit Iniciativë për themelimin e Degës së LDK-së se personalisht nuk isha i interesuar të zgjidhesha në udhëheqjen e Degës së LDK-së për Suedi dhe se unë isha për një udhëheqje me veprimtarë të rinj, e që do të përfaqësonin të gjitha rrymat politike shqiptare që vepronin në Suedi..

Meqë Milazim Krasniqi e kishte një lidhje familjare me Xhafer Durmishin, me kërkesën e këtij të fundit, i ftova në darkë, në banesën time, Milazim Krasniqin dhe Basri Çapriçin. Qëllimi i kësaj darke ishte që Xhafer Durmishi të takohej me Milazim Krasniqin.

Gjatë qëndrimit në banesën time, Basri Çapriçi, ishte shumë i interesuar t'i shikonte titujt e librave që kisha në vitrinën time. Kisha përshtypjen se atë e kishin "informuar" në Malmo se ç'farë literature mund të gjente në shtëpinë time! Në bisedë e sipër Basriu më thotë:

– Marksist-leninistët e Kosovës kanë luftuar për marksizëm-leninizmin dhe jo për lirinë e shqiptarëve!

Tensioni i gjakut më shkoi në pikën kulmore! U befasova dhe zhgënjeva shumë kur e dëgjova një konstatim të tillë nga goja e një poeti, që tashmë ishte dhe anëtar i kryesisë së LDK-së! Këtë ide nuk ishte hera e parë që po e dëgjoja nga goja e elementëve të qarqeve të tjera pro-serbe, titiste dhe antishqiptare. Sipas kësaj që thoshte Basri Çapriçi, heronjët tanë si Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla dhe shokët e tyre që nga titistët jugosllavë janë quajtur marksistë-leninistë nuk paskan derdhur gjakun për lirinë e shqiptarëve, por për marksizëm-leninizmin, ndërsa titistët jugosllavë, ish funksionarë të LKJ-së, ish spiunë dhe ish kalemxhinjtë e tyre, ashtu si dje, edhe sot, ndonëse kanë ndërruar rroba dhe janë vetëshpallur demokratë, na paskan luftuar për lirinë e shqiptarëve!

Mirëpo, Basri Çapriçin e kisha mysafir dhe për hir të këtij fakti dhe edukatës që kisha marrë nga shtëpia ime, nuk ia ktheva ashtu si e meritonte. Basri Çapriçit i thashë vetëm:

– Unë nuk mendoj se nëse një shqiptar ka shkruar një vjershë për Titon, ai ka luftuar për titizmin!

Pas disa orësh qëndrimi, i përcolla mysafirët.

U ktheva në shtëpi shumë i dëshpëruar. Nuk u besoja veshëve për atë që kisha dëgjuar nga goja e Basri Çapriçit. Përfaqësuesin e LDK-së nuk e njihja, por isha i sigurt se "qëndrimet" e shfaqura nga ana e tij ishin pjesë e doktrinës antishqiptare serbomadhe dhe ato përhapeshin nga njerëzit e saj infiltruar në radhët e LDK-së. Përçarja e shqiptarëve dhe nxitja e luftës vëllavrasëse shpie ujë në mullirin serbomadh. Këtë qëllim duhet ta kenë ata që ish të përndjekurit

shqiptarë i identifikojnë në krimet e regjimit komunist në Shqipëri. Por unë uroja që këto qëndrime të mos ishin edhe qëndrime të udhëheqjes së LDK-së dhe kryetarit të saj Ibrahim Rugova! Meqë në Kryesi të LDK-së ishte zgjedhur edhe Hydajet Hyseni dhe disa ish të burgosur të tjerë, më mbante shpresa se qëndrimi i Basri Çapriçit ishte një qëndrim individual dhe se ky nuk ishte edhe qëndrimi i LDK-së.

***

Verën e vitit 1990, Agron Raimi, bashkatdhetari nga Shkupi, gjatë vizitës në familje, e viziton edhe familjen time në Mihaliq. Në të kthyer në Suedi, me vete e merr edhe vëllanë tim, Shabanin.

Shabani gjithashtu gjatë ditëve sa qëndroi tek unë më ka njoftuar për veprimtarinë e tij dhe të shokëve në Kosovë. Shabani, veç të tjerash më ka lënë me shkrim përshkrimin e një aksioni në shkrimin e parullave që ai e ka zhvilluar së bashku me Shyqëri Imerin. Shabani shkruan si vijon:

"Nuk jam i sigurt, të ketë qenë fillimi i marsit, pra në prag të përvjetorit të shpërthimit të demonstratave të 11 marsit, apo ka qenë 31 marsi i një ditë para 1 prillit 1985. Vendimi ishte marrë më herët. Nga shokët isha caktuar që së bashku me një shok të shkruanim parulla në Komunën tonë. Unë, për shok zgjodha Shyqën, me të cilin i bëmë edhe të gjitha përgatitjet e duhura për natën e aksionit. Takimin me Shyqën e kishim lënë në periferi të Vushtrrisë – buzë lumit Silnica –, saktësisht do të takoheshim në ora 21.00. Ne ishim marrë vesh që të mos e shkruajmë një parullë dhe t'ia mbathnim, por që vërtetë ta stolisnim qytetin dhe një numër fshatrash afër magjistrales Prishtinë-Mitrovicë.

Ashtu siç edhe ishim marrë vesh, në kohën e caktuar u takuam me Shyqën. Aty ku u takuam, bëmë edhe konsultimet e fundit. Ishim të bindur se njerëzit i kishin braktisur rrugët e qytetit dhe se dyqanet tashmë ishin mbyllur.

Në Vushtrri kemi hyrë kah pjesa perëndimore e qytetit, pranë Urës së Gurit. Në muret e mullirit, që gjendet para urës, kemi shkruar vetëm dy shkronja: K.R. Me këtë edhe e testuam brushën dhe ngjyrën. Cak kishim Shkollën e Mesme "Muharrem Bekteshi", institucionet dhe fabrikat e qytetit. Menjëherë jemi mësy, ndarazi, nëpër rrugica të ndryshme, dhe jemi takuar tek pjesa e prapa shkollës. Kah fusha e sportit kemi kaluar rrethojat me gjemba dhe kemi hyrë në oborrin e shkollës. Jemi ndalur dhe kemi shikuar rreth e rrotull gjersa kemi fituar përshtypjen se nuk ka lëvizje të njerëzve, sidomos të shtëpive përballë, për të cilat më vonë kemi mësuar se kishin qenë shtëpi të serbo-malaziasve. Në atë rast Shyqa ka vëzhguar çdo gjë, sidomos lëvizjet e rojës së shkollës, kurse unë e kam shkruar parullën "Kosova-Republikë", me një gjatësi rreth 15 metra dhe shkronja të mëdha mbi një metër. Shkrimi i kësaj parulle na ka marrë rreth 30 minuta.

Kur mbaruam punë, vendosëm të largohemi kah hyrja kryesore e shkollës. Shyqa ecte para meje, por papritur e shoh se është ndalur para hyrjes kryesore. Prit se po e kalon rrugën, por ai nuk lëvizte vendi! Mendja më shkoj mos ka hetuar gjë të dyshimtë. Papritur, u kthye dhe po vinte kah unë!

– Ç'u bë? – e pyeta me zë të ultë.

– Po e bëjmë edhe një punë! –u përgjigj Shyqa.

– Cilën punë Shyqë?– e pyeta.

– Po ia marrim pushkën rojës! – ma ktheu Shyqa.

– Jo, kurrsesi –i thashë.

– Ec e shikoje–flakë e re!– u përgjigj Shyqa!

Unë e kundërshtova duke i thënë se "pushkën ia marrim, por edhe mund ta marrim në qafë të gjorin!"Shihej se Roja ishte një njeri i moshuar dhe ndoshta lehtë do të mund ta lidhnim! Por nuk kishim me çka ta lidhnim. Përfundimisht hoqëm dorë nga kjo ide. Kaluam rrugën dhe u futëm në parkun që e kishim përballë, Aty ndodhej edhe një kishë e vogël ortodokse dhe në muret e saj e shkruam vetëm "K.R" ngase s'kishte vend për të gjitha shkronjat e parullës sonë. Nga aty, nëpër rrugica, kemi marrë rrugën drejt Fabrikës së Tekstilit të quajtur "POLET". Kur kemi arritur përballë Fabrikës së Tekstilit, Shyqa që ecte diku rreth 100 metra para meja, u ndal dhe po më priste. Edhe unë u ndala aty ku isha, duke menduar se athu përse u ndal Shyqa?Pas pak Shyqa më dha shenjë me dorë që të vazhdoja. Kur u afrova, Shyqa duke buzëqeshur më tha:

– Shiko se ç'vend na kanë bërë?

Unë as që kisha idenë dhe as që e kisha vërejtur një mur betoni përballë Fabrikës. E pashë se vendi ishte me rrezik të madh që të zbuloheshim. Në ato momente nuk kishte lëvizje të ndonjë automjeti, por shtrohej pyetja se vallë a do të arrijmë ta shkruajmë parullën pa u diktuar?Krejt papritur mund të kalonte ndonjë makinë. Megjithëkëtë, ne vendosëm t'i shkruajmë parullat aty. E nxora tasin me ngjyrë dhe brushën. Dorëzat i kishim të veshura dhe nuk i kishim hequr fare. Shumë më shpejtë se në shkollë, ndonëse me gjysmë frymë, të shqetësuar e me gjithë ankth, e shkruam. Ia lëshuam një sy dhe na dukej e pabesueshme se sa bukur na doli parulla "KOSOVA-REPUBLIKË". Me shpejtësi e duke vrapuar ia kemi dal ta lëshojmë qytetin dhe të dalim në drejtim të Prishtinës. Jemi ndalur dhe kemi pushuar një çikë në arat në mes Vushtrrisë dhe fshatit Nedakovcë. Ishim shumë të gëzuar, por edhe të liruar nga ankthi. Tanimë s'kishte rrezik. "Pothuajse bota, ishte e jona!"

Në hyrje të fshatit Nedakovc ndodhej një shitore. Në muret e saj përballë rrugës, pa asnjë problem, e kemi shkruar parullën "Kosova-Republikë" dhe të qetë e kemi mësy rrugën drejt fshatit Pestovë. Tashmë ishte afruar mesnata. Në fshatin Novosellë të Maxhunajve, afër Mullirit të Zekollëve, ndodhej një shtëpi e gjatë. Aq sa ishte e gjatë shtëpia e kemi shkruar edhe parullën "Kosova-Republikë."E vazhduam rrugën dhe rrugës nuk gjetëm ndonjë vend të përshtatshëm për të shkruar parulla. Cak e kishim fshatin Stanovcë. Kur kaluam pranë Dumnicës, me shaka i drejtohem Shyqës:

– A po ecë në shtëpi?

–Jo more! – ma ktheu Shyqa – A kemi ende ngjyrë?

E pashë se tasi i parë një kilogramësh, veç kishte ra në fund dhe ne vazhduam rrugën. Duke kaluar nëpër fshatin Lumi i Madh më ra ndërmend kushëriri im

Sadiku, i cili e kishte zakon që pas çdo shkrim të parullave në fshatin e tyre thoshte:

– Vallahi s'po i shkruajnë shqiptarët, por shkiet – shqiptarët s'guxojnë me i shkrua!

I tregova Shyqës se çka po më sillej nëpër kokë. Dalëngadalë kemi hy në fshatin Lumi i Madh. Ora ishte dy e pas menatës. Në të katër anët e shkollës i kemi shkruar parullat: "Kosova-Republikë!", "Poshtë shovinizmi serbomadh serb!", "Rroftë Adem Demaçi!", "Lavdi veprës heroike të Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës e Bardhodh Gërvallës!", "Lavdi veprës heroike të Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës" dhe vetë me vete thashë: "ia pafsh hajrin, baca Sadik!

Vazhduam drejt Stanovcit. Pas pak arritëm tek depoja e grumbullimit të drithërave, që ndodhej buzë magjistrales – te udhëkryqi Prishtinë-Mitrovicë-Breznic-Stanovc-Prelluzhë. Dalëngadalë nisa ta shkruaj parullën e cila dëshiroja të ishte aq sa ishte ndërtesa. Edhe shkronjat teknike i shkrova me madhësi një metër e gjysmë. Ndjehesha shumë i kënaqur për këtë.

Pas pak biseduam me njëri-tjetrin dhe për një moment dëshironim ta përfundojmë aksionin, ngase ishte bërë edhe vonë, mirëpo për këtë na i prishi planet ngjyra, sepse kishim ngjyrë edhe për një parullë të gjatë. Mirëpo na duhej edhe ta gjenim vendin se ku do ta shkruajmë parullën, ndonëse ishim shumë të lodhur dhe s'kishim marrë as ujë e as ushqim me vete. Megjithëkëtë, vendosëm të shkojmë deri tek kthesa e rrugës për Bajmovc. Duke ecur, më ra në sy Kanali i Hidrosistemit Ibër-Lepenc i cili kishte formën e urës në fshatin Gracë. Vendi ishte i largët nga rruga dhe nuk kishte rrezik të diktoheshim. Mirëpo nga aty nuk e dinim se a kishte ujë në kanal apo jo?U afruam e u ngjitëm lartë dhe u kënaqem shumë kur pamë se kanali ishte pa ujë. Megjithëkëtë e pamë se ishte problem çështja e shkrimit të parullës në ballin e kanalit që do të dukej nga rruga dhe fshatrat përreth. Për një çast menduam të afrohemi tek disa shtëpi dhe ta kërkonim ndonjë shkallë, por kishim frikë se po na hetojnë qenët. Në një moment vendosëm që ta lëmë fare shkrimin e parullës, por na tërhiqte vendi dhe pamja që do të merrte parulla ditën e nesërme. Të dy bisedonim se ç'zgjidhje të bëjmë?Më shkoj mendja që ta shkruaja parullën duke pasur kokën poshtë.

– M'i mbaj këmbët,– i thashë Shyqës.

Shyqa kundërshtonte sepse kishte rrezik të madh të bija poshtë.

– Shyqë, ose kam me e shkruar ose kam me vdekur! – M'i mbaj këmbët,– i thashë dhe jam zgjatur me kokë teposhtë."

Shyqa m'i mbante këmbët dhe më tha:

– A je në vete, Shaban? A e dinë se po më rrëshqite nga dora do të biesh poshtë i vdekur?

Unë kisha vendosur dhe nuk tërhiqesha. Vazhdoja të t'i shkruaj shkronjat dhe analizoja se si do të dukeshin shkronjat nëse i shikoj nga larg, nga rruga. I shkrova të gjitha shkronjat një nga një dhe pas disa pushimeve arrita tek shkronja e fundit "Ë".

Pasi e përfunduam, u ngrita dhe nga kanali së bashku me Shyqën zbritëm poshtë. E kontrolluam nga aty dhe e pamë se s'kishte fare gabime. E kisha shkruar drejtë, sikur ta kisha shkruar nga një skele. Ecëm nëpër ara të Stanovcit dhe tek ura mbi lumin Llap jemi ndarë me Shyqën. Pra se të ndaheshim u morëm vesh që nesër në ora 09,00 të dalim në Vushtrri. Dy tasat me ngjyrë (i kam mbushur me gurë e dhe), dorëzat dhe brushën i hodhëm në Llap. Nëpërmjet Libarit kam arritur tek Ura e Frengut në mes Prelluzhës dhe Mihaliqit. Aty i kam heqë këpucët, i kam mbushur me gurë dhe i kam hedhur në Silnicë, ngase aty i kisha fshehur edhe rrobat dhe këpucët tjera që do t'i ndërroja me ato që kisha veshur e mbathur. Pak para agut të ditës kam hy në shtëpi pa u vërejtur nga askush. E kam ndezur zjarrin, e kam ngrohur një kusi me ujë dhe jam pastruar. Para se të lahesha jam kontrolluar mirë nëpër trup se mos më ka mbetur ndonjë njollë me ngjyrë. Nëpër xhepa po e kërkoja pakon e cigareve dhe mendoja ta piqja një kafe. Duke e përzier kafenë, u hap dera dhe brenda hyri nëna. Se ajo e dinte që unë nuk kisha fjetur në shtëpi, e kuptova në fytyrën e saj!

– Përse je çuar kaq herët?– ma priti?

– A s'kemi për të shkuar në Vushtrri, për ta shitur jonxhën në treg apo jo?–iu përgjigja?

Se nuk kisha fjetur fare, më kishte vërejtur edhe nëna. Ajo më drejtohet:

– Ç'e besa ti s'ke fjetur asnjë minutë!

I pimë kafet.

– Po shtrihem pak, pra, mbasi po thua se s'kam fjetur,-i thashë nënës.

Nuk e di se sa kohë ka kaluar, por ndjeja se dikush po më shkundke dhe e dëgjoja një zë:

-Shaban, a po shkojmë apo jo? – Shikova orën dhe pashë se kisha pushuar gati dy orë. Ndjehesha i këndellur. Skënderi e kishte përgatitur traktorin dhe priste të niseshim për në tregun e Vushtrrisë –Po, po, po shkojmë, –iu përgjigja.

Pas pak u nisëm. Skënda mori timonin dhe në dalje të fshatit i thashë ta merrte rrugën për Prelluzhë, "se shkojmë ma shpejtë,-i thashë". Ai u çudit dhe duke buzëqeshur me tha:

– A ke fjetur mirë apo jo?

–S'kam fjetur fare,po... –thashë vetë me vete.

–Grahi për Prelluzhë se ma shpejtë shkojmë,– ia përsërita –Ose prit...prit...ndale traktorin. Ma jep mua se po na ndalin policia e ti s'ke patent shoferi!

Ia mora traktorin dhe vazhdova rrugën drejt Prelluzhës. Me të arritur në Stanovc, afër udhëkryqit e magjistrales, ç'të shihje?Bllokadë! Policë! Ishte tërbuar pushteti! Disa legjitimonin, disa vëzhgonin dhe disa të tjerë i lyenin parullat me gëlqere që të mos dukeshin. Nga rruga i pashë Enver Maxhunin dhe Zeqir Sadriun- udbashët e Vushtrrisë. Skënderi me shikonte në çdo ndalesë dhe sikur dëshironte të më pyeste: "Ku ishe mbrëmë?Edhe udbashët na panë, na shikuan, por u bënë sikur nuk na panë dhe sikur na injoruan!"Aq më

mirë,–thashë vetë me vete.”Vazhduam rrugën drejt Vushtrrisë. Kudo patëm ndalesa, pritje dhe pamë policë të tërbuar!

Pas shumë ndalesash e pritjesh arritëm në Vushtrri dhe u futëm në treg afër Urës së Gurit. Skënderit i thashë:

-Po dal kah qendra dhe po e blej pak bukë.

– A ke para, – ma priti Skënderi?

– Jo,– iu përgjigja.

– Ani përse po shkon pra...?– Po më duket se paska ndodh diçka – më tha Skenda si me buzë në gazë dhe sikur priste përgjigje nga unë!

E kuptoja se ai e thoshte këtë vetëm sa për të marrë përgjigje edhe nga unë sepse që nga fshati Stanovc ai e kishte të qartë se ç’kishte ndodhur.

– Ani de – ia ktheva– po dal pak.

Dola. Ç’të shihje. Policë kudo. E merrja me mend se duhet të jenë ftuar edhe shumë agjentë civilë nga qendrat tjera. Mora vesh se të gjithë nxënësit e shkollave ishin lëshuar të ktheheshin në shtëpi. Mirëpo ata nuk kishin shkuar në shtëpi, por ishin dal në qytet. Nxënësit dukeshin kudo. Fytyrat e njerëzve ishin plot gaz.

Sapo dola në qendër të qytetit, i ballafaquam shikimet me Shyqën. Sikur i thamë njëri-tjetrit: “Ja rezultati i punës së mbrëmshme.”

Mora vesh se parullën e Shkollës së Mesme “Muharrem Bekteshi” nuk e kishin vërejtur personeli i shkollës, por serbo-malazezët që banonin afër shkollës, të cilët të tërbuar kishin shkuar dhe me hunj e sopata e kishin sulmuar drejtorin e shkollës së bashku me kolektivin mësimdhënës, se për këtë çështje kishte ndërhyrë edhe policia.”

***

Nëndega e LDK-së në Malmo ishte nga nëndegët më të mëdha që kishte Dega e LDK-së në Suedi. Në Malmö jetonin rreth pesë-gjashtë mijë shqiptarë dhe kjo nëndegë kishte rëndësi të madhe për aktivitetin e gjithëmbarshëm të Degës së LDK-së në Suedi.

Në mbledhjen themeluese të Nëndegës së Malmos, anëtarësia më zgjodhi sekretar në Nëndegës. Duke e pranuar këtë detyrë unë shpresoja se do të kontribuoja në ushtrimin e veprimtarisë së LDK-së në Malmö.

Në rolin e sekretarit të Nëndegës së LDK-së në Malmö kam vepruar gati dy vite të plota. Aty kam bashkëpunuar me veprimtarë të shquar: Muhamet Shatri (që ishte edhe kryetar i Degës së LDK-së në Suedi), Enver Camaj, Shefki Ollomani, Haxhi Haxhiu, Imer Baqaj, Haziz Osaj, Ismail Rugova, Bajram Kabashi e të tjerë.

Dega e LDK-së e kishte shtrirë aktivitetin e saj që nga Malmö gjer në Kirunë. Nëndegët e LDK-së ishin krijuar edhe nëpër kampe refugjatësh dhe kudo zhvillohej aktivitet shumë i dendur, sidomos në grumbullimin e tre përqindëshit, Fondit të Republikës së Kosovës, që mund të thuhet lirisht se, sidomos nëpër kampe refugjatësh, pjesëmarrja e bashkatdhetarëve tanë në pagimin e tre përqindëshit ka qenë shumë masive.

Duhet theksuar se në regjistrimin dhe evidentimin e paguesve të tre përqindëshit një punë të shkëlqyeshme ka bërë Muhamet Shatri dhe Enver Camaj.

Së bashku me shumë bashkatdhetarë mora pjesë në demonstratën e Oslos. Në ballë të demonstratës së Oslos pashë se ishte Rrahim Përçuku, për të cilin shokët e mi në Kosovë më kishin njoftuar se kohë më parë e kishte lënë Vushtrrinë. Një nga bashkatdhetarët e mi nga Malmoja më njoftoi se Rrahim Përçuku ishte edhe në ballë të LDK-së në Norvegji!

I "entuziazmuar" nga lajmi që mora iu afrova afër Rrahim Përçukut dhe ju prezantova:

– Ju njoh profesor Përçuku. Ju kam takuar së bashku me Ferki Morinën në Prishtinë në vjeshtën e vitit 1979. A ka mundësi ta pimë një kafe së bashku?"

Rrahim Përçuku jo që nuk patë kohë ta pinte një kafe me mua, por atë dhe suitën e tij e "lëshoi toka" dhe u largua nga vendi i mbajtjes së demonstratës. Ku ta dija se ç'kujtime i kishte ngjallur prania ime kryetarit të Degës së LDK-së në Norvegji?! Rrahim Përçukun e njihja që nga vera e vitit 1979 dhe nga shokët e LNÇKVShJ-së në Vushtrri jam njoftuar se ai ka qenë një njeri i dyshimtë si bashkëpunëtor i Shërbimit të Sigurimit të Shtetit Jugosllav.

Me kalimin e kohës kisha mësuar se nëpër nëndegë të LDK-së ishin zgjedhur nga anëtarësia edhe njerëz shumë të kompromentuar dhe që kanë bashkëpunuar hapur me pushtuesin serb.

Nga disa shokë, mësova se kryetar i një nëndege ishte zgjedhur një ish aktivist i Bozhurit dhe që kishte ushtruar detyrën e drejtorit të dhunshëm nëpër disa shkolla në Kosovë!

Meqë e njihja ish drejtorin e dhunshëm, ju drejtova kryetarit të Degës së LDK-së në Suedi, prof. Dr Muhamet Shatri dhe e njoftova për personin në fjalë. Në atë rast unë kërkova që të pyetet edhe Ibrahim Rugova për personin në fjalë. Prof. Dr. Muhamet Shatri u shpreh gjithashtu i zhgënjyer për lajmin që mori nga unë dhe më premtoi se do ta pyeste Prishtinën për këtë rast.

Diku, pas rreth një muaji, prof. Dr Muhamet Shatri më ka njoftuar se ka marrë përgjigje nga Prishtina dhe se për personin në fjalë nuk kishte asnjë vërejtje! Ky ishte një lajm shumë i keq dhe një zhgënjim i madh për mua.

Në verën e vitit 1992 kam dhënë dorëheqje nga detyra e Sekretarit të Nëndegës së LDK-së në Malmö, por edhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Pas dorëheqjes, nuk i kam shkëputur lidhjet e mia me Muhamet Shatrin, Enver Camajn dhe veprimtarë të tjerë të Degës së LDK-së në Suedi, përkundrazi kam pasur miqësi me ta dhe kam bashkëpunuar me ta për ato çështje që i kam gjykuar si të interesit kombëtar.

Në Shkup pas trembëdhjetë vitesh

Politika serbomadhe dhe antishqiptare e Beogradit u kishte bërë një goditje të rëndë të gjitha segmenteve të jetës në Kosovë. Me vendime raciste, të shkruara e të ardhura nga Beogradi, shqiptarët u nxorën nga administrata, ekonomia shoqërore, shërbimi shëndetësor dhe sistemi shkollor. Shqiptarët, madje, u pushuan edhe nga puna në polici e gjyqësi dhe u zëvendësuan me policë e gjyqtarë serbë të Kosovës dhe të ardhur nga Kraina e Kroacisë dhe pjesët tjera të ish Jugosllavisë.

Si rezultat i politikës së aparteidit që ushtronte Beogradi mbi shqiptarët me mijëra shqiptarë morën botën në sy. Ky proces, që kishte nisur para disa viteve, tani ishte intensifikuar shumë. Gjithnjë e më shumë, në shtypin suedez, por edhe nga burimet tjera të informacionit mësoja se po rritej numri i shqiptarëve nga Kosova.

Verën e vitit 1996, ashtu si edhe çdo vere tjetër, shoqen dhe fëmijët i nisa me aeroplan për Kosovë. Me që unë nuk kisha vizituar asnjëherë familjen time, ashtu si nuk kishte pasur mundësi vizite në Suedi as nga familja ime (me përjashtim të Shabanit dhe motrës sime, Nafijes), për shkak të mungesës së pasaportave, Florien e porosita që të fliste me prindërit e mi dhe t'i njoftonte se unë e kisha ndërmend të udhëtoja në Shqipëri dhe në këtë udhë kisha dëshirë të kaloja për dy-tre ditë në Shkup.

Diku rreth dhjetë ditë pas udhëtimit të shoqes sime dhe fëmijëve, jam nisur me tren për Shqipëri, nëpërmjet Zvicrës e drejt në Bari të Italisë.

Gjatë rrugës kam qëndruar tek vëllai im Shabani, i cili tani ishte refugjatë në Zvicër. Në Zvicër u takova edhe me dy djemtë e dajës Isë: Fadil dhe Ilir Mirena, të cilët nuk i kisha takuar që nga vitit 1983, kur ata ishin ende fëmijë.

Në Zvicër jam takuar me kunatin tim, Reshat Rexhaj dhe jemi nisur së bashku për Shqipëri. As Reshati nuk guxonte të udhëtonte në Kosovë, meqë policia serbe ia kishte bastisur shtëpinë dhe e kërkonte për një armën që ia kishte gjetur në shtëpi.

Vizita ime në Durrës, po bëhej pas nëntë vitesh. Qyteti dhe njerëzit ishin të lirë, por gjendja ekonomike ishte shumë e rëndë. Varfëria ishte e skajshme. Për ndryshim nga vitit 1987, tani flitej hapur për varfërinë dhe vitet e rënda nëpër të cilat kishin kaluar shqiptarët gjatë kohës së diktaturës. Njerëzit me të cilët pata rastin të bisedoja flisnin për histori të tmerrshme nëpër të cilat kishin kaluar dhe që unë as që i kisha marrë me mend se kanë mundur të ndodhin në Shqipërinë Socialiste. Më vinte keq për vuajtjet e tyre. Por ndjehesha edhe krenar për veprimtarinë time dhe të shokëve të mi, sepse ne, ndonëse kishim mbajtur

kontakte me përfaqësues të shtetit shqiptar dhe kishim kërkuar ndihmën e tyre për luftën tonë, nuk ishim pjesë as përkrahës të krimeve të diktaturës.

Në Durrës, së bashku me Reshatin qëndruam rreth një javë.

Reshati duhej të kthehej përsëri në punë në Austri, sepse në Kosovë nuk mund të udhëtonte! Reshati u nis për Austri, ndërsa unë mora autobusin për Shkup.

Maqedonia ishte shpallur e pavarur dhe unë kishte vite që e kisha nënshtetësinë suedeze dhe besoja se nuk do të më nxirrnin telashe për t'u futur brenda. Kështu edhe bëra. Nga Durrësi në Shkup kalova pa problem.

Në Stacionin e Autobusëve në Shkup, aty ku e kisha marrë autobusin për Stamboll para trembëdhjetë vitesh, zbrita nga autobusi dhe mora një taksi për lagjen Butel II, ku jetonte familja e bashkatdhetarit dhe mikut tim Agron Raimi, i cili ishte edhe nip i Shkuri Raimit, historianit të njohur dhe autorit të librit "Vilajeti i Kosovës", që e kisha lexuar qysh kur isha student.

Në rrugë pranë shtëpisë së Raim Raimit (të atit të Agronit), nga makina e taksisë, e pashë tim atë, i cili, kishte dal dhe po më priste, meqë edhe autobusi im ishte vonuar për disa orë. Shoferi i taksisë e ndaloi makinën dhe e hapi dritaren e po i thotë tim atë:

– Ku je nisur, o burrë? Eja me ne se këtu është Asllani?!

Im atë ma lëshoi një shikim shpejtë dhe meqë unë isha i rrezitur dhe bënte natë, nuk më njohu dhe ju drejtua shoferit:

– Jo, jo. Ky nuk është Asllani!

Atëherë unë e hapa derën dhe zbrita nga makina dhe ju ofrova:

– Eja, se unë jam Asllani. Më shiko më mirë!– dhe e përqafova.

Krah për krahu shkuam së bashku me tim atë gjer tek dera e shtëpisë së Agronit.

Sapo u afruam pranë derës së shtëpisë dolën jashtë nga shtëpia Agroni dhe brenda gjeta nënën time, dy motrat e mia dhe kushërirën tim Hoxhën e Vogël. U përqafuam me mall dhe atë natë nuk fjetëm deri në mëngjes. Prindërit e mi kishin ardhur qysh paradite. Ata kishin menduar se do të më gjenin në Shkup, prandaj e kishin marrë trenin e parë.

Pas dy ditë çmallje me njëri-tjetrin, prindërit, motrat dhe Hoxha i Vogël u kthyen në Kosovë, ndërsa unë e prita Florën dhe fëmijët që t'i përcillja me aeroplan për Kopenhagë.

Familja e Raim Raimit, e cila me bujarinë dhe mikpritjen e saj na bëri të ndjeheshim si në shtëpinë tonë, më la mbresa të paharruara. Aty mësova se Raim Raimi, qysh në vegjëli ishte shpërngulur në Shkup nga fshati Nasallcë i rrethit të Preshevës, ashtu siç mësova se Agronin nuk e kishte pagëzuar me emrin e tij të bukur Shukri Raimi, ashtu siç kisha menduar unë, por gjyshi i Agronit.

Sapo i përcolla Florën dhe fëmijët për Suedi, përsëri nga Shkupi, sikur po ia ktheja shpinën Kosovës, u nisa për Durrës.

Në autobus kishte shumë njerëz. Në mesin e tyre takova edhe një të larguar për shkak të dhunës serbe nga Kosova që ishte nisur për Shqipëri. Në vendkalimin kufitar Maqedoni- Shqipëri, në Shën Naumin e dikurshëm shqiptar, por që falë dhuratës së satrapit Ahmet Zogu, tani ishte bërë maqedonas, takuam edhe një hallexhi nga Kosova, por që ishte duke e pritur autobusin për Durrës meqë policia maqedonase nuk e kishte lejuar të hynte në Maqedoni meqë kishte pasaportë të refugjatit politik. Hallexhiu që ishte nisur nga Shqipëria për ta takuar familjen e tij në Maqedoni ishte Martin Çuni, për të cilin unë kisha dëgjuar se ishte i burgosur politik. Më erdhi shumë keq për te dhe familjen e tij. Ku ta dish se sa vite nuk i ka takuar,-thashë vetë me vete?!

Isha shumë i lumtur që i kisha takuar njerëzit e mi të dashur pas trembëdhjetë vitesh. Nga bisedat me prindërit, motrat dhe Hoxhën e Vogël, mësova se gjendja në Kosovë ishte shumë më e rëndë nga ajo që kisha dëgjuar e mësuar nga njerëzit që kisha takuar në Suedi, por edhe të atyre ditëve sa qëndrova në Shqipëri. Kjo më shqetësonte shumë. Kur isha larguar nga Kosova trembëdhjetë vite më parë, kishte një gjendje shumë më ndryshe dhe të favorshme për shqiptarët. Tani serbomëdhenjtë duan ta dëbojnë popullsinë shqiptare nga Kosova. Ky qëllim i kamotshëm si duket po ecën drejtë realizmit të tij! Ndërsa ne nuk jemi askund në mbrojtjen nga kjo e keqe që na kanosej. Lidhja Demokratike e Kosovës ka zgjedhur avazin e rezistencës paqësore. Serbomëdhenjtë po bëjnë të gjitha përpjekjet që rezistencën paqësore ta shfrytëzojnë për ndërrimin e strukturës etnike të Kosovës. Kosova po boshatisej nga shqiptarët. Gjatë ditëve sa kisha qëndruar në Shqipëri, isha ndarë me përshtypje shumë të zymta. Fatkeqësisht, as Shqipëria nuk ishte në gjendje të merrej me Kosovën! – po me fluturonte mendja sa andej e sa këndej.

Natën e kalova në Hotel "Apollonia".

Në mëngjes mora një taksi drejt Portit të Durrësit.

Para Portit të Durrësit, e shohë një grua të re që bartte një qantë shumë të madhe dhe që mezi e çonte nga toka! E pyeta se a mund ta ndihmoja dhe pas pak arritëm tek anija e pasagjerëve që quhej "La Vikinga".

Sapo zumë vende në anije, gruaja e re, takoi edhe një grua tjetër të moshës së saj, që siç e mora vesh e njihte qysh më parë. I qerosa me nga një kafe. Aty nisëm edhe bisedën tonë.

Gruas që i ndihmova ju prezantova se kush isha. Ajo gjatë udhëtimit, nisi të m'i numëroi të njëmijë të zezat që kishin bërë kosovarët në Shqipëri!

I habitur nga gjithë ato që dëgjova, që për mua nuk ishin asgjë tjetër pos paragjykime dhe thashetheme, e pyeta motrën time shqiptare:

– A ke ndonjë dëshmi se unë, gjatë qëndrimit tim njëjavor në Shqipëri, kam bërë ndonjë punë të pistë të llojit të atyre që i zure në gojë?

Motra nga Shqipëria e kuptoi se isha i zemëruar dhe nuk tha gjë.

Pas shumë mundimesh, meqë deti ishte i trazuar dhe anija jonë tundej nga valët e mëdha, arritëm në Bari.

Sapo u ankorua anija, u përshëndeta me motrat shqiptare dhe zura vend në radhë për ta lënë anijen dhe drejtuar drejt vend kontrollit të pasaportave.

Rreth një gjysmë ore më vonë kalova në tokën italiane.

Tek vendi i taksive, e takova përsëri motrën shqiptare, së bashku me një burrë. Motra shqiptare, e ngriti dorën dhe po më sinjalizonte që te shkoja drejt saj. Ç'është e vërteta unë bëhesha sikur nuk po i shohë dhe nuk dëshiroja të shkoja gjer në Stacionin e Trenit me makinën e tyre. Mirëpo motra shqiptare më drejtohet me zë:

– Eja, eja tek ne se po të presim! Ne të dërgojmë në Stacion të Trenit!– dhe ecte drejt meje!"

Motra" shqiptare, u ofrua pranë meje, ma mori një çantë dhe më tha të ecja pas saj! Nga aty me makinën e italianit arritëm në Stacionin e Trenit të qytetit të Barit.

Dalja në skenë e UÇK-së

Në mars të vitit 1998, im vëlla, Shabani, e viziton Shqipërinë, me që rast takohet me prindërit dhe dy motrat, të ardhur enkas nga Kosova për t'u takuar me te.

Në të kthyer nga Zvicra, Shabani më ka njoftuar për gjendjen në Kosovë dhe për inkuadrimin e tre vëllezërve tanë (Skënderit, Muharremit dhe Avniut) në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Nga e majta ulur: Skënder Muharremi, Mehdi Hasani dhe Avni Muharremi
Nga e majta, në këmbë: Ejup Hasani, Zymer Sadiku, Muharrem Muharremi dhe Safet Murati

Nga Shabani, mora vesh se me 14 qershor 1998 në fshatin Mihaliq ishte themeluar Skuadra e parë e UÇK-së dhe se komandant i saj ishte emëruar, vëllai im, Skënder Muharremi.

Dhjetorin e vitit 1998, gjatë një udhëtimi në Zvicër, pata rastin të takohem me Hysen Hasanin, bashkëfshatarin tim dhe pjesëtarin e Skuadrës së UÇK-së në Mihaliq, i cili disa javë më parë kishte ardhur nga Kosova. Hyseni më njoftoi më për afër për gjendjen në Kosovë dhe për plagosjen e Mehdi Hasanit, Lutfi

Hasanit, Avni Muharremit (vëllati tim) dhe Shukri Mustafës. Nga Hyseni dhe Shabani jam njoftuar për qëndrimin e LDK-ës në fshatin Mihaliq, gjatë mbledhjes së Skuadrës së UÇK-së me bashkëfshatarët që ishte mbajtur me 23 qershor, me që rast, përfaqësuesit e LDK-së jo vetëm që nuk ju kishin bashkuar UÇK-së, pa marrë pëlqimin e presidentit Ibrahim Rugova. Disa aktivistë të LDK-së, kishin shprehur rezervat e tyre edhe lidhur me organizimin e rojeve në fshat dhe udhëheqjen e Skuadrës së UÇK-së nga vëllai im, Skënder Muharremi!

Gjatë ditëve të qëndrimit në Zvicër mësova gjithashtu se në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishin inkuadruar Xhemajl Pllana, Sheremet Saraçi dhe Rexhep Ahmeti; se Xhemajl Pllana ishte emëruar Drejtor i Drejtorisë për Administrim Civil në kuadër të Zonës Operative të Shalës (ZOSh).

Në ndërkohë unë kisha dëgjuar disa deklarata e vlerësime të presidentit Ibrahim Rugova lidhur me me veprimtarinë dhe ekzistencën e UÇK-së, në që rast aksionet e UÇK-së, identifikoheshin me "segmente të policisë serbe"! Ndonëse deklaratat e tilla më patën zhgënjyer shumë, edhe më tutje, unë nuk besoja se ato ishin qëndrimet e vërteta të Ibrahim Rugovës. Deklaratat e tilla unë besoja se ishin pjesë e propagandës serbe për ta përçarë frontin e luftës së popullit tonë për liri dhe pavarësi.

Ditëve të qëndrimit të Zvicër jam takuar dhe me Shyqyri Imerin dhe të vëllanë e tij, Esatin, i cili po përgatitej t'ju bashkohej radhëve të UÇK-së.

Më vonë, kam marrë vesh se Esat Imeri, gjatë përpjekjeve për t'u futur nga Shqipëri në Kosovë, plagoset rënd.

***

Gjatë një takimi me Xhafer Durmishin jam njoftuar se Ahmet Krasniqi ishte emëruar Ministër i Mbrojtjes së Kosovës në Qeverinë e Bujar Bukoshit!

Duke ditur se nga ç'derë e madhe ka dal Ahmet Krasniqi, lajmi se ai do ta ketë epror Bujar Bukoshin, për të cilin kisha dëgjuar fjalë të mbara e të mbrapshta, dhe aq më tepër që ai do të vendosej në Tiranë, ku lirisht, vepronin të gjitha agjenturat e botës dhe më së shumti ato serbe, jam shqetësuar për jetën e Ahmet Krasniqit. Unë druaja se shërbimet informativ serbë do t'i shfrytëzoi deri në maksimum edhe kundërthëniet që ekzistonin në mes UÇK-së dhe FARK-ut për të nxitur vëllavrasje në mes shqiptarëve. Këtë ia kam shprehur edhe Xhafer Durmishit gjatë atij takimi e shëtitje që kemi pasur në Arlöv.

Nga Sabri Novosella, qysh kur isha në Turqi, kisha dëgjuar se Ahmet Krasniqi ka pasur kontakte me Shefqet Jasharin qysh para shkuarjes së tij në Akademinë Ushtarake. Gjithashtu pas emërimit të Ahmet Krasniqit, ministër i Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës, kisha marrë vesh se së bashku me të në Tiranë ndodhej edhe Shefqet Jashari, njëri nga nga tre themeluesit e LNÇKVShJ-së. Disa javë më vonë mora lajmin e hidhur se në Tinanë ishte vrarë Ahmet Krasniqi.

Duke ditur gjendjen në Shqipëri, vrasja e Ahmet Krasniqit në mes të Tiranës, nuk më ka befasuar. Që nga momenti i vendosjes së tij në Tiranë e kam pritur se do të vritej. Jam i sigurt se agjentë të UDB-ës serbe ka pasur me bollëk, jo vetëm

në radhët e SHIK-ut shqiptar, në radhët e FARK-ut,por edhe në radhët e UÇK-së. UDB-a serbe nuk do ta lejonte Ahmet Krasniqin t'i bashkohej UÇK-së dhe ta ndërtonte së bashku me të një ushtri çlirimtare. Prandaj, agjentët e UDB-ës serbe kanë vepruar dhe nxitur kundërthëniet. Vrasja e Ahmet Krasniqit i përmbushi pikërisht këto objektiva serbe.

Lidhur me veprimtarinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kam mësuar më shumë nga Haxhi Berisha i cili kishte lidhje me të bijtë e Ismail Haradinajt: Nasim, Naim dhe Agron Haradinaj, të cilët ishin angazhuar dhe vepronin për masivizimin e UÇK-së.

Ato ditë mësova se radhëve të UÇK-së iu kishte bashkuar edhe Ismet Bicaj, i cili banonte në Karlstad të Suedisë. Ismet Bicaj e kishte lënë të shoqen dhe dy fëmijët e tij në Suedi. I lakmova shumë për aktin e tij të lavdishëm! Ismet Bicaj ishte larguar nga Kosova qysh në vitet 1982-1983 dhe ishte një veprimtarë i devotshëm i luftës sonë për liri dhe çlirim nga zgjedha serbe.

Disa ditë më vonë Ramadan Behramaj më ka njoftuar se ai ishte duke mbledhur ndihma për Fondin "Vendlindja Thërret".

Gjatë kësaj kohe unë kisha kontakte të shpeshta me Hajdin Abazin, por, miku im i Lëvizjes Popullore të Kosovës, nuk më ka folur fare, në fillim, për UÇK-në dhe për kyçjen e tij në radhët e saj!

Hajdin Abazi më ka folur për lidhjet e tij me UÇK-në vetëm pas marrjes së lajmit se unë e kisha njohur atë gjatë një paraqitje të tij në televizionin suedez, si pjesëmarrës i luftimeve në Kosovë dhe si i plagosur në luftime. Në atë rast, Hajdin Abazi, më ka bërë ftesë që t'i bashkohesha edhe unë UÇK-së, por unë i kam thënë jo ofertës së tij me arsyen se unë kisha tre vëllezër që kishin veshur uniformën e UÇK-së dhe se nga shtëpia më kishin thënë që të mos shkoja në Kosovë, tani për tani.

Gjendja në Kosovë po përkeqësohej në mënyrë dramatike. Ushtria dhe policia serbe po e terrorizonte Kosovën dhe popullin e saj. Ushtria Çlirimtare e Kosovës po luftonte me gjithë fuqinë e saj për ta çliruar vendin dhe popullin e saj nga okupatori serb.

Duke pësuar humbje në përballje me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ushtria dhe policia serbe hakmerrej kundër popullsisë së pambrojtur. Masakra e Prekazit, pas qëndresës heroike të Adem Jasharit, masakra e Likoshanit dhe masakrat tjera që bënë ushtria dhe policia serbe kundër popullsisë civile e zgjuan ndërgjegjen e botës dhe bota demokratike angazhoj forcat ajrore të NATO-s kundër makinerisë vrastare të Serbisë.

Koha e bombardimeve të NATO-s, ndërprerjes së lidhjeve telefonike me Kosovën, vrasjeve masive dhe dëbimit të qindra mijëra shqiptarëve nga ana e ushtrisë dhe policisë serbe, kanë qenë momentet nga më të rëndat të jetës sime, në mërgim. Përkundër qëndrimit tim gati gjatë gjithë kohës pranë internetit, televizionit dhe radios, unë nuk merrja vesh asnjë lajm për familjen time dhe njerëzit e mi të dashur.

Në fillim të prillit 1999 Radio Televizioni Shqiptar publikoi fotografitë e televizionit serb dhe atyre të botës në të cilat Ibrahim Rugova dhe Millosheviqi dukeshin gjoja duke biseduar! U bëra tym. Në atë gjendje të rënd në të cilën ndodhej Kosova si rezultat i barbarisë së ushtrisë dhe policisë serbe, isha i sigurt se Ibrahim Rugova ishte detyruar të zhvendosej nga Prishtina në Beograd. Për mua gjithçka ishte inskenim i policisë serbe. Më erdhi keq për Ibrahim Rugovën dhe familjen e tij, sepse për mendimin tim, duke i kidnapuar, Serbia po përpiqej t'i vriste për së gjalli.

Gati një muaj pas ndërprerjes së lidhjeve, vëllai im, Skënderi, më ka marrë në telefon (me një telefon të UÇK-së) dhe më ka njoftuar se deri në ato çaste ai dhe familja ishin gjallë dhe shëndoshë e mirë! Kjo bisedë telefonike, ndonëse e shkurtër, për mua, ka qenë një nga bisedat më të vlefshme që kam marrë gjatë luftës.

Në maj të vitit 1999, Radiotelevizioni shqiptar dha lajmin se në luftë me ushtrinë serbe kishte rënë Ismet Bicaj. Ndonëse Ismet Bicaj i kishte falur jetën lirisë së atdheut të tij, më erdhi keq për shoqen dhe fëmijët e tij në Suedi që tani e tutje kishin ngelur pa më të dashurin dhe të shtrenjtin e tyre.

Ato ditë unë isha lajmëruar dhe regjistruar në listën e vullnetarëve që do t'i bashkoheshin Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ende pa mbaruar të gjitha përgatitjet, Jakup Krasniqi dha urdhëresën që të pushohet me mobilizimin e bashkatdhetarëve tanë që kishin një moshë të caktuar dhe që ishin në marrëdhënie pune.

Disa javë më vonë Ushtria dhe Policia Serbe detyrohen të kapitullojnë dhe nënshkruhet Marrëveshja e Kumanovës.

Me 12 qershor 1999, në televizor pashë skena biblike të kthimit të shqiptarëve në vatrat e tyre, largimin e ushtrisë dhe policisë serbe nga Kosova , zbritjen nga malet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe hyrjen e forcave tokësore të NATO-s në Kosovë.

Udhëtimi im i parë në Kosovën e çliruar nga pushtuesi serb

Falë qëndresë së popullit tonë, luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bombardimeve të NATO-s, Kosova u çlirua nga pushtimi serb. Shqiptarët e dëbuar u kthyen në vatrat e tyre stërgjyshore.

Disa ditë më vonë bëra edhe bisedën e parë telefonike me familjen time në Kosovë. Më thanë se ishin të gjithë gjallë, se fshati ishte djegur i tëri dhe familja ime ishte vendosur në fshatin Lumi i Madh.

Në fillim të korrikut bëra një bisedë me shoqen time, Florien dhe fëmijët e mi Albanin, Gentën dhe Mimozën dhe u tregova se kisha vendosur ta vizitoja Kosovën.

Ditën kur do të udhëtoja, trageti Malmo- Kopenhagë u vonua, gati një orë e gjysmë. "Fatbardhësisht" edhe aeroplani u vonua nëntë orë! Nga Kopenhaga në Lubjanë, fluturuam në mbrëmje, ndërsa në Shkup ateruam diku pas mesit të natës.

Përqafimi i nënës në Kosovën e lirë

Natën e kalova në Aeroportin e Shkupit. Në mëngjes e mora një taksi dhe u nisa drejtë pikës kufitare *Hani i Elezit.* Vendkalimi Maqedoni-Kosovë kontrollohej nga ushtarët e NATO-s. Pas kontrollimit të pasaportës kalova në territorin e Kosovës dhe u nisa në këmbë drejtë Hanit të Elezit. Një çun i ri me një karrocë më ndihmoi ta bartja bagazhin deri tek qendra e Hanit të Elezit. Para një kafeje të ulur i gjeta tim atë, motrën time Arifen dhe vëllanë tim Skënderin të cilin po e takoja për herë të parë pas mbi gjashtëmbëdhjetë vitesh, e që sapo kishte hequr nga trupi rrobat e ushtarit të UÇK-së, pas më shumë se dy vite lufte kundër pushtuesit serb. Në ato çaste isha njeriu më i lumtur i botës!

Së bashku me tim atë, motrën time Arifen dhe vëllanë tim Skënderin, diku afër mesit të ditës arritëm në fshatin Lumi i Madh, ku familja ime ishte strehuar përkohësisht. Takimi me nënën time, motrat dhe vëllezërit ishte shumë emocional dhe prekës. Më dukej vetja sikur të isha i dehur. Nuk dija se çka të flisja e as se për çka të flisja së pari. Prindërit ishin afruar moshës së pleqërisë, por ndjeheshin mirë me shëndet. Motrat dhe vëllezërit ishin rritur. Shtëpisë ju kishte shtuar edhe kunata ime, Shyhrejta dhe dy fëmijët e saj dhe të Skënderit: Albioni dhe Majlinda, të cilët po i shija për herë të parë. Në Kosovë i gjeta edhe kunatën time, Luljetën dhe fëmijët e saj dhe Shabanit: Arbëroren, Fitoren, Meritonin dhe Ardianin.

Në Lum të Madh jam takuar për herë të parë edhe me kushërinjtë dhe të afërmit tjerë që gjithashtu ishin duke banuar aty.

Shtëpia e djegur

Të nesërmen, menjëherë pas ngrënies së mëngjesit, së bashku me Skënderin jemi nisur në këmbë për Mihaliq, vendlindjen time të shtrenjtë. Kaluam nëpër vigë, aty ku bashkohen lumenjtë Silnica e Llap dhe një pjesë e Rrafshit të Kosovës. Tek *udha e pampurit* (hekurudha Mitrovicë-Fushë Kosovë) e kam takuar bacën Selman. i cili kishte zbritur nga fshati dhe po e kosiste një livadh. Baca Selman nuk më njohu dhe kur ju afrova afër më quajti Shaban. Pas përshëndetjes dhe përqafimeve me mua, baca Selman i lëshoi një rrufe të sharash kundër policisë dhe ushtrisë serbe që e kishin djegur fshatin:

– Po të poshtër e të pabesë ishin kanë! Na kanë bërë shkrumb, o Asllan! – më tha baca Selman.

– Shëndoshë, o baca Selman, se shtëpitë i ndërtoni edhe më të bukura se ato që i keni ndërtuar më parë!– e ngushëllova bacën Selman.

Po thuajse të gjitha shtëpitë e fshatit ishin të djegura dhe të plaçkitura nga ushtria dhe policia serbe. Në këmbë kishin ngelur vetëm oxhaqet dhe muret e shtëpive dhe i kishin dhanë fshatit një pamje të tmerrshme.

Sheremet Saraçi– me pushkë e penë për liri

Në fshat ishin kthyer vetëm disa kryefamiljarë dhe ata ishin vendosur nëpër bodrume që kishin shpëtuar pa u djegur. Disa të tjerë, mësova se vinin gjatë ditës dhe bënin përpjekje t'i meremetonin shtëpitë e tyre, para dimrit që shumë shpejtë mund të trokiste në derë.

Bagëtitë e fshatarëve të mi kishin ngelur pa të zotët e tyre dhe shumë prej tyre ishin vrarë dhe kishin ngelur nëpër ara. Arat ishin të pakorrura e livadhet e pa kositura...

Shtëpia jonë ishte djegur, ashtu s'i të gjitha shtëpitë tjera të fshatit. Kishte shpëtuar një pjesë e sofrës së bukës, saçi, sanxhaku dhe lagraçi. Traktori, gjithashtu kishte shpëtuar sepse Skënderi e kishte fshehur në pyllin e fshatit sepse policëve serbë nuk ua kishte mbajtur të kërkonin atje. Edhe kroin e ujit që e kishim para derës së shtëpisë e kishin thyer, policët serbë dhe serbët e Prelluzhës. Djegien e shtëpisë sime dhe fshatit tonë e kisha parë në RTSh, që kishte emituar një reportazh të CNN-it. Ndjeva një dhembje të madhe kur mësova se serbët kishin plaçkitur gjithçka kishin gjetur në shtëpi, por se ata kishin gjetur dhe marrë me vete edhe fotografitë e shtëpisë dhe aparatin e markës Kodak që e kisha dhuratë nga Jusuf Gërvalla dhe që familja ime e kishte fshehur së bashku me fotografitë nën një grumbull gurësh në oborr.

Përkundër dëmit të madh material dhe psikologjik, fatbardhësisht, siç mësova nga Skenda, në fshatin tonë nuk kishte asnjë banorë të vrarë. Skenda me tha se, kishte dëgjuar se, e bija e Azem Mustafës së bashku me të shoqin e saj, ishte e zhdukur dhe nuk dihej se cili ishte fati i tyre.

Disa ditë më vonë e kam takuar Xhemajl Pllanën, i cili kishte zbritur nga mali dhe kishte hequr uniformën e ushtarit të UÇK-së dhe nga Qeveria e Përkohshme ishte emëruar kryetar i Komunës së Vushtrrisë. Edhe Xhemën po e takoja për herë të parë që nga viti 1983. Xhemajl Pllana dhe Selvete Grajçevci kishin tre fëmijë.

Pranverë 1999, në malin e Qyqavicës. Nga e majta: Bekim Selmani, Xhemajl Pllana, Skënder Muharremi dhe Ejup Thaçi

Nga shokët tjerë e kam takuar edhe Sheremet Saraçin, i cili, gjithashtu, ishte rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës së bashku me dy bijtë e tij: Kujtimin dhe Gëzimin. Kujtimi ishte plagosur rëndë dy herë gjatë luftës.

Radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ju kishte bashkuar edhe Safet Murati, i biri i *Hoxhës së Vogël*, të cilin e gjeta së bashku me familjen e tij në fshatin Gllavotinë.

Me pushkë në dorë kishte luftuar në radhët e UÇK-së, Zona Operative e Shalës edhe Rexhep Ahmeti së bashku me të vëllanë e tij, Muhametin.

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ju kishte bashkuar edhe Ilir Mirena, djali i dajës Isë. Daja Isë dhe familja e tij, për shkak të djegies së fshatit Hade, ishte zhvendosur në Prishtinë.

Vëllai im Skënderi më ka njoftuar se togu i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Mihaliq, në fund të luftës çlirimtare, ka numëruar 42 ushtarë dhe se në mesin e tyre kanë qenë dhe tre vëllezërit e mi (Skënderi, Muharremi dhe Avniu).

Gjatë qëndrimit në shtëpi, prindërit e mi më kanë njoftuar, se policia serbe i kishin vrarë, në shtëpinë e tyre në fshatin Hade, të birin e dadës Halë, Ajet Mirenën së bashku me të birin e tij, Fitimin dhe nipin Milaimin. Ndjeva dhembje të madhe për ta dhe zemra m'u bë pelin!

Rexhep Ahmeti, ushtar i orëve të para i UÇK-së.

Nëna më tregoi se si policia serbe e kishte vrarë burrin tezës Vahije, Rexhep Konjuhun, në prani të saj dhe fëmijëve, gjatë masakrës së Studimës së Vushtrrisë. "Rexhep Konjuhi ka qenë në kolonë së bashku me familjen dhe shumë familje të tjera dhe policët serbë e kanë nxjerrë nga kolona dhe e kanë pushkatuar, para syve të fëmijëve dhe prindërve të tij,-më tha nëna- Edhe 19 kushërinj të mi në Fushë Kosovë i kanë vrarë,- vazhdoi nëna!"

Nga nëna mësova se në mesin e të vrarëve ishte edhe Hamdi Mirena, moshatari im dhe shoku e daja im i vegjëlisë me të cilin unë shoqërohesha luaja sa herë i vizitoja dajat në Hade.

Gjatë dhjetë ditëve sa do të qëndroja në Kosovë e kisha ndërmend ta vizitoja edhe familjen e shoqes sime në fshatin Cerrcë, në Komunën e Istogut.

Një mëngjesi morëm rrugën për Cerrcë. Kudo nga Mihaliqi, Vushtrria, Mitrovica e gjer në Istog shiheshin shtëpitë e djegura dhe gjurmët e luftës. Ashtu

si në Mihaliq, që pashë një tank të ushtrisë serbe të shkatërruar nga UÇK-ja, edhe në afërsi të Istogut pashë tri tanke tjera të shkatërruara nga NATO-ja.

Në fshatin Cerrcë shkova së bashku me prindërit e mi dhe Skënderin. Na priten vjehërri dhe vjehrra (Kamer dhe Salë Rexhaj) me familjen e tyre, që sapo ishin kthyer nga Mali i Zi, ku ushtria dhe policia serbe i kishte detyruar të kalonin në këmbë dhe nëpër male me borë dhe të qëndronin në Ulqin për disa javë gjersa mori fund lufta në Kosovë.

Nga familja e Flories unë kisha takuar vetëm të atin e saj, Kamerin, të vëllanë Reshatin dhe të motrën, Fetijen. Të gjithë anëtarët tjerë të familjes po i shihja dhe njihja për herë të parë, pas dhjetë vitesh martesë me të bijën e tyre.

Nga kunati im Hysen Daka, të cilin gjithashtu po e shihja për herë të parë, mësova edhe për veprimtarinë e Ismet Bicajt gjatë luftës çlirimtare në rrethin e tyre dhe së bashku shkuam tek varri i tij dhe i vumë një tufë me lule që unë i mblodha aty pari.

Një ditë gjersa po bisedoja dhe po bëhesha gati të kthehesha në Suedi, nëna ime, e mërzitur se më kaluan ditët dhe më duhej të kthehesha në Suedi më tha:

– Mjaft ke qëndruar, atje larg! Merre familjen dhe kthehu edhe ti në Kosovë; se edhe këtu ka bukë për ty!

Gati ia plasa vajit, por u përmbajta.

– **Do të kthehem nënë,-** i thashë dhe mendja me shkoi tek titulli i një poezie të Jusuf Gërvallës që përmbante, gjithashtu, këtë premtim.

U largova nga Kosova dhe u ktheva në Suedi me mbresa të përziera. Kosova ime e dashur ishte lënduar rëndë nga dora gjakatare e pushtuesit serb, por ajo ishte e lirë dhe pa thundrën e pushtuesit gjakatar. Në popull, si asnjëherë më parë, ishte kthyer buzëqeshja. Kosova ime e shtrenjtë po hidhte themelet e shtetit të së drejtës dhe demokracisë së vërtetë.

SHËNIME

1. **Le të piqen pemët kur të kesh ardhur serish...** Është marrë nga poezia "Bekimi i nënës" e shkruar nga Jusuf Gërvalla.
2. *Shiftari*- shprehje përbuzëse për shqiptarët që përdorej nga serbët. *Shiftari,* quheshin sharrëxhinjtë dhe punëtorët që bënin punë fizike, si hapjen e kanaleve dhe punëve tjera të rënda në Beograd.
3. *Dardha e ka bishtin prapa.* Fjalë e urtë.
4. *Zemlak.* Në serbisht do të thotë vendas apo bashkatdhetar.
5. *Varri i Kangjallozit.* Kështu quhej vendi ku gjendej varri i konsullit rus që u vra nga forcat kryengritëse shqiptare të udhëhequra nga Isa Boletini.
6. *Libar.* Kështu quhet fusha në mes lumenjve Silnica e Llap dhe në mes fshatrave Lumi i Madh, Stanovcë dhe Prelluzhë.
7. *Degergjik.* Lojë cicmic.
8. *Oda e madhe.* Kështu quhej dhoma e burgut të Mitrovicës. Oda e madhe më parë kishte qenë bodrum thëngjilli, por që gjatë demonstratave të pranverës së viti 1981 ishte përshtatur si dhomë burgu.
9. *Artakollit.* Fshatrat rrëzë malit të Qyqavicës. Shtatë fshatra konsiderohen si fshatra të kësaj zone.
10. *"Të gjitha aftësitë e mia fizike, psikike dhe materiale do t'i vë në shërbim të popullit dhe do të jem shumë i lumtur po që se flijohem për çlirimin e Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare dhe bashkimin e tyre me Nënën Shqipëri".* Teksti i betimit që praktikohej kur bëhej pranimi i anëtarëve të rinjë në organizatën LNÇKVShJ-së. Teksti është hartuar nga Sabri Novosella.
11. *Guten tag. Kan ich schprehen mitt Herr Gërvalla, bitte? Ein moment, bitte!(* Teksti i mësuar përmendësh). Mirë dita. A mund të flas me zotin Gërvalla, ju lutem? Një moment, ju lutem!
12. *Shkrimi"Tetë kërkesat e parevokueshme të LNÇKVShJ-së"* është marrë nga numri i parë i organit "Zëri i Kosovës".
13. *Gjyteti*- Një kodër në formë hinke në mes të pyjeve të Cërrnushës, ku ndodhen edhe muret e një kështjelle shumë të vjetër. Banorët e Cërrnushës e quajnë këtë vend Gjytet. Në fund të kodrës dhe afër një përroi e një shpelle të vogël, e cila nga banorët quhet *Birat e Kishës (* banorët e thërrasin shpellën birat e kishës, në shumës)!
14. *Batallakut*- Ara përballë shtëpisë sonë në të cilën dikur ka pasur shumë pemë të moçme, qindravjeçare, prej të cilave kanë ngelur vetëm dy dardha ujce, nga na është quajtur *batallak.* Gjatë hapjes së një kanali të ujit, vëllai im Skënderi ka gjetur disa mbetje të disa enëve shumë të vjetra të baltës. Ndoshta *batallaku* është ndonjë vendbanim shumë i vjetër?
15. *E, sinko moje...* serbisht. E, biri im.
16. *Eto propala republika...* serbisht. Pa shiko, e patë puna e republikës!
17. *Cerebellum...* latinisht. Truri i vogël.
18. *Imas pametnog oca!* Serbisht. E paske të zgjuar të atin!
19. *Rrema.* Emri përkëdhelës i vëllait tim, Muharremit.
20. *Nushi.* Emri përkëdhelës i vëllait tim, Avniut.
21. *Skënda.* Emri përkëdhelës i vëllai tim, Skënderit.
22. *Livadhi i ukut*- Kështu quhej kopshti me pemë në Cërrnushë.
23. *Sokaku qorr*- Kështu quhet një rrugë në fshatin tonë.
24 *Rexhep Muja*- Gjatë kohës sa isha në ilegalitet kam dëgjuar tri histori që i çjerrin maskën figurës së tij. *E para,* nga një shok kam dëgjuar se disa ditë pas arrestimit të Vehbi Mujës dhe gjersa të bijat e Qerim Mujës, po e fshinin shtëpinë, në dhomën e

ditës, nën televizor, ato kishin gjetur një ekzemplar të "Zërit të Kosovës". Sapo ua sheh në dorë motrave organin e ndaluar, Rexhep Muja, ngritët nga kolltuku ku ishte i ulur, i drejtohet të atit të tij (Qerimit) me një "dhe po thua se s'ka bërë gjë" dhe e merr "Zërin e Kosovës" dhe e dërgon në Stacionin e Policisë në Gllogovcë; *e dyta*, nga një shok nga Drenica kam dëgjuar se Rexhep Muja, disa herë është parë, duke u shoqëruar me Ajet Istogun, Shefin e UDB-ës së Gllogovcit dhe *e treta*, se Rexhep Muja është parë duke u futur në Stacionin e Policisë në Vushtrri dhe duke u shoqëruar me Enver Maxhunin dhe Zeqir Sadriun!

25 *Babic Janko*- Emri dhe mbiemri i pasaportës së falsifikuar që kishte fotografinë time gjatë largimit nga Kosova.

26 *Benum arnavut*- turqisht. Unë jam shqiptar.

27 *Evet,evet tetovali*- turqisht. Ashtu, ashtu, tetovar.

28 *Shtëpia e madhe*- Kështu i quanim ambasadat shqiptare gjatë komunikimit me njëri-tjetrin.

29 ...*bajrak*... turqisht. Flamur.

30 *Dovidjenja*- serbisht. Mirupafshim!

31 *Auf Wiederschen*- gjermanisht. Mirupafshim!

32 ...*liberté, égalité, fraternité*- frëngjisht, Liri, barazi, vëllazëri!

33 *Les miserables*- frëngjisht. Të mjerët (titulli i librit të famshëm të Viktor Hygos).